



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

“Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë e aktivitetit ekonomik dhe financiar”.

Qershor 2018

Tiranë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

NR	PËRMBAJTJA	Faqe
I	HYRJA (Të dhëna mbi Raportin e auditimit) a. Objektivat e qëllimit b. Identifikimi i çështjes c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese d. Përgjegjësitë e audituesve e. Kriteret e vlerësimit f. Standardet e auditimit	2-5
II	Përshkrimi i auditimit <i>1. Auditimi i llogarive vjetore të administratës së institucionit për vitin 2016.</i> <i>2. Auditimi i zonave të llogarisë.</i> <i>3. Krijimi dhe përdorimi i ardhurave.</i> <i>4. Vlerësimi i auditimit të brendshëm dhe funksionimi i sistemeve të menaxhimit financiar.</i> <i>5. Të tjera çështje dalë gjatë auditimit.</i>	6-118
III	Gjetjet dhe rekomandimet.	119-125
IV	Konkluzione dhe opinioni i auditimit.	126-129
V	Dokumente shoqëruese.	



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

I. Hyrje

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 1,264/2, datë 14.12.2017 miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 4.1.2018 deri në datë 28.2.2018, në subjektin Ministria e Kulturës (këtu e në vazhdim MK) Tiranë, u krye auditimi i përputhshmërisë me objekt “Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet “ nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. Fatmir Zilja Përgjegjës Grupi
2. Miranda Haxhia Auditues
3. Bruna Zeneli Auditues
4. Alkida Llakaj Auditues
5. Erjola Meçaj Auditues

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë e aktivitetit ekonomik dhe financiar të MK, duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore, në menaxhimin financiar dhe kontrollin, në hartimin dhe zbatimin e buxhetit, në miratimin e respektimin e strukturës organike dhe të nivelit të pagave sipas klasifikimit të funksioneve, në organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, në administrimin e vlerave materiale e monetare, në prokurimin e fondeve publike etj.

a. Titulli. “Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet “.

b. Marrësi. Ministria e Kulturës.

c. Objektivat dhe qëllimi.

Objektivi i auditimit të KLSH është dhënia e një opinioni objektiv dhe të pavarur, mbi zbatimin korrekt dhe me paanshmëri për shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave ligjeve, rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave kushteve mbi të cilat është rënë dakord.

Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Raportimi i deviacioneve ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre.

Auditimi jonë ka për qëllim **promovimin e transparencës** duke ofruar raporte te besueshme mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik dhe financiar të MK në respektim të kuadrit ligjor rregullator në fuqi. *Gjithashtu auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysht rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (sipas ISSAI 400, p 18).*

d) Identifikimi i çështjes.

Referuar çështjeve të audituara të cilësuar më sipër, objektivi kryesor është dhënia e një opinioni nëse misioni i këtij institucioni është realizuar në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, nëse fondet e përdorura në funksion të veprimtarisë institucionale janë shpenzuar në përputhje me dispozitat ligjore.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

e. **Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim.**

f. **Përgjegjësitë e audituesve.** Janë për dhënien e opinionit mbi *ligjshmërinë dhe rregullshmërinë*, e vlerësimit nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet (ISSAI 100, ISSAI 400, 4000, 4,100 etj), në vijim të të cilave, është dhënë opinion sipas çështjeve që janë audituar.

g. **Kriteret e vlerësimit.**

-Kushtetuta e Shqipërisë, neni 162-163

-Ligji nr 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

Rregullore e procedurave të auditimit në KLSH, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 107, datë 08.8.2017,

-Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

-VKM 709, datë 24.10.2012 “Për procedurat e financimit të projekteve dhe veprimtarive artistike ...” .

-VKM nr.914/2014, legjislacioni bazë e detyësor, dhe/ose dispozita të tjera, si dhe kriteret e tjera që janë përdorur dhe iu janë referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.

h. **Standardet e auditimit** të aplikuara në kryerjen e punës janë:

-Standardet INTOSAI-t (ISSAI 100, 400, 4000, 4100 etj.).

-eksperienca në terren (MK).

Subjekti i audituar: Ministria e Kulturës.

Misioni i MK: Në përputhje me drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe me programin e Këshillit të Ministrave, ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

- Harton, programon dhe zhvillon politikat kombëtare të kulturës, të trashëgimisë kulturore, materiale dhe shpirtërore, të rritjes së tolerancës fetare e të dialogut kulturor dhe integritit kulturor në familjen, evropiane dhe botërore, në përputhje me programin e qeverisë së Republikës së Shqipërisë .

- Harton dhe bashkërendon punën për politikat në fushën e artit e të kulturës nëpërmjet edukimit të popullsisë, rritjes së vlerave dhe trashëgimisë kulturore, nxitjes së investimeve, publike dhe private, në këta sektorë, monitorimit të mënyrës së përdorimit të fondeve publike në mbështetje të zhvillimit kulturor, edukimit në kulturë, mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, ruajtjes dhe vijimësisë së traditës së harmonisë fetare në kulturën shqiptare, si dhe të bashkëpunimit rajonal.

-Harton politikat, mbrojtëse dhe promovuese, për trashëgiminë kulturore, materiale ose shpirtërore, si dhe krijon hapësirat e nevojshme, ligjore e mbështetëse, për ruajtjen e kultivimin e kulturës së shkruar, për krijimtarinë artistike në përgjithësi, si dhe për të promovuar arritjet e kulturës shqiptare e për të rritur konkurrencën e produktit shqiptar kulturor përtej kufijve.

- Harton politika për ekzistencën e Shqipërisë si një partner aktiv në organizatat ndërkombëtare, evropiane dhe rajonale, në fushën e artit e të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore, nëpërmjet aderimit në institucionet përkatëse.

-Udhëheq, programon dhe mbështet veprimtaritë, kombëtare e ndërkombëtare, me qëllim identifikimin dhe zhvillimin e tendencave kulturore, artistike dhe letrare, brenda vendit, si



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

dhe përfshirjen e ballafaqimin e vlerave më të mira kombëtare me ato rajonale, si ato të trashëguara dhe ato bashkëkohore dhe për krijimin e një hapësire dialogu mbarëshqiptar dhe të diversitetit kulturor.

- Nëpërmjet strukturave të varësisë realizon regjistrimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të autorëve dhe të të drejtave të tjera, të lidhura me të, nga subjektet, persona fizikë/juridikë, privatë a publikë, përdorues të pronësisë letrare, artistike e shkencore.
- Kryen funksione dhe veprimtari të tjera në përputhje me ligjin.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

II. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. AUDITIMI I LLOGARIVE VJETORE TË ADMINISTRATËS SË INSTITUCIONIT PËR VITIN 2016

Sipas Programit të Auditimit nr. 1264/2, datë 14.12.2017, është audituar planifikimi dhe zbatimi i buxhetit të Ministrisë së Kulturës për vitin 2015, 2016 dhe 2017. Për auditimin e kësaj pike grupi i auditimit është mbështetur në:

- VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore si dhe njësisve që varen prej tyre”;
- Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 14 datë 28.12.2006 “Për përgatitjen e pasqyrave financiare të organeve qendrore, organet e Pushtetit vendor dhe njësisve që varen prej tyre si dhe të Njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”, me ndryshime;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” me ndryshime;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 25, datë 28.12.2016 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të vitit 2016”.

Konstatim: Baza ligjore mbi përgatitjen e pasqyrave financiare nuk ka pësuar rregullimet e nevojshme, pasi aktet nënligjore i referohen VKM-ve të dala në zbatim të një ligji të shfuqizuar, konkretisht ligjit nr. 7661, datë 19.01.1993 “Për kontabilitetin”. Kështu udhëzimi nr. 14, datë 28.12.2006 dhe nr. 26, datë 27.12.2007 i referohen VKM nr. 248, datë 10.04.1998, si dhe ligjit nr. 7661 datë 19.01.1993 “Për kontabilitetin”, ligj i cili është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

1.1. Zbatimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë në përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raportimit, respektimi i afateve.

Për vitin 2016, llogaritë vjetore të MK-së janë mbyllur në zbatim të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 25, datë 28.12.2016 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të vitit 2016” Kapitulli V “Rakordimi dhe mbyllja e llogarive të tjera të qeverisjes së përgjithshme” pika 32 ku përcaktohet: “Rakordimi, mbyllja e llogarive të tjera të njësisve të qeverisjes së përgjithshme dhe hartimi i pasqyrave financiare **do të vazhdojë të kryhet në bazë të udhëzimit nr. 14, datë 28.12.2006 dhe udhëzimit nr. 26, datë 27.12.2007 ndryshuar me udhëzimin nr. 10, datë 27.02.2008**”.

Paraqitja e pasqyrave financiare është bërë sipas formateve të miratuara nga Ministria e Financave dorëzimi i saj është bërë brenda afateve të përcaktuara, si dhe klasifikimi i shpenzimeve është kryer sipas nomenklaturës së llogarive të planit kontabël publik.

- Plotësimi i pasqyrave financiare është paraqitur qartë dhe veçmas, bazuar në Udhëzimin nr. 14, datë 28.12.2006, ndryshuar me Udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007.

-Janë plotësuar të gjitha pasqyrat financiare dhe relacioni shpjegues i tyre;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

- Para mbylljes së llogarisë vjetore është kryer inventarizimi i përgjithshëm i pasurisë, në zbatim të procedurave, rregullave të parashikuara në Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime.
- Janë inventarizuar të gjitha kërkesat debitore dhe detyrimet kreditore ndaj të tretëve, llogaritë analitike përputhen me ato sintetike.
- Është kryer përlllogaritje e amortizimit të AQT të trupëzuara. Për pajisjet elektronike është aplikuar norma e amortizimit në masën 25 %, parashikuar në udhëzimin nr. 14 datë 28.12.2006, Kreu II “Procedurat e përgatitjes dhe mbylljes së llogarive vjetore të vitit 2006”, Kapitulli 1 “Procedura të përgjithshme”, si dhe në normat e përcaktuara në VKM nr. 401/1989.
- Janë mbajtur me Degën e Thesarit Tiranë akt-rakordimet përkatëse mbi shpenzimet dhe të ardhurat.
- Janë kryer veprimet e mbylljes
- Pasqyrat financiare janë firmosur nga Shefe e Sektorit të Financës znj. Marjana Braholli, në cilësinë e hartuesit të pasqyrave financiare, nga Drejtori i Drejtorisë së Financës z. Sh. Sh. në cilësinë e NZ, Sekretari i Përgjithshëm znj. E. K. në cilësinë e NA si dhe është vulosur dhe firmosur nga specialisti i Degës së Thesarit Tiranë, në përputhje me ligjin për MFK.

Sa më sipër arrijmë në konkluzionin që: Ministria e Kulturës, nga ana formale, në paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe afatet e dorëzimit të tyre, ka zbatuar kriteret e paracaktuara në udhëzimin nr. 14, datë 28.12.2006 me ndryshime dhe udhëzimin nr. 25, datë 28.12.2016 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të vitit 2016” Kapitulli V “Rakordimi dhe mbyllja e llogarive të tjera të qeverisjes së përgjithshme”, etj.

1.2. Nga auditimi i paqyrave financiare rezultoi

Pasqyra 1 aktivi dhe pasqyra 2 pasivi i bilancit, janë të plotësuara dhe rakorduar në vlerën totale 1,516,521,719 lekë, si dhe janë të përputhura me llogaritë analitike. Është pasqyruar ushtrimi i paraardhës.

Aktivi i bilancit (pasqyra 1).

AQT të pasqyruara në postin A të aktivit të bilancit janë të kuadruara me AQT e pasqyruara në pasqyrën 6 (me vlerë bruto), duke zbritur amortizimin. Pasqyrimi i tyre është bërë me vlerën e mbetur. Amortizimi është përlllogaritur sipas klasifikimit dhe normave të përcaktuara (pajisjet IT-25 % të vlerës së mbetur, ndërtesa konstruksione me 1%, inventari ekonomik me 3 %). Ndryshimi i gjendjes së llogarisë 219 “Amortizim i AQT” në shumën 197,266,806 lekë, përputhet me vlerën e amortizimit për vitin 2016 në shumën 197,266,806 sipas pasqyrës nr. 7.

Aktivet qarkulluese të pasqyruara në postin B të aktivit të bilancit, janë në shumën 135,538,772 lekë dhe pasqyrojnë gjendjen e llogarive të mëposhtme:

-Llogaritë e klasës 3 “Gjendja e inventarit” e cila është pakësuar për shumën 1,512,831 lekë. Ndryshimi i gjendjeve të inventarit, përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit (pakësim) nga periudha e mëparshme (30,364,967-31,877,798) = -1,512,831 lekë, e barabartë me gjendjen e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve”.

-Llogaritë e klasës 4 “Kërkesa arkëtimi mbi debitorët” në shumën 80,502,678 lekë, ndërsa llogaritë e klasës së 4 “Detyrime afatshkurtra në pasiv të bilancit” të cilat paraqiten në shumën 154,374,651 lekë. Diferenca 73,871,973 lekë, përfaqëson: shumën e llogarisë 466



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

“Kreditorë për mjete në ruajtje” në shumën 17,880,405 lekë dhe shumën e llogarisë 401-408 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në shumën 55,991,568 lekë (investime të kryera dhe të pa likuiduara), në total 73,871,973 lekë.

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” në vlerën 46,955,443 lekë përfaqëson detyrimeve afatshkurtra të pasqyruara në pasiv të bilancit konkretisht: llog. 401-408 në shumën 13,575,759 lekë; llog.42 “Personeli dhe llogari të lidhura me to” në shumën 4,504,721 lekë përfaqëson pagat e muajit dhjetor; llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa” në shumën 455,943 lekë; llog.435 “Sigurime shoqërore” në shumën 1,487,051 lekë; llog.436 “Sigurime shëndetësore” në shumën 195,600 lekë dhe llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” në shumën 26,736,369 lekë, në total 46,955,443 lekë.

Në llog.468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitet në vlerën 23,152,848 lekë, debitorë të mbartur prej vitit 2006, të cilët në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Nr	Debitorët	Vlera
1	Expo Hanover 2000	2,782,643
2	Gjykata e Rrethit Tiranë	252,840
3	Terma Engenering	1,114,110
4	TBU Tirana	10,930,000
5	Alba TV	7,999,755
6	Global shpk	93,500
7	Totali analitike	23,172,848
8	Sintetike	23,152,848
9	Diferenca	20,000

Burimi i informacionit: MK
Punoi: KLSH

Në aktiv, llogaria 423,429 “Personeli, paradhënie deficite e gjoba” paraqitet në shumën 10,394,387 lekë. Gjendja debitore është ë përbërë nga paradhënie të pakthyera në vite, duke filluar prej vitit 2003, dhe përbëhet si më poshtë:

Nr	Lloji monedhës	Vlera në monedhe të huaj	Vlera në lekë
1	Euro	57,887	7,556,848
2	DM	3,204	227,003
3	USD	18,400	2,610,536
4	Totali		10,394,387

Burimi i informacionit: MK
Punoi: KLSH

Në aktiv, Gjendja e llogarisë 512 “Llogari në bankë” paraqitet në vlerën 0 lekë.

Në aktiv, llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet në vlerën 24,670,989 lekë dhe përfaqëson, vlerën e mjeteve në ruajtje llogaria 466 në shumën 17,880,425 lekë dhe vlerën e sponsorizimeve të cilat do të trashëgohen në vitin 2017, në shumën 6,790,584 lekë, pasqyruar në llogarinë 85 “Rezultati i ushtrimit”, në pasiv të bilancit. Këto veprime janë në përputhje me udhëzimin nr. 14, datë 28.12.2006 kapitulli “Procedura për veprimet e mbylljes së llogarive”.

Në aktiv, llogaria 531 “Llogari në arkë” paraqitet në shumën 138 lekë dhe përfaqëson gjendje në arkën në lekë valutë.

Pasivi i bilancit (pasqyra 2):

Pasi A i pasivit të bilancit paraqitet në shumën 1,355,356,484 lekë, e barabartë me gjendjen e AQT në shumën 1,324,991,379 lekë + gjendjen e inventarit në shumën 30,364,967 lekë + gjendje në arkë 138 lekë, në total 1,355,356,484 lekë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Posti B i pasivitet "Detyrime" paraqitet në shumën 154,374,651 lekë, ndërsa shuma e llogarive të klasës së 4 "Kërkesa arkëtimi mbi debitorët" të postit B të aktivitet është 80,502,678 lekë. Diferenca 73,871,973 lekë, përfaqëson: shumën e llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" në shumën 17,880,405 lekë dhe shumën e llogarisë 401-408 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" në shumën 55,991,568 lekë (investime të kryera dhe të pa likuiduara, llog 404).

-Llogaritë 421, 431, 435, 436, përfaqësojnë detyrimet e muajit dhjetor për paga, sigurime, tatim mbi të ardhurat.

-Llogaria 4341 "Të tjera operacione me shtetin kreditor" në shumën 33,547,235 lekë i korrespondon në aktiv të bilancit llogarive të klasës 4 "Kërkesa arkëtimi mbi debitorët", konkretisht gjendjes së llogarisë (423,429) në shumën 10,394,387 lekë dhe gjendjes së llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" në shumën 23,152,848 lekë, në total 33,547,235 lekë.

-Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" në shumën 69,567,327 lekë, përfaqëson detyrime ndaj 143 subjekteve për fatura të pa likuiduara në vlerën 13,575,759 lekë, nga të cilat gjatë vitit 2016 është shtuar vlera 446,880 lekë kundrejt subjektit "P". Kjo llogari është mbajtur në mënyrë analitike dhe vlera totale e tyre kuadron me llogarinë sintetike në pasiv të bilancit.

Në këtë llogari janë pasqyruar edhe detyrimet kundrejt subjekteve për blerje pajisje, por të pa likuiduara (llog. 404) në vlerën 55,991,568 lekë.

Gjetje nga auditimi:

Situata:

Sipas llogarive analitike të furnitorëve llog. (401-408) dhe kreditorëve të ndryshëm llog. (467) rezultojnë:

Emertimi	Llogaritë		
	401-408	404	401-408 & 404
Vlera totale	13,575,759	55,991,759	69,567,327

Shuma në total e dy llogarive analitike të paraqitura në tabelë (401-408) në vlerën 69,567,327 lekë është e barabartë me llog. 401-408 të paraqitur në pasivin e bilancit në shumën 69,567,327 lekë dhe që pasqyron detyrimet e institucionit për shpenzime të kryera por të palikuiduara, të cilat duhet të pasqyrohen në llogarinë 4342 "Marrëdhënie me shtetin debitor", llogari e cila pasqyron detyrimet buxhetore, të lindura por të pa likuiduara. Në bilanc shuma prej 13,575,759 lekë ka si kundërparti llog 4342 "Të tjera operacione me shtetin (debitor)", ndërsa 55,991,759 lekë, ka si kundërparti në aktiv të bilancit kontabël llogarinë 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" llogari e cila përfaqëson likuidim (parapagesa) për shpenzime të pakryera që ju përkasin periudhave të ardhshme.

Kriteri:

Udhëzimi nr. 14, datë 28.12.2006, Kapitulli III "Shpjegime lidhur me përmbajtjen dhe plotësimin e pasqyrave financiare", Aktivi i bilancit kontabël, ku cilësohet se: "Llogaria 486 përfaqëson shpenzime për blerje dhe shërbime, realizimi faktik i të cilave ndodh në ushtrimin e ardhshëm (shpenzime të parapaguara), si psh. Qira të paguara në avancë, prime të sigurimeve për rreziqe të paguara në avancë etj".

Ndikimi/efekti:

Mos pasqyrim i saktë i detyrimeve të shtetit për fatura të pa likuiduara.

Shkaku:

Kontabilizim i gabuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Rëndësia e shkëljes:

E ulët

Rekomandimi:

Nëpunësi Zbatues të marrë masa për kryerjen e sistemimit kontabël, pasqyrimin e drejtë të kundërpartisë së llogarisë pasive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në aktiv të bilancit kontabël, në llogarinë 4342 “Të tjera operacione me shtetin, debitor”.

Pasqyra e shpenzimeve dhe të ardhurave (pasqyra 3)

-Të ardhurat: Grant korent i brendshëm llog.720 në shumën	291,595,935 lekë
-Nga i njëjti nivel qeverisje llog.7200 në shumën	246,061,397 lekë
-Financim i pritshëm nga buxheti llog.7206 në shumën	19,803,008 lekë
-Sponsorizime nga të tretë	25,731,530 lekë

Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet (pasqyra 4). Në këtë pasqyrë janë pasqyruar shpenzimet për investime dhe burimi i financimit:

Shpenzimet për investime:

Në debi përfaqëson shtesën e AQT llog. 231 në vlerën 304,621,584 lekë, shumë e cila rakordon me shumën e shpenzimeve të llog.231 në aktrakordin e mbajtur me Degën e thesarit e cila paraqitet në vlerën 304,621,584 lekë.

Burimet për investime:

Në Kollonën (c) “Teprica në çelje” e pasqyrës nr.4 është paraqitur:

Burimet për investime:

-Grante të brendshme kapitale	llog. 105	398,399 mijë lekë
-Grante të kapitale për investime për të tretë	llog.14	258,688 mijë lekë
Sipas udhëzimit nr. 14, teprica e këtyre llogarive në çelje të vitit ushtrimor duhet të jetë respektivisht sa çelja e këtyre llogarive në bilanc (pasqyra 2).		139,711 mijë lekë

Në pasivin e bilancit, pasqyra nr.2, tepricat e këtyre llogarive në vitin ushtrimor paraardhës paraqiten:

-Grante të brendshme kapitale	llog.105	-
-Grante të kapitale për investime për të tretë	llog.14	139,711 mijë lekë

Në kollonën (d) “Transaksionet e vitit” paraqiten pakësimet gjatë vitit ushtrimor si më poshtë:

Burimet për investime:

1. Grante të brendshme kapitale	llog. 105	192,557 mijë lekë
Nga i njëjti nivel qeverisje	llog.1050	84,802 mijë lekë
Grante të brendshme në natyrë	llog.1059	79,598 mijë lekë
2. Grante të kapitale për investime për të tretë	llog.14	5,204 mijë lekë
Grante të brend. kap. për pjesëmarrje në inv. ne të tretë	llog.145	107,754 mijë lekë
		107,754 mijë lekë

Në kollonën (e) paraqiten shtesat gjatë vitit ushtrimor si më poshtë:

Burimet për investime:

1. Grante të brendshme kapitale	llog. 105	378,862 mijë lekë
Nga i njëjti nivel qeverisje	llog.1050	84,802 mijë lekë
Grante të brendshme në natyrë	llog.1059	79,598 mijë lekë
2. Grante të kapitale për investime për të tretë	llog.14	5,204 mijë lekë
Grante të brend. kap. për pjesëmarrje në inv. ne të tretë	llog.145	294,060 mijë lekë
		294,060 mijë lekë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Pasqyra e lëvizjes “CASH” (pasqyra 5), ka të pasqyruara në debi fondet buxhetore të vëna në dispozicion dhe të pasqyruara në llog. 520 “disponibilitete në thesar” konkretisht: teprica në çelje në shumën 14,380,033 e barabartë me vlerën e llog. 520 në aktiv të bilancit “ushtrimi paraardhës”; fonde nga buxheti në shumën 596,705,543 lekë, vlerë e barabartë me planin e buxhetit sipas rakordimit me Degën e Thesarit, si dhe të ardhura nga sponsorizimet në shumën 22,770,808 lekë gjithashtu të rakorduara me Degën e Thesarit, si dhe ka të pasqyruara në kredi shpenzimet e kryera dhe të rakorduara me Degën e Thesarit në shumën 583,209,694 lekë, diferenca është pasqyruar si “Autorizime buxhetore të papërdorura” në shumën 25,975,701 lekë.

Në mbyllje të vitit ushtrimor, debia e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 24,670,989 lekë përfaqëson vlerën e mjeteve në ruajtje në kredi të llogarisë 466 në shumën 17,880,425 lekë, si dhe vlerën e sponsorizimeve të cilat do të trashëgohen në vitin 2017, në shumën 6,790,584 lekë, pasqyruar në llogarinë 85 “Rezultati i ushtrimit”, në pasiv të bilancit.

Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve të qëndrueshme (pasqyra 6). AQT e pasqyruara në pasqyrën 6 (*me vlerë bruto*), kanë të pasqyruar vlerën e tyre në çelje të vitit ushtrimor, e njëjtë me gjendjen e këtyre llogarive në pasiv të bilancit, Ndryshimi i tyre është në vlerën 144,060,759 lekë dhe përfaqëson pagesat për investime të pasqyruara në pasqyrën nr. 3 në vlerën 144,060,759 mije lekë, si dhe shtesa pa pagese “Mjete transporti”

Pasqyra e amortizimeve (pasqyra 7), ka të pasqyruar amortizimin e akumuluar në shumën 192,574,045 lekë dhe atë të përlllogaritur të vitit 2016, shtesa në shumën 5,014,247 lekë dhe pakësime në vlerën 321,486 lekë, në total 197,266,806 lekë, shumë e pasqyruar edhe në aktiv të bilancit në llog.219 “Amortizimi i AQT”. AQT të pasqyruara në postin A të aktivit të bilancit janë të kuadruara me AQT e pasqyruara në pasqyrën 6 (*me vlerë bruto*), duke zbritur amortizimin (AQT të trupëzuara).

Pasqyra e lëvizjes së fondeve (pasqyra 8), ka të pasqyruar:

- Çeljen e vitit ushtrimor, llog. 101 “Fonde bazë” në shumën 952,553,855 lekë e pasqyruar edhe në pasivin e bilancit llog. 101 “Fonde bazë”;
- Teprica në fund e llog. 101, është e njëjtë me tepricën e saj në pasiv të bilancit kontabël, pasqyra nr.2 është në vlerën 1,029,339,574 lekë.
- Në lëvizjet gjatë periudhës ushtrimore në debi dhe kredi të kësaj llogarie u konstatua:

Gjetje nga auditimi:

Situata:	<p>Vlera prej 1,090,851 lekë si pakësim i AQT nga nxjerrjet jashtë përdorimi është përfshirë dy herë në pasqyrën nr. 8, njëherë llog.1015 në shumën 1,090,851 dhe njëherë si pjesë e llog.1016 në shumën 40,529,437 lekë e cila është e përbërë nga (39,438,586 lekë + 1,090,851 lekë).</p> <p>Është debituar respektivisht, për:</p> <table style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="width: 80%;">- 1016 “Pakësim nga transfertat e AQT”</td> <td style="text-align: right;"><u>40,529,437 lekë</u></td> </tr> <tr> <td>- 1015 “Pakësim nga nxjerrja jashtë përdorimi”</td> <td style="text-align: right;"><u>1,090,851 lekë</u></td> </tr> <tr> <td>- 1013 “Pakësim nga konsumi i AQT (amortizimi)</td> <td style="text-align: right;">4,692,761 lekë</td> </tr> <tr> <td>Totali:</td> <td style="text-align: right;">46,313,049 lekë</td> </tr> </table> <p><i>Shpjegime:</i></p> <p>- Vlera e paraqitur në llogarinë 1013 “Pakësim nga konsumi i aktiveve të</p>	- 1016 “Pakësim nga transfertat e AQT”	<u>40,529,437 lekë</u>	- 1015 “Pakësim nga nxjerrja jashtë përdorimi”	<u>1,090,851 lekë</u>	- 1013 “Pakësim nga konsumi i AQT (amortizimi)	4,692,761 lekë	Totali:	46,313,049 lekë
- 1016 “Pakësim nga transfertat e AQT”	<u>40,529,437 lekë</u>								
- 1015 “Pakësim nga nxjerrja jashtë përdorimi”	<u>1,090,851 lekë</u>								
- 1013 “Pakësim nga konsumi i AQT (amortizimi)	4,692,761 lekë								
Totali:	46,313,049 lekë								



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

	<p>qëndrueshme” në shumën <u>4,692,761 lekë</u>, kuadron me vlerën vjetore të amortizimit (shtesa/pakësime) të paraqitur në pasqyrën nr. 7 (5,014,247-321,486)=<u>4,692,761 lekë</u>, ndërsa:</p> <p>- Vlera e paraqitur si pakësim i fondeve bazë, nga transfertat e AQT në shumën 40,529,437 lekë, është paraqitur edhe në pasqyrën nr. 6 “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme” si pakësim total të tyre, duke përfshirë në këtë shumë edhe vlerën e nxjerrjeve jashtë përdorimi në shumën 1,090,851 lekë, si më poshtë:</p> <p>Pasqyra nr. 6 është paraqitur :</p> <table style="width: 100%; border: none;"> <tr> <td style="width: 80%;">- Nxjerrje jashtë përdorimi</td> <td style="text-align: right;"><u>1,090,851 lekë</u></td> </tr> <tr> <td>- Pakësime të tjera</td> <td style="text-align: right;">39,438,586 lekë</td> </tr> <tr> <td>- Totali</td> <td style="text-align: right;"><u>40,529,437 lekë</u></td> </tr> </table>	- Nxjerrje jashtë përdorimi	<u>1,090,851 lekë</u>	- Pakësime të tjera	39,438,586 lekë	- Totali	<u>40,529,437 lekë</u>
- Nxjerrje jashtë përdorimi	<u>1,090,851 lekë</u>						
- Pakësime të tjera	39,438,586 lekë						
- Totali	<u>40,529,437 lekë</u>						
Kriteri:	Udhëzimi nr. 14, datë 28.12.2006.						
Ndikimi/efekti:	Mos pasqyrim i saktë i lëvizjes së fondeve në pasqyrën nr. 8.						
Shkaku:	Kontabilizim i gabuar.						
Rëndësia e shkeljes:	E ulët						
Rekomandimi:	Nëpunësi Zbatues i MK-së, të marrë masa për kryerjen e sistemit kontabël, me qëllim pasqyrimin e drejtë Aktiveve të Qëndrueshme të trupëzuara (AQT) në pasqyrën nr. 8 “Pasqyra e lëvizjes së fondeve”.						

Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (pasqyra 9), në këtë pasqyrë është paraqitur numri faktik i punonjësve me ndryshime dhe sipas kategorive; fondi i pagave gjithsej, si dhe kontributet për sigurime shoqërore shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale. Shumat e paraqitura në këtë pasqyrë kuadrojnë me pasqyrën 3/1 “Shpenzime të ushtrimit” konkretisht me llog.600 “Paga shpërblye e të tjera personeli” në shumën 67,916,639 lekë.

Për sa më sipër arrijmë në konkluzionin që: Plotësimi i pasqyrave financiare në përgjithësi është bërë në përputhje me udhëzimin nr. 14, datë 28.12.2006, përveç rastit ku vlera prej 1,090,851 lekë si pakësim i AQT nga nxjerrjet jashtë përdorimi është përfshirë dy herë në pasqyrën nr. 8, njëherë në llog.1015 në shumën 1,090,851 dhe njëherë si pjesë e llog.1016 në shumën 40,529,437 lekë e cila është e përbërë nga (39,438,586 lekë + 1,090,851 lekë).

1.3. Mbajtja dhe plotësimi i dokumentacionit financiar kontabël;

Nga MK është mbajtur ky dokumentacion:

- Ditari i kontabilitetit në çelje të tij ka të hedhura llogaritë sipas gjendjes në fund të vitit paraardhës. Veprimet në ditar janë të regjistruara që prej datës 1 Janar deri në datë 31 Dhjetor. Regjistrimi i veprimeve ka ndjekur radhën kronologjike të dokumentacionit justifikues të veprimeve të kryera. Për çdo veprim kontabël janë debituar dhe kredituar llogaritë përkatëse;
- Libri i madh, ku janë të pasqyruara gjendjet e llogarive në fund të periudhës ushtrimore. Gjendja e tyre në fund rakordon me gjendjen e llog. 600, 601 dhe 602 dhe 231 sipas Aktrakordimeve me Degën e Thesarit;
- Ditari i arkës në valutë (euro/usd), ku janë regjistruar të gjitha veprimet me arkën në valutë dhe ku është vendosur edhe kursi ditor i këmbimit.
- Libri i arkës, është mbajtur për çdo muaj, në fillim të çdo muaji është regjistruar gjendja në fund të muajit paraardhës si gjendje në fillim.
- Regjistri i fletë konatabilizimeve;
- Regjistri i magazinës.
- Pasqyrat financiare



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Për sa më sipër, arrijmë në konkluzion që: Mbajtja e dokumentacionit kontabël është në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin në dhe pasqyrat financiare”, si dhe udhëzimet e Ministrisë së Financave.

Për mangësitë e trajtuara më sipër mbajnë përgjegjësi, znj. M. B. në cilësinë e hartueses së pasqyrave financiare të vitit 2016 dhe z. Sh. Sh. në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

Në përfundim Grupi i auditimit jep opinion të pakualifikuar me theksim çështje, bazuar në (ISSAI 4200¹) si më poshtë:

1.1. Çështja e audituar mbi përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore, raportimin dhe respektimin e afateve të dorëzimit të tyre, si dhe në mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit financiar kontabël, është në përputhje me kriteret e paracaktuara (kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi) në të gjitha aspektet materiale, si dhe informacioni i paraqitur është i vërtetë dhe i drejtë.

1.2. Çështja e audituar mbi plotësimin e pasqyrave financiare, në përgjithësi është në përputhje me kriteret e paracaktuara (kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi) në të gjitha aspektet materiale, si dhe informacioni i paraqitur është i vërtetë dhe i drejtë, **përveç rasteve të mëposhtme:**

- Rastit ku shuma prej 1,090,851 lekë si pakësim i AQT nga nxjerrjet jashtë përdorimi është përfshirë dy herë në pasqyrën nr. 8, njëherë llog.1015 në shumën 1,090,851 dhe njëherë si pjesë e llog.1016

-Rastit ku shuma prej 55,991,568 lekë, e pasqyruar në pasiv të bilancit llog. (401-408) “Furnitorë e llogari të lidhura me to” e cila në mënyrë të gabuar ka si kundërparti llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në aktiv të bilancit në shumën 55,991,568 lekë, llogari e cila përfaqëson pagesa të periudhave të ardhshme. Sipas udhëzimit nr. 14, datë 28.12.2006, Kapitulli III “Shpjegime lidhur me përmbajtjen dhe plotësimin e pasqyrave financiare”, Aktivi i bilancit kontabël, përfaqësojnë shpenzime për blerje dhe shërbime, realizimi faktik i të cilave ndodh në ushtrimin e ardhshëm (shpenzime të parapaguara), si psh. Qira të paguara në avancë, prime të sigurimeve për rreziqe të paguara në avancë etj”.

1.3. Çështja e audituar mbi mbajtjen e dokumentacionit kontabël është në përputhje me kriteret e paracaktuara (kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi) në të gjitha aspektet materiale, si dhe informacioni i paraqitur është i vërtetë dhe i drejtë.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraportit të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr.1, datë 26.02.2018, protokolluar në Ministrinë e Kulturës me nr.1363, datë 28.02.2018, mbi të cilin nuk janë paraqitur observacione.

2. AUDITIMI I VEPRIMEVE TË KRYERA ME BANKË DHE ARKË, SI DHE INVENTARIZIMI I PRONËS.

Sipas Programit të Auditimit nr. 1264/2, datë 14.12.2017, është audituar ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës, arkës dhe inventarizimi i pronës, për vitin 2015, 2016 dhe 2017. Për auditimin e kësaj pike grupi i auditimit është mbështetur në:

- VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” me ndryshime;

¹ ISSAI 4200 - Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet lidhur me auditimin e pasqyrave financiare



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

- VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin e punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës” me ndryshime;
- Udhëzimi nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” me ndryshime;
- Ligji 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me ndryshime;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” me ndryshime;
- Udhëzimi nr. 3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël” me ndryshime;
- VKM nr. 28, datë 14.01.2015 “Ngarkimin e agjencisë së blerjeve të përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”, me ndryshime;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime.

2.1/a. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës.

Nga auditimi me zgjedhje për periudhën objekt auditimi, për veprimet e kryera nëpërmjet bankës rezultoi se, në përgjithësi veprimet kontabël janë kryer në përputhje me aktet ligjore e nënligjore. Regjistrimi dhe kontabilizimi në ditar është bërë i rregullt dhe në fund të çdo muaji, shuma e pagesave të bankës është e njëjtë me nxjerrjen e llogarisë në fund të viteve ushtrimore. Veprimet e kryera janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarët përkatës. Pagesat e kryera me urdhër shpenzimi, në përgjithësi janë të shoqëruara me dokumente të rregullta justifikuese. Të gjithë urdhër shpenzimet janë plotësuar në përputhje me kërkesat e formatit të përcaktuar nga Ministria e Financave.

Shpenzimet për udhëtim e dieta jashtë vendit.

Përsa ju përket shpenzimeve për udhëtim e dieta jashtë vendit, pagesat janë përlllogaritur dhe kryer në zbatim të VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” dhe Udhëzimit nr. 22, datë 10.07.2013, në zbatim të tij. Bashkëngjitur urdhër shpenzimit është ftesa nga organizatorët, autorizimi i NA, urdhër shërbimi, preventivi i shpenzimeve, fatura e biletave dhe akomodimit në hotel. Çdo urdhër shpenzimi është vulosur nga Dega e Thesarit Tiranë.

- Përsa i përket shpenzimeve të kryera për akomodim në hotel të personave të cilat kanë udhëtuar me shërbim jashtë shtetit ka rezultuar, se në disa raste objekt i prokurimit ka qenë “Blerje bilete dhe akomodim i personave që do të udhëtojnë me shërbim jashtë vendit (trajtuar si shërbim, por pa praktikë, realizuar nga agjencitë të cilat kanë kryer blerjen e biletave të udhëtimit)”.

Gjetje nga auditimi:

Situata:	Për justifikimin e shpenzimeve për akomodim (hotel) nga këqyrja e dokumentacionit rezultoi se bashkëngjitur urdhër shpenzimeve, nuk ndodhet asnjë dokument që vërteton vlerën e akomodimit të konfirmuar nga hotelet e rezervuara on-line, dërguar agjencive turistike, të cilat kanë ofruar shërbimin për Ministrinë e Kulturës.
Kriteri:	Likuidimi i tyre është bërë vetëm referuar faturës së paraqitur nga agjencitë turistike.

Udhëzimi nr. 2, datë 06.02.2012, paragrafi “Përgjegjësia e NZ”, pika 48/dh, ku cilësohet: “Dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

<p>Ndikimi/efekti:</p> <p>Shkaku:</p> <p>Rëndësia e shkëljes:</p> <p>Rekomandimi:</p>	<p><i>tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi”.</i></p> <p>Nuk dihet sa është vlera reale e shpenzimeve të akomodimit. Gjithashtu, presupozohet se agjencitë turistike e ofrojnë këtë shërbim kundrejt pagesës në formë komisioni, ç’ ka përbën një kosto shtesë për buxhetin, por nga dokumentacioni bashkëngjitur praktikës nuk pasqyrohet sesa është pagesa e hotelit dhe sa është vlera e komisionit për agjencitë. Nga Agjencitë nuk paraqitet asnjë dokument (faturë) nga hotelet respektive.</p> <p>Mënyra e parapagimit është e ndalur të kryhet nga institucionet buxhetore referuar udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012, paragrafi “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike” pika 147, si dhe nga ana e tyre nuk disponohet kartë krediti. Rezervimi i hoteleve nga agjencitë bëhet me pa parapagim, nëpërmjet, kartë kreditit.</p> <p>E mesme</p> <p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë në shqyrtim këtë fakt, i cili sjell kosto shtesë për buxhetin e shtetit dhe të pajisë me kartë krediti në emër të Nëpunësit Zbatues, institucionet buxhetore, me qëllim që të përdoret për kryerjen e këtyre pagesave duke ju referuar planit të valutës për çdo institucion të miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Gjithashtu të bëhet rregullim në udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, ku të parashikohet përdorimi i kartë kreditit dhe parapagimi për shpenzimet e akomodimit në hotel, në rastet e udhëtimit të punonjësve të administratës publike jashtë vendit.</p>
---	--

-Përsa i përket blerja e biletave, është realizuar nëpërmjet llojit të procedurës “Blerje e vogël” on-line në SPE. Nga grupi i auditimit u audituan me zgjedhje disa praktika mbi procedurat e prokurimit “Blerje në vlerë të vogël” të cilat janë trajtuar në paragrafin “Likuidimi i shpenzimeve të realizuara si “Blerje në vlerë të vogël”.

Shpenzimet për udhëtim e dieta brenda vendit.

Përsa ju përket shpenzimeve për udhëtim dhe dieta brenda vendit, pagesat janë përlllogaritur në përputhje me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin e punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës” me ndryshime, bashkëngjitur urdhër shpenzimit është urdhër shërbimi, autorizimi, fatura tatimore dhe kuponi tatimor për shpenzimet e akomodimit, biletat për shpenzimet e transportit si dhe dokumentacion tjetër justifikues.

Likuidimi i shpenzimeve për investime.

Nga auditimi i likuidimit të shpenzimeve për investimeve, ka rezultuar se janë kryer në përputhje me kriteret e paracaktuara. Dokumentacioni justifikues bashkëngjitur Urdhër shpenzimit është i plotë dhe i firmosur nga personat dhe strukturat e përcaktuara. Për çdo likuidim është mbajtur 5 % i garancisë së punimeve.

Bashkëngjitur tij ndodhet dokumentacioni i mëposhtëm:

- Fatura tatimore;
- Situacioni i punimeve;
- Urdhër prokurimi i titullarit të AK;
- Procesverbal i miratimit të DT;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

- Procesverbal i vlerësimit të ofertave;
- Kontrata;
- Formular oferte;
- Preventiv;
- Njoftim fituesi për OE;
- Njoftim për klasifikim përfundimtar;
- Raport përmbledhës;
- Formular sigurim kontrate;
- Njoftim për fillim punimesh;
- Akt dorëzimi i sheshit të ndërtimit;

Likuidimi i shpenzimeve sipas kontratave për realizimin e “Projekteve kulturore”.

Likuidimi i projekteve kulturore është kryer në dy faza në vlerën 40 % dhe 60 % të vlerës totale. Bashkëngjitur urdhër shpenzimeve ndodhet, Raporti narrativ, Raporti financiar, Vendimi i kolegjiut, kontrata “Për mbështetje financiare me fonde publike” me përfituesin, dokumentacioni lidhur me shpenzimet për blerje materiale, kontrata dhe fatura me të tretë, si dhe bordero, kontrata, ID të personave realizues të projekteve në rast të shpërblimit të tyre etj.

Likuidimi i shpenzimeve të realizuara si “Blerje në vlerë të vogël”.

Për **vitin 2015**, u audituan me zgjedhje 22 procedura prokurimi “Blerje e vogël” si më poshtë:

Nr.	Objekti	Urdhër prokurimi
1	Blerje bilete “Tirane-Nisë-Tiranë”	80, datë 10.02.2015
2	Blerje bilete “Tiranë-Stamboll-Tiranë”	1905/2, datë 15.04.2015
3	Blerje bilete “Tiranë-Milano-Tiranë”	92, datë 08.07.2015
4	Blerje bilete “Tiranë-Këln-Tiranë”	3079/1, datë 22.06.2015
5	Blerje kancelari	76, datë 27.04.2015
6	Blerje bilete “Tiranë-Venecia-Tiranë”	931, datë 24.02.2015
7	Blerje bilete “Tiranë-Bruksel-Tiranë”	84, datë 20.04.2015
8	Blerje llampa ndriçimi	1581, datë 30.03.2015
9	Blerje bilete “Tiranë-Bruksel-Tiranë”	1058, datë 02.03.2015
10	Blerje bilete “Tiranë-Lubjanë-Tiranë”	2672/3, datë 25.05.2015
11	Riparim automjete	1580/1, datë 30.03.2015
12	Blerje bilete “Tiranë-Nicë-Tiranë”	2221/1, datë 06.05.2015
13	Blerje bilete “Tiranë-Baku-Tiranë”	2289/1, datë 11.05.2015
14	Blerje siguracioni TPL, Kasko dhe karton jeshil	93, datë 06.07.2015
15	Blerje bilete “Tiranë-Strazburg-Tiranë”	1222, datë 11.03.2015
16	Blerja kancelarie	102, datë 09.12.2015
17	Instalime për rrjetin e internetit	65, datë 09.01.2015
18	Blerje laptop, hard disk etj.	120, datë 14.12.2015
19	Blerje kompjutera	122, datë 24.12.2015
20	Blerje bilete “Tiranë-Venecia-Tiranë”	106, datë 03.12.2015
21	Blerje bilete “Tiranë-Duseldorf-Tiranë”	100, datë 20.11.2015
22	Blerje perde	67, datë 03.02.2015.

Burimi i informacionit: MK
Punoi: KLSH

Nga auditimi rezultuan këto mangësi:

- Sipas urdhër prokurimit nr. 3079/1, datë 22.06.2015 është prokuruar blerje bilete “Tiranë-Këln-Tiranë”, në praktikë nuk ndodhet asnjë dokument ku të evidentohet OE fitues i kësaj



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

blerje, si procesverbal i KBV, njoftim fituesi, faturë, dokumentacion i OE i shpallur fitues sipas përcaktimeve të bëra në ftesën për ofertë, si dhe ftesa nga organizatorët.

- Sipas urdhër prokurimit nr. 84, datë 20.04.2015 është prokuruar blerje bilete “Tiranë-Bruksel-Tiranë”, me fond limit 63,100 lekë. Në praktikë nuk ndodhet asnjë dokument ku të evidentohet OE fitues i kësaj blerje, si procesverbal i KBV, faturë, njoftim fituesi, dokumentacioni i OE i shpallur fitues sipas përcaktimeve të bëra në ftesën për ofertë, përlllogaritja e fondit limit, ftesa e organizatorëve.
- Sipas urdhër prokurimit nr. 76, datë 27.04.2015 është prokuruar “Blerje llampa ndriçimi” me fond limit 148,833 lekë. Në praktikë nuk ndodhet asnjë dokument i OE, i kërkuar në ftesën për ofertë, si ekstrat i QKR, vërtetim i OSHEE, deklaratë për plotësimin e specifikimeve teknike, si dhe procesverbal i KBV, vlerësimi përfundimtar, njoftim fituesi.
- Sipas urdhër prokurimit nr. 1058, datë 02.03.2015 është prokuruar blerje bilete “Tiranë-Bruksel-Tiranë”, me fond limit 40,424 lekë. Në praktikë nuk ndodhet asnjë dokument ku të evidentohet OE fitues i kësaj blerje, si procesverbal i KBV, faturë, vërtetim nga OSHEE i OE i shpallur fitues sipas përcaktimeve të bëra në ftesën për ofertë dhe vlerësimi përfundimtar.
- Sipas urdhër prokurimit nr. 2672/3, datë 25.05.2015 është prokuruar blerje bilete “Tiranë-Lubjanë-Tiranë”. Në praktikë nuk ndodhet asnjë dokument ku të evidentohet OE fitues i kësaj blerje, si procesverbal i KBV, njoftim fituesi si dhe dokumentacioni i OE i shpallur fitues, vërtetim nga OSHEE, ekstrat QKR, certifikatë IATA, sipas përcaktimeve të bëra në ftesën për ofertë.
- Sipas urdhër prokurimit nr. 1580/1, datë 30.03.2015 është prokuruar “Riparim automjete” me fond limit 175,000 lekë. Në praktikë nuk ndodhet asnjë dokument i OE, i kërkuar në ftesën për ofertë, si ekstrat i QKR, vërtetim i OSHEE, deklaratë për plotësimin e specifikimeve teknike, si dhe procesverbal i KBV, vlerësimi përfundimtar dhe njoftim fituesi.
- Sipas urdhër prokurimit nr. 2289/1, datë 11.05.2015 është prokuruar blerje bilete “Tiranë-Baku-Tiranë”. Në praktikë nuk ndodhet asnjë dokument ku të evidentohet OE fitues i kësaj blerje, si procesverbal i KBV, faturë, njoftim fituesi, si dhe dokumentacioni i OE i shpallur fitues sipas përcaktimeve të bëra në ftesën për ofertë.
- Sipas urdhër prokurimit nr. 1580/1, datë 30.03.2015 është prokuruar “Blerje bilete Tiranë-Strasburg-Tiranë”. Në praktikë nuk ndodhet asnjë dokument i OE, i kërkuar në ftesën për ofertë, si ekstrat i QKR, vërtetim i OSHEE, certifikata IATA, si dhe procesverbal i KBV, vlerësimi dhe njoftim fituesi.
- Sipas urdhër prokurimit nr. 102, datë 09.12.2015 është prokuruar “Blerje kancelari” me fond limit 260,000 lekë. Në praktikë nuk ndodhet asnjë dokument i OE, i kërkuar në ftesën për ofertë, si ekstrat i QKR, vërtetim i OSHEE, deklaratë për plotësimin e specifikimeve teknike, si dhe asnjë dokumentacion që të evidentojë OE fitues si procesverbal i KBV, njoftim fituesi, kontratë, akt-marrje në dorëzim, faturë etj.
- Sipas urdhër prokurimit nr. 120, datë 14.12.2015 është prokuruar “Blerje laptop, harddisk, video konferencë” me fond limit 800,000 lekë. Në praktikë nuk ndodhet asnjë dokument i OE, i kërkuar në ftesën për ofertë, si ekstrat i QKR, vërtetim i OSHEE, deklaratë për plotësimin e specifikimeve teknike, si dhe asnjë dokumentacion që të evidentojë OE fitues si procesverbal i KBV, njoftim fituesi, kontratë, akt-marrje në dorëzim, faturë etj, likuiduar sipas urdhër shpenzimit nr. 819, datë 31.12.2015 vlera 867,600 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Po kështu, sipas urdhër shpenzimit nr. 820, datë 31.12.2015 është likuiduar vlerë 190,200 lekë për blerje kompjutera. Kjo blerje është realizuar me procedurë “Blerje e vogël”, sipas Urdhër prokurimit nr. 122, datë 24.12.2015 me fond limit 166,666 lekë pa tvsh.

Procedura është zhvilluar on-line në SPE dhe sipas vlerësimit përfundimtar katër operatorët e renditur të parët nuk janë paraqitur. Është kualifikuar dhe shpallur fitues OE i renditur i pesti “X” me ofertë 158,500 lekë pa tvsh.

Sa më sipër, arrijmë në konkluzionin që, kemi të bëjmë me copëzim fondesh, pasi dy procedurat janë zhvilluar për të njëjtin grup-mallrash “Blerje kompjutera, laptop” dhe vlera e tyre e prokuruar, sipas urdhër prokurimeve të dala është 966,666 lekë pa tvsh, çka e kalon kufirin e ulët monetar 800,000 lekë për t’u trajtuar si blerje e vogël, veprim i cili bie në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore.

- Sipas urdhër prokurimit nr. 100, datë 11.12.2015 është prokuruar blerje bilete “Tiranë-Duseldorf-Tiranë”, në praktikë procesverbal i KBV, vlerësimi përfundimtar sipas SPE, njoftim fituesi, ftesa nga organizatorët.
- Sipas urdhër prokurimit nr. 67, datë 03.02.2015 dhe urdhër shpenzimit nr. 173, datë 06.05.2015 është likuiduar fatura nr. 38, datë 19.02.2015 për blerje perde për Ministrinë e Kulturës. Në ftesën për ofertë është përcaktuar se OE që do të shpallet fitues duhet të paraqesë:

-Kopje e Ekstartit të QKR, ku të përfshihet objekti i prokurimit;

-Vërtetim nga OSHEE, për pagesat e energjisë;

-Certifikatë prodhuesi që vërteton që malli është prodhim Euro1.

Sipas klasifikimit sipas vlerës së ofertës së paraqitur në SPE, ka rezultuar se OE fitues është subjekti “M. L.” renditur i dyti me vlerë 289,000 lekë. Bashkëngjitur praktikës mungon Ekstrati i QKR, ku të përfshihet objekti i prokurimit, Certifikatë prodhuesi që vërteton se malli është prodhim Euro1.

Për **vitin 2016**, u audituan me zgjedhje 20 procedura prokurimi “Blerje e vogël” si më poshtë:

Nr.	Praktika	Objekti	Urdhër prokurimi
1	29	Blerje bilete “Tiranë-Bruksel-Tiranë”	31, datë 05.05.2016
2	42	Blerje bilete “Tiranë-Stamboll-Tiranë”	50, datë 21.06.2016
3	3	Blerje bilete “Tiranë-Bari-Tiranë”	2, datë 07.01.2016
4	6	Blerje bilete “Tiranë-Bruksel-Tiranë”	4, datë 15.01.2016
5	10	Blerje bilete “Tiranë-Berlin-Tiranë”	14, datë 01.02.2016
6	26	Shërbim automjeti	23, datë 20.04.2016
7	2	Shërbim ruajtje dhe sigurie “Godina Gjethi” shtesë	S’ka
8	57	Blerje bilete “Tiranë-Milano-Tiranë”	87, datë 31.08.2016
9	52	Blerje kancelari	80, datë 17.08.2016
10	55	Blerje bilete “Tiranë-Bari-Tiranë”	89, datë 02.09.2016
11	36	Blerje bilete “Tiranë-Zagreb-Tiranë”	47, datë 10.06.2016
12	56	Blerje bilete “Tiranë-Venecia-Tiranë”	83, datë 08.09.2016
13	-	Blerje materialesh për montim të kondicionerëve	91, datë 05.09.2016
	-	Montim kondicionerësh dhe mbushja e tyre me gas	92, datë 07.09.2016
14	30	Blerje bilete “Tiranë-Beograd-Tiranë”	40, datë 23.05.2016
15	33	Blerje bilete “Tiranë-Verona-Torino-Tiranë”	42, datë 06.06.2016
16	50	Blerje montim gomash	77, datë 01.08.2016
17	8	Blerje lulesh	10, datë 02.02.2016
18	7	Blerje dhe montim gomash	7, datë 26.01.2016
19	5	Blerje bilete “Tiranë-Vjenë-Tiranë”	3, datë 13.01.2016
20	17	Blerje bilete “Tiranë-Vjenë-Tiranë”	8, datë 14.04.2016

Burimi i informacionit: MK

Punoi: KLSH



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Nga auditimi rezultuan këto mangësi:

- Në praktikën nr. 2 “Shtesë kontrate-Shërbim roje private” për Godinën Gjethi, ka dalë urdhri nr. 6488, datë 31.12.2015 për lidhjen e kontratës shtesë në masën 20 %, ose në vlerën 573,000 lekë pa tvsh. Nga AK nuk është zhvilluar procedura e prokurimitin “Negocim pa shpallje paraprake të vlerës limit të kontratës” siç parashikohet në nenin 33 të LPP-së.
- Në praktikën nr. 56 “Blerje bilete Tiranë-Venecia-Tiranë” në ftesën për ofertë është kërkuar që OE i shpallur i pari, përpara se të shpallet fitues duhet të paraqesë:
 - Certifikatë QKR, ku të përfshihet objekti i veprimtarisë;
 - Vërtetim OSHEE;
 - Certifikatë I.A.T.A.Nga OE “P”, nuk është paraqitur Certifikatë QKR dhe Vërtetim OSHEE.
- Në praktikën për “Blerje materialesh për montim kondicionerësh” dhe “Montim kondicionerësh dhe mbushja e tyre me gas”, procedura të kryera sipas prokurimeve me vlerë nën 100,000 lekë rezulton se, këto dy procedura duhej të zhvilloheshin si një e vetme, duke proceduar me blerje on-line në SEP, “Blerje e vogël”. Copëzimi i fondeve, ka sjellë shmangie të procedurës, gjë që bie në kundërshtim me udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015, pika 3, ku cilësohet: *“Kjo lloj procedurë do të përdoret për blerjen e një grupi mallrash, kryerjen e shërbimeve apo punëve të ngjashme, që kanë të njëjtin funksion kryesor apo që kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve. Përdorimi i kësaj procedure nuk duhet parë si mundësi për shmangien e procedurave normale të prokurimit. Në asnjë rast, autoritetet kontraktore nuk duhet të prokurojnë veçmas mallra, shërbime apo punë që përfshihen në një grup për shkak të ngjashmërisë së tyre, apo për shkak të funksionit kryesor”*.
- Në praktikën nr. 8 “Blerje lulesh”, në ftesën për ofertë është kërkuar që OE i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues duhet të paraqesë:
 - Certifikatë QKR, ku të përfshihet objekti i veprimtarisë;
 - Vërtetim OSHEE;
 - Të këtë kontrata të ngjashme me institucione shtetërore.Nga OE “Irena Caslli”, nuk është paraqitur asnjë prej dokumenteve të më sipërme.
- Në praktikën nr. 5, Blerje bilete “Tiranë-Vjenë-Tiranë” në ftesën për ofertë është kërkuar që OE i shpallur i pari, përpara se të shpallet fitues duhet të paraqesë:
 - Certifikatë QKR, ku të përfshihet objekti i veprimtarisë;
 - Vërtetim OSHEE;
 - Certifikatë I.A.T.A.Në praktikë nuk ndodhet asnjë prej dokumenteve të mësipërme.

Për **vitin 2017**, u audituan me zgjedhje 10 procedura prokurimi “Blerje e vogël” si më poshtë:

Nr.	Objekti	Urdhër prokurimi
1	Blerje kompjuterike hardëare dhe harddisk i jashtëm	1981/3, datë 15.05.2017
2	Blerje kompjuterike hardëare dhe harddisk i jashtëm	1981/1, datë 14.04.2017
3	Shërbim gjelbërimi për ambientet e MK	839/1, datë 01.03.2017
4	Blerje bileta “Tiranë Bruksel-Tiranë”	1304/1, datë 15.03.2017
5	Blerje kancelarie	397/3, datë 03.02.2017
6	Blerje materiale pastrimi	463/1, datë 01.02.2017
7	Blerje bileta “Tiranë-Berlin-Tiranë”	749/1, datë 13.02.2017



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

8	Blerje bileta "Tiranë-Vjenë-Tiranë" dhe akomodim	401/2, datë 07.02.2017
9	Blerje bilet "Milano-Sarajevë-Tiranë"	2105, datë
10	Shërbim gjelbërim në ambientet e MK	839/1, datë 01.03.2017

Burimi i informacionit: MK
Punoi: KLSH

Nga auditimi rezultuan këto mangësi:

1. Me urdhër prokurimi nr. 401/2, datë 07.02.2017, është urdhëruar blerja e biletave sipas autorizimit nr. 401, datë 26.01.2017 Tiranë-Vjenë-Tiranë.

Sipas dokumentacionit të praktikës nga OE janë faturuar edhe shpenzimet e akomodimit në hotel dhe siguracioni. Përsa i përket shërbimit të kryer nga OE, për akomodimin në hotel nuk ka praktikë prokurimi sipas objektit në urdhrin e prokurimit.

Në mënyrë të përmbledhur mangësitë e evidentuara nga auditimi i shpenzimeve të realizuara me procedurën e prokurimit "Blerje në vlera të vogla" pas shqyrtimit të observacioneve paraqiten sa më poshtë:

Gjetje nga auditimi:

Situata 1:	Nga auditimi i praktikave të procedurave të prokurimit "Blerje e vogël" ka rezultuar se nga Komisioni i Blerjeve të Vogla, nuk është vepruar në përputhje me procedurat e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore. Në praktikë nuk ndodhet Procesverbali i KBV, për dokumentimin e veprimeve të kryera prej komisionit në vlerësimin e OE.
Kriteri 1:	LPP, neni 40, pika 5 ku cilësohet: "...Këto veprime duhet të dokumentohen nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nëpërmjet një procesverbali të mbajtur për këtë qëllim. Në çdo rast, autoriteti kontraktor të marrë në konsideratë për realizimin e objektit të kontratës vetëm operatorët ekonomikë të renditur deri në vendin e pestë të klasifikimit.
Situata 2:	Nga AK janë prokuruar me UP nr. 91, datë 05.09.2016 "Blerje materialesh për montim kondicionerësh" dhe UP nr. 92, datë 07.09.2016 "Montim kondicionerësh dhe mbushja e tyre me gas", procedura të kryera sipas prokurimeve me vlerë nën 100,000 lekë rezulton se, këto dy procedura duhej të zhvilloheshin si një e vetme, duke proceduar me blerje on-line në SEP, "Blerje e vogël".
Kriteri 2:	Udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015, pika 3 ku cilësohet: "... Në asnjë rast, autoritetet kontraktore nuk duhet të prokurojnë veçmas mallra, shërbime apo punë që përfshihen në një grup për shkak të ngjashmërisë së tyre, apo për shkak të funksionit kryesor ".
Situata 3:	Sipas urdhrit nr. 6488, datë 31.12.2015 është urdhëruar "Shtesë kontrate-Shërbim roje private" për Godinën Gjethi, pa zhvilluar asnjë procedurë.
Kriteri 3:	VKM nr. 914, datë 29.12.2014 neni 36.5 ku cilësohet: "Kur autoriteti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, sipas kushteve të parashikuara në këtë nen, duhet të provojë se kandidatët plotësojnë minimalisht kërkesat e nenit 45" dhe neni 36.6 ku cilësohet: "Negocim pa shpallje paraprake të vlerës limit të kontratës", ku cilësohet: Në rastin e procedurës së prokurimit me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, sipas kushteve të parashikuara në këtë nen, autoriteti



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

kontraktor përdor dokumentet standarde të procedurës me negociim me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, përsa është e mundur.

Për sa është trajtuar më lart mbajnë përgjegjësi: Antarët e Komisionit të Blerjeve të Vogla për vitin 2015, 2016 dhe 2017.

2.1/b Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet arkës në valutë.

Arka valutë (euro)-2015

	2015		2016		2017	
	Arkëtime	Pagesa	Arkëtime	Pagesa	Arkëtime	Pagesa
Gjendje në fillim të periudhës	7.9		0.9		1.9	
Nga të cilat:	50,760	50,767	48,705	48,704	35,963	35,965
Tërheqje valute	24,800		26,750		13,412	
Arkëtime paradhënesh	25,760		21,955		22,551	
Gjendje në fund të periudhës		0.9		1.9		0

Burimi i informacionit: MK
Punoi: KLSH

Nga auditimi i veprimeve të kryera nëpërmjet arkës në lekë dhe valutë, për periudhën objekt auditimi rezultoi se, regjistrimet kontabël në ditarin e arkës janë bërë në mënyrë të rregullt, bazuar në dokumentet justifikuese dhe çdo muaj është bërë kuadrimi i ditarit të arkës me gjendjen e librit të arkës. Të gjitha mandat-arkëtimet dhe mandat-pagesat janë të firmosur nga dy palët, janë plotësuar në përputhje me kërkesat e formatit të përcaktuar në urdhrin e Ministrit të Financave dhe mbështeten në dokumentet justifikues ligjorë. Pagesat janë kryer duke u mbështetur në dokumentacionin justifikues, bashkëngjitur urdhër pagesës. Veprimet kontabël janë kryer në përputhje me dispozitat ligjore. Gjendja e arkës në valutë në fund të çdo viti, paraqitet zero.

Sa më sipër arrijmë në konkluzionin që: Shpenzimet e kryera nëpërmjet bankës dhe arkës në valutë, sipas dokumentacionit kontabël të audituar me zgjedhje, janë kryer në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore.

2.1/c. Inventarizimi i pronës shtetërore nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave.

Për vitin 2015, ka rezultuar se: Është kryer inventarizimi i pronës shtetërore, sipas urdhrin të inventarizimit të nxjerrë nga Titullari i Institucionit nr. 280, datë 21.07.2015. Gjendja e inventarit paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Gjendja/kontabilitet	Gjendja/fizike	Diferenca
Ndërtesa	342,431,474	342,431,474	0
Mjete transporti	15,662,646	15,662,646	0
Inventar ekonomik	61,929,359	55,431,601	-6,497,758
Instalime teknike	6,002,242	12,500,000	+6,497,758
Totali	426,025,721	426,027,721	0

Burimi i informacionit: MK
Punoi: KLSH

Gjendja e inventarit është e kuadruar sipas llogarive inventariale të pasqyruara në kontabilitet dhe aktivin e bilancit kontabël, nuk janë evidentuar diferencë në mungesë apo tepriçë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Inventari nuk është përfunduar brenda afatit datë 20.09.2015, të përcaktuar në Urdhrin e Titullarit,

Fletët e inventarit janë firmosur nga grupi i inventarizimit si dhe nga personat përgjegjës. Në përfundim të tij është përgatitur relacioni me nr. 5787, datë 19.11.2015, sipas të cilit nuk kanë rezultuar diferenca midis gjendjes kontabël dhe asaj fizike. Nga Komisioni është hartuar si dhe Memo “Mbi inventarin fizik” nr. 734, datë 10.02.2016.

Gjatë inventarizimit janë evidentuar materiale të dëmtuara fizikisht, për të cilat është mbajtur fletë inventari e veçantë në vlerën 1,090,851 lekë, pasqyruar edhe në llogarinë vjetore të vitit 2016 si pakësim aktivesh.

Për vitin 2016, ka rezultuar se: Është kryer inventarizimi i pronës shtetërore, sipas urdhrit të inventarizimit të nxjerrë nga Titullari i Institucionit nr. 380, datë 06.12.2016. Gjendja e inventarit paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Gjendja/kontabilitet	Magazinë	Përdorim
Ndërtesa	433,454,210	433,454,210	
Mjete transporti	14,693,786	9,687,368	5,006,418
Inventar ekonomik	74,926,162	51,798,249	23,127,913
Instalime teknike	31,523,654	31,523,654	
Totali	554,597,812	526,463,481	28,134,331

Burimi i informacionit: MK

Punoi: KLSH

Gjendja e inventarit është e kuadruar sipas llogarive inventariale të pasqyruara në kontabilitet dhe aktivin e bilancit kontabël, nuk janë evidentuar diferenca në mungesë apo tepriçë. Inventari është përfunduar brenda afatit datë 31.12.2016, të përcaktuar në Urdhrin e Titullarit.

Fletët e inventarit janë firmosur nga grupi i inventarizimit si dhe nga personat përgjegjës. Në përfundim të tij është përgatitur relacioni me nr. 381/1, datë 30.12.2016 dhe Informacioni nr. 331, datë 24.01.2017, sipas të cilit nuk kanë rezultuar diferenca midis gjendjes kontabël dhe asaj fizike. Gjatë inventarizimit janë evidentuar materiale të dëmtuara fizikisht, për të cilat është mbajtur fletë inventari e veçantë në vlerën 4,322,554 lekë.

Sa më sipër, arrijmë në konkluzionin që: Para mbylljes së llogarisë vjetore të vitit ushtrimor 2016 dhe 2017 është kryer inventarizimi i përgjithshëm i pasurisë, në zbatim të ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhim e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime. Kryerja e inventarizimit të pronës është bërë në përputhje të plotë me kriteret e paracaktuara.

Në përfundim mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 400², Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, bazuar në (ISSAI 4100³) japim opinion të pakualifikuar me theksim çështje, si më poshtë:

Opinion: “Mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës, arkës në lekë dhe valutë si dhe inventarizimi i pronës”.

2.1/a. Çështja e audituar mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet

² ISSAI 400: Parimet themelore të përputhshmërisë

³ ISSAI 4100 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

bankës në përgjithësi është në përputhje me kriteret e paracaktuara (kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi) në të gjitha aspektet materiale, si dhe informacioni i paraqitur është i vërtetë dhe i drejtë **përveç rastit të mëposhtëm:**

- Për shpenzimet e kryera për akomodim në hotel të personave që udhëtojnë me shërbim jashtë vendit, nga këqyrja e dokumentacionit rezulton se bashkëngjitur urdhër shpenzimeve, nuk ndodhet asnjë dokument që vërteton vlerën e akomodimit të konfirmuar nga hotelet e rezervuara on-line, dërguar agjencive turistike, të cilat kanë ofruar shërbimin për Ministrinë e Kulturës. Likuidimi i tyre është bërë vetëm referuar faturës së paraqitur nga agjencitë turistike.

2.1/b. Çështja e audituar mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet arkës në valutë është në përputhje me kriteret e paracaktuara (kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi) në të gjitha aspektet materiale, si dhe informacioni i paraqitur është i vërtetë dhe i drejtë.

2.1/c. Çështja e audituar mbi inventarizimin e pronës shtetërore nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave, është në përputhje me kriteret e paracaktuara (kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi) në të gjitha aspektet materiale, si dhe informacioni i paraqitur është i vërtetë dhe i drejtë.

2.1/d. Çështja e audituar mbi procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, në përgjithësi është në përputhje me kriteret e paracaktuara (kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi) në të gjitha aspektet materiale, si dhe informacioni i paraqitur është i vërtetë dhe i drejtë, **përveç rasteve të mëposhtme:**

- Nga auditimi i praktikave të procedurave të prokurimit “Blerje e vogël” ka rezultuar se nga Komisioni i Blerjeve të Vogla, nuk është vepruar në përputhje me procedurat e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore. Në praktikë nuk ndodhet Procesverbali i KBV, për dokumentimin e veprimeve të kryera prej komisionit në vlerësimin e OE, pra mungon gjurma e auditimit;

- Në përgjithësi në praktikat e audituara ka rezultuar se, nga OE nuk janë plotësuar të gjitha kërkesat mbi dokumentacionin që duhet të paraqesin në rast se shpallen fitues, përcaktuar kjo në “Ftesën për ofertë”. Mosparaqitja e dokumentacionit nuk është konsideruar mangësi nga Komisioni i Blerjeve të Vogla, i cili ka proceduar me kualifikimin e tyre;

- KBV ka vepruar në kundërshtim me procedurat e paracaktuara, pasi dokumentacioni, që duhet të paraqitet nga OE të shpallur fitues, nuk është e drejtë e KBV. Dokumentacioni i kërkuar në ofertë është i pandryshueshëm;

MK ka paraqitur vërejtjet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: “Në lidhje me gjetjet e mungesës së dokumentacionit të konstatuara nga grupi i auditit për 22 procedurat “blerje e vogel”, per vitin 2015, 20 procedurat “blerje e vogel” për vitin 2016 dhe 10 procedurat “blerje e vogel” për vitin 2017, ju bejme me dije se në mënyrën si është procedura në MK në lidhje me arkivimin e dosjeve të prokurimit të blerjeve të vogla rezulton se dokumentacioni origjinal i procedurave ndodhet i ndarë në dy pjesë, një pjesë bashkëlidhur urdher shpenzimeve të hartuara dhe arkivuara nga zyra e financës dhe një pjesë të arkivuara në dosjet e prokurimit të arkivuara nga sektori i prokurimit. Kjo mangësi në arkivim ka cuar me të drejtë në gjetjet e grupit të auditit mbi mungesën e dokumentave në materialet e audituara. Për të rregullar këtë situatë është urdhëruar nga Ministri që dosjet e prokurimit “blerje të vogla” të mbahen të plota dhe nëse disa dokumenta origjinale do duhet të mbahen në dosjen e financës, kjo nuk duhet të kryhet pa hartuar procesverbale të sakta mbi këtë ndarje të dokumentacionit si dhe në dosjen e prokurimit duhet te mbahen kopje të njuhësuar me origjinalin të atyre dokumentave origjinal që shkeputen nga dosja e prokurimit.

Në çdo rast nëse analizojmë dosjen e plotë tashmë (me dokumente të bashkuara nga dosja e finances dhe dosja e sektorit te prokurimit) vihet re se dokumentet e konstatuara nga ju si mungesa ndodhen në dosjet specifike”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH^{-së}: Për 12 praktika të blerjeve me vlerë të vogël për vitet 2015-2017, të cilat janë evidentuar me mangësi, nga ana e subjektit janë paraqitur observacione të mbështetura në dokumentacionin bashkëngjitur. Pasi u rivlerësuan faktet u morën në konsideratë dhe u pasqyruan në Raportin Përfundimtar të auditimit.

2.2. Mbi programimin dhe realizimin e projekteve kulturore (llog. 604).

a. Programi i veprimtarisë kulturore në projektbuxhetin e institucionit, objektivat dhe qëllimi për të cilin programohen.

Bazuar në ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën” me ndryshime, Ministria e Kulturës nxit, mbështet zhvillimin e krijimtarisë së subjekteve të artit dhe të kulturës për krijimin, ekzekutimin dhe kultivimin e veprave të të gjitha gjinive të artit dhe kulturës.

Për këtë qëllim nga buxheti i shtetit **për vitin 2015**, është planifikuar dhe miratuar fondi buxhetor ose “fondi publik i artit dhe kulturës” në total 157,341 mijë lekë për zërin 604 “projekte” nga e cila, vetëm vlera prej 76,239 mijë lekë përfaqëson financimin për një projekt të vetëm siç është “Festivalit Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës” miratuar me VKM 249, datë 18.3.2015. Auditimi për këtë periudhë u bë me zgjedhje duke vlerësuar me risk projektet me vlera të mëdha. Nga këto u audituan gjithsejt projekte me vlerë 49,550 mijë lekë. Realizimi për vitin 2015, paraqitet në vlerën 146,331 mijë lekë ose 93%.

Për **vitin 2016**, nga buxheti i shtetit janë planifikuar 144,879 mijë lekë, nga e cila, vetëm vlera prej 43,000 mijë lekë përfaqëson vlerën e financimit për 5 projekte miratuar me aktin normativ të Ministrisë së Financave për buxhetin e vitit 2016 nr.10739/51, datë 12.8.2016. Realizimi për vitin 2016, paraqitet në vlerën 142,084 mijë lekë ose 98%. Për këtë periudhë u audituan me zgjedhje projekte me vlerë 26,515 mijë lekë.

Për vitin **2017**, janë planifikuar 155,450 mijë lekë nga e cila vlera prej 20,000 mijë lekë miratuar me akt normativ, përfaqëson vlerën e një projekti. U audituan me zgjedhje projekte me vlerë 10,253 mijë lekë. Realizimi për vitin 2017, paraqitet në vlerën 148,914 mijë lekë ose 96%.

b. Realizimi i projekteve në art/kulturë, në mbështetje të dokumentacionit justifikues.

Për vitin 2015, nga Ministria e Kulturës, me Urdhër të Ministrit nr.331, datë 17.11.2014 është miratuar formulari i aplikimit për fonde dhe/ose mbështetje “Thirrje për projekt propozime, në art-kulturë dhe trashëgimi kulturore” si dhe udhëzuesit “Për procedurat e financimit dhe të mbështetjes së projekteve pranë ministrisë së kulturës për vitin 2015”.

Auditimi i projekteve u bë me zgjedhje për “programin në art/kulturë” dhe për “programin në trashëgimi” trajtuar si më poshtë:

2.2.1. Projekti “Art House” (Prog. Arti, vlera e financuar 2,119,000 lekë).

Nga auditimi konstatohet se:

Titullari i institucionit ka nxjerrë Urdhrin nr. 331/2, datë 9.1.2015 për ngritjen e kolegjiut i cili do të shqyrtojë, vlerësojë dhe propozojë miratimin e projektit dhe preventivin e paraqitur nga subjekti propozues. Me Urdhrin e ministrit nr. 331/4, datë 9.2.2015, është urdhëruar financimi i këtij projekti në vlerën 2,119,000 lekë, bazuar në propozimin e Kolegjiut me vendim nr.626, datë 9.2.2015.

-Për vlerësimin e projekt-propozimit me Urdhër të ministrit nr.331, datë 17.11.2014 është ngritur grupi i punës në përputhje me VKM nr. 709, datë 24.10.2012 kreu IV, pika 1.

-Kolegjiut ka **miratuar preventivin** e paraqitur nga subjekti, pa bërë analizë kostoje për disa nga zërat e preventivit listuar më poshtë në vlerën 775,000 lekë, pasi nuk është përcaktuar sasia



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

e llampave, destinacioni i lëvizjes së njerëzve si dhe zërat konkretë për përgatitjen e hapësirave për instalimin e ekspozitës:

“llampa Led dhe instalime” në vlerën 200,000 lekë

“vajtje-ardhje 2 organizatorë” në vlerën 2 persona x 35,000 lekë, 1 person x 35,000 lekë dhe 2 organizatorë x 35,000 lekë gjithsej 175,000 lekë

“përgatitje e hapësirave për instalimin e ekspozitës dhe shpenzime për instalimin etj” në vlerën 400,000 lekë.

Zërat e sipërm janë miratuar në mënyrë a priori nga Kolegjiumi, duke mos vepruar në përputhje me nenin 27/1, pika 1, a të ligjit nr.10352, datë 18.11.2010 i ndryshuar, sipas të cilit “ Kolegjiumi ka këto kompetenca: përzgjedh dhe klasifikon projektet e artit nga pikëpamja e vlerave... dhe ekonomike”.

-Me Urdhër Shpenzimin nr. 741, datë 21.12.2015 është likuiduar përfituesi i projektit “*Art House*”, në vlerën 578,108 lekë ose 40% të vlerës së financimit që përbën dhe fazën e dytë dhe finale të financimit bazuar në nenin 6 të kontratës nr.2523, datë 19.5.2015, pasi 60% e vlerës së kontratës është likuiduar në momentin e nëshkrimit të saj.

-Referuar situacionit përfundimtar rezulton se janë kryer pagesa për shpenzime bileta avioni në total 465,303 lekë, me dokumentacion shoqërues fotokopje (bileta-boarding pass), parregullësi në mospërputhje me Udhëzimin nr. 30 të Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” (Nga vlera totale e financimit ka mbetur pa u paguar 269,492 lekë).

2.2.2. Projekti “Dita zë fill” (Prog. Arti, vlera e financuar 1,800,000 lekë).

Me Urdhër nr. 331/2, datë 9.1.2015 është ngritur Kolegjiumi për shqyrtimin, vlerësimin dhe propozimin për miratimin e projektit dhe preventivin e paraqitur nga subjekti propozues. Me Urdhër të ministrit nr. 331/4, datë 9.2.2015, është urdhëruar financimi i këtij projekti në vlerën **1,800.000** lekë, bazuar në propozimin e Kolegjiumit me vendim nr.626, datë 9.2.2015.

-Për vlerësimin e projekt-propozimit me Urdhër të ministrit nr.331, datë 17.11.2014 është ngritur grupi i punës në përputhje me VKM nr. 709, datë 24.10.2012 kreu IV, pika 1.

Kolegjiumi ka *miratuar preventivin* e paraqitur nga subjekti. Për zërat “regji”, “skenar” etj. nuk ka një analizë të detajuar, pasi nuk ka tarifa të përcaktuara për këtë qëllim dhe si referencë përdoren çmimet e tregut.

-Me Urdhër Shpenzimin nr. 719, datë 16.12.2015 është likuiduar përfituesi i projektit “*Dita zë fill*”, në vlerën **720,000 lekë** ose 40% të vlerës së financimit që përbën dhe fazën e dytë të financimit bazuar në nenin 6 të kontratës nr.1272, datë 12.3.2015 bazuar në faturën tatimore dhe dokumentacionin justifikues, 60% e vlerës së kontratës është likuiduar në momentin e nëshkrimit të saj.

2.2.3. Projekti “Festivali Folklorik Kombëtar, Gjirokastër 10-16 Maj 2015” (Prog. Trashëgimia, vlera e financuar 21,252,370 lekë për zërin akomodim, transport, publicitet etj.)

Me VKM nr.249, datë 18.3.2015 është miratuar një shtesë në buxhetin e vitit 2015 në vlerën 76,239,500 lekë për Ministrinë e Kulturës, e cila do të përdoret për mbulimin e shpenzimeve për akomodim, transport, publicitet etj. për realizimin e festivalit folklorik të Gjirokastrës. Bazuar në ligjin nr.10352, datë 18.11.2010 me ndryshime, neni 26, pika 1, b Ministria e Kulturës financon projekte të cilat konsiderohen të rëndësishme së vecantë dhe që kanë një buxhet që arrin mbi 40% të fondit vjetor për projekte. Në zbatim të këtij detyrimi ligjor me Urdhër të Ministrit nr. 360, datë 17.2.2015 i ndryshuar është ngritur Kolegjiumi për realizimin e Fazës së parë të projektit. i cili ka miratuar fondin limit në vlerën 22,389,500



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

lekë (procesverbali datë 23.3.2015) miratuar dhe me Urdhërin nr.10, datë 23.3.2015 të Ministrit si dhe hartimin e dokumenteve të konkurrimit dhe specifikimet teknike.

Llogaritja e fondit limit si dhe hartimi i specifikimeve teknike është bazuar në vendimmarrjet e mëparshme të Kolegjiut për evente të kësaj natyre.

Me Urdhër nr.119, datë 30.3.2015 të Ministrit është miratuar Komisioni për Vlerësimin e ofertave si dhe me Urdhërin nr.118, datë 30.3.2015 është shpallur konkursi për përzgjedhjen e ofertave për zërin transport, akomodim, ushqim me fond limit 22.389,500 lekë.

KVO me anë të Procesverbalit nr.1, datë 30.3.2015 ka miratuar dokumentacionin ligjor të konkurrimit. Ftesa për ofertë i është dërguar 3 operatorëve ekonomikë bazuar në VKM nr.709, datë 24.10.2012 “Procedura e financimit të realizimit të projekteve artistike kulturore nga subjektet private” të cilët operojnë në këtë fushë.

KVO ka kualifikuar në vend të parë ofertën e operatorit “A” sh.p.k. që ka dhe vlerën më të ulët të ofertës 21,252,370 lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit të ofertës fituese konstatohet se ka mangësi në dokumentacionin e kërkuar sipas DK “specifikimet teknike” (dokumentet e konkurrimit) konkretisht:

-Dokumentet ligjore janë paraqitur vetëm për 10 mjete ndërkohë që kërkohet për 24 automjete.

-Për mjetin me targë AA129 GH mungon vërtetimi i pronësisë ose autorizim përdorimi

-Mjeti me targë AA273 dhe AA274 LE janë vit prodhimi 2008 ndërkohë që kërkohet jo më i vjetër se 2010.Me fituesin e konkurrimit operatorin ASG sh.p.k është lidhur kontrata nr.1921, datë 15.4.2015 në vlerën 21,252,370 lekë . me TVSH.

Mangësitë e konstatuara më sipër, janë materiale për nga natyra dhe nuk ndikojnë në rezultatin e kualifikimit pasi procedura që ndiqet për financimin e projekteve sipas nenit 26, pika 2 të ligjit nr.10352, datë 18.11.2010 me ndryshime, nuk i nënshtrohet legjislacionit të prokurimit publik. Pavarësisht nga kjo, KVO është e detyruar të respektojë dokumentacionin e konkurrimit të miratuar nga vetë ajo.

2.2.4. Projekti “Festivali Folklorik Kombëtar, Gjirokastër 10-16 Maj 2015” (Prog. Trashëgimia, vlera e financuar 21,252,370 lekë për zërin logjistikë, foni etj.).

Bazuar në VKM nr.249, datë 18.3.2015 që ka miratuar një shtesë në buxhetin e vitit 2015 në vlerën 76,239,500 lekë për Ministrinë e Kulturës, që do të përdoret për mbulimin e shpenzimeve për logjistikë, foni etj. për realizimin e festivalit folklorik të Gjirokastrës, si dhe në ligjin nr.10352, datë 18.11.2010 me ndryshime, neni 26, pika 1,b, me Urdhër të Ministrit nr. 360, datë 17.2.2015 i ndryshuar është ngritur Kolegjiut për realizimin e projektit. i cili ka miratuar fondin limit në vlerën 24,379,000 lekë (procesverbali datë 13.4.2015) miratuar dhe me Urdhërin nr.11, datë 13.4.2015 të Ministrit si dhe hartimin e dokumenteve të konkurrimit dhe specifikimet teknike.

Me Urdhër nr.156, datë 20.4.2015 të Ministrit është miratuar Komisioni për Vlerësimin e ofertave si dhe me Urdhërin nr.155, datë 20.4.2015 është shpallur konkursi për përzgjedhjen e ofertave për zërin “logjistikë, etj” me fond limit 24,379,000 lekë.

Llogaritja e fondit limit si dhe hartimi i specifikimeve teknike është bazuar në kërkesat e ardhura nga Regjisori i Festivalit për pajisje të teknikës, vegla muzikore, etj, në propozimin e koordinatorëve të Festivalit të bërë me shkresën datë 18.2.2015 për ambiente sanitare, çadra portative etj.(logjistikë) si dhe në sondazhet e kryera në treg nga Kolegjiut për zërat që kërkohen (procesverbali i mbedhjes datë 23.2.2015).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Nisur nga përbërja profesionale e Kolegjiut vetëm me përfaqësues të Drejtorive të ndryshme të MK konstatohet se përgatitja e specifikimeve teknike është një proces që nuk mund të realizohet me kapacitet profesionale ekzistuese të kësaj ministrie, ose përgatitja e tyre nuk është në nivelin profesional të mundshëm pasi, për të hartuar specifikimet teknike të karakterit foni, ndriçimi, skenografi etj të kësaj natyre, kërkohen specialistë të fushës. Në këtë aspekt deri tani dhe hartimi i specifikimeve teknike është bazuar totalisht në kërkesat e regjisurës apo koordinatorëve të festivalit, të cilët duke dhënë mendim individual dhe jo në grup, mund të çojnë në kërkesa të pa pabazuara që në fund kanë një kosto financiare e cila materializohet me llogaritjen e fondit limit.

Për këtë qëllim, në raste të organizimit të eventeve të tilla kombëtare, Kolegjiu duhet të ketë në përbërje të tij edhe specialistë të gjinive përkatëse të artit.

KVO ka miratuar dokumentacionin ligjor të konkurrencës. Ftesa për ofertë i është dërguar 3 operatorëve ekonomikë bazuar në VKM nr.709, datë 24.10.2012 “Procedura e financimit të realizimit të projekteve artistike kulturore nga subjektet private” të cilët operojnë në këtë fushë.

KVO ka kualifikuar në vend të parë ofertën e operatorit “S” sh.p.k. që është oferta e vetme e paraqitur datën e konkurrencës me vlerë 23,930,000 lekë me TVSH me të cilin është lidhur kontrata nr.2061/2, datë 23.4.2015.

Për vitin **2016**, nga Ministria e Kulturës, me Urdhër të Ministrit nr.442, datë 02.12.2015 është miratuar formulari i aplikimit për fonde dhe/ose mbështetje “Thirrje për projekt propozime, në art-kulturë dhe trashëgimi kulturore” si dhe udhëzuesit “Për procedurat e financimit dhe të mbështetjes së projekteve pranë ministrisë së kulturës për vitin 2016”.

Auditimi i projekteve me zgjedhje trajtuar si më poshtë:

2.2.5. Projekti “Vox Baroque” (Prog. Arti, vlera e financuar 1,200,000 lekë).

Nga auditimi konstatohet se:

Me Urdhër nr. 442/1, datë 20.1.2016 është ngritur Kolegjiu i cili do të shqyrtojë, vlerësojë dhe propozojë miratimin e projektit dhe preventivin e paraqitur nga subjekti fitues. (Kolegjiu do të shqyrtojë të gjithë projektet me thirrje për aplikim për vitin 2016). Me Urdhër e ministrit nr. 442/2, datë 15.2.2016, është urdhëruar financimi i këtij projekti në vlerën **1,200,000** lekë, bazuar në propozimin e Kolegjiut të marrë me vendim nr.5983/5, datë 15.2.2016.

-Kolegjiu ka miratuar preventivin në të cilin zërat me emërtimin “Grupi italian” në vlerën 480,000 lekë dhe në 320,000 lekë, nuk kanë të detajuar dhe të identifikuar punën/shërbimin. Tarifat e përdorura për shpërbimin e “drejtorit artistik”, “koordinatorit artistik” dhe “skenografit” janë bazuar në çmimet e tregut dhe eksperiencat e mëparshme, pasi nuk ka tarifa të miratuara për këtë qëllim.

Me Urdhër e ministrit nr. 442/3, datë 16.2.2016 është ngritur grupi për monitorimin e projekteve.

Pas përfundimit të projektit është përgatitur raporti i monitorimit nr.3098/1, datë 22.8.2016 i cili nuk është nënshkruar dhe nga anëtarët e tjerë të grupit të monitorimit.

Me Urdhër Shpenzimin nr. 527, datë 20.9.2016 është likuiduar përfituesi i projektit, në vlerën **480,000 lekë** ose 40% të vlerës së financimit që përbën dhe fazën e dytë të financimit sipas kushteve të kontratës, bazuar në dokumentacionin justifikues dhe faturën tatimore të shitjes, ndërsa me Urdhër Shpenzimin nr.343, datë 29.6.2016 është likuiduar vlera 720,000 lekë që përbën 60% të vlerës së financimit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

2.2.6. Projekti “*Festivali Ndërkombëtar Operistik Marije Kraja*” (Prog. Arti, vlera e financuar 1,250,000 lekë).

Nga auditimi konstatohet se:

Me Urdhrin e ministrit nr. 442/2, datë 15.2.2016, është urdhëruar financimi i këtij projekti në vlerën 1,250,000 lekë, bazuar në propozimin e Kolegjiumit të marrë me vendim nr.5983/5, datë 15.2.2016.

Në preventivin e miratuar nga Kolegjiumi tarifa për shpërblimin e zërave “orkestrantë kat.parë”, “spala”, “koncert maestër i orkestrës” dhe “regjisor “i është referuar cmimeve të tregut dhe eksperiencave të mëparshme, pasi nuk ka tarifa të miratuara për këtë kategori shërbimi/performance.

Me Urdhër Shpenzimin nr.743, datë 6.12.2016 është likujduar shoqata “K” në vlerën 500,000 lekë ose 40% të vlerës së kontratës mbi bazën e faturës dhe dokumentacionit justifikues, ndërsa diferenca që përbën 60% të vlerës së financimit është likujduar në momentin e nënshkrimit të kontratës.

2.2.7. Projekti “*10 vjet Poeteka*” (Prog. Arti, vlera e financuar 1,500,000 lekë).

Nga auditimi konstatohet se:

Me Urdhrin e ministrit nr. 442/2, datë 15.2.2016, është urdhëruar financimi i këtij projekti në vlerën 1,500,000 lekë, bazuar në propozimin e Kolegjiumit të marrë me vendimin nr.5983/5, datë 15.2.2016.

Miratimi i preventivit nga Kolegjiumi është bërë pa detajuar në mënyrë analitike zërin “botim, shtypshkrim ...” në vlerën 200,000 lekë (nuk shprehet sasia dhe cmimi/njësi) dhe zërin “shpenzime akomodimi” në vlerën 200,000 lekë.

Pas përfundimit të projektit është paraqitur raport monitorimi me shkresën nr.818/3, datë 12.12.2016 i cili nuk rezulton të jetë nënshkruar dhe nga anëtarë të tjerë të grupit të monitorimit.

Me Urdhër Shpenzimin nr.797, datë 14.12.2016 është likujduar shoqata “P” në vlerën 600,000 lekë ose 40% të vlerës së kontratës mbi bazën e faturës dhe dokumentacionit justifikues, ndërsa diferenca që përbën 60% të vlerës së financimit është likujduar në momentin e nënshkrimit të kontratës. Nga MK është likujduar gjithashtu shpenzimi që rrjedh nga detyrimi kontraktor i qiradhënies të lidhur mes subjektit përfitues të projektit dhe qiradhënësit për sipërfaqen 83 m², në vlerën 200,000 lekë. Ky shpenzim nuk është parashikuar në preventivin e miratuar nga Kolegjiumi dhe pse si vlerë përputhet me vlerën e zërit “akomodim” sipas shpejgimeve të subjektit (MK). Parregullësi të tilla në detajimin e preventivit i cili miratohet nga Kolegjiumi sipas përcaktimit ligjor neni 27/1, pika 1/a Ligji nr. 10352, datë 18.11.2010 me ndryshime, sjellin paqartësi dhe vonesa në kryerjen e veprimeve financiare.

2.2.8. Projekti “*Koncert i Shkelzen Dollit dhe Filarmonisë së Vienës*” (Prog. Arti, vlera e financuar 22.565,152 lekë).

Nga auditimi konstatohet se:

Me aktin normativ nr.1, datë 29.7.2016 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 147/2015”Për buxhetin e vitit 2016” të Ministrisë së Financave janë miratuar ndryshimet në planin buxhetor të vitit 2016 në vlerën 43,000 mijë lekë .

Pas celjes së fondeve nga Ministria e Financës me Urdhërin e Ministrit të Kulturës nr.342, datë 24.10.2016 është miratuar mbështetja financiare për projektin e koncertit të violinistit Shkelzen Dollit dhe Filarmonisë së Vienës, në vlerën 165,930 euro bazuar në propozimin e bërë me vendimin nr.5208, datë 24.10.2016 të Kolegjiumit.Kolegjiumi i ngritur me Urdhër të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

ministrit nr. 30, datë 9.02.2016 ka miratuar vetëm ato zëra të preventivit të paraqitur nga subjekti “A” shpk që përfaqëson violinistin Shkelzen Dolli, të cilat ndikojnë direkt në promovimin e trashëgimisë kulturore shqiptare të tilla si: “prodhimi i 3 videoklipeve në monumentet e trashëgimisë kulturore shqiptare” në vlerën 37,180 euro, “promovimi dhe publiciteti (reklama) i projektit” në vlerën 8,000 euro dhe “pagesat për shpërblimin e 35 artistëve” në vlerën 120,750 euro. Kolegjiumi për çmimet e këtyre zërave që përfaqësojnë kategori interpretimi artistik, realizimi artistik si dhe prodhimin publicitar i është referuar çmimeve të tregut dhe eksperiencave të mëparshme, pasi nuk ka tarifa të miratuara nga organe të njohura me ligj.

Me Urdhër Shpenzimin nr.806, datë 14.12.2016 është likujduar shoqëria “A” në vlerën 13,512,012 lekë/99,558 euro ose 60% të vlerës së kontratës mbi bazën e faturës dhe dokumentacionit justifikues.

Për vitin 2017, nga Ministria e Kulturës, me Urdhër të Ministrit nr.376, datë 30.11.2016 është miratuar formulari i aplikimit për fonde dhe/ose mbështetje “*Thirrje për projekt propozime, në art-kulturë dhe trashëgimi kulturore*” si dhe udhëzuesit “*Për procedurat e financimit dhe të mbështetjes së projekteve pranë ministrisë së kulturës për vitin 2017*”.

Auditimi i projekteve me zgjedhje trajtuar si më poshtë:

2.2.9. Projekti “*Koncert i Shkelzen Dollit dhe Filarmonisë së Vienës*” (Prog. Arti, vlera e financuar 22.565,152 lekë).

Nga auditimi konstatohet se:

Me Urdhërin e Ministrit të Kulturës nr.342, datë 24.10.2016 është miratuar mbështetja financiare për projektin e koncertit të violinistit Shkelzen Dolli dhe Filarmonisë së Vienës, në vlerën 165,930 euro. Procedura për miratimin e mbështetjes financiare dhe miratimit të preventivit janë zhvilluar në vitin 2016, si dhe likujdimi prej 60% të vlerës së financimit të cilat janë trajtuar më sipër. Me Urdhër Shpenzimin nr.56, datë 14.02.2017, është likujduar subjekti përfitues “A” në vlerën 66,372 euro/9,053,141 lekë ose 40% e vlerës së kontratës bazuar në faturën tatimore dhe dokumentacionin justifikues.

2.2.10. Projekti “*Ciceroni virtual*” (Prog. Arti, vlera e financuar 1,200,000 lekë).

Me Urdhërin e Ministrit nr. 74, datë 30.2.2017, është urdhëruar financimi i këtij projekti në vlerën 1,200,000 lekë, bazuar në propozimin e Kolegjiumit të marrë me vendimin nr.887, datë 17.2.2017. Kolegjiumi i ngritur me Urdhër të Ministrit nr.376/1, datë 16.01.2017 ka miratuar me Vendimin nr.887, datë 17.2.2017 projektin dhe preventivin e paraqitur nga subjekti konkurrues, në vlerën 1,200,000 lekë. Zërat e preventivit “ekspertizë” .” Aplikacion pajisje teknike....” dhe “Instalim i objekteve të artit në aplikacion...” janë zëra të cilët nuk kanë një analizë të detajuar kostoje, por merren “a priori” ashtu siç i ka paraqitur subjekti, duke mos analizuar cmimet e tregut apo eksperiencat e mëparshme.

Me Urdhër Shpenzimin nr. 591, datë 21.9.2017, është likujduar subjekti përfitues “Metroresearch” në vlerën 40% të kontratës ose 480,000 lekë pas përfundimit të projektit.

Gjetje nga auditimi:

Situata:	Nga auditimi me zgjedhje i projekteve në art-kulturë dhe trashëgimi kulturore për vitet 2015, 2016 dhe 2017 konstatohet se në disa raste, tarifa për financimin e zërave të tillë si “orkestrantë kategoria e parë”, “spala”, “koncert maestër i orkestrës”, “regjisor”, “prodhimi i videoklipeve në monumentet e trashëgimisë kulturore shqiptare”, “drejtor artistik”, “koordinator artistik”, “skenograf” etj. i referohet
-----------------	---



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

	<p>çmimeve të tregut dhe eksperiencave të mëparshme, pasi nuk ka tarifa të miratuara për kontributin e angazhimit të përkohshëm në projektet artistike. Ministria e Kulturës, si organ qendror nuk ka një Bord Artististik sikurse kanë organet e saj të varësisë bazuar në nenin 10, të Ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën” me ndryshime, në të cilat ajo ka përfaqësuesit e saj, pasi në bazë të detyrimit që përcakton neni 11 i këtij Ligji, Bordet miratojnë kriteret dhe masën e shpërblimit të krijimtarisë artistike.</p> <p>Në lidhje me zbatimin e këtij neni dhe referuar nenit 34, pika 1 të ligjit “Për artin dhe kulturën” me ndryshime, ligjvënësi ka ngarkuar Këshillin e Ministrave për përcaktimin e masës së shpërblimit të gjinive artistike, sipas fushave të artit dhe për kontributin e angazhimit të përkohshëm në projektet artistike. Ky instrument ligjor ende nuk është miratuar dhe pse në nenin 35 të tij, afati ligjor i parashikuar ka qënë 6 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit. Në kushtet e mungesës së rregullimit ligjor për tarifën, për vlerësimin e projekteve, krijohen mundësi për abuzime/shpenzime të paargumentuara gjatë realizimit të tyre</p>
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.20014 e ndryshuar, neni 26, pika 6/a.
Ndikimi/efekti:	Ligji nr. 10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën” me ndryshime, 10, neni 34.
Shkaku:	Mungesa e tarifave për kontributin e angazhimit në projekte sjell si pasojë, abuzime/shpenzime të paargumentuara gjatë realizimit të tyre. Mospërbushja e detyrime ligjore që rrjedhin nga neni 35 i Ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010
Rëndësia e shkeljes:	E lartë
Rekomandimi:	Të kërkohet nga Këshilli i Ministrave përmirësim ligjor (shtesa dhe ndryshime), në Ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën” me ndryshime, në nenin 10 dhe neni 35. Ministria e Kulturës si organ përgjegjës për artin dhe kulturën, të ketë pranë saj Bordin Artistik Bordet të civilitetit ligji i njeh të drejtën e miratimit të kriterëve dhe masës së shpërblimit të krijimtarisë artistike. <p>Gjithashtu, bazuar në nenin 35 të ligjit Ministria e Kulturës të kërkojë nga Këshilli i Ministrave, sipas detyrimit që rrjedh nga neni 34 i ligjit, nxjerrjen e vendimit për masën e shpërblimit të gjinive artistike, sipas fushave të artit dhe për kontributin e angazhimit të përkohshëm në projektet artistike.</p>

*Subjekti i audituar ndaj këtij akti ka bërë observacion me komente dhe shpjegime si më poshtë i cili, pasi u mor në shqyrtim **nuk merret në konsideratë** me arsyetimin:*

1.Pretendimi i subjektit per projektin “Art House” ku është konstatuar që kolegji ka miratuar preventivin të paraqitur nga subjekti pa bërë analize kostoje, si dhe për të gjitha projektet e tjera ku është konstatuar e njëjta gjetje, ju sqarojme se subjektet të cilat financohen nga MK nëpërmjet thirrjes publike me aplikim, e zhvillojnë analizën e kostove duke patur parasysh negociimet apo çmimet e tregut që ofrohet nëpërmjet shërbimeve me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

tretët për të arritur produktin dhe objektivin e projektit. Në raste specifike Kolegjiumi sugjeron uljen e kostove për njësi, kjo në raport dhe me fondin e miratuar nga MK për secilin vit.

Qendrimi i audituesve KLSH-së: Në lidhje me këtë pretendim, sqarojmë dhe njëherë se konstatimi i KLSH i cili është në përputhje të plotë me ligjin Nr.10352, datë 18.11.2010 i ndryshuar, neni 27/1, pika 1, a nuk ka të bëjë me procedurën e ndjekur nga MK për testimin e tregut për zërat të veçantë të preventivit, por me miratimin a priori që bën Kolegjiumi të disa zërave të preventivit për projektë të ndryshme të cilat nuk detajohen në mënyrë analitike sipas njësisë, sasisë dhe çmimit, të cilat në përfundim çojnë në analizë analitike të preventivit. Për rrjedhojë observacioni **nuk merret në konsideratë.**

2. Pretendimi i subjektit për projektin **Festivali Folklorik Gjirokastër (zëri akomodim transport publicitet)** ku është konstatuar që subjekti fitues ka paraqitur me dokumentacion vetëm 10 mjete transporti ndërkohë që kërkohen 24 automjete, ju sqarojmë se grupi i auditit i është referuar detajimit që ka bërë kolegjiumi për nevojat për automjete për të gjithë periudhën e aktivitetit. Ky detajim përkon për nevojat në kohë dhe vende të ndryshme ku do të realizoheshin aktivitetet në kuadër të festivalit. Po ti referohemi procesverbalit nr. 1, datë 30.3 2015 ku parashikohen kërkesat për kualifikim komisioni nuk ka percaktuar paraqitjen e një numri të caktuar automjeteve. (Bashkelidhur do të gjeni PV nr. 1).

Qendrimi i audituesve KLSH-së: Në lidhje me këtë pretendim, sqarojmë se mospërcaktimi i numrit të mjeteve si kërkesë specifike ashtu sikurse dhe pretendohet nga ana e subjektit, nuk garanton realizimin me sukses të kontratës (projektit). Në këtë këndvështrim, mungesa e një kërkesë të tillë e bën jo të plotë hartimin e dokumenteve të konkurrimit. Nga ana tjetër në Procesverbalin bashkangjitur observacionit, shprehet qartë se “lista e këtyre mjeteve të transportit duhet të jetë e njohur paraprakisht...” cka tregon se MK ka vendosur një kërkesë të tillë referuese në DK (24 mjete automjete) e cila përbën kusht kualifikimi. Në kushte të tilla observacioni **nuk merret në konsideratë.**

3. Pretendimi i subjektit për projektin **“Vox Baroque”** ku është konstatuar që raporti i Monitorimit nuk është nënshkruar nga të gjithë monitoruesit, si dhe për të gjitha projektet e tjera ku është konstatuar e njëjta gjëje ju sqarojmë që bazuar në urdhërat e monitorimit secili specialist i fushës ka një numer dhe fushën e përcaktuar të projekteve që monitorin. Në përfundim të monitorimit nga specialisti apo monitoruesit e deleguar në institucionet përkatëse kur aktiviteti zhvillohet jashtë territorit të qarkut Tiranë, raporti i monitorimit përveç specialistit përkatës konfirmohet edhe nga titullari i Drejtorisë së Përmbytjes.

Qendrimi i audituesve KLSH-së: Pretendimi merret në **konsideratë pjesërisht** vetëm për faktin që specialisti apo monitoruesi i deleguar në institucionet përkatëse nënshkruan për projektin nën monitorim, por Raporti i Monitorimit duhet të nënshkruhet nga anëtarët e urdhëruar me Urdhër Ministri apo konfirmohet nga Drejtori Drejtorisë së Përmbytjes.

2.3. Shpenzimet për investime.

(Zbatimi i procedurave ligjore në prokurimin e fondeve publike).

Nga Ministria e Kulturës në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, për vitin **2015** janë zhvilluar 71 procedura prokurimi nga të cilat:

- 5 procedura “Tender i Hapur” me fond limit 118,283,321 lekë,
- 5 procedura “negocim pa shpallje”, me fond limit 4,722,342 lekë,
- 1 procedurë “kërkesë për propozim”, me fond limit 6,656,000 lekë,
- 2 procedura “shtesa kontrate” me fond limit 769,450 lekë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

-58 procedura “blerje me vlera të vogla”, me fond limit 8,101,368 lekë.

Fondi limit i vënë në dispozicion të AK është 138,532,481 lekë, realizuar 114,879,372 lekë ose 137,328,861 lekë me TVSH. Diferenca prej 23,653,109 lekë përbën diferencën mes fondit limit dhe vlerës së kontratës fituese.

Për vitin **2016**, janë zhvilluar 85 procedura prokurimi nga të cilat:

-4 procedura “Tender i Hapur” me fond limit 1,484,052,098 lekë,

-8 procedura “negocim pa shpallje”, me fond limit 52,056,484 lekë,

-3 procedura “shtesa kontrate” me fond limit 7,921,747 lekë,

-1 procedurë “shërbim konsulence” me fond limit 7,486,863 lekë

-61 procedura “blerje me vlera të vogla”, me fond limit 10,051,538 lekë.

Fondi limit i vënë në dispozicion të AK është 1,561,568,731 lekë, realizuar 1,412,283,489 lekë ose 1,693,826,174 lekë me TVSH. Diferenca prej 149,285,242 lekë përbën diferencën mes fondit limit dhe vlerës së kontratës fituese.

Për vitin **2017**, janë zhvilluar 18 procedura prokurimi nga të cilat:

-3 procedura “Tender i Hapur” me fond limit 45,283,128 lekë

-14 procedura “negocim pa shpallje”, me fond limit 179,873,741 lekë

-26 procedura “blerje me vlera të vogla”, me fond limit 8,638,230 lekë.

Fondi limit i vënë në dispozicion të AK është 233,795,099 lekë, realizuar 230,862,214 lekë ose 276,768,279 lekë me TVSH. Diferenca prej 2,932,885 lekë përbën diferencën mes fondit limit dhe vlerës së kontratës fituese.

Për periudhën objekt auditimi, nga 174 tendera të zhvilluar me fond limit 1,933,896 mijë lekë, janë audituar 10 tendera me fond limit 1,794,054 mijë lekë e cila përfaqëson 92% të fondit limit të vënë në dispozicion të AK.

U audituan tenderët me objekt:

1. “Rikonstruksioni i Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijët/Teatri i Kukullave dhe Qendrës Kombëtare të Veprimtarive të Folklorit” me fond limit 47,835,830 lekë..

2. “Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor”, me fond limit 998,862,862 lekë.

3. Rindërtimi i banesës zona kadastrale 8564” në Korçë me fond limit 22,396,023 lekë.

4. “Rikonstruksioni dhe ndryshim destinacioni i ish Laboratorit të Hidroteknikës në qendër arti Skena e Re” faza e II” me fond limit 449,612,938 lekë.

5. “Rikonstruksioni dhe përshtatje e godinës së ish-Lidhjes së Shkrimtarëve në funksion të strukturave të Ëetting-ut”, me fond limit 84,676,788 lekë procedurë “Negociim pa shpallje”, prokurim i klasifikuar në nivelin "I kufizuar".

6. “Rikonstruksioni dhe përshtatje e godinës së ish-Lidhjes së Shkrimtarëve në funksion të strukturave të Ëetting-ut”, shtesë kontrate me fond limit 16,661,663 lekë (I kufizuar).

7. “Blerje pajisje të teknologjisë dhe informacionit dhe pajisje të tjera për strukturat e Vettingu-t” me fond limit 57,128,028 lekë (I klasifikuar).

8. “Muzerealizimi i Godinës së ish Selisë së Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit (Objekti i Gjethit)” me fond limit 41,046,542 lekë.

9. “Sistemi i disinfektimit, konservimit i ruajtjes së ikonave në Muzeun e Artit Mesjetar Korçë” me fond limit 39,787,907 lekë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

10. “Krijimi i qendrave të informimit publik për regjistrimet online të pasurive kult-kombet” me fond limit 36,046,173 lekë.

Efekti i garës në tenderët e audituar është 159,368 mijë lekë (1,794,057 – 1,634,683) ose rreth 9 për qind ndaj vlerës së fondit limit. Ky efekt është pothuaj tërësisht nga tenderët me objekt “Rehabilitim i TOB ...” (72,108 mijë lekë), “Rikonstruksion i skenës faza e II” (70,010 mijë lekë) dhe “Rikonstruksioni i qendrës kombëtare të fëmijëve ...”, 2,125 mijë lekë).

Nga auditimi ka rezultuar dëm ekonomik në buxhet me vlerë **83,060,768 lekë** në tenderët me objekt si më poshtë:

2.3.1. “Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor”, me fond limit 998,862,862 lekë i zhvilluar gjatë vitit 2016.

2.3.1.1. Parregullsi e konstatuar:

Njësia e prokurimit, në hartimin dokumentacionit standard (DS) të tenderit me objekt “Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor” ka vendosur kriteret të veçanta në kualifikimin (KVK) e operatorëve ekonomikë në kundërshtim me:

- Frymën/thelbin e nenit 1 “Objekti dhe qëllimi” i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar në të cilin është përcaktuar se ... *Qëllimi i këtij ligji është:*

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

- Nenin 46 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të cilin ndër të tjera është përcaktuar se ... *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese*

Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.

- Nenin 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në të cilin ndër të tjera është përcaktuar se ... *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës...*

KVK e vendosura nga njësia e prokurimit, kanë ndikuar thelbësisht në pjesëmarrjen e OE në tender dhe në përcaktimin e OE fitues.

Argumentim:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Nga verifikimi i dokumentacionit kryesisht KVK, u konstatua se njësia e prokurimit ka vendosur kriteret/kërkesa të padrejta (të tepërta/të panevojshme për zbatimin e kontratës), të cilat përfundojnë me cenimin e vet qëllimit të ligjit të prokurimit publik dhe në themel kanë përcaktuar OE fitues, si më poshtë:

2.3.1.2. Ka kërkuar që OE pjesëmarrës në tender të kenë në stafin e vet teknik të punësuar për periudhën janar-dhjetor 2014, janar-dhjetor 2015 dhe janar-korrik 2016 *një inxhinier mjedisi*, ndërkohë që në licencën e OE, nuk është kërkuar kategoria e punimeve *N.P. 12 Punime të inxhinierisë mjedisore*.

2.3.1.3. Ka kërkuar që OE pjesëmarrës në tender të kenë në stafin e vet teknik të punësuar për periudhën janar-dhjetor 2014, janar-dhjetor 2015 dhe janar-korrik 2016 *një arkitekt*, ndërkohë që objekti është punë/zbatim.

2.3.1.4. Ka kërkuar që OE pjesëmarrës në tender duhet të kenë të punësuar:

2.3.1.4.1 një ekspert mbi akustikën me përvojë pune minimalisht 10 vjeçare, në të paktën 5 objekte të ngjashme sipas objektit të prokurimit.

2.3.1.4.2. Një ekspert mbi skenat me përvojë pune minimalisht 10 vjeçare, në të paktën 5 objekte të ngjashme sipas objektit të prokurimit.

Në të dy rastet, vendosja e kriterit për "*përvojë në punë 10 vjeçare*" është në kundërshtim me parashikimet ligjore që përcaktojnë "*përvojë, punime të ngjashme*" të kryer nga gjatë tre vjetëve të fundit, ndaj kohës së zhvillimit të tenderit.

Kjo marrëdhënie për të dy ekspertet me vete OE të vërtetohet me:

- Kontrate bashkëpunimi të nënshkruar mes palëve;
 - CV e punëve të realizuara në projektim ose zbatim;
 - Referenca nga bashkëpunëtorët për punët e ngjashme sipas objektit të prokurimit për pjesen e akustikës për secilin objekt të deklaruar.
 - Referenca nga bashkëpunëtorët për punët e ngjashme sipas objektit të prokurimit për pjesen e skenës për secilin objekt të deklaruar (pika 5.4 e KVK) ndërkohë që: formulimi ... *ekspert mbi akustikën dhe ekspert mbi skenat* ... është i kundërligjshëm, diskriminues, pasi nuk i referohet ndonjë dispozite ligjore, ndonjë profesioni, ose kategorie punimesh që ligji njih.
- Ligjërish ky kriter është i zgjidhur njëherësh, dyfish në KVK e hartuara nga vet AK (njësia e prokurimit):

- Njëpërmjet kategorive të punimeve që duhet të kenë në licencë OE, kërkuar nga AK (njësia e prokurimit) për realizimin e punimeve (pika 4.1. e KVK të miratuara) dhe

- Punë të ngjashme në punë civile ... plotësimi i së cilës ... do të vërtetohet njëpërmjet dokumenteve si më poshtë:

a. Për kontrata të realizuara me Institucione shtetërore, duhet të paraqitet kontrata, formulari i vlerësimit sipas shtojcës bashkangjitur, akt kolaudimi, situacioni përfundimtar dhe fatura tatimore.

b. Për kontrata të realizuara me subjektet private, duhet të paraqitet kontrata, leja e ndërtimit, situacion përfundimtar, akt kolaudimi dhe leja e përdorimit, faturë tatimore (pika 3 e KVK të miratuara).

Për më tepër, kushti që "*ekspertët ...*" të kenë përvojë pune minimalisht 10 vjeçare, në të paktën 5 objekte të ngjashme sipas objektit të prokurimit, ka paracaktuar/vulosur plotësisht, se kush do të jetë OE fitues.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Akoma më i kundërligjshëm është përcaktimi i bërë nga njësia e prokurimit, që *ekspertët të kenë realizuar të paktën 5 objekte të ngjashëm ...* Lidhur me përvojën për “Punime të ngjashme” LPP kërkon vlerën e *punimeve të ngjashme të kryera*, dhe jo numër objektesh, ndërkohë që në rastin konkret kërkohet numër objektesh.

Në argumentim të pikës 3.2. lidhur me *marrëdhënien e dy ekspertëve me vete OE ...* Njësia e prokurimit e ka zgjidhur në pikën 5.2. të KVK në të cilën është përcaktuar se ... *Për inxhinieret pjese e stafit të cilët duhet detyrimisht të jene të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për periudhën e mësipërme, duhet të paraqitet kontratë pune...*

Ky përcaktim bën akoma më shumë të pa mbështetur në ligj, papranueshëm kriterin e njësisë së prokurimit lidhur me sa është parashikuar për *marrëdhënien e dy ekspertëve me vete OE*.

(BOE që ka fituar tenderin, kriterin për një ekspert mbi “akustikën” dhe një ekspert mbi “skenën”, e ka plotësuar me lidhjen e marrëveshjeve me një inxhinier ndërtimi i profilizuar për “Konstruksione civile dhe industriale” dhe një inxhinier elektrik/kompjuterik, shtetas rumunë, të cilët kanë paraqitur vetëm vërtetime (pa vleftë) nga të tretë, sipas të cilëve kanë realizuar nga 5 objekte secili (akustikë dhe skenë). Vërtetimet për punë të ngjashme për “Skenë” janë për punë të realizuara para vitit 2005.

Eksperti G. i diplomuar në inxhinieri elektrike, në cilësinë e “Konsulentit”, i cili ka lidhur kontratë për zbatimin e punimeve të “akustikës” dhe “skenës”, për *punime të ngjashme* ka paraqitur disa vërtetime për **blerje pajisje “fonie”** etj, të kësaj natyre prej vitit 1998, e fundit prej të cilave është në vitin 2007 me vlerë rreth 3,500 mijë lekë.

Sa më sipër komprometon qëllimin, vendosjen e këtij kriteri, pasi nga verifikimi i dokumentacionit të shoqërisë fituese, asnjë nga ekspertët, nuk ka punime/projektme deri 10 vjet para zhvillimit të tenderit dhe ato të paraqitura, i kanë pa vlerë).

Ky kriter nuk përputhet gjithashtu dhe me kërkesat e nenit 26, pika 8/a VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, sipas të cilit “*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore*”. Në përmbushje të këtyre kërkesave AK nuk ka kërkuar që për të përmbushur këtë kriter operatori duhet të zotërojë ndonjë dëshmi/diplomë e cila ka lidhje direkt me kriterin, por ka vënë kërkesa që nuk plotësojnë qëllimin e tij siç është CV e punëve të realizuara etj....

Nëse i referohemi edukimit të arsimit të lartë në Shqipëri, rezultojnë se nuk ekziston si disiplinë më vete “inxhinieria akustike”, ashtu siç e kanë të përfshirë në programet e tyre Universitetet e Bashkimit Evropian. Inxhinieria akustike, si disiplinë shkencore merret me prodhimin, riprodhimin, transmetimin, regjistrimin e tingujve, studimi i të cilës mundësohet në nëndegë të tilla si: fizikë akustike, elektro akustikë, akustikë muzikore, akustikë arkitektonike etj. Në vendin tonë kjo ekspertizë nga eksperiencia në mënyrë të përgjithshme është mbuluar nga inxhinieria elektroteknike. Në kushte të tilla, kërkesa për “**ekspert akustike**” duhet ti referohej në mënyrë të përgjithshme dëshmive/diplomave përkatëse. Për pasojë, kriteri i vendosur kufizon pjesëmarrjen në tender të operatorëve, krijon pabarazi në oferta dhe pengon konkurrencën.

-Për “**fuqinë mesatare punëtore**”, AK ka kërkuar që “*operatori duhet të dëshmojë se përveç specialistëve të disiplinave të sipër përmendura....duhet të rezultojnë të punësuar personeli teknik i kualifikuar nga IQT, Grupi III e lart.....*”. Vendosja e këtij kriteri nuk është në përputhje me:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

-Ligjin nr. 83/2013, datë 14.2.2013 “Për Shfuqizimin e Ligjit nr. 9595, datë 27.7.2006 “Për Krijimin e Inspektoratit Qendror Teknik”, pasi me këtë ligj është shfuqizuar IQT. Në këtë kontekst kriteri i vënë nga AK për kualifikimin nga IQT nuk qëndron, pasi nuk ekziston si subjekt licencues.

-Ligjin Nr. 8734, datë 1.2.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike” pasi nëse i referohemi dëshmi që jep subjekti “*Inspektorati i Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike (IPIE) i cili është organizëm teknik dhe Kontrollues*” që sipas nenit 9 lëshon dëshmi aftësie për përdorimin e pajisjeve elektrike. Sjellim në vëmendje që ligjvënësi në këtë rast, kur kemi të bëjmë me përdorimin e këtyre pajisjeve ka pasur parasysh të bëhet nga staf i kualifikuar. Në rastin konkret, objekti i tenderit nuk është “shërbim” apo “furnizim” por është “punë” dhe nisur nga përcaktimi që bën ligji për IPIE-në, si organ që lëshon dëshmi aftësie për rastet kur kemi të bëjmë me kryerje shërbimi mirëmbajtje dhe përdorimi të pajisjeve elektrike, kriteri është jo transparent.

Megjithëse kriteri është inekzistent, përsëri dhe pse i vënë në këto kushte, nuk i është bërë interpretimi teknik dhe ligjor se pse është bërë modifikimi/ndryshimi i kësaj kërkesë në DT nga kërkesa për “*personel teknik i kualifikuar nga IQT, Grupi IV e lart*” në kërkesën për “*personel teknik i kualifikuar nga IQT, Grupi III e lart*”, modifikim i cili ka ardhur si rezultat i ankimeve të OE që më hollësisht trajtohen më poshtë. Një veprim i tillë nuk është në përputhje me kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.20014 me ndryshime, neni 61/2 sipas të cilit “*Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim,... Në çdo rast ... duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre....*”.

2.3.1.5. Lidhur me “Makineritë” (pika 6 e KVK). Ka kërkuar që OE pjesëmarrës në tender duhet të **kenë 27 copë makineri/pajisje të cilat, nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera deri në përfundim të punimeve (30 muaj)** ... ndërkohë që punimet në objekt nuk kryhen të gjitha në front njëherësh, por kryhen sipas grafikut të punimeve.

Kështu sipas grafikut, punimet e ndërtimit për gërmim, transport etj të kësaj natyre, përfundojnë kryesisht brenda 10 muajve të parë. Ndërkohë AK (njësia e prokurimit) ka kërkuar 5 copë “Kamionë vetëshkarkues” me kapacitet mbajtës mbi 20 ton, të mos angazhohen në kontrata të tjera pune (gati për dy vjet të rinë pa punë).

Sipas preventivit këto zëra punimi janë rreth 10,000 m³, dhe sikur mjetet të kryejnë vetëm një rrugë/ditë, ky volum pune do të kryhej për rreth tre muaj.

I njëjti arsyetim vlen dhe për mjetet autobetonierë 3 copë, autopompë betoni 3 copë, autovinç me aftësi mbajtëse 70 ton një copë, fadrom dy copë, autobot një copë etj.

Njësia e prokurimit, kërkesën për “Disponibilitetin e makinerive”, nuk e ka shoqëruar me llogaritjet përkatëse bazuar mbi volumin e punimeve të parashikuar në preventive.

Nën arsyetimin e mësipërm, kushti i njësive së prokurimit **që makineritë/mjetet nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera deri në përfundim të punimeve (30 muaj), është i kundërligjshëm (bie ndesh me dispozitat e përshkruara më lart).**

Për më tepër, nga verifikimi në vend i kantierit (rreth 400 m²) dhe “Plan-Organizimi i punimeve” të paraqitur nga OE, rezulton se ka vend vetëm për sasi mjetesh (jo më shumë se 10) dhe materialesh tejet të kufizuar. Nuk ka mundësi të parkohen në kantier 5 kamionë vetëshkarkues me peshë mbi 20 ton, 6 autobetoniera etj.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

2.3.1.6. Ka kërkuar që OE pjesëmarrës në tender duhet të kenë një autovinç me aftësi mbajtëse mbi 70 ton, ndërkohë që sipas preventivit të punimeve, pesha maksimale e pajisje/makinerive që do të instalohen, nuk kalon pesë ton.

2.3.1.7. Ka kërkuar që OE pjesëmarrës në tender duhet të ketë për periudhën janar 2014 deri korrik 2016, jo me pak se 150 punonjës.

Për këtë numër mesatar punonjësish, nuk jepet ndonjë llogaritje, ose argument se mbi çfarë baze është kryer dhe konkretisht se për çfarë specialitetesh është llogaritur.

Për më tepër është kërkuar që *Operatoret Ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre teknik të punësuar për periudhën janar-dhjetor 2014, janar-dhjetor 2015 dhe janar-korrik 2016:*

- 1 Arkitekt
- 1 Inxhinier ndërtimi Strukturist
- 2 Inxhinier ndërtimi
- 1 Inxhinier elektrik
- 2 Inxhinier mekanik
- 1 Inxhinier mjedisi
- 2 Inxhinier hidroteknik
- 1 Inxhinier gjeolog

Për inxhinieret pjesë e stafit të cilët duhet detyrimisht të jenë të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për periudhën e mësipërme, duhet të paraqitet kontratë pune ... me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt ...

Kushti që ... *inxhinierët pjesë e stafit ... detyrimisht të jenë të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për periudhën e mësipërme*, është në kundërshtim me dispozitat ligjore të përshkruara, diskriminues etj ... për OE që duan të konkurrojnë.

Mbështetur në normat/punonjës/makineri sipas manualit të miratuar me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 dhe UKM nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, numri mesatar i punonjësve të nevojshëm sipas specialiteteve, nuk e kalon shifrën 80.

Në tërësi kriteret/kërkesat e njësisë së prokurimit për “Makineritë/pajisjet” dhe numrin mesatar vjetor të punonjësve janë diskriminuese për OE që kërkojnë të konkurrojnë.

2.3.1.8. Pasaktësi e konstatuar:

Në preventiv është përfshirë si zë punimi (më vete) “Punime për ngritje kantjeri”. Në preventivin e bashkimit të operatorëve ekonomikë (BOE) “E” sh.p.k. & “A” sh.p.k. fitues, *punimet për ngritje kantjeri* janë paraqitur me vlerë 1,841,942 lekë, ose 1,934,039 lekë gjithsej (1,841,942 lekë x 1.05 fondi rezervë). Në preventiv/situacion (ndarja e punimeve) ky punim është parashikuar/realizuar nga OE “E” sh.p.k.

Përfshirja si zëra punimi me vete në preventiv/situacion i sa më sipër është në kundërshtim me germën B/3 të “Shpenzimet e përgjithshme dhe fitimi” të UKM nr. 2, datë 8.5.2003 në të cilën është përcaktuar se në shpenzimet e përgjithshme përfshihen *Shpenzimet për masat e sigurimit teknik, rrethimet e përkohshme gjatë ndërtimit në lartësi, skelat, makineritë,*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

tabelat sinjalizuese etj. Nën këtë arsyetim vlera prej 1,934,039 lekë gjithsej përbën dëm ekonomik, e cila është përfituar padrejtësisht nga OE "E" sh.p.k. Parregullsitë e konstatuara ngarkojnë me përgjegjësi njësinë e prokurimit.

Ministria e Kulturës me shkresë nr. 2543, datë 13.4.2018 ka bërë vërejtje si më poshtë:

A. Pikat 2.3.1.2; 2.3.1.3 dhe 2.3.1.4 të projekt-raportit

Konstatimi: Në projekt-raport konstatimi i audituesit të autorizuar të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

C. në pikën 2.3.1.2. është "Është kërkuar që OE pjesëmarrës në tender të ketë në stafin e tij teknik të punësuar për periudhën janar-dhjetor 2014 dhe janar-dhjetor 2015 dhe janar-korrik 2016 një Inxhinier mjedisi, ndërkohë që në licencën e OE nuk është kërkuar kategoria e punimeve N.P. 12. Punime të inxhinierisë mjedisore";

D. në pikën 2.3.1.3. është - "Është kërkuar që OE pjesëmarrës në tender të ketë në stafin e tij teknik të punësuar për periudhën janar-dhjetor 2014 dhe janar-dhjetor 2015 dhe janar-korrik 2016 një arkitekt, ndërkohë që objekti është punë/ zbatim";

E. në pikën 2.3.1.4. është - "Është kërkuar që OE pjesëmarrës në tender duhet të ketë të punësuar një ekspert mbi akustikën dhe një ekspert mbi skenat me pervojë pune minimalisht 10 vjeçare, në të paktën 10 objekte të ngjashme.

Kjo marrëdhënie të vertetohet me:

- Kontratë bashkëpunimi të nënshkruar mes palëve;
- CV e punëve të realizuara në projektim ose zbatim;
- Referenca nga bashkëpunëtorët për punë të ngjashme sipas objektit të prokurimit për pjesën e akustikës për secilin objekt të deklaruar.

Përgjigje: Ministria e Kulturës, në kushtet që të treja gjetjet në pikën 2.3.1.2; në pikën 2.3.1.3 dhe në pikën 2.3.1.4, mbështeten në të njëjtën logjikë dhe nevojë të autoritetit kontraktor paraqet përgjigjet si më poshtë:

Projekti për rehabilitimin e Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit, të vetmit objekt të këtij lloji në vend, është e para ndërhyrje rrënjësore që prej ndërtimit të tij në 1966, ndërhyrje e cila ka për qëllim të përmirësojë në mënyrë cilësore dhe ta kthejë atë në një teatër bashkëkohor dhe me standarde të larta Evropiane. Ky projekt multidisiplinar ka kërkuar bashkërendimin e disa ekspertizave në mënyrë që të zgjidhen problematikat që lidhen me: sistemet teknike, akustikën, konfortin, përmirësimin e komunikimit duke rimodeluar volumnin dhe lëvizjen, përmirësimin e marrëdhënies me spektatorin, etj. Për këtë, që në hartimin e projektit janë kërkuar si pjesë e domosdoshme e stafit këto figura teknike: Arkitekt, inxhinier ndërtimi, strukturist, inxhinier elektrik, inxhinier mekanik, inxhinier mjedisi, inxhinier hidroteknik, inxhinier gjeolog. Si rrjedhojë, të njëjtat ekspertiza duhet të jenë të pranishme në zbërthimin dhe zbatimin me përpikmëri të një projekti kaq kompleks dhe unik në vend.

Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, VKM Nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në parashikimet e tyre vënë theksin në faktin se kriteret për kualifikim vendosen në mënyrë të tillë që ti shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë kualifikimet e nevojshme profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

me sukses të kontratës dhe njëkohësisht me cilësinë maksimale të realizimit. Për Autoritetin Kontraktor është e domosdoshme të vërtetohet se një Operator Ekonomik plotëson kriteret e kërkuara, mjaft që ato të jenë në përputhje dhe në përpjesëtim me përmasat dhe natyrën e objektit që prokurohet.

Neni 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.(...) b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës";

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik.

Këto qëllime të parashikuara nga ligjvënësi si dhe përgjegjësia e madhe e kryerjes së një ndërhyrjeje e cila jo vetëm që duhet të plotësojë standartet e veçanta të këtij objekti të vecantë por ai duhet edhe ti rezistonte kohërave, kanë qënë në fokus të AK në hartimin e kriterëve të nevojshme teknike si dhe në vlerësimin e subjekteve të cilat do të mund të klasifikoheshin për të realizuar punimet për zbatimin e këtij projekti kaq të rëndësishëm për komunitetin.

Në rastin konkret zbatimi i një projekti kompleks siç është ai i Teatrit të Operës dhe Baletit nuk mund të mos kërkojë prezencën në kantier të stafit teknik të specializuar në tre nga drejtimet më të rëndësishme të këtij investimi sic janë ekspertët arkitektë; ekspertet akustikë dhe eksperti mjedisor pasi në mënyrë të detajuar ata do të mund të kryenin korrektësisht leximin e drejtë të projektit si dhe propozimet e ndryshimeve të mundshme të tij nëse nevojitet (eksperienca e zbatimit të këtyre punimeve edhe sot tregojnë se nevojat për ndryshime janë konstatuar dhe të nevojshme); leximi i drejtë i specifikave akustike pasi qëllimi i realizimit të punimeve nuk është të kemi një objekt të ri të përshtatur por të kemi një Teatër të kohëve bashkohore.

Konteksti i punimeve që realizoheshin në këtë prokurim është një element i rëndësishëm për tu mbajtur parasysh pasi Ministria e Kulturës për herë të parë parashikon prokurim punimesh për ndërtimin e një teatri. Punime të cilat në përfundim të tyre duhet të sigurojnë që ndërtesa e ofruar siguron dy kriteret sigurinë e punimeve në një godinë e cila do të ketë akses publiku të konsiderueshëm dhe sidomos akustika të jetë realizuar në kushte optimale. Këtë kriter e ka pasuar parasysh edhe AK që ka siguruar prokurimin e projektit të teatrit duke siguruar që një ekspert akustikë të ishte pjesë e ekipit projektues. Nëse kjo nevojë e sigurtit të kushteve maksimale të akustikës nuk do të sigurohej gjatë fazës së zbatimit do të dështonte edhe sigurimi i kushtit në fazën e projektimit. Gjithashtu, nga analiza e AK të një



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

numri të konsiderueshëm prokurimesh teatrosh në botë në të gjitha rastet e analizës shoqëria e zbatimit kishte të përfshirë edhe ekspertin e akustikës, si një nevojë ekstreme për të siguruar suksesin e investimit.

Konkretisht, në lidhje me pikën 2.3.1.2 vlen të theksohet ndonëse në këtë prokurim punimesh nuk mund të parashikohet nevoja që subjekti të kishte license për punime të inxhinierisë mjedisore pasi kjo nuk e pengon AK të realizoj qëllimin e garantimit të punimeve në tëresinë e tyre nëpërmjet pajisjes së shoqërisë me staf teknik të specializuar.

Argumenti më sipër bazohet në parashikimin e VKM nr. 943, datë 28.12.2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Lidhja 3, “Kategoritë në fushat e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, pika II. “Punime speciale ndërtimi;” Lidhja 3/1, “Shpjegime për kategoritë në fushat e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim, pika i. punime speciale ndërtimi” në të cilin parashikohet se: “N.P. 12. Punime të inxhinierisë mjedisore, “Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjike, nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte.”

Në fakt në asnjë nga zërat e preventivit objekt i prokurimit nuk parashikon punime që lidhen me përshkrimin e punimeve të zbatimit në ndërtim sipas pikes N.P. 12. “Punime të inxhinierisë mjedisore” të parashikuar nga legjislacioni në fuqi cituar më sipër.

Ndërkohë, siç argumentuam më sipër, legjislacioni në mënyrë taksative si dhe në zbatim të qëllimit të legjislatorit, autoriteti kontraktor duhet të siguroj që shoqëria e ndërtimit që do të krey punimet duhet patjetër të përmbushë detyrimin për të marrë masat për sigurimin e ndikimit dhe ndryshimit në ekuilibrat mjedisorë të punimeve që do të kryej nëse klasifikohet fitues.

Duhet theksuar se në rastin konkret punimet kryhen në qendrën kryesore të qytetit e cila jo vetëm është e banuar por është edhe atraksioni turistik dhe atraksioni kryesor kombëtar i gjithë të huajve që gjenden në Shqipëri. Është detyrë e AK të siguroj që shoqëria zbatuese jo vetëm kryen punimet me cilësi por edhe nuk vë në rrezik ndikimin e këtyre në mjedisin që kyen këto punime.

Për sa i përket llojit të dokumentacionit të kërkuar për të siguruar plotësimin e këtyre kriterëve në mënyrë që të sigurohet kapaciteti teknik i kompanisë që do të shpallej fituese dhe njëkohësisht të sigurohet garueshmëria nëpërmjet Operatoreve Ekonomike, këto kritere nuk janë vendosur si kusht përjashtues por duke e thjeshtëzuar në paraqitjen e kualifikimit nëpërmjet diplomës, CV dhe/ose licencë.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të argumentave të dhëna edhe në kontestimet e proceverbaleve përkatëse kërkohet ndryshimi i gjetjeve në pikën 2.3.1.2; në pikën 2.3.1.3 dhe në pikën 2.3.1.4, pasi interesi publik i mbrojtur në rastin konkret është madhor dhe nuk çënon rregullat e prokurimit publik.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

B) Pikat 2.3.1.5 dhe 2.3.1.6 të projekt-raportit

Konstatimi: Në projekt - raport gjetja e audituesit të autorizuar të Kontrollit të Lartë të Shtetit

- në pikën 2.3.1.5 “Është kërkuar që OE pjesëmarrës në tender duhet të kenë 27 copë makineri/ pajisje të cilat nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera deri në përfundim të punimeve (30 muaj), ndërkohë që punimet në objekt nuk kryhen në një front njëherësh, por kryhen sipas grafikut të punimeve. Kështu sipas grafikut, punimet e ndërtimit për gërmim, transport etj., të kësaj natyre, përfundojnë kryesisht brenda 10 muajve të parë. Ndërkohë AK (njësia e prokurimit) ka kërkuar 5 copë «Kamionë vetëshkarkues» me kapacitet mbajtës mbi 20 ton, të mos angazhohen në kontrata të tjera punë. Sipas preventivit këto zëra punimi janë rreth 10.000m³ dhe sikur mjetet të kryejnë vetëm një rrugë/ ditë, ky volum pune do të kryhej për rreth 3 muaj. I njëjti arsytim vlen edhe për mjetet autobetoniere 3 copë, autopompë betoni 3 copë, autovinç me aftësi mbajtëse 70 ton 1 copë, fadromë 3 copë, autobot 1 copë, etj.

Njësia e prokurimit, kërkesën për «Disponibilitetin e makinerive», nuk e ka shoqëruar me llogaritjet përkatëse, bazuar me volumin e punimeve të parashikuar në preventiv. Për më tepër, nga verifikimi në vend i kantierit (rreth 400 m²) dhe Plan organizimi i punimeve të paraqitur nga OE, rezulton se ka vend vetëm për sasi mjetesh (jo më shumë se 10) dhe materialesh tejet të kufizuar. Nuk ka mundësi të parkohen në kantier 5 kamione vetëshkarkues me peshe mbi 20 ton, 6 autobetoniere, etj.”

- në pikën 2.3.1.6 është- “Është kërkuar që OE pjesëmarrës në tender duhet të kenë një autovinç me aftësi mbajtëse mbi 70 ton, ndërkohë që sipas preventivit të punimeve, pesha maksimale e pajisjeve/ makinerive që do të instalohen, nuk kalon 5 ton”.

Përgjigja: Ministria e Kulturës në përgjigje për gjetjet në pikën 2.3.1.5 dhe pikën 2.3.1.6. sqaron se me qëllim përdorimin me efikasitet të lartë të fondeve të buxhetit dhe ngritjen e këtyre fondeve nga burime të tjera financiare, projekti i zbatimit i rikonstruksionit të Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Ansamblit Popullor është një projekt i cili po zbatohet mbështetur nga disa tipologji fondesh sic janë fonde të buxhetit të shtetit, fonde të huaja të vëna në dispozicion nga Qeveria e Republikës Popullore të Kinës dhe Qeveria Greke, si dhe fonde nga Bashkia e Tiranës për punime që ndërthuren me projektin me objekt: “Rivitalizim i Sheshit Skënderbej”.

Në këtë kuadër, ky informacion i është vënë në dispozicion auditueseve të autorizuar të Kontrollit të Lartë të Shtetit i detajuar me preventivat përkatës. Konkretisht fondet e vëna në dispozicion nga Qeveria e Republikës Popullore të Kinës, e cila është angazhuar për të asistuar me pajisje dhe makineri të skenës dhe sallës, kanë në preventivin e tyre makineri dhe pajisje të skenës që arrijnë në kapacitetin e kërkuar në DT.

Plotësojmë këtu edhe faktin që ky objekt unik, monument kulture i kategorisë II, ndodhet në Qendrën Historike të qytetit, në qendër të qytetit, në zonë me trafik të limituar dhe pjesërisht në zonë pedonale. Në këtë kontekst, si dhe për faktin që është një vepër e madhe, objekti më i rëndësishëm në fushën e artit dhe kulturës, nuk mund ti lejojmë të vëmë në diskutim realizimin e veprës me analiza analitike që nuk garantojnë qëllimin.

Për më tepër theksojmë se, kapaciteti për aftësinë mbajtëse të makinerisë autovinç përcaktohet gjithashtu edhe nga metodologjia e punës (e operacionit të ngritje/ uljes), që



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

është rrjedhojë e disa variablave si: distanca e ngritjes, këndi i krahut të auto vinçit, rrezja e sigurisë, etj, kriteret këto që çënohen nga konteksti ku zhvillohen punimet (sqsuar me lart).

Për sa më sipër dhe në mbështetje të argumentave të dhëna edhe në kontestimet e proceverbaleve përkatëse kërkohet ndryshimi i përfundimeve në pikat 2.3.1.5 dhe 2.3.1.6 të projekt-raportit pasi interesi publik i mbrojtur në rastin konkret është madhor dhe nuk çënon rregullat e prokurimit publik.

C. Pika 2.3.1.7 e projekt-raportit

Konstatimi i audituesit të autorizuar të Kontrollit të Lartë të Shtetit në pikën 2.3.1.7 është - “Është kërkuar që OE pjesëmarrës në tender duhet të kenë për periudhën janar 2014 deri korrik 2016, jo me pak se 100 punonjës. Për këtë numër mesatar punonjësish, nuk jepet ndonjë llogaritje, ose argument se mbi çfarë baze është kryer dhe konkretisht se për çfarë specialitetesh është llogaritur. Për më tepër është kërkuar që Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre teknik të punësuar për periudhën janar-dhjetor 2014 dhe janar-dhjetor 2015 dhe janar-korrik 2016:

- 1 Arkitekt
- 1 Inxhinier ndërtimi Strukturist
- 2 Inxhinier ndërtimi
- 1 Inxhinier elektrik
- 2 Inxhinier mekanik
- 1 Inxhinier mjedisi
- 2 Inxhinier hidroteknik
- 1 Inxhinier gjeolog

Për inxhinieret pjesë e stafit të cilët duhet detyrimisht të jenë të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e mësipërme, duhet të paraqitet kontratë pune (me kohe të plotë) me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt si dhe diplomë, CV dhe/ose licensë. Kushti që inxhinierët pjesë e stafit duhet detyrimisht të jenë të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e mësipërme, është në kundërshtim me dispozitat ligjore të përshkruara, diskriminuese etj, për OE që duan të konkurojnë.”

Pergjigja: Ministria e Kulturës në përgjigje për gjetjet në pikën 2.3.1.7 thekson se në zbatim të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapacitetëve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë kualifikimet e nevojshme profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës dhe njëkohësisht me cilësinë maksimale të realizimit. Për Autoritetin Kontraktor është e domosdoshme të vërtetohet se një Operator Ekonomik plotëson kriteret e kërkuara, mjaft që ato të jenë në përputhje dhe në përpjesëtim me përmasat dhe natyrën e objektit që prokurohet.

Në të njëjtën frymë të ligjit Neni 46, pika 1 gërma “b” i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik.

Në rastin konkret, ashtu sic theksuam edhe me lart, që në hartimin e projektit janë kërkuar si pjesë e domosdoshme e stafit këto figura teknike: Arkitekt, inxhinier ndërtimi, strukturist, inxhinier elektrik, inxhinier mekanik, inxhinier mjedisi, inxhinier hidroteknik, inxhinier gjeolog. Si rrjedhojë, të njëjtat ekspertiza duhet të jenë të pranishme në zbërthimin dhe zbatimin me përpikmëri të një projekti kaq kompleks dhe unik në vend.

Prandaj është gjykuar e drejtë, e domosdoshme dhe aspak diskriminuese vendosja e kushteve të cilat do të mund të që të siguronin se investimi publik të realizohej me sukses duke bërë të mundur zbatimin korrektësisht të projektit kompleks. Në rastin konkret AK kishte përgjegjësinë që punimet për zbatimin e një projekti kompleks, unik në llojin e tij që zhvillohej në qendren e qytetit dhe në pikën më atraktive kombëtare të mos viheshin në diskutim nga prania e një stafi të përkohshëm, të pa specializuar i cili mund të angazhohej vetëm përkohësisht nga ana e një shoqërie ndërtimi. Qëllimi i ligjshëm në rastin konkret - ai i realizimit të një teratri të denjë kombëtar me parametra bashkohorë- përbën asye të drejtë dhe të bazuar që AK të mund të kërkonte që shoqëria që do kryente punimet të kishtë staf të konsoliduar dhe me eksperience pune në fushën specifike.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të argumentave të dhëna edhe në kontestimet e proceverbaleve përkatëse kërkohet ndryshimi i këtij përfundimi pasi është i pa mbështetur në ligj dhe në vendimet e KPP, pasi kërkesat për stafin e tij teknik të punësuar janë vendosur në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për konstatimin 1.8.dhe 1.9 te risjelle ne projektraporti ne faqet 40-43 në lidhje me konstatimin e dytë të audituesit të autorizuar të Kontrollit të Lartë të Shtetit se:

Në mosperputhje me UKM nr.2. datë 8.5.2003. «Për klasifikimin dhe strukturën e kostos në punimet e ndërtimit» kreu I, pika A dhe UKM nr.1. datë 16.06.2011, për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3. datë 15.02.2001. të Këshillit të Ministrave «Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” (i ndryshuar), shtojca «Preventiv», në strukturën e preventivit, «Furnizimi me pajisje» është llogaritur me TVSH, për këtë ngarkohen me përgjegjësi: hartuesit e preventivit dhe Njësia e Prokurimit; sqarojmë sa më poshtë vijon:

Në përgjigje të kësaj gjetje të pikës 1.8 Ministria e Kulturës sqaron se projekti për këtë objekt është siguruar nëpërmjet procedurave ligjore të prokurimit – sherbim konsulence, ku Autoriteti Kontraktor ka qenë Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe operatori



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

ekonomik fitues me të cilin është lidhur kontrata ka qenë Studio e Projektimit "A". Krahas projektit të zbatimit, pjesë e detyrimeve kontraktuale të këtij OE ka qenë edhe përcaktimi i fondit limit e hartimi i preventivit për këtë objekt. Për pasojë, në shpalljen e kësaj procedure prokurimi është përdorur preventivi i hartuar nga "A". Është kompetencë dhe përgjegjësi e tyre zbatimi i legjislacionit përkatës që përcakton strukturën apo çmimet e përdorura të preventivit dhe të tjera detaje teknike.

Marrja në dorëzim e projektit të zbatimit nga ana e AK konsiston në verifikimin e përmbushjes së detyrimeve kontraktuale sipas detyrës së projektimit që i është dhënë OE, mes të cilave edhe përputhshmëria e vlerës së preventivit shoqërues me atë që është deklaruar në ofertën ekonomike të OE dhe kontrolli i projektit kryhet në formë dhe jo në përmbajtje.

Bazuar në Ligjin Nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.363, datë 18.7.2002 "Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e ndërtimit të objekteve", oponenta teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të bëhet për të gjitha llojet e ndërtimeve, me vlerë të preventuar së paku 100 milionë lekë, nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve. Çertifikimin e projekteve e ka për detyrë Institucioni që kryen me ligj oponencën teknike për projektet e ndërtimit.

Në çdo rast sqarohet se ndërkohë që në udhëzimin nr.3. datë 15.02.2001, përcaktohen rregullat për mbikqyrjen e kolaudimit e punimeve dhe në asnjë rast ky Udhëzim, apo edhe ligji organik nga i cili buron, nuk shprehen për një gjë kaq specifike sikurse janë struktura e preventivit dhe përfshirja me TVSH për pajisjet, gjë e cila rregullohet nga legjislacioni përkatës për TVSH-në.

Por edhe baza ligjore të cilës Ju i referoheni, UKM nr.1. datë 16.06.2011, (që në vetvete është një Udhëzim që kontrollon rregullat për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit dhe nuk është specifik për klasifikimin dhe strukturën e kostos në punimet e ndërtimit) vetëm shpjegon faktin që pajisjet nuk bëjnë pjesë në strukturën e punimeve të ndërtimit, por nuk shprehet për TVSH-në. Në shtojcat bashkëlidhur UMK-së, mes të cilave edhe ajo "Preventiv", thjesht jepen modele të mënyrës së paraqitjes së dokumentacionit që duhet të administrohen në kantierin e ndërtimit, ku në rastin e modelit tip të preventivit dhe situacionit kuptojmë që pajisjet nuk futen në strukturën e punimeve të ndërtimit, por renditen të shkëputura nga llogaritjet e para. Nuk shpreh pra nëse në rreshtin "Pajisje" do të vendoset vlera me apo pa TVSH e pajisjeve.

Në UKM nr.2. datë 8.5.2003. «Për klasifikimin dhe strukturën e kostos në punimet e ndërtimit», kreu I, pika A ka të bëjë me klasifikimin e punimeve të ndërtimit, ku në pikën 7 (paragrafi i dytë) thuhet: "Në të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat". Pra, i referohet faktit që duhet të përfshijmë ose jo pajisjet në punimet e ndërtimi.

Nga ana tjetër, në pikën C të këtij Udhëzimi "Të ndryshme" thuhet shprehimisht: Në strukturën e investimeve dhe të ndërtimeve themelore, përveç punimeve të ndërtim montimit përfshihen edhe: a) makineri e pajisje (teknologji dhe të tjera).

Pra, pajisjet duhet të evidentohen të ndara nga punimet e ndërtim montimit, por brenda të njëjtit preventiv dhe situacion, për shkak të natyrës së veçante që kanë si mall në strukturën e kostos së ndërtimit. Në asnjë moment në këtë Udhëzim nuk përmendet që "pajisjet dhe aparaturat" duhet të përjashtohen nga TVSH-ja. Ky është një akt ligjor që rregullon mënyrat e evidentimit të pajisjeve në kontabilitetin teknik duke ndarë punën e gjallë nga ajo e materializuar. Kjo gjë është e shprehur qartë në preventivin dhe situacionin e objektit të audituar, ku zëri "puntori për montimin e pajisjeve" është vendosur brenda strukturës së



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

ndërtimit, pasi procesi i montimit ka në vetvete të gjithë elementet e punimeve të ndërtimit, si instalime apo prodhimin e aksesorëve, përdorimi i makinerive, transportit, pagat etj.

Madje, në shembujt e analizave teknike, të marra në shqyrtim në fund të Udhëzimit, shprehet shumë qartë pas shembullit të montimit të pompës (që klasifikohet si pajisje), ku në zërin II shkruhet: a) Blerje pompe (vihet veç tek fondi i pajisjeve), pra evidentohet që duhet të veçohet nga struktura e ndërtimit, dhe në shënimin përmbledhës të të gjithë analizës citohet: **pika 2. Në analizë çmimet janë orientuese pa TVSH, pasi kjo parashikohet në fund të preventivit të zërave të punës.**

Bazuar në legjislacionin specifik për TVSH-në :

a. Ndërkohë që Udhëzimi KM nr.2 datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” ka si qëllim kryesor të përcaktojë rregullat se ku vendosen pajisjet në klasifikimin e punimeve të ndërtimit dhe strukturën e kostos, **është legjislacioni që rregullon TVSH-në ai që nuk lejon shmangien e TVSH-së për pajisjet**, pjesë e strukturës së investimit (është e pakuptueshme që grupi i auditimit nuk i referohet fare kësaj baze ligjore).

Llogaritja e TVSH është bërë në zbatim të Ligjit nr.7928 datë 27.04.1995, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” dhe specifikisht të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.3, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, pika 7 “Furnizimet e tatueshme dhe ato të përjashtuara” gërma b, c, ku thuhet shprehimisht: Ligji “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” zbatohet mbi çdo furnizim mallrash e shërbimesh që kryhet nga çdo person i tatueshëm, pavarësisht nga forma juridike e organizimit të tij dhe pavarësisht nga lloji i veprimtarisë ekonomike që ai kryen. Në të njëjtën kohë, nenet 19 deri në 25.7 dhe neni 26.1 të ligjit parashikojnë edhe përjashtimet nga ky tatim (të cilat nuk i përkasin rastit në fjalë). Pra sipas nenit nr.7, pajisjet nuk janë të përjashtuara nga tatimi mbi vlerën e shtuar. Si të tilla ato blihen me TVSH dhe faturohen e raportohen në shitje me TVSH. Do të ishte shkelje e ligjit për tatimin e vlerës së shtuar nëse faturimi i paisjeve do të bëhej pa TVSH, pasi shteti nuk do të përfitonte tatimin mbi vlerën e shtuar të cilën subjektet e kanë derdhur rregullisht sipas afateve ligjore.

b. Udhëzimi nr. 117, datë 13.05.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, në pikën 8.1 “Toka dhe ndërtesat” përcakton se furnizimi i shërbimeve të ndërtimit, pra kryerja e procesit të ndërtimit si dhe të mirëmbajtjes janë furnizime të tatueshme....Ndërtimi përcaktohet si çdo operacion që ka për rezultat përfundimin tërësor ose pjesor të një ndërtese të re ose substancialisht të ndryshuar, muri, rruga, ose themeli. Ndërtime konsiderohen:...b) **punët për pajisjen e ndërtesave dhe të objekteve të tjera ku futen: punët për pajisjen e ndërtesave, pajisje të cilat inkorporohen në mënyrë definitive në ndërtesë, duke u transformuar kështu për shkak të destinacionit të tyre në pasuri të patundshme.**

Në pikën 8.1.2 të po këtij Udhëzimi përcaktohet se TVSH në ndërtim aplikohet: a). **Kur shoqëritë e ndërtimit ndërtojnë për të shitur apo për të dhënë me qera TVSH llogaritet dhe paguhet çdo muaj mbi vlerën e situacionit mujor të punimeve. Bashkëngjitur do të jetë detyrimisht fatura tatimore me nr. serial. Vlera e situacionit mujor do të jetë vlera e tatueshme mbi të cilën do të llogaritet TVSH-ja në masën 20%.**

Pra, nga sa më lart kuptohet se pajisjet janë pjesë e ndërtimit (njësoj sikurse përcakton edhe UKM nr.2. datë 8.5.2003, pika C) dhe situacioni, që ka strukturë të njëjtë me preventivin, është një dokument ligjor, i cili për shkak të volumit nuk mund të pasqyrohet në faturën tip, por detyrimisht duhet të respektojë strukturën e kësaj fature, dmth duhet që të gjithë elementet e tij përbërës (perfshi edhe pajisjet) ti nënshtrohen TVSH-së. Pra nuk mund të aplikohen dy standarte brenda të njëjtë dokument, një pjesë e faturës me TVSH dhe një pjesë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

jo; një gjë e tillë mund të ndodhë vetëm në rastet përjashtimore të shprehura (nenet 19 deri ne 25.7 dhe neni 26.1 të ligjit përkatës).

c. TVSH-ja si në blerje edhe në shitje nuk është element kostoje dhe si e tillë nuk shkakton dëm ekonomik, pasi ajo i nënshtrohet zinxhirit të llogaritjeve në kolonë të veçantë, ashtu siç e kërkon neni 36/1 “Mbi përpilimin e faturës” i Ligjit nr.7928 datë 27.04.1995, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, dhe çdo rast tjetër do të ishte deformim i raportimit dhe shmangie nga detyrimet fiskale.

d. Mendojme se, krahas interpretimit ligjor nga ana jonë, duhet të merret parasysh edhe fakti në terrenin konkret ku veprojnë OE që kanë zbatuar punimet e ndërtimit. Nga ana OE është respektuar vlera totale e preventivit të tenderit duke mos e tejkalaruar atë. Ato kanë raportuar në organet tatimore faturat e blerje–shitjeve ku përfshihet edhe vlera e TVSH-së së pajisjeve. Mbi bazën e deklarimeve kanë bërë edhe pagesën e TVSH-së që u takon në buxhetin e shtetit dhe në mbyllje të vitit ushtrimor kanë paguar tatim fitimit.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të argumentave të dhëna edhe në kontestimet e proceverbaleve përkatëse kërkohet ndryshimi i përfundimeve në pikën 1.8 të aktkonstatimeve pasi interesi publik i mbrojtur në rastin konkret është madhor dhe nuk cënon rregullat e prokurimit publik.

1.9. Në strukturën e kostos, në preventivin e hartuar/ dorëzuar nga OE «A» sh.p.k për objektin: “Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Ansambllit Popullor”, midis zërave të punimeve është përfshirë vlera e pajisjeve e shtuar me 18% (shpenzime plotësuese/ përgjithshme 8% dhe fitimi 10%) në kundërshtim me germën A/7, paragrafi i fundit i UKM nr.2. datë 8.5.2003. «Për klasifikimin dhe strukturën e kostos në punimet e ndërtimit», e cila përcakton se në të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat.

Në përgjigje të kësaj gjetje të pikës 1.9 Ministria e Kulturës sqaron se bazuar ne UKM nr.2. datë 8.5.2003. «Për klasifikimin dhe strukturën e kostos në punimet e ndërtimit», kreu I, pika A ka të bëjë me klasifikimin e punimeve të ndërtimit, ku në pikën 7 thuhet: "Në të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat", i referohet faktit që duhet të përfshijmë ose jo pajisjet në punimet e ndërtimit.

Plotesojme se, bazuar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, përcaktohet qartë se si analizohet struktura e kostos për pajisjet, duke iu referuar shembullit konkret të marrë në konsideratë nga UKM nr.2. datë 8.5.2003 cituar më lart, për Pompën e ujit.

Bashkëngjitur pjesë nga Manuali Nr.2, VKM nr. 629, datë 15.07.2015:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Manuali 2 ANALIZA TEKNIKE PER PUNIMET E NDERTIMIT TE NDERTESAVE

Mars - 2015

No.	EMERTIMI	Njesia	PUNTORI			TRANSPORT			MARRINDE			MATERIAL			Shuma	Shp. p/ %	Firm	TOTALI
			nr	cmimi	Vlefte	F'lor	cmimi	Vlefte	n.p	cmimi	Vlefte	Qanta	cmimi	Vlefte				
1	2	3	4.00	3	6.00	7	8.00	9.0	10	11.0	12.0	13	14	15.0	16.0	17	18	19.0
As - 13	F V rezervuar shtegat 1000 litra	copa																
	Sht + p	op	6.00	300	1,110.00													
	Squrime shpazime 16.7%	leke	1,101.00	5,167	185.17													
	Transport	F'lor				7.50	21.00	157.5										
	Autobrev 2.5 litra	op							1.0	2,000.0	2,000.0							
	Reservuar shtegat 1000 litra	copa										1	12,000	12,000.0				
	Budimja shpazime	op										4	100	400.0				
	Ta rryshetja 3 %	leke										10000	3	372.0				
	Shuma :				5,296.17			187.5			2,000.0			13,772.0	16,894.3	1351	1,640	16,894.3
As - 14	F V rezervuar shtegat 500 litra	copa																
	Sht + p	op	4.50	300	812.10													
	Squrime shpazime 16.7%	leke	812.50	5,167	119.01													
	Transport	F'lor				4.40	21.00	100.8										
	Autobrev 2.5 litra	op							0.8	2,000.0	2,000.0							
	Reservuar shtegat 500 litra	copa										1	8,000	8,000.0				
	Budimja shpazime	op										4	100	400.0				
	Ta rryshetja 3 %	leke										10400	3	382.0				
	Shuma :				971.63			108.8			2,000.0			9,882.0	12,884.3	1100	1,285	12,168.3
As - 15	F V motor 80 litra, oja te ngrohte	copa																
	Sht + p	op	7.00	180	3,295.00													
	Squrime shpazime 16.7%	leke	3,295.00	5,167	216.17													
	Transport	F'lor				0.35	21.00	20.0										
	Trapan elektrik	op							0.8	95.0	71.3							
	Bojler uj ngrohte 80 litra	copa										1	9,500	9,500.0				
	Gazetja ujpa dante	tercos										1	125	125.0				
	Ta rryshetja 3 %	leke										3675	3	138.8				
	Shuma :				3,811.87			39.8			71.3			9,813.8	11,814.3	821	1,112	13,888.1
As - 16	F V motor 12 litra, oja te ngrohte sanitar	copa																
	Sht + p	op	4.50	180	812.10													
	Squrime shpazime 16.7%	leke	812.50	5,167	119.01													
	Transport	F'lor				0.35	21.00	20.0										
	Trapan elektrik	op							0.5	95.0	47.5							
	Bojler uj ngrohte 12 litra	copa										1	4,500	4,500.0				
	Gazetja ujpa dante	tercos										1	125	125.0				
	Ta rryshetja 3 %	leke										3675	3	138.8				
	Shuma :				971.63			39.8			47.8			4,753.8	6,882.7	661	500	6,847.3
As - 17	F V pompa me pajisje 24 litra	copa																
	Sht + p	op	4.38	180	1,010.10													
	Squrime shpazime 16.7%	leke	1,010.50	5,167	216.10													
	Transport	F'lor				3.30	21.00	71.3										
	Trapan elektrik	op																
	Pompe uj me pajisje 24 l	copa							1.3	95.0	142.5							
	Gazetja ujpa dante	tercos										1	14,500	14,500.0				
	Materiale te arsy + shpazime	tercos										1	750	750.0				
	Ta rryshetja 3 %	leke										35175	3	131.8				
	Shuma :				1,899.28			71.6			142.8			19,818.8	17,884.8	1404	1,710	20,713.7

Si konkluzion theksojmë se edhe sikur parashikimi ligjor i përmendur në kostatimin tuaj të jetë i zbatueshëm në rastin konkret, në kushtet e perplasjeve të qëndrimeve të posaçme për të njëjtën çështje, nga pikëpamja e hierarkisë së ligjeve, parashikimi i VKM prevalon mbi parashikimin e UKM (për më tepër që është një UKM e vitit 2003 dhe një VKM e vitit 2015).

Për sa më sipër dhe në mbështetje të argumentave të dhëna edhe nga kontestimet e proceverbaleve përkatëse kërkohet ndryshimi i këtij përfundimi pasi baza ligjore e referuar nga AK është në hierarki më e lartë se UKM e cituar në gjetjet tuaja.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së :

Njësia e prokurimit, në komentet/shpjegimet e dhëna përgjithësisht ka përsëritur të mëparshmet, të cilat nuk prekin argumentet e paraqitur hollësisht nga audituesit në Akt-konstatim, projektraport dhe Raport Përfundimtar, për rrjedhojë, komentet/shpjegimet, **nuk qëndrojnë**.

Lidhur me “vërejtjet” e bëra nga MK për pikën 2.3.1.8. dhe 2.3.1.9 me objekt përfshirjen në preventivin e ndërtimit të vlerës së pajisjeve/mjeteve me TVSH, grupi i auditimit sqaron se ky “problem”, nuk është trajtuar/ngritur prej tij në projektraport.

Gjetje nga auditimi:

Situata:	Në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i TOB...”, njësia e prokurimit ka vendosur/kërkuar në kriteret të veçanta në kualifikim që OE të kenë ne
-----------------	---



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Kriteri:	licencë kategori për zëra punimesh, të cilat nuk përmbahen në preventivin e punimeve të objektit, një ekspert mbi akustikën dhe një ekspert mbi skenat me përvoje pune minimalisht 10 vjeçare, në të paktën 5 objekte të ngjashme sipas objektit të prokurimit, <i>27 copë makineri/pajisje të cilat, nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera deri në përfundim të punimeve (30 muaj) ... etj</i> , ndërkohë që punimet në objekt nuk kryhen të gjitha në front njëherësh, por kryhen sipas grafikut të punimeve etj.
Ndikimi/efekti:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë datë 29.12.2014 i ndryshuar.
Shkaku:	KVK e vendosura nga njësia e prokurimit, kanë ndikuar thelbësisht në pjesëmarrjen e OE në tender dhe në përcaktimin e OE fitues.
Rëndësia e shkeljes:	Zbatimi i deformuar i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë datë 29.12.2014 i ndryshuar.
Rekomandimi:	E lartë
	-

Lidhur me “*Përputhshmërinë/rregullshmërinë ligjore*”, në procedurën e kualifikimit dhe shpalljes së operatorit ekonomik (OE) fitues në tenderin me emërtim “*Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor*”, disa të dhëna për të cilin janë:

Të dhëna për prokurimin	Komisioni i Vlerësimit Ofertave	Njësia e prokurimit
a	b	c
1.Urdhër prokur. nr. 281 dt. 19.8.2016 2.Fondi limit 998,862,862 lekë. 3. Procedura e prok. “Hapur” 4. Data e zhvillimit 28.9.2016 5.Kontraktuesi subjekti BOE “E” sh.p.k. & “A” sh.p.k. Data e lidhjes kontratës 31.10.2016 Vlera e kontratës 1,112.105,000 lekë. Diferenca ndaj FL 72,108,000 lekë	Z.C kryetar zv/m D. P. arkitekt R. Xh. jurist H. D. E. Z.	SH. Sh.finan B. H juriste K. A.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes në sistemin elektronik të APP, u konstatua se kanë paraqitur ofertë OE:

Nr	Operatorët ekonomikë	Njësia e matjes	Ofertat ekonomike		Kualifikuar/skualifikuar
			Pa TVSh	Me TVSh	
1	BOE “A & C & ”	000 L	846,326,626		skualifikuar
2	BOE “E – ” & “A” sh.p	”	926,754,355		fitues
3	OE “A” sh.p.k.	”	965,902,760		kualifikuar

Kanë paraqitur 3 BOE/OE, nga të cilët KVO ka skualifikuar 1 BOE.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Grupi i auditimit verifikoi *mangësitë* në *dokumentacion* të evidentuara nga KVO për skualifikimin e BOE "A & C & ..." dhe konstatoi se:

Bashkimi i operatoreve "A" sh.p.k, "C sh.p.k" dhe "AD sh.p.k" është skualifikuar pasi nga shqyrtimi I Dokumentacionit rezulton se Bashkimi i operatorëve ka mangësi në dokumentacion si më poshtë:

a. Operatorit "A1" sh.p.k i mungon një vërtetim i gjendjes financiare nga një ose më shumë banka me vlerë jo më të ulët se 10% e fondit, lëshuar jo më parë se 10 ditë nga data e hapjes së ofertave.

Nga verifikimi rezultoi se ka paraqitur vërtetim të gjendjes financiare datë 26.9.2016, por jo në dhurën e duhur. Vlerësimi KVO qëndron.

b. Operatorit "A2" i mungon vërtetim nga OSHEE.

Nga verifikimi rezultoi se ka paraqitur vërtetim nga OSHE nr. 7051, datë 28.8.2016. Vlerësimi KVO **nuk qëndron.**

c. Operatorit "A3" i mungon fatura e likuidimeve për kontratat e ngjashme.

Nga verifikimi rezultoi se ka paraqitur fatura likuidimi për kontrata të ngjashme për:

- "Ndërtimi i qendrës së paraburgimit" në Shkodër me fonde të BE me vlerë 14,371,454 euro.
- "Restaurimi i 5 shkollave" në Durrës me vlerë 683,451 euro.
- "Ndërtim pallati në Farkë" me vlerë 175,203,615 lekë etj.

Vlerësimi KVO, **nuk qëndron.**

d. Operatorit "A4" i mungon licenca

Nga verifikimi rezultoi se ka paraqitur licencë. Vlerësimi KVO, **nuk qëndron.**

e. Mungon licensa në restaurimin bazuar në kriterin që në rastin e bashkimit të operatoreve ai që ka përqindjen më të madhe në BOE duhet të disponojë licencë në restaurime.

Vlerësimi KVO qëndron.

f. Currit sh.p.k i mungojnë listë pagesat për vitin 2014 si dhe qershor-korrik i vitit 2016.

Nga verifikimi rezultoi se ka paraqitur listë pagesat për vitin 2014 si dhe qershor-korrik i vitit 2016. Vlerësimi KVO, **nuk qëndron.**

g. Operatorit "A5" i mungojnë mungojnë listë pagesat për vitin 2014 .

Nga verifikimi rezultoi se ka paraqitur listë pagesat për vitin 2014. Vlerësimi KVO, **nuk qëndron.**

h. Operatorit "C" sh.p.k i mungon një kontratë e punës për punonjësit me IQT ka paraqitur vetëm IQT.

Vlerësimi KVO qëndron.

i. Operatorit A- k sh.p.k i mungojnë punonjësit e mirëmbajtjes.

Ka mbi 30 punonjës me IQT të profesioneve të ndryshme si murator, elektrikist, mekanik etj, por jo me emërtim mirëmbajtës. Pavarësisht, vlerësimi KVO qëndron.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

j. A- K sh.p.k ka sjellë vetëm një kontratë për punonjës mekanik vetëm jo për tre sipas DST. Si më lart. Pavarësisht, vlerësimi KVO qëndron.

k. Referenca e ekspertit të akustikës është në gjuhën angleze. I gjithë dokumentacioni është në gjuhë të huaj. Nuk ka të deklaruar punë të ngjashme në portofolin e tij. Vlerësimi KVO qëndron.

l. Mungojnë referenca në gjuhën shqipe (një referencë e paraqitur është në anglisht), kontrata të ngjashme dhe punë të ngjashme për ekspertin e akustikës dhe të skenës.

m. Për BOE mungojnë raportet e auditimit për certifikatat ISO. "C" sh.p.k i mungojnë përkatësisht OHSAS 18001-2007 dhe PAS 99:2012. Vlerësimi KVO qëndron.

n. Autorizimi për kondicionimin është dorëzuar nga distributori dhe jo nga prodhuesi DAIKIN. Autorizimi për furnizimin me ndriçuesit nuk është dhënë nga Prodhuesi që është V-TAC, por nga distributori për Shqipërinë S E.

Vlerësimi KVO qëndron.

Për sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi të skualifikoje Bashkimin e operatoreve "A. K." sh.p.k, "C sh.p.k" dhe "AD-S sh.p.k"

Grupi i auditimit verifikoi rregullshmërinë e dokumentacionit ligjor kualifikues të OE "A- s" sh.p.k. dhe rezultoi se vlerësimi i KVO për kualifikimin e tij është i saktë.

Krahas sa më sipër u verifikua dokumentacioni ligjor kualifikues i BOE "E" sh.p.k. & "A" sh.p.k. i shpallur fitues të cilët do të kryejnë respektivisht 49 për qind dhe 51 për qind të punimeve, sipas ndarjes së tyre të paraqitur në preventiv.

1. Lidhur me dokumentacionin e OE "A" sh.p.k për zërat dhe volumet e punimeve që do të kryejë.

2.3.1.9. Parregullsi e konstatuar:

1.1. Në KVK e DT të miratuar nga AK, është kërkuar që OE pjesëmarrës në tender të kenë në licencë kategorinë e punimeve NS-12 C. OE "A" sh.p.k në licencë, nuk e ka këtë kategori punimesh , **kriter i pa plotësuar.**

2.3.1.10. Në KVK e DT të miratuar nga AK, është kërkuar që OE pjesëmarrës në tender të kenë në licencë kategorinë e punimeve NS-14 C. OE "A" sh.p.k në licencë ka kategorinë e punimeve NS-14 A, **kriter i pa plotësuar.**

Sa më sipër është në kundërshtim me:

- Pikën 1/b të UKM nr. 42, datë 16.1.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", në të cilën ndër të tjera është përcaktuar se ... **kur verifikohet se subjekti përfshihet në investime që tejkalojnë klasën e**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

kategorisë së licencuar ..., kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence ... dhe

- Pikën 4 të KVK të miratuara me DST nga autoritetit kontraktor (*Licenca lidhur me ekzekutimin e punimeve...*).

Ministria e Kulturës ka bërë vërejtje/sqarime si më poshtë:

Pikat 2.3.1.9 dhe 2.3.1.10 të projekt-raportit

Konstatimi i audituesit të autorizuar të Kontrollit të Lartë të Shtetit

- në pikën 2.3.1.9 është: “Ne KVK e DT te miratuar nga AK eshte kerkuar qe OE pjesemarrës ne tender te kete ne licence kategorine e punimeve N.S. 12. C. Operatori ekonomik “A” shpk ne licence, nuk e ka kete kategori punimesh, kriter i pa plotesuar.

- në pikën 2.3.1.10. Ne KVK e DT te miratuar nga AK eshte kerkuar qe OE pjesemarrës ne tender te kete ne licence kategorine e punimeve N.S. 14. C. Operatori ekonomik “A” shpk ne licence ka kategorine e punimeve N.S. 14. A, kriter i pa plotesuar.

Përgjigje: Ministria e Kulturës në përgjigje për gjetjet në pikat 2.3.1.9. dhe 2.3.1.10 vëren se bazuar ne ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 44 parashikon se BOE mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm. Autoriteti kontraktor duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimi të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit.

Gjithashtu, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar në Kreun VIII (“Kushte të përgjithshme për zbatim”), neni 74 (“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”), pika 1, 2 dhe 3 parashikon se: “1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi (...) Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.”

“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”. Operatorët ekonomikë duhet të ndajnë dhe të përcaktojnë % e shërbimit, si dhe zërat e shërbimeve që do të kryejnë secili operator dhe jo të ndajnë kriteret e kualifikimit pasi kriteret teknike dhe ato ekonomike plotësohen në përputhje me përqindjet e mara përsipër”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, në kontratën e bashkëpunimit operatorët ekonomikë nuk duhet të ndajnë kriteret dhe kërkesat e autoritetit duke përcaktuar se cilat kriteret do të plotësojë çdo anëtar i bashkimit, por duhet të ndajnë dhe përcaktojnë elementët konkretë të shërbimit që do të kryejë secili referuar zërave të shërbimit që kërkon autoriteti kontraktor. Sa më sipër, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër.

Ndërsa kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Në rastin konkret, kriteri për pasjen me licence kategorie punimesh N.S. 12. C. dhe N.S. 14. C. është përmbushur nga njëri prej anëtarëve të BOE që në rastin konkret është shoqëria "E".

Në përfundim, ky bashkim kapacitetesh përmbush kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike dhe nuk bie ndesh me përcaktimet e Udhezimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", ndryshuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 943, datë 28.12.2016, Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim" dhe as me përcaktimet në pikën 4 të KVK të miratuara në DST nga Autoriteti Kontraktor.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të argumentave të dhëna edhe në kontestimet e proceverbaleve përkatëse kërkohet ndryshimi i këtij përfundimi pasi jo vetëm që është i pambështetur në argumenta ligjore por edhe sepse interesi publik i mbrojtur në rastin konkret është madhor dhe nuk cënon rregullat e prokurimit publik.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së : Sqarimet/shpjegimet e dhëna nga MK (megjithëse kanë ndryshim nga të mëparshmet), nuk prekin argumentet e paraqitur hollësisht në Akt konstatim, projektraport dhe Raport Përfundimtar, për rrjedhojë, komentet/shpjegimet e MK, **nuk qëndrojnë.**

2.3.1.11. OE "A" sh.p.k. ka paraqitur "Autorizim prodhuesi" (AP) fotokopje nga shoqëritë "Delta light" me vendndodhje në Belgjikë (për ndriçim arkitektonik), "Spotlight" me origjinë në Itali (Sisteme ndriçimi), "Harman Internacional..." me origjinë në SHBA (pajisje tingulli dhe ndriçimi), "Apart" me origjinë në Belgjikë (pajisje tingulli) dhe "Daikin" me vendndodhje në Austri (Pajisje HVAC), në kundërshtim me sa është përcaktuar në pikën 7 të KVK të miratuara nga AK, në të cilën është përcaktuar se ... *Operatori ekonomik duhet të paraqes autorizim nga prodhuesi (jo distributori) i pajisjeve të kondicionimit dhe ventilimit, audios, ndriçimit, me të cilin prodhuesi autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertoj këto pajisje në këtë procedurë prokurimi.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

OE nuk paraqiti AP origjinalë gjatë kohës së auditimit, megjithëse ju kërkua nëpërmjet zj. R. Xh. **Kriter i pa plotësuar.**

Argumentim:

Rasti konkret për paraqitjen e *Autorizim prodhuesi* (AP) është i ndryshëm referuar KPK dhe KVK klasikë, të parashikuara përgjithësisht në DST, pasi ai (AP):

- Nuk është parashikuar specifikisht si dokument në DST,
- Për nga natyra dokumenti AP është i veçantë, sepse duke qenë se është i personalizuar, rezulton të jetë një përdorimësh (nuk vlen për gjë tjetër) dhe normalisht, plotësisht normalisht OE duhet të paraqiste “Autorizim Prodhuësi” origjinal dhe po normalisht, nuk ka arsye për të paraqitur AP fotokopje të notuar, nëse e ka të vërtetë/origjinal AP, e lëshuar kompanitë prodhuese.

Është një tender me vlerë të lartë (rreth 1,100,000 mijë lekë) dhe për shkak të objektit ku do të përdoren, me kërkesa të veçanta për pajisjet.

Për këtë arsye, AK (MK) në DST ka vendosur një kriter/kusht tejet të vështirë për t’u plotësuar nga OE pjesëmarrës të mundshëm në tender që ... *Operatori ekonomik duhet të paraqes autorizim nga prodhuesi (jo distributori) i pajisjeve...* (“Agi cons” sh.p.k. ka paraqitur pesë AP, nga pesë kompani të ndryshme ndërkombëtare).

Vendosja e këtij kriteri, pakëson/selekon ndjeshëm numrin e OE pjesëmarrës të mundshëm.

Për këto shkaqe, për të shmangur çdo keqkuptim, AK (KVO) duhet të kërkonte rigorozisht/saktësisht, AP origjinal.

Gjatë kohës së auditimit, grupi i auditimit, nëpërmjet zj. Risena Xhaja (me funksion Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse me profesion juriste, anëtare e KVO) i kërkoi OE “A” sh.p.k. të paraqesë AP origjinalë.

OE “A” sh.p.k. në përgjigje, ka paraqitur vetëm një “Autorizim” origjinal (nga pesë të sjellë në DT) lëshuar datë 5.2.2018 nga shoqëria D, me përmbajtje si vijon ... *Kompania “D..” Austria, në cilësinë e prodhuesit zyrtar të pajisjeve NVAC: DAIKIN autorizon kompaninë “A” sh.p.k. me përfaqësues ligjor z. A. Ç, të furnizojë dhe instalojë, por edhe të mbulojë periudhën e garancisë për shërbim për të gjitha produktet e prodhuara nga ne, për tenderin. “A” sh.p.k. do të furnizohet me të gjitha pajisjet HVAC për tenderin e “Rehabilitimit të TOB”, i cili do të zhvillohet nga klienti Ministria e Kulturës, në rast se “A” sh.p.k. do të shpallet fitues për këtë procedurë.*

I hartuar kështu, ky dokument, nuk përbën AP (jo vetëm i formuluar keq, por autorizon “A” sh.p.k. në vitin 2018 ... për një tender që është zhvilluar në vitin 2016). Vlen të evidentohet se *Autorizimi* i shoqërisë DAIKIN, është dërguar në adresë të E K, Qendra Tregëtare “Casa Italia” Tiranë. Nga dokumentacioni i OE “A” sh.p.k. nuk konstatohet ndonjë lidhje e tij me z. E K.

Arsyetimi i MK, se ky kriter është përmbushur jo vetëm në teori por edhe në praktikë nga subjekti, nuk fsheh favorizimin/abuzin e mundshëm në procedurën e kualifikimit dhe fitimit të tenderit, që i është bërë BOE “A” sh.p.k. & “E” sh.p.k., nga të shprehurit se është i pajisur me AP. Në të kundërt, do të ishte skualifikuar. Blerje të kompania D mund të bëjë kushdo, por të qenit i pajisur me AP, i një operatori ekonomik, gëzon avantazhe të padiskutueshme në fitimin e një procedurë tenderi, në veçanti kur vlera e tij është miliardare.

Nëse OE “A” sh.p.k. nëse i ka AP, nuk ka arsye që të mos i paraqis në dokumentet e tenderit. Në tërësi sa më sipër, komprometon rëndë procedurën e tenderit, OE “A” sh.p.k. dhe vet AK.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

MK ka bërë vrejje/sqarim për pikën 2.3.1.11. të projektraportit si më poshtë:

Konstatimi i audituesit të autorizuar të Kontrollit të Lartë të Shtetit në pikën 2.3.1.11 është: Operatori ekonomik “A” shpk ka paraqitur “Autorizim nga prodhuesi” fotokopje nga shoqerite “D” me vendndodhje ne Belgjike (per ndricim arkitektonik), “S” me origjine ne Itali (Sisteme ndricimi), “HI”, me origjine ne SHBA (pajisje tingulli dhe ndricimi), “A” me origjine ne Belgjike (pajisje tingulli) dhe “D” me vendndodhje ne Austri (pajisje HVAC), ne kundershtim me sa eshte percaktuar ne piken 7 te KVK e DT te miratuar nga AK, ne te cilen eshte percaktuar se: Operatori ekonomik duhet te paraqes autorizim nga prodhuesi (jo distributori) i pajisjeve te kondicionimit dhe ventilimit, audios, ndricimit, me te cilin prodhuesi autorizon kompanin pjesmarrese ne tender te ofertoj keto pajisje ne kete procedure prokurimi.

Përgjigje : Ministria e Kulturës në përgjigje për gjetjet në pikën 2.3.1.11 i referohet parashikimit të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu III, pika 3/b “Për rregullat e prokurimit publik”, në të cilin përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike dhe/ose [...]”.

Në kontekst të ligjit, kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë kualifikimet e nevojshme profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Për autoritetin kontraktor është e domosdoshme të vërtetohet se një operator ekonomik plotëson kriteret e kërkuara, mjaft që ato të jenë në përputhje dhe në përpjesëtim me përmasat dhe natyrën e objektit që prokurohet.

Autorizimi nga prodhuesi është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues.

Ne lidhje me konstatimin 5.1 mbi Autorizimin e Prodhuesit ju sqarojme se KVO ka marre te mireqene faktin qe dokumentacioni lidhur me autorizimin e prodhuesit ne sistem eshte hedhur ne original dhe pas shpalljes fitues eshte paraqitur i njesuar me origjinalin prane organit te noterit.

Lidhur me kete pike ju bejme me dije se, ne dokumentet e tenderit parashikohet se dokumentacioni duhet te paraqitet ne cdo rast origjinal ose kopje e noterizuar.

Paraqitja e ketj dokumenti fotokopje e noterizuar, nuk perben shkelje te ligjit.

Nga ana e KVO, ne kushtet kur dokumentacioni eshte derguar i njesuar me origjinalin nga noteri, atehere ky dokument eshte gjykuar dhe pranuar i sakte.

Ne akt konstatim ngrihet edhe pretendimi se Autorizimi i prodhuesit nuk u paraqit origjinal.

Per me teper, ne objekt po zbatohen te gjitha punimet specifikike me materialet dhe produktet e prodhuara nga kjo kompani.

Te gjitha autorizimet e paraqitura jane te leshuara nga prodhuesit perkates. Asnje autorizim nuk eshte i leshuar nga distributoret. Sjellim ne vemendje qe kompani prodhuese ose “prodhues” nuk quhet vetem vendi ose kordinata gjeografike ku ndodhet fabrika e nje kompanie – kompani prodhuese eshte kompania perkatese qe eshte prodhuese e nje marke te



KONTROLLI I LARTË I SHËTËTIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

caktuar pavaresisht se ku i ka fabrikat e saj. Kompani distributore jane kompani te tjera, te ndryshme nga kompania prodhuese, te cilat shperndajne produktet e nje kompanie prodhuese. Sjellim ne vemendje qe nuk eshte kerkuar autorizim fabrike, eshte kerkuar autorizim nga prodhuesi.

Gjithashtu vlen te theksohet se parashikomet ligjore ne fuqi nuk vene ne dispozicion te AK apo te OE formate tip te miratuar konformiteti me te cilat duhet te kerkohet nga KVO per aq kohe sa formulimi I autorizimit perputhet me qellimin e nevojës me te drejte KVO e ka konsideruar si te plotësuar si kusht. Ne vleresimin e diteve te soteme gjate procesit te zbatimit te veprës konstatohet qe ku kriter eshte perzbushur jo vetem ne teori por edhe ne praktike nga subjekti.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të argumentave të dhëna edhe në kontestimet e proceverbaleve përkatëse kerkohet ndryshimi i këtij përfundimi pasi është i pa mbështetur në prova e ligj.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH^{-së} : Sqarimet/shpjegimet e dhëna nga MK, nuk prekin argumentet e shprehura hollësisht në akt konstatim, projektraport dhe raport përfundimtar, për rrjedhojë komentet/shpjegimet e MK, **nuk qëndrojnë.**

2.3.1.12. Lidhur me stafin teknik të punësuar:

- Nuk ka lidhur kontratë (dhe nuk ka në listë pagesa të paktën për periudhën janar – korrik 2016) një inxhinier mekanik, një inxhinier hidrolog, një inxhinier gjeolog dhe - ka lidhur kontratë, por nuk janë në listë pagesa të paktën për periudhën janar – korrik 2016, tre inxhinier ndërtimi (A. R. lidhur kontratë datë 25.3.2016, I.X. lidhur kontratë datë 14.4.2016 dhe F. S. ing. restaurator lidhur kontratë datë 14.9.2016), një inxhinier mekanik (R. S. inxhinier mekanik lidhur kontratë datë 15.9.2016) një inxhinier mjedisi (L. Xh. lidhur kontratë datë 13.9.2016) .

Sipas licencës drejtues (staf) teknik është i përbërë nga R. Th. inxhinier hidro dhe E. Sh. inxhinier elektrik.

Sa më sipër në kundërshtim me pikën 5.1. dhe 5.2 të KVK të miratuara, në të cilat është përcaktuar se ...

5.1. OE duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve për periudhën janar-dhjetor 2014 janar 2015 – dhjetor 2015 dhe janar 2016 – korrik 2016 duhet të jetë jo me pak se 150 punonjës.

Kjo do të dëshmohet me vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën janar-dhjetor 2014 janar 2015 – dhjetor 2015 dhe janar 2016 – korrik 2016 dhe të shoqërohet me listë pagesat e plotësuar rregullisht, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj sipas formularit të përcaktuar E-SIG 025/a të cilat të jene të konfirmuara nga Dega e Tatim Taksave ku është regjistruar.

5.2. Operatoret Ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tij teknik të punësuar për periudhën janar-dhjetor 2014, janar-dhjetor 2015 dhe janar-korrik 2016:

- ***1 Arkitekt***
- ***1 Inxhinier ndërtimi Strukturist***
- ***2 Inxhinier ndërtimi***
- ***1 Inxhinier elektrik***
- ***2 Inxhinier mekanik***
- ***1 Inxhinier mjedisi***



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

- 2 Inxhinier hidroteknik
- 1 Inxhinier gjeolog

Për inxhinieret pjesë e stafit të cilët duhet detyrimisht të jenë të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për periudhën e mësipërme, duhet të paraqitet kontratë pune (me kohe të plote) me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt si dhe diplomë, CV dhe/ose licence.

Operatori ekonomik duhet të deklarojë me shkrim që i gjithë stafi teknik do të jetë prezent gjatë gjithë kohës, gjatë zbatimit të punimeve deri në kolaudimin e objektit.

Kriteri i paplotësuar.

MK ka bërë vërejtje/sqarime për pikën 2.3.1.12 të projektraportit si më poshtë:

Konstatimi i audituesit të autorizuar të Kontrollit të Lartë të Shtetit në pikën 2.3.1.12. Lidhur me stafin teknik të punësuar është: - Nuk ka lidhur kontrate (dhe nuk ka ne listpagesa të pakten për periudhën Janar-Korrik 2016) një inxhinier mekanik, një inxhinier hidrolog, një inxhinier gjeolog; dhe

- ka lidhur kontrate, por nuk janë ne liste pagesa, të pakten për periudhën Janar-Korrik 2016, tre inxhinierë ndertimi (A. R. lidhur kontrate date 25.3.2016, I. X. lidhur kontrate date 14.4.2016 dhe F. S. ing. restaurator lidhur kontrate date 14.9.2016), një inxhinier mekanik (R. S. inxhinier mekanik lidhur kontrate date 15.9.2016), një inxhinier mjedisi (L. Xh. lidhur kontrate date 13.9.2016).

Sipas Licences drejtues (staf) teknik është i perbere nga R. Th., inxhinier hidro dhe E Sh, inxhinier elektrik.

Sa me sipër, në kundërshtim me pikën 5.1 dhe 5.2 të KVK të miratuara, në të cilat është percaktuar se:

5.1. OE duhet të ketë numerin e nevojshëm të punonjesve për zbatimin e kontrates. Numeri i punonjesve për periudhën për periudhën janar-dhjetor 2014 janar 2015 – dhjetor 2015 dhe janar 2016 – korrik 2016 duhet të jete jo më pak se 150 punonjes.

Kjo do të deshmohet me vertetim nga Drejtoria e Tatimeve për numerin e punonjesve të siguruar për periudhën janar-dhjetor 2014 janar 2015 – dhjetor 2015 dhe janar 2016 – korrik 2016 dhe të shoqërohet me listpagesat e plotesuara rregullisht, ku të specifikohet numeri i punonjesve për secilin muaj sipas formularit të percaktuar E-SIG 025/a të cilat të jene të konfirmuara nga Dega e Tatim Taksave ku është regjistruar.

5.2. Operatoret Ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tij teknik të punësuar për periudhën janar-dhjetor 2014 dhe janar-dhjetor 2015 dhe janar-korrik 2016:

- 1 Arkitekt
- 1 Inxhinier ndertimi Strukturist
- 2 Inxhinier ndertimi
- 1 Inxhinier elektrik
- 2 Inxhinier mekanik
- 1 Inxhinier mjedisi
- 2 Inxhinier hidroteknik
- 1 Inxhinier gjeolog

Për inxhinieret pjesë e stafit të cilët duhet detyrimisht të jene të pasqyruar në listpagesat e shoqërisë për periudhën e mësipërme, duhet të paraqitet kontratë pune (me kohe të plote) me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt si dhe diplomë, CV dhe/ose license.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Përgjigje : *Ministria e Kulturës në përgjigje për gjetjet në pikën 2.3.1.12. parashtron se: Ne lidhje me pretendimin se Shoqeria A nuk ka asnjë inxhinier mekanik per periudhen Janar-Korrik 2016 qe te figuroje ne listepagesat perkatese, sqarojme se se në analizën e saj KVO ka marrë në konsideratë plotësimin e kriterëve të tenderit nga ana e BOE dhe jo vetëm nga ana e secilit operator.*

Në cdo rast theksojmë se kjo shoqeria A ka paraqitur në tender të gjithë stafin e kerkuar, të cilët figurojnë ne listpagesat perkatese. Gjithashtu, shoqeria tjetër anetare e ketij BOE ka paraqitur në tender të gjithë stafin teknik, për të gjithë perudhen e kërkuar. Sipas këtyre listave rezulton se

nje inxhinier mekanik,

- nje inxhinier hidrolog/ hidroteknik - inxhinieri R. Th, Inxhinier Hidroteknik, figuron ne listpagesa per te gjithë periudhen e kerkuar ne DT te miratuar nga AK. Numri i regjistrimit: G40422140ë

nje inxhinier gjeolog

I njëjti argument vlen per analogji per te gjithë stafin, te cilet figurojne ne listpagesat e vitit 2016.

Lidhur me Ekspertin Restaurator Inxh. F. S. sqarojme se, kjo shoqeri ka paraqitur ne tender dokumentacionin perkates si inxhinier restaurator, sipas kerkeses per kualifikim duke plotesuar te gjitha kerkesat e percaktuara ne dokumentet e tenderit.

Lidhur me kontratat e punes, sqarojme se nje shoqeri nuk mund te kete gjithmone kontrata te perheshme dhe pa afat - pune, per AK është e rëndësishme që BOE të paraqesi kontratat e punes të cilat janë në fuqi, në momentin e zhvillimit të procedurës si dhe që ky personel të figurojë në listepagesa, kushte të cilat ky BOE i plotëson.

Për sa më sipër dhe në mbeshtetje të argumentave të dhëna edhe në kontestimet e proceverbaleve përkatëse kerkohet ndryshimi i këtij perfundimi pasi nuk bazohet në prova che në argumenta ligjore.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së : Sqarimet/shpjegimet e dhëna nga MK, nuk prekin argumentet e paraqitur hollësisht në Akt konstatim, projektraport dhe Raport Përfundimtar, për rrjedhojë, komentet/shpjegimet e MK, **nuk qëndrojnë.**

2.3.1.13. *Lidhur me ekspertët e akustikës dhe skenës.*

G. S, eksperti (konsulenti sipas kontratës lidhur me “A” sh.p.k.) për punë të ngjashme të fundit, ka paraqitur “Blerje fonie dhe ndriçimi” me vlerë 3,500 mijë lekë në vitin 2009. “Punime të ngjashme” të tjera të deklaruara prej vitit 1998 janë pa vleftë.

BOE që ka fituar tenderin, kriterin për një ekspert mbi “akustikën” dhe një ekspert mbi “skenën” , e ka plotësuar me lidhjen e marrëveshjeve me një inxhinier ndërtimi i profilizuar për “Konstruksione civile dhe industriale” dhe një inxhinier elektrik/kompjuterik, shtetas rumunë (përkatësisht të datëlindjes 1947 dhe 1950), të cilët kanë paraqitur vetëm vërtetime (pa vleftë) nga të tretë, sipas të cilëve kanë realizuar nga 5 objekte secili (akustikë dhe skenë). Vërtetimet për punë të ngjashme për “Skenë” janë për punë të realizuara para vitit 2008.

Në dokumentacionin e z. D. G, nuk gjendej licencë për ushtrim aktiviteti.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Për kontrata të realizuara me subjektet private, nuk janë paraqitur kontrata/kontratat, situacion përfundimtar, akt kolaudimi dhe leja e përdorimit, faturë tatimore (pika 3 e KVK të miratuara).

2.3.1.14. Lidhur me dokumentacionin kualifikues të OE “E” sh.p.k.

2.3.1.14.1. Në zbatim të KVK , për plotësimin e tyre ka paraqitur ndër të tjera një eskavator me goma katerpilar 432 D, një fadromë Bennati MOD 16S S/N, pompë suvatimi tre copë, të cilat saktësisht janë paraqitur në shtojcën 9 “Disponibiliteti i makinerive/mjeteve” në tenderin me objekt *“Rikonstruksion dhe ndryshim Destinacioni i Ish Laboratorit te Hidroteknikes, ne Qendër Arti Skena e Re” Faza II Punime Ndërtimore*” me fond limit me fond limit prej 449,612,937 lekë, i zhvilluar datë 31.03.2016 me afat të zbatimit të punimeve 18 muaj. Kriter i paplotësuar.

2.3.1.14.2. Lidhur me stafin teknik të punësuar nga OE “E” sh.p.k.

Në KVK (pika 5) është kërkuar që OE të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve **për zbatimin e kontratës**. Numri i punonjësve *për periudhën janar-dhjetor 2014 janar 2015 – dhjetor 2015 dhe janar 2016 – korrik 2016 duhet të jetë jo më pak se 150 punonjës*.

2.3.1.15.3. OE “E” sh.p.k. mesatarisht për periudhën e kërkuar ka rreth 100 punonjës. Duke qenë pjesëmarrës në BOE me 49 për qind të punimeve të preventivit, proporcionalisht duhet të plotësojë dhe fuqinë mesatare punëtore për gjithë periudhën, që i takon 73 punonjës.

2.3.1.15.4. Nga verifikimi i regjistrimit të realizimit të prokurimeve, konstatohet se OE “E” sh.p.k. ka marrë pjesë dhe është shpallur fitues në procedurën e tenderit me objekt *“Rikonstruksion dhe ndryshim Destinacioni i Ish Laboratorit te Hidroteknikes, në Qendër Arti Skena e Re” Faza II Punime Ndërtimore*”.

Në pikën 3 të KVK të miratuar nga AK, është përcaktuar që ... OE të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve **për zbatimin e kontratës**. Numri i punonjësve *për periudhën janar-dhjetor 2014 janar 2015 – dhjetor 2015 dhe janar 2016 duhet të jetë jo më pak se 100 punonjës*.

Nga krahasimi i numrit mesatar të punonjësve sipas pikave 2.2.1 dhe 2.2.2 rezulton se tërësisht fuqia punëtore ka plotësuar kriterin për tenderin me objekt *“Rikonstruksion dhe ndryshim Destinacioni i Ish Laboratorit te Hidroteknikes, ne Qendër Arti Skena e Re” Faza II Punime Ndërtimore*”, kurse për tenderin me objekt *“Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor*”, kriteri i numrit mesatar të punonjësve, rezulton i paplotësuar.

I njëjti përfundim është dhe për stafin teknik të punësuar dhe me IQT (shih pikën 1.7. të akt konstatimit), pasi janë të njëjtit persona në të dy tenderët . Deklaratat se ... *stafi drejtues – teknik do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet deri në kolaudimin e objektit (për të dy tenderët)*... nuk janë të vërteta, (nuk mund të jetë njëkohësisht në realizimin e punimeve për të dy tenderët, përjashtojnë njëra tjetrën (pika 2.2.1. dhe 2.2.2.). Kriter i paplotësuar.

Ka qenë detyrë e KVO të saktësonte *“Deklarimin për fuqinë punëtore mesatare...”* të OE “E” sh.p.k. dhe mbi këtë bazë, për *“Deklarim të rremë”* të skualifikonte OE “E” sh.p.k.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

2.3.1.15.5. Vlen të veçohet se mbështetur në procesverbalin datë 15.3.2017 me objekt “Mbi fillimin e punimeve” lidhur midis mbikëqyrësit të punimeve përfaqësues ligjor i “A” sh.p.k. BOE “E” sh.p.k. & “A” sh.p.k. dhe përfaqësuesit të MK, *stafi* i caktuar për ndjekjen/zbatimin e punimeve nuk është në zbatim të pikës 5.2.të KVK të miratuara nga AK.

Nga verifikimi i dokumentacionit nëse *përbërja e stafit është ajo e kërkuar në KVK dhe e deklaruar nga BOE “E” sh.p.k. & “A” sh.p.k. u konstatua se:*

- A. P. me profesion arkitekt, nuk është në përbërje të stafit teknik dhe nuk ka kontratë me OE të BOE.

- P. P. me profesion inxhinier ndërtimi strukturist, nuk është në përbërje të stafit teknik dhe nuk ka kontratë me OE të BOE.

- G. T. me profesion inxhinier hidroteknik, nuk është në përbërje të stafit teknik dhe nuk ka kontratë me OE të BOE.

- A. L. dhe B. A. me profesion ing. Gjeodet, nuk është në përbërje të stafit teknik dhe nuk ka kontratë me OE të BOE.

- A. A. me profesion inxhinier elektrik, nuk është në përbërje të stafit teknik dhe nuk ka kontratë me OE të BOE.

Në stafin e zbatimit të deklaruar, mungojnë:

- Një inxhinier ndërtimi është deklaruar vetëm E. Z. (janë kërkuar të jenë dy).

- Një inxhinier mekanik është deklaruar vetëm R. S. (janë kërkuar të jenë dy).

- Një inxhinier hidroteknik, është deklaruar vetëm G. T. (janë kërkuar të jenë dy).

Sa më sipër në kundërshtim me pikën 5.2. të KVK (Shih pikën 1.6. të këtij akt konstatimi).

Kriter i paplotësuar.

(Në tenderin me objekt “*Rikonstruksion dhe ndryshim Destinacioni i Ish Laboratorit të Hidroteknikes, ne Qendër Arti Skena e Re” Faza II Punime Ndërtimore*”, me fond limit prej 449,612.937 lekë, OE janë skualifikuar ndër të tjera pasi:

- “H” sh.p.k. *nuk ka ne stafin e vet specialistin Arkitekt për vitin 2014 dhe 2015.*

- “C” sh.p.k. *nuk ka paraqitur Plan - Organizimin e punimeve në objekt me të gjithë kërkesat që kërkon ai, si, rrethimi provizor, depozitimi i materialeve kryesore, ambientet e kantierit zyra magazina, rrugë kalimet, vendosja e vinçit, tabelat e sigurimit teknik etj.*

- “A” sh.p.k. nuk ka paraqitur Fadromë 1 copë, Autobetoniere 1 copë etj, megjithëse oferta ekonomike e tyre ka qenë ndjeshëm nën atë të ofruar nga OE “E” sh.p.k.).

Ministria e Kulturës, në vitin 2016 ka zhvilluar tenderin me objekt “Rikonstruksioni i TOB...”.

Përmbledhur:

Në këtë procedurë tenderimi, kanë marrë pjesë tre OE me të dhëna si më poshtë:

Nr	Operatorët ekonomikë	Njësia e matjes	Ofertat ekonomike		Kualifikuar/ skualifikuar
			Pa TVSh	Me TVSh	
1	BOE “A & C & ”	000 L	846,326,626		skualifikuar
2	BOE “E” & “A” sh.	”	926,754,355		fitues
3	OE “A” sh.p.k.	”	965,902,760		kualifikuar

Për mangësi/parregullsi në dokumentacionin ligjor kualifikues, autoriteti kontraktor ka skualifikuar me të drejtë BOE “A & C& ...” sh.p.k.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Autoriteti kontraktor, ka kualifikuar e në vijim ka shpallur fitues BOE "E" sh.p.k. & "A" sh.p.k. me vlerë të ofertës ekonomike 926,754,355 lekë pa TVSH.

Nga verifikimi i dokumentacionit ligjor dhe kualifikues të BOE "E" sh.p.k. & "A" sh.p.k. u konstatuan mangësi/parregullsi për të cilat autoriteti kontraktor, duhet të kishte skualifikuar këtë BOE.

Në kushtet që autoriteti kontraktor, nuk e ka skualifikuar BOE "E" sh.p.k. & "A" sh.p.k, atëherë duke ruajtur të njëjtin standard, do të ishte më e arsyeshme që autoriteti kontraktor të kualifikonte dhe shpallte fitues BOE "A & C & ..." sh.p.k. me ofertë 846,326,626 lekë, ose 80,427,729 lekë më pak se sa oferta ekonomike e BOE "E" sh.p.k. & "A" sh.p.k. e cila nën arsyetimin e *mësipërm përbën përdorim pa efektivitet, eficensë dhe ekonomicitet të fondeve publike*

Gjetje nga auditimi:

<p>Situata:</p>	<p>Në tenderin me objekt "Rikonstruksioni i TOB...",</p> <p>1. Njësia e prokurimit, në hartimin dokumentacionit standard (DS) të tenderit me objekt ka vendosur kritere të veçanta në kualifikimin (KVK) e operatorëve ekonomikë në kundërshtim me:</p> <ul style="list-style-type: none">- Frymën/thelbin e nenit 1 "<i>Objekti dhe qëllimi</i>" i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar,- Nenin 46 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006,- Nenin 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". <p>KVK e vendosura nga njësia e prokurimit, kanë ndikuar thelbësisht në pjesëmarrjen e OE në tender dhe në përcaktimin e OE fitues.</p> <p>2. Autoriteti kontraktor ka:</p> <p>Për mangësi/parregullsi në dokumentacionin ligjor kualifikues, autoriteti kontraktor ka skualifikuar me të drejtë BOE "A & C & ..." sh.p.k.</p> <p>Autoriteti kontraktor, ka kualifikuar e në vijim ka shpallur fitues BOE "E" sh.p.k. & "A" sh.p.k. me vlerë të ofertës ekonomike 926,754,355 lekë pa TVSH.</p> <p>Nga verifikimi i dokumentacionit ligjor dhe kualifikues të BOE "E" sh.p.k. & "A" sh.p.k. u konstatuan mangësi/parregullsi për të cilat autoriteti kontraktor, duhet të kishte skualifikuar këtë BOE.</p> <p>Në kushtet që autoriteti kontraktor, nuk e ka skualifikuar BOE "E" sh.p.k. & "A" sh.p.k, atëherë duke ruajtur të njëjtin standard, do të ishte më e arsyeshme që autoriteti kontraktor të kualifikonte dhe shpallte fitues BOE "A & C & ..." sh.p.k. me ofertë 846,326,626 lekë, ose 80,427,729 lekë më pak se sa oferta ekonomike e BOE "E" sh.p.k. & "A" sh.p.k. e cila nën arsyetimin e mësipërm përbën përdorim pa efektivitet, eficensë dhe ekonomicitet të fondeve publike</p> <p>Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 i ndryshuar.</p>
<p>Kriteri:</p>	<p>Moszbatimi i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 i ndryshuar.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Shkaku:	E lartë
Rëndësia e shkeljes:	-
Rekomandimi:	

MK ka bërë vërejtje/sqarime për pikat 2.3.1.13, 2.3.1.14 dhe 2.3.1.15 të projektraportit, si më poshtë:

Pika 2.3.1.13 e projekt-raportit

Konstatimi i audituesit të autorizuar të Kontrollit të Lartë të Shtetit në pikën 2.3.1.13. lidhur me ekspertet e akustikes dhe skenes G. S, eksperti (konsulenti sipas kontrates së lidhur me "A" shpk), për punë të ngjashme të fundit, ka paraqitur "Blerje fonie dhe ndricimi" me vlerë 3.500 leke në vitin 2009. "Punime të ngjashme" të tjera të deklaruara prej vitit 1998 janë pa vlefte. BOE që ka fituar tenderin, kriterin për një ekspert mbi "akustiken" dhe një ekspert mbi "skenen", e ka plotësuar me lidhjen e marreveshjeve me një inxhinier ndertimi i profilizuar për "Konstruksione civile dhe industriale" dhe një inxhinier elektrik/ kompjuterik, shtetas rumune, të cilët kanë paraqitur vetëm vertetime (pa vlerë) nga të trete, sipas të cileve kanë realizuar nga 5 objekte secili (akustike dhe skene). Vertetimet për punë të ngjashme për "Skene" janë për punë të realizuara para vitit 2008, kriteri i paplotësuar. Në dokumentacionin e Z. D. Ch, nuk gjendej licence për ushtrim aktiviteti. Për kontrata të realizuara me subjektet private, nuk janë paraqitur kontrata, situacion përfundimtar, aktkolaudimi dhe leja e përdorimit, fature tatimore (pika 3 e KVK të miratuara).

Përgjigje : Ministria e Kulturës në përgjigje për gjetjet në pikën 2.3.1.13 sqaron se:

Eksperti G. S. është paraqitur i tepert referuar kërkesave për kualifikim, pasi kërkesa përkatëse plotësohet nga ky BOE për një ekspert skene dhe një akustike, konkretisht Z. G. si ekspert skene. Pra, kërkesa për kualifikim plotësohet, kurse ekspertet e tjera të paraqitura, nuk i ndikojnë fatin të kualifikimit, në kushtet kur plotësohet kërkesa për kualifikim.

Lidhur me pretendimet tuaja për vlerat për ekspertet e skenes, ju sqarojmë se një përcaktim i tillë nuk është kërkesë për kualifikim.

Lidhur me pretendimin tuaj se Z. D. G. nuk ka license ju sqarojmë që një kërkesë e tillë nuk është kërkuar në dokumentet e tenderit. Për këtë person është paraqitur i plote i gjithë dokumentacioni sipas kërkesës për kualifikim, ku është kërkuar të paraqitet kontrata, referencat, CV, kërkesa keto të shprehura në kërkesat për kualifikim të tenderit.

Në lidhje me punët e ngjashme – paragrafi i fundit në pikën 1.7., që i referohet pikës 3 në KVK, për punët e ngjashme të Operatoreve Ekonomike dhe jo të eksperteve të disiplinave të kërkuara.

Në çdo rast, me poshtë gjëni listën dhe dokumentacionin e venë në dispozicion në lidhje me punët e ngjashme të kërkuara në dokumentata standarde në kërkesat për kualifikim 3. Kapaciteti teknik i operatoreve ekonomike:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Pune te ngjashme ne pune civile ku vlera monetare totale e puneve te kryera ne kuader te disa kontratave, e marre se bashku gjate 3 viteve te fundit, te jete dyfishi i vleres limit te kontrates qe prokurohet.Per kontrata te realizuara me subjektet private, duhet te paraqitet kontrata, leja e ndertimit, situacion perfundimtar, akt kolaudimi dhe leja e perdorimit, faturë tatimore.

Shoqeria A shpk ka paraqitur ne proceduren e prokurimit: si pune te ngjashme:

➤ *Sheshi 3*

1. *Kontrate sipermarrje Nr.3934 rep, 1057 kol date 01.12.2014*
2. *Kontrate sipermarrje Nr.4273 rep/132 kol date 08.04.2009*
3. *Kontrate sipemarrje Nr.3937 rep /196 kol date 17.09.2011*
4. *Leje ndertimi Nr.998 date 28.05.2012*
5. *Leje ndertimi nr.999 date 28.05.2012*
6. *Situacion punimesh ,*
7. *Akt kolaudimi*
8. *Leje legalizimi Nr.70202897 date 27.04.2016*
9. *Per sa i perket lejes se shfrytesimit eshte paraqitur Shkrese nga Bashkia Tirane Nr28305/1 date 23.09.2016 ne te cilen eshte sqaruar shoqeria se leje e legalizimit eshte e barazvlefshme , me lejen e shfrytezimit*
10. *Formulari i vleresimit*

➤ *Zona A*

1. *Kontrate sipermarrje Nr.5080 rep, 1618 kol date 29.04.2009*
2. *Kontrate sipermarrje date 11.05.2012*
3. *Leje ndertimi Nr.1421 date 13.09.2007*
4. *Leje ndertimi nr.1631 date 20.06.2005*
5. *Situacion punimesh ,*
6. *Akt kolaudimi*
7. *Leje perdorimit nr.2073 date22.09.2014*
8. *Formulari i vleresimit*

➤ *Zona B*

1. *Kontrate sipermarrje Nr.3932 rep, 1055 kol date 01.12.2014*
2. *Kontrate sipermarrje Nr.4823 rep/820 kol date 18.07.2003*
3. *Leje ndertimi Nr.1179 date 14.07.2010*
4. *Situacion punimesh ,*
5. *Akt kolaudimi*
6. *Leje legalizimi Nr.664121 date 20.02.2015*
7. *Per sa i perket lejes se shfrytezimit eshte paraqitur Shkrese nga Bashkia Tirane Nr.28305/1 date 23.09.2016 ne te cilen eshte sqaruar shoqeria se leje e legalizimit eshte e barazvlefshme , me lejen e shfrytezimit*
8. *Formulari i vleresimit*

➤ *Zona C*

1. *Kontrate sipermarrje Nr.3931 rep, 1054 kol date 01.12.2014*
2. *Kontrate sipermarrje Nr.4822 rep/820 kol date 18.07.2003*
3. *Leje ndertimi Nr.1859 date 31.12.2007*
4. *Situacion punimesh ,*
5. *Akt kolaudimi*
6. *Leje perdorimi Nr.1630 date 17.07.2014*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

7. *Formulari i vleresimit*
 - *Zona E*
 1. *Kontrate sipermarrje Nr.4822 rep, 820 kol 18.07.2003*
 2. *Leje ndertimi Nr.192 date 24.01.2006*
 3. *Situacion punimesh ,*
 4. *Akt kolaudimi*
 5. *Leje legalizimi Nr.664254 date 20.02.2015*
 6. *Per sa i perket lejes se shfrytesimit eshte paraqitaur Shkrese nga Bashkia Nr.28305/1 date 23.09.2016 ne te cilen eshte sqaruar shoqeria se leje e legalizimit eshte e barazvlefshme , me lejen e shfrytezimit*
 7. *Formulari i vleresimit*
 - *Masha*
 1. *Kontrate sipermarrje Nr.2943 rep, 803/3 korrik 2007*
 2. *Leje ndertimi Nr.672 date 24.04.2012*
 3. *Situacion punimesh ,*
 4. *Akt kolaudimi*
 5. *Leje legalizimi Nr.665167 date 25.04.2015*
 6. *Per sa i perket lejes se shfrytesimit eshte paraqitaur Shkrese nga bashkia Tirane Nr.28305/1 date 23.09.2016 ne te cilen eshte sqaruar shoqeria se leje e legalizimit eshte e barazvlefshme , me lejen e shfrytezimit .*
 7. *Formulari i vleresimit*
 - *Paja -Jahelezi*
 1. *Kontrate sipermarrje Nr.9019 rep, 1948 kol date 24.12.2009*
 2. *Kontrate sipermarrje Nr.623 rep/268 kol date 28.01.2008*
 3. *Kontrate bashke investimi Nr.4521 rep /1969 dt.12.11.2010*
 4. *Leje ndertimi Nr.1573 date 27.09.2011*
 5. *Situacion punimesh ,*
 6. *Akt kolaudimi*
 7. *Leje perdorimi Nr.2076 date 22.09.2014*
 8. *Formulari i vleresimit*
 - *Zgjerimi*
 1. *Kontrate sipermarrje Nr.8528 rep, 4030 kol date 15.10.2007*
 2. *Kontrate sipermarrje Nr.10310 rep/2939 kol date 21.09.2011*
 3. *Kontrate sipemarrje Nr.3928 rep /1050 kol date 21.12.2014*
 4. *Leje ndertimi Nr.1611 date 07.08.2013*
 5. *Situacion punimesh ,*
 6. *Akt kolaudimi*
 7. *Leje legalizimi Nr.665168 date 25.04.2015*
 8. *Per sa i perket lejes se shfrytesimit eshte paraqitaur Shkrese nga bashkia Nr.28305/1 date 23.09.2016 ne te cilen eshte sqaruar shoqeria se leje e legalizimit eshte e barazvlefshme , me lejen e shfrytezimit*
 9. *Formulari i vleresimit*

Shoqeria Agi kos ne vijim te kerkesave per kualifikim te autoritetit kontraktor ka paraqituar kopje te njesuara me origjinalin te te faturave tatimore me nr. si me poshte:

 - *89/2014; 96/2017; 149/2014; 179/2014;7/2011; 88/ 2012 ; 50/2009; 105/2010; 141/2010; 47/2010 ;53/2011 ; 62/2011; 53/2012 ;*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

- 20/2005;3/2007;11/2007;1/2008;25/2009;
- 36/2013; 43/2013; 64/2013; 73/2013; 86/2013; 89/2014; 96/2014; 43/2009;1/2013; 36/2013; 10/2015; 134/2014; 103/2014; 54/2013 ; 171/201; 170/ 2014
- 50/2013; 86/2014 ;46/2011; 73/2013 ;4/2008; 120/2014; 7/2008; 7/2008 ; 1/2009; 38/2011; 90/2014
- 96/2014; 81/ 2014; 002/2013; 25/2007 ;
- 21/2013; 28/2013; 36;2013; 80/2014; 05/2015; 194/2013;
- 13/2018; 9/2008; 54/2013 187/2014; 120/2014 ; 30/2011; 30/2011; 131/ 2010 ; 148/2010 157/2010 95/2013.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të argumentave të dhëna edhe në kontestimet e proceverbaleve përkatëse kërkohet ndryshimi i këtij përfundimi pasi jo vetëm që është i pambështetur në argumenta ligjore por edhe sepse interesi publik i mbrojtur në rastin konkret është madhor dhe nuk cënon rregullat e prokurimit publik.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së: Sqarimet/shpjegimet e dhëna nga MK, nuk kanë lidhje me sa është shprehur në akt-konstatim, por ato vërtetojnë pikërisht atë që ka theksuar grupi i auditimit, lidhur me termin “punime të ngjashme”.

Pika 2.3.1.14 e projekt-raportit

Konstatimi i audituesit të autorizuar të Kontrollit të Lartë të Shtetit në pikën 2.3.1.14. lidhur me dokumentacionin kualifikues të OE “Edil AL-IT” sh.p.k.

Në zbatim të KVK për plotësimin e tyre ka paraqitur ndër vite të tjera një eskavator me goma katerpillar 432 D, një fadromë Bennati MOD 16S S/N, pompë suvatimi tre copë, të cilat saktësisht janë paraqitur në shtojcën 9 “Disponibiliteti i makinerive/mjeteve” në tenderin me objekt “Rikonstruksion dhe ndryshim Destinacioni i Ish Laboratorit të Hidroteknikes, në Qendër Arti Skena e Re” Faza II Punime Ndërtimore” me fond limit me fond limit prej 449,612,937 lekë, i zhvilluar me datë 31.03.2016 me afat të zbatimit të punimeve 18 muaj. Kriteri i paplotësuar.

2.3.1.14.2. Lidhur me stafin teknik të punësuar nga OE “E” sh.p.k.

Në KVK (pika 5) është kërkuar që OE të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve për periudhën janar – dhjetor 2014 janar 2015-dhjetor 2015 dhe janar 2016- korrik 2016 duhet të jetë jo më pak se 150 punonjës.

2.3.1.14.3. OE “E” sh.p.k. mesatarisht për periudhën e kërkuar ka rreth 100 punonjës. Duke qenë pjesëmarrëse në BOE me 49 përqind të punimeve të preventivit, proporcionalisht duhet të plotësojë dhe fuqinë mesatare për periudhën, që i takon 73 punonjës.

2.3.1.15.4. Nga verifikimi i regjistrimit të realizimit të prokurimeve, konstatohet se OE “E” sh.p.k. ka marrë pjesë dhe është shpallur fitues në procedurën e tenderit me objekt “Rikonstruksion dhe ndryshim Destinacioni i Ish Laboratorit të Hidroteknikës, në Qendër Arti Skena e Re” Faza II Punime Ndërtimore”

Në pikën 3 të KVK të miratuar nga AK, është përcaktuar që... OE të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve për periudhën janar-dhjetor 2014 janar 2015 – dhjetor 2015 dhe janar 2016 duhet të jetë jo më pak se 100 punonjës.

Nga krahasimi i numrit mesatar të punonjësve sipas pikave 2.2.1 dhe 2.2.2 rezulton se



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

tërësisht fuqia puntore ka plotësuar kriterin për tenderin me objekt “Rikonstruksion dhe ndryshim Destinacioni i Ish Labororit të Hidroteknikës, në Qendër Arit Skena e Re” Faza II Punime Ndërtimore”, kurse për tenderin me objekt “Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor”, kriteri i numrit mesatar të punonjësve, rezulton i paplotësuar.

Pergjigja : Ministria e Kulturës në përgjigje për gjetjet në pikën 2.3.1.14. parashtron se, ashtu sic eshte argumentuar edhe ne lidhje me pikat 2.3.1.9 dhe 2.3.1.10 të projekt-raportit: Bazuar ne ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 44 parashikon se BOE mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm. Autoriteti kontraktor duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimi të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit.

Gjithashtu, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar në Kreun VIII (“Kushte të përgjithshme për zbatim”), neni 74 (“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”), pika 1, 2 dhe 3 parashikon se: “1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi (...) Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.”

“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”. Operatorët ekonomikë duhet të ndajnë dhe të përcaktojnë % e shërbimit, si dhe zërat e shërbimeve që do të kryej secili operator dhe jo të ndajnë kriteret e kualifikimit pasi kriteret teknike dhe ato ekonomike plotësohen në përputhje me përqindjet e mara përsipër”.

Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, në kontratën e bashkëpunimit operatorët ekonomikë nuk duhet të ndajnë kriteret dhe kërkesat e autoritetit duke përcaktuar se cilat kritere do të plotësojë çdo anëtar i bashkimit, por duhet të ndajnë dhe përcaktojnë elementët konkretë të shërbimit që do të kryejë secili referuar zërave të shërbimit që kërkon autoriteti kontraktor. Sa më sipër, përmbushja e kritereve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Ndersa kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Se pari, te gjitha mjetet e permendura nga audituesit te autorizuar të Kontrollit të Lartë të Shtetit ne piken 2.3.1.14. zoterohen njekohesisht nga te dy Operatorët ekonomikë. Konkretisht:

- OE “E” sh.p.k. ka paraqitur - një eskavator me goma katerpilar 432 D;*
- OE “A” sh.p.k. ka paraqitur - një eskavator me goma TR1886N;*
- OE “E” sh.p.k. ka paraqitur - një fadromë Bennati MOD 16S S/N;*
- OE “A” sh.p.k. ka paraqitur - një fadromë Kramer,130104;*
- OE “E” sh.p.k. ka paraqitur - pompë suvatimi tre cope, ndersa ne kriteret e vendosura eshte kerkuar vetem nje e tille.*

Se dyti, referuar nenit 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.(...) b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”;

Operatori Ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates dhe te paraqese deshmi per mjetet dhe pajisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund ti vihen ne dispozicion operatorit ekonomik sipas kerkesave ne piken 6.1. ne KVK e miratuar por duhet edhe te vertetoje/ paraqese aftesine dhe kapacitetin e shoqerise. Prandaj fakti qe i ka paraqitur si pjese e dokumentacionit te tij per te treguar aftesine dhe kapacitetin e shoqerise, mgjs mund ti kete te angazhuara edhe ne nje kontrate tjeter, nuk perben asnje shkelje. Njekohesiht nuk eshte nje kriter i paplotesuar nga bashkimi i Operatoreve.

2.3.1.14.2. Lidhur me stafin teknik të punësuar nga OE “E” sh.p.k. ne lidhje me kete pike duhet te theksojme qe ne kriteret per Kualifikim OE i eshte kerkuar te kene te siguruar nje numer te caktuar punonjesish per te patur sigurine qe kemi te bejme me shoqeri serioze dhe qe i mbulojne kapacitetet e investimit. Por ne asnje rast nuk eshte kerkuar qe keta punonjes te jene te gjithë ne sherbim te ketij projekti.

Citim nga DST:

“5. Deshmi per fuqine mesatare punetore te operatorit ekonomik:

5.1. OE duhet te kete numerin e nevojshem te punonjesve per zbatimin e kontrates. Numeri i punonjesve per periudhen per periudhen janar-dhjetor 2014 janar 2015 – dhjetor 2015 dhe janar 2016 – korrik 2016 duhet te jete jo me pak se 150 punonjes”.

Per sa me siper, skualifikimi i shoqerise me motivin qe ka marre pjese ne nje procedure tjeter prokurimi dhe e ka te angazhuar punetorene nuk qendron.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Për sa më sipër dhe në mbështetje të argumentave të dhëna edhe në kontestimet e proceverbaleve përkatëse kerkohet ndryshimi i këtij përfundimi pasi nuk bazohet në prova dhe në argumenta ligjore por edhe sepse interesi publik i mbrojtur në rastin konkret është madhor dhe nuk cënon rregullat e prokurimit publik.

Pika 2.3.1.15 e projekt-raportit

Konstatimi i audituesit të autorizuar të Kontrollit të Lartë të Shtetit në pikën 2.3.1.15. mbështetur në procesverbalin datë 15.03.2017 me objekt “Mbi fillimin e punimeve” lidhur midis mbikqyrësit të punimeve i “A” sh.p.k BOE “E” sh.p.k & “A” sh.p.k dhe përfaqësuesit të Ministrisë së Kulturës, staf i caktuar për ndjekjen/zbatimin e punimeve nuk është në zbatim të pikës 5.2 të KVK të miratuar nga AK.

Nga verifikimi i dokumentacionit nëse përbërja e stafit është ajo e kërkuar në KVK dhe e deklaruar nga BOE “E” sh.p.k & “A” sh.p.k u konstatua se:

- *A. P. me profesion arkitekt, nuk është në përbërje të stafit teknik dhe nuk ka kontratë OE të BOE.*
- *P. P. me profesion inxhinier ndërtimi strukturist, nuk është në përbërje të stafit teknik dhe nuk ka kontratë OE të BOE.*
- *G.T. me profesion inxhinier hidroteknik, nuk është në përbërje të stafit teknik dhe nuk ka kontratë OE të BOE.*
- *A.L.dhe B. A. me profesion ing. Gjeodet, nuk është në përbërje të stafit teknik dhe nuk ka kontratë OE të BOE.*
- *A.A. me profesion inxhinier elektrik, nuk është në përbërje të stafit teknik dhe nuk ka kontratë OE të BOE.*

Në stafin e zbatimit të deklaruar, mungojnë:

- *Një inxhinier ndërtimi është deklaruar vetëm E. Z. (janë kërkuar të jenë dy).*
- *Një inxhinier mekanik është deklaruar vetëm R.S. (janë kërkuar të jenë 2).*
- *Një inxhinier hidroteknik, është deklaruar vetëm G. T. (janë kërkuar të jenë 2).*

Sa më sipër në kundërshtim me pikën 5.2 të KVK (Shih pikën 1.6. të këtij akt konstatimi).

Kriter i paplotësuar.

(Në tenderin me objekt “Rikonstruksion dhe ndryshim Destinacioni i Ish Laboratorit të Hidroteknikës, në Qendër Arti Skena e Re” Faza II Punime ndërtimore ”, me fond limit prej 449,612.937 lekë, OE janë skualifikuar ndër të tjera pasi:

- *“H” sh.p.k. nuk ka në stafin e vet specialistin Arkitekt për vitin 2014 dhe 2015*
- *“C” sh.p.k nuk ka paraqitur Plan – Organizimin e punimeve në objekt **me të gjithë kërkesat që kërkon ai**, si, rrethimi provizor, depozitimi i materialeve kryesore, ambjentet e kantierit zyra magazine, rrugë kalimet, vendosja e vinçit, tabelat e sigurimit teknik etj.*
- *“A” sh.p.k. nuk ka paraqitur Fadromë 1 copë, Autobetoniere 1 copë etj., megjithëse oferta ekonomike e tyre ka qenë ndjeshëm nën atë të ofruar nga OE “E” sh.p.k.).*

Përgjigje : *Ministria e Kulturës në përgjigje për gjetjet në pikën 2.3.1.14. parashtrohet se në lidhje me konstatimin që tek procesverbali i fillimit të punimeve nuk janë emrat e deklaruar në tender ose nuk ka firmosur i gjithë stafi teknik që është deklaruar në tender.*

Lidhur me këto konstatime sqarohet se, stafi teknik i kërkuar në kushtet e tenderit, janë të pranishëm në objekt sipas nevojës dhe sipas përcaktimit të punës dhe ky BOE ka paraqitur dhe ka të angazhuar të gjithë stafin e nevojshëm për të realizuar me sukses punimet brenda afatit të përcaktuar dhe me cilësi të përcaktuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Ne procesverbalin datë 15.03.2017 me objekt “Mbi fillimin e punimeve” është caktuar dhe ka qene present ne objekt stafi i perbere nga:

- A. P.me profesion arkitek;
- P. P. me profesion inxhinier ndërtimi;
- G.T. me profesion inxhinier hidroteknik;
- A. L. dhe B. A.me profesion ing. Gjeodet;
- A.A.me profesion inxhinier elektrik;
- Një inxhinier ndërtimi është deklaruar vetëm E.Z.;
- Një inxhinier mekanik është deklaruar vetëm R. S.;
- Një inxhinier hidroteknik, është deklaruar vetëm G. T.

Dosja e zbatimit te punimeve te ndertimit me objekt: “Rehabilitimi i Teatrit Kombetar te Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor” nuk ka qene objekt auditimi nga audituesit te autorizuar të Kontrollit të Lartë të Shtetit (pasi është objekt ne proces zbatimi) dhe ne keto kushte nuk kane mundur te administrojne te gjithë dokumentacionin shtese sa i perket ceshtjes ne fjale. Pas njohjes se projektit ne formed he permbajtje, pas vleresimit te situates ne kantier, per secilen nga disiplinat dhe ekspertizat e kerkuara për ndjekjen/zbatimin e punimeve në zbatim të pikes 5.2 të KVK të miratuar nga AK, BOE ka propozuar dhe negociuar me mbikqyresin dhe perfaqesuesin e Autoritetit kontraktor grupin qe do te ndjeke procesin e zbatimit. Ne vijim te punimeve te zbatimit mund te linde nevoja per ndryshime, shtesa ne staf apo disiplina te tjera, te gjitha keto ceshtje jane pjese e shqyrtimit dhe vleresimit te pergjegjesve te cilet monitorojne kontraten e zbatimit.

Për sa më sipër dhe në mbeshtetje të argumentave të dhëna edhe në kontestimet e procesverbaleve përkatëse kerkohet ndryshimi i këtij përfundimi pasi nuk bazohet në prova dhe në argumenta ligjore por edhe sepse interesi publik i mbrojtur në rastin konkret është madhor dhe nuk cënon rregullat e prokurimit publik.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së : Sqarimet/shpjegimet e dhëna nga MK, nuk prekin argumentet e paraqitur hollësisht në Akt konstatim dhe projektraport, për rrjedhojë, komentet/shpjegimet e MK, **nuk qëndrojnë.**

Lidhur me disponibilitetin e disa mjeteve nga OE “E” sh.p.k. grupi i auditimit sqaron përsëri se përfundimi i tij i është referuar përmbajtjes së shtojcës 9 “Disponibiliteti i mjeteve/makinerive” të deklaruar zyrtarisht nga operatorët ekonomikë të BOE të kërkuar/miratuar me KVK nga AK.

MK ka bërë vërejtje në lidhje me autovinçin me aftesi mbajtëse mbi 70 ton ...

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së : Sqarimet/shpjegimet e dhëna nga KVO, janë pranuar dhe janë reflektuar në Projektraportin e auditimit.

2.3.2. “Rikonstruksioni i Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijët/Teatri i Kukullave dhe Qendrës Kombëtare të Veprimtarive të Folklorit”, i zhvilluar në vitin 2015 disa të dhëna për të cilin janë:

Tëdhënapërprokurimin	Komisioni i Vlerësimit Ofertave	Njësia e prokurimit
a	b	c



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

1.Urdhër prokur. nr. 400 dt. 5.11.2015	A.D. arkitekte	B. H. juriste
2.Fondi limit 47,835,830 lekë.	R. Xh. juriste	A. A. ekon
3. Procedura e prok. "Hapur"	Joli Mitrojorgji	M. M.
4. Data e zhvillimit 8.12.2015	K. A.	
5.Kontraktuesi subjekti OE "B" sh.p.k.	A. R.	
Data e lidhjes kontratës 30.12.2015		
Vlera e kontratës 43,547,284 lekë.		
Diferenca ndaj FL 11,546,426 lekë		

Nga verifikimi I dokumentacionit u konstatua se:

Në sistemin elektronik të APP, u konstatua se kanë paraqitur ofertë OE:

Nr	Operatorët ekonomikë	Njësia e matjes	Ofertat ekonomike		Kualifikuar/skualifikuar
			Pa TVSh	Me TVSh	
1	K	000 L	35,496		skualifikuar
2	B		36,289		fitues
3	L		37,093		kualifikuar
4	S		39,762		kualifikuar
5	e		40,784		skualifikuar
6	K		45,095		kualifikuar

Janë paraqitur 6 OE nga të cilët KVO ka skualifikuar 2 OE ekonomikë. Ka kualifikuar në vend të parë OE "B" sh.p.k.

Parregullsi e konstatuar:

Në preventivin e punimeve të objektit janë përfshirë dhe zërat e punimeve "Rrethim i përkohshëm" me vlerë 120,000 lekë dhe "Rrethim rruge me rrjetë teli" me vlerë 20,000 lekë, ose 147,000 lekë gjithsej (përfshirë dhe fondin rezervë përkatës në masën 5 për qind), në kundërshtim me pikën 3 të germës B "Shpenzimet e përgjithshme" të UKM nr. 2, datë 5.2.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostot së punimeve të ndërtimit" në të cilën është përcaktuar se ... *Në shpenzimet e përgjithshme përfshihen ... Shpenzimet për masat e sigurimit teknik, rrethimet e përkohshme gjatë ndërtimit në lartësi, skelat, makineritë, tabelat sinjalizuese etj., për mbrojtjen në punë si trajtimi me veshmbathje, ushqime, antidotë, ndihmë e shpejtë etj. e cila përbën dëm ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi hartuesit e projekt/preventivit.*

MK për sa më sipër ka bërë vërejtje/sqarime si më poshtë:

Në lidhje me konstatimet e bëra në auditin e procedurës me objekt: "Rikonstruksioni i Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijët", sa i përket punimeve të kryera në preventivin e objektit dhe zërave: "Rrethim i përkohshëm" në vlerë 120.000 lekë dhe "Rrethim rruge me rrjetë teli" në vlerë 20.000 lekë, sqarojmë si më poshtë:

Bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", përcaktohet qartë se si analizohet struktura e kostos për punimet e ndërtimit, duke ndarë vlerën për cdo zë në: Puntori, transport, makineri, material, shpenzimet e përgjithshme 8% dhe fitimi 10%.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Referuar UKM Nr.2, datë 8.5.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kapitulli B, Shpenzimet e përgjithshme dhe fitimi, pika 3, parashikohet në mënyrë të qartë se çfarë mund të konsiderohet në menyre të përmbledhur, për çdo punim në ndërtim “Shpenzime të përgjithshme”. Konkretisht janë “Shpenzimet për masat e sigurimit teknik, rrethimet e përkohshme gjatë ndërtimit në lartësi, skelat, makineritë, tabelat sinjalizuese etj., për mbrojtjen në punë si trajtimi me veshmbathje, ushqime, antidodë, ndihmë e shpejtë etj”, i referohet.

Shpenzimet e përgjithshme dhe fitimi, janë shpenzimet që nuk mund të llogariten e të vlerësohen me zëra pune, sepse ndryshojnë sipas llojit të ndërtimit, konstruksionit, rifiniturave, kohëzgjatjes së punimeve dhe strukturës organizative të sipërmarrësit etj., por llogariten me përqindje.

Shpenzimet e përgjithshme dhe fitimi, që përfshihen në çmimet njësore të zërave të punës, për punimet e ndërtimit dhe punimet teknologjike llogariten me përqindje mbi shpenzimet e drejtpërdrejta, ndërsa për punimet e montimit të pajisjeve dhe makinerive, me përqindje mbi pagat bazë e shtesë të fuqisë punëtore, që merret me punimet e montimit.

Punimet e përmendura nga audituesit i referohen zërave: “Rrethim i përkohshëm me kollona b/a + rrjete teli” dhe “Rrethim rruge me rrjete teli”, të dyja këto masa të nevojshme (punime të pakthyeshme) për zgjidhjen e aksesueshmerisë për në objekt për shkak të ndërtimeve pa leje që impaktonin zhvillimin e ndërtimit.

Në asnjë rast këto zëra nuk mund të konsiderohen si shpenzime të përgjithshme plotësuese mbi shpenzimet e drejtpërdrejta të punimeve të tjera.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të argumentave të dhëna edhe në kontestimet e proceverbaleve përkatëse kërkohet ndryshimi i këtij përfundimi në lidhje me këtë procedurë pasi është i pa mbështetur në prova e ligj.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH^{-së}: Sqarimet/shpjegimet e dhëna nga MK, nuk prekin argumentet e paraqitur hollësisht në Akt konstatim dhe projektraport, për rrjedhojë, komentet/shpjegimet e MK, nuk qëndrojnë.

2.3.3 “Rikosntruksioni dhe përshtatje e godinës së ish-Lidhjes së Shkrimtarëve në funksion të strukturave të Ëëting-ut” me të dhënat si më poshtë:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rikosntruksioni dhe përshtatje e godinës së ish-Lidhjes së Shkrimtarëve në funksion të strukturave të Ëëting-ut”.		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 1/3, Datë 13.6.2017	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 01, dt.13.6.2017 B. H-juriste	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 08 dt. 14.6.2017 Z. Ç-Kryetar
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Negociim pa shpallje”, prokurim i klasifikuar në nivelin "I KUFIZUAR”,	A. H-Financiere A.O-IT	R. Xh-anëtar A. D K. S L. D
5.Fondi Limit (pa tvsh) 84,676,788 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 84.000,000 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 676,788 lekë
8. Data e hapjes së tenderit	9.Burimi Financimit Buxheti i shtetit	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 3 OE b) Nuk janë paraqitur 2 OE,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

15.6.2017		c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-s'ka; APP-s'ka; KPP-s'ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK S'ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP S;ka
b. Kontrata e Punimeve		
14. Lidhja e kontratës Nr. 11 Datë 22.6.2017 Aneks kontrate nr.25, datë 10.8.2017 Shtesë kontrate me nr. 60, datë 28.9.2017	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 100.800,000 lekë Aneks kontrate 100,789,098 lekë Shtesë kontrate: 19,993,996	16. Likuiduar deri dt..... Lekë..... Pa likuiduar deri dt.....Lekë.....

Mbi përzgjedhjen e procedurës së prokurimit të klasifikuar të nivelit “Kufizuar” ndjekur nga Autoriteti Kontraktor-Ministria e Kulturës (MK):

-Me shkresën nr.1087, datë 20.2.2017 dërguar nga Kryeministria, është kërkuar nga MK të merren masa për kalimin e godinës së ish-Lidhjes së Shkrimtarëve në përdorim të strukturave të Ëetting-ut. Kjo kërkesë ka ardhur si rezultat i nevojës për krijimin e kushteve të punës në funksion të procesit të parashikuar me ligjin nr.84/2016, datë 30.8.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve....” si detyrë e qeverisë sonë, për pajisjen me ambiente të strukturave që do të krijohen në zbatim të këtij ligji si dhe Shkresës së Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri (prot.në MK nr. 1349, datë 13.3.2017). Gjithashtu është kërkuar të merren masa për klasifikimin e objekti, pasi dokumentacioni që do të përpunohet aty do të konsiderohet i “klasifikuar” Objekti në fjalë (ish godina e Lidhjes së Shkrimtarëve) është në përgjegjësi administrimi nga MK me VKM nr.165, datë 28.3.2007. Një kërkesë e është bërë edhe për faktin se objekti me Urdhërin nr.122, datë 05.3.2007 të Ministrit të Kulturës është shpallur Monument Kulture i Kategorisë së II.

-Me Urdhërin nr.66, datë 14.2.2017 të Ministrit, MK dhe Godinat në administrim të saj janë përcaktuar si “zona të sigurisë” ku krijohet, regjistrohet etj. informacioni i klasifikuar “sekret shtetëror” bazuar në VKM nr.189, datë 4.3.2015 “Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", të NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare”, pika 9, Kreu I. Gjithashtu dhe me Urdhërin nr.132, datë 28,3,2017 të Ministrit “Për një shtesë nr Urdhërin nr.115/1, datë 25.3.2015 ”Për listën e dokumentave të klasifikuara “sekret shtetëror” shtohet emërtimi i dokumentit “Planimetria, skica e projektit të Ministrisë së Kulturës dhe të godinave në varësi të administrimit saj (të përfshira në zonën e sigurisë). Me shkresën nr.1742, datë 28.3.2017 përcillet në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dokumentacioni i sipërm (Urdhri nr.66, datë 14.2.2017, Urdhëri nr.132, datë 28,3,2017 dhe Udhëzimi i Ministrit të Kulturës nr.1726, datë 28.3.2017). Meqënëse godina e ish Lidhjes së Shkrimtarëve është klasifikuar “zonë sigurie” si dhe informacioni që krijohet aty është klasifikuar “sekret shtetëror”, niveli “i kufizuar”, atëherë dhe procedura për kryerjen e këtij investimi të klasifikuar, përjashtohet nga legjislacioni i prokurimit publik duke iu nënshtuar kërkesave të VKM nr.701, datë 22.10.2014 ku parashikohet për raste të tilla procedura e prokurimit negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.

-Godina objekt rikonstruksioni gjithashtu dhe objekt restaurimi, gëzon statusin “Monument Kulture i Kategorisë së II. Nisur nga statusi i saj, bazuar në ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë Kulturore” neni 17, pika 6, për projektet e restaurimit në çdo rast duhet miratimi i nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve. Për këtë qëllim me Vendimin (Qarkullues) nr.187,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

datë 9.6.2017 të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve është miratuar projekti për restaurimin e godinës objekt tenderimi.

Godina është jo vetëm objekt restaurimi por është dhe objekt rikonstruksioni. Për pasojë duhet ti nënshtrohet legjislacionit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe konkretisht VKM nr.408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”.

-Nisur nga tipologjia e procedurës “e klasifikuar”, MK dhe institucionet në varësi të saj nuk janë të pajisur me certifikatë përkatëse dhe për këtë qëllim kanë kërkuar nëpërmjet shkresës nr.1417/1, datë 16.3.2017 drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes (MM), hartimin e projekt preventivit për rikonstruksionin e godinës.

MM (Instituti Gjeografik dhe Infrastrukturës Ushtarake (IGJIU) me shkresën nr.584/1, datë 7.6.2017 ka dërguar detyrën e projektimit të Godinës së ish Lidhjes së Shkrimtarëve ku vlera e përllogaritur e preventivit rezulton 82,503,616.7 lekë me TVSH.

Investimi do të përballohet nga fondi i buxhetit të shtetit për vitin 2017 miratuar për MK me VKM nr.478, datë 23.6.2017, nga zëri “shpenzime kapitale me financim të brendshëm” në programin “Arti dhe Kultura.

-Me shkresën nr.3879, datë 9.6.2017 MK ka bërë kërkesë pranë Kryeministrisë për miratimin paraprak të procedurës së prokurimit në zbatim të VKM nr.473, datë 1.6.2017, neni 19, e cila është miratuar me shkresën nr.3326, datë 9.6.2017 të Kryeministrisë.

-Pas konfirmimit nga Kryeministria, është dërguar pranë DSIK lista e projekteve vjetore të “klasifikuara” me shkresën nr.01, datë 9.6.2017, bazuar në kërkesat e ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 dhe VKM nr.701, datë 22.10.2014, neni 4.

Mbi Hartimin e Dokumenteve të Tenderit (DT).

-Me Urdhërin nr.01, datë 13.6.2017 është ngritur Njësia e Prokurimit si dhe ka dalë Urdhër Prokurimi nr.1/3, datë 13.6.2017 ku është përcaktuar fondi limit, në vlerën 84,676,788 lekë pa TVSH (llogaritja e tij është bërë referuar projektpreventivit të hartuar nga (IGJIU). Përzgjedhja e procedurës së prokurimit “Negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” është bazuar në VKM nr.701, datë 22.10.2014 “Për miratimin e rregullave për sigurimin e informacionit të klasifikuar në fushën industriale” si dhe Manualin e Sigurisë. Me Urdhërin nr.1/2, datë 13.6.2017 është përcaktuar edhe Personi Përgjegjës i Autoritetit Kontraktor (PPAK).

-Njësia e Prokurimit ka miratuar DT me Procesverbalin nr.1, datë 13.6.2017 sipas së cilës është vendosur:

-si kriter për kapacitetin teknik “*punë të ngjashme të së njëjtës natyrë në fushën e trashëgimisë kulturore për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 50% e vlerës së objektit që prokurohet që prokurohet*” (2.2 pika 1/a e DT). Vendosja e një kriteri të tillë nuk mundëson trajtim të njëjtë për të gjithë operatorët konkurrues dhe pengon konkurrencën, pasi nuk mund të kufizosh/përcaktosh “objektin e punëve të ngjashme të së njëjtës natyrë” duke vepruar kështu në mospërputhje të VKM nr. 914, datë 29.12.20014 e ndryshuar, neni 26, pika 6/a. Meqenëse objekti i tenderimit ka statusin “monument kulture” vendosja e kriterëve për përmbushjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale, ku autoriteti kontraktor kërkon licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, plotëson në mënyrë të qartë specifikën e objektit të tenderimit, që në rastin konkret vërtetohet me përcaktimin e kriterëve të vendosura në pikën 2.4 dhe C të DT.

Nga ana tjetër vërehet se AK përdor standarde të dyfishta në përcaktimin e kriterëve. Përvec



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

sa sipër, AK kërkon dhe/ose “punë të ngjashme ku vlera totale e punës së 3 viteve të fundit.....”. Sic shihet, për këtë kriter me të drejtë nuk është kërkuar “punë të ngjashme në fushën e trashëgimisë kulturore “ sic kërkohet në pikën 2.2, pika 1/a, në këtë rast AK ka vepruar në mënyrë korrekte me ligjin dhe në mënyrë jo korrekte në vendosjen e kriterit të pikës 2.2 pika 1/a e DT, trajtuar më sipër.

-Vendosja e kriterit “punë të ngjashme të së njëjtës natyrë për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 50% e vlerës së objektit që prokurohet” (2.2 pika 1/a e DT) nuk është gjithashtu në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.20014 e ndryshuar, neni 26, pika 6/a, për faktin se AK ka vendosur vlera dysHEME dhe jo vlerë tavan sic e kërkon VKM-ja (jo më të madhe se 50% e vlerës së kontratës që prokurohet).Megjithëse ligjvënësi nuk ka vendosur vlera minimale dhe as nuk ka ndaluar vendosjen e tyre, nuk është tagër i AK të anashkalojë këtë detyrim ligjor, pasi shmang konkurrencën dhe trajton në mënyrë jo të barabartë operatorët -Për të vërtetuar plotësimin e kriterit “punë të ngjashme” nuk është kërkuar dokumentacioni që duhet të paraqesë OE në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat. Për sa sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit sipas VKM nr. 914, datë 29.12.20014 e ndryshuar, neni 57.

Mbi Zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe lidhjen e kontratës.

Me Urdhërin nr.2/1, datë 13.6.2017 është urdhëruar dërgimi i ftesës për pjesmarrje në prokurim 3 operatorëve” K sh.p.k., L sh.p.k, Sh sh.p.k dhe me Urdhërin nr.07. datë 14.6.2017 është ngritur komisioni i negociimit dhe vlerësimit të ofertave.

Me shkresën nr.6, datë 14.6.2017 është dërguar njoftim mbi verifikimin e sigurisë së OE dhe përfaqësuesve të tyre pjesmarrës në prokurim të ftuar nga AK.Bashkangjitur kësaj shkrese janë vetëm dokumentacioni për OE “K” sh.p.k.

Në konkurrim kanë konfirmuar marrjen e ftesës 3 OE të ftuar, por është paraqitur vetëm OE “K.” sh.p.k. me vlerë oferte 84,000,000 lekë pa TVSH/100,800,000 lekë me TVSH.

Numri i punonjësve të deklaruar nga operatori që do të inkuadrohen për punimet në objektin e tenderimit është 26 sipas listës së punonjësve të paraqitur nga operatori, ndërkohë që në dokumentet e tenderit kërkohet që “operatori të ketë të punësuar minimumi 45 punonjës...” (2.3, pika 3 të DT).

Mospërmbushja e kriterit përbën kusht për skualifikimin e operatorit, i cili nuk duhet të ishte klasifikuar dhe shpallur fitues.

KVO pas përfundimit të klasifikimit dhe afateve të ankimit, ka dërguar njoftimin për klasifikimin përfundimtar fituesit me shkresën nr.10, datë 15.6.2017 dhe me shkresën nr.10/1, datë 15.6.2017 është njoftuar i fituesi dhe ftuar për të lidhur kontratë e cila është finalizuar me kontratën nr.11, datë 22.6.2017, me afat 6 muaj nga dita e nisjes së punimeve.

MK me shkresën nr.2543, datë 13.4.2018 për sa sipër ka bërë observacion me komente dhe shpjegime si më poshtë i cili, pasi u mor në shqyrtim merret pjesërisht në konsideratë me arsyetimin:

1.Pretendimi i subjektit: Lidhur me konstatimin qe “nuk eshte marre leje ndertimi ju bejme me dije qe bazuar ne ligjin per trashëgiminë kulturore, ndërhyrja në këto kategori objektesh bëhet me miratim te Këshillit Kombëtar të Restaurimit. IMK në cilësinë e Sekretariatit Teknik mjaftohet vetem të njoftojë pushtetin vendor, në rastin konkret Bashkinë Tiranë për ndërhyrjet në objekt. Bashkelidhur do të gjeni njoftimin e berë Bashkise Tiranë për këtë investim...”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Qendrimi i audituesve KLSH-së: Pretendimi i ngritur **merret** në konsideratë dhe ndryshimet pasqyrohen në këtë Raport Auditimi.

2.Pretendimi i subjektit: Lidhur me konstatimin se “ OE duhet te plotesoje “Punë të ngjashme të së njëjtes natyrë në fushën e trashëgimise kulturore për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulet se 50% e vleres se objektit që prokurohet”, ju informojmë që për nga natyra e objektit është e rendesishme që subjektet që marrin pjesë të kenë përvojë në ndërhyrjet ne monumentet e kulturës.Megjithëse AK nuk ka qënë përjashtues pasi kriteri i vendosur në DT është me gjithpërfshirës si më poshtë.....

Kriteri “b-Pune te ngjashme ku vlere totale e punes se tre viteve te fundit te jete ne nje vlere jo me e ulet se dyfishi i vleres se objektit qe prokurohet” është kriteri i dytë për kapacitetin teknik i vendosur nga AK. Theksojmë edhe një herë që ligji në rastin e këtyre procedurave është me vakum dhe lë hapësira që institucionet të vendosin kriteret të cilat i mendojnë më të përshtatshme për investimin që do të realizojnë. Jo detyrimisht i referohemi legjislacionit të PP”.

Qendrimi i audituesve KLSH-së:Pretendimi sipërm **nuk merret** në konsideratë me arsyetimin e shprehur më lart dhe të ritheksuar dhe njëherë se vendosja e këtij kriteri është jo në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.20014 e ndryshuar, neni 26, pika 6/a.

3.Pretendimi i subjektit: “Qe nuk eshte hartuar raporti permbledhes dhe nuk eshte nenshkuar nga Titullari, ju bejme me dije se ne rastin e procedurave te klasifikuara ka mangesi ne kriteret e dokumentacionit qe duhet mbajtur nga institucioni. Keto Procedura përjashtohen nga Ligji Për Prokurimin Publik. Këto investime kryhen në bazë të VKM nr. 701, datë 22.10.2014 ... dhe Udhëzimit nr. 1726, datë 28.3.2017 të Ministrit të Kulturës “Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 701, datë 22.10.2014 “Për miratimin e rregullave “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar në fushën industriale”, i ndryshuar. Nga analiza e kuadrit ligjor cituar më sipër vihet re se ka vakum ligjor për disa aspekte të zhvillimit të procedurës ndaj për të siguruar zbatimin e parimeve të përgjithshme që karakterizojnë procedurat e blerjes së shërbimeve dhe mallrave në RSH, kemi sugjeruar të zbatohen, për aq sa mund të jenë të përshtatshme, rregulla e parashikuara me VKM përkatëse në lidhje me “Rregullat e procedurave të prokurimit publik”. Konkretisht hapat që janë parashikuar që ne fillim ne memon drejtuar titullarit te AKPer sa me siper Urdheri per nenshkrimin e kontrates nga AK automatikisht nenkupton miratimin e procedures”.

Qendrimi i audituesve KLSH-së: Për sa sipër pretendimi **merret parasysh** duke u reflektuar ndryshimet në këtë Raport Auditimi.

4.Pretendimi i subjektit: “Ne lidhje me konstatimin qe mungojne 6 karpentjeret dhe nje sinjalizues, ju bejme me dije se subjekti ka leshuar deklarate ne proceduren e prokurimit per te gjithë stafin e kerkuar ku ka bashkelidhur dhe kodet sipas Esig (bashkelidhur)”.

Qendrimi i audituesve KLSH-së: Pretendimi **merret në konsideratë** dhe ndryshimet pasqyrohen në këtë Raport Auditimi.

2.3.4. “Rikonstruksioni dhe përshtatje e godinës së ish-Lidhjes së Shkrimtarëve në funksion të strukturave të Vetting-ut” (shitesë kontrate).

Me datë 23.6.2017 zbatuesi “K” sh.p.k ka njoftuar investitorin MK dhe mbikqyrësin e punimeve subjektin “A” sh.p.k me shkresën nr.23/6, datë 23.6.2017 për fillimin e punimeve, ndërsa me shkresën nr.3/7, datë 3.7.2017 ka njoftuar mbi problem që ka dalë në lidhje me zbatimin e projektit. Për sa sipër, me datë 10.7.2017 bazuar në memo nr. 4721, datë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

10.7.2017 është realizuar vizitë në kantier në prezencë të përfaqësuesve të MK, IMK, subjektit zbatues “K” sh.p.k. subjektit mbikqyrës “A” sh.p.k, Gardës së Republikës, Delagacionit të BE në Shqipëri, BE (EEAS Tirana) BE dhe Kryeministrit, nga ku u konstatua nevoja për ndërhyrje në projekt.

Me memo nr.4721/2, datë 1.8.2017 është këkuar nga Ministri, hartimi nga një grup pune i MK i detyrës së re të projektimit për MM, në cilësinë e autorit të projektit, ngritjen e një grupi pune me ekspertë që të angazhohen rast pas rasti i cili është ngritur me Urdhërin e ministrit nr.547, datë 1.8.2017.

Me shkresën nr.5255, datë 1.8.2017 të ish Sekretarit të Përgjithshëm i është dërguar MM detyra e projektimit për të hartuar ndryshimet në projekt e cila me shkresën nr.584/3, datë 2.8.2017 ka vënë në dispozicion projektin. Me vendim të KKR nr.245, datë 4.8.2017 është miratuar projekti (rishikimi i projektit).

Gjithashtu me shkresën nr. 5259, datë 1.8.2017 të ish Sekretarit të Përgjithshëm është kërkuar pezullimi i punimeve nga zbatuesi dhe mbikqyrësi i punimeve si dhe një raport mbi gjendjen e zbatimit të kontratës deri me datë 1.8.2017.

Me shkresën nr.5255.2, datë 4.8.2017 të ish Sekretarit të Përgjithshëm është kërkuar gjithashtu nga zbatuesi dhe mbikqyrësi i punimeve që të sjellin oferta për për zërat e rinj të preventivit e shoqëqeruar me analizën e cmimeve të cilat do të analizohen nga Komisioni i Negocimit të ofertave.

Me urdhër nr.545, datë 8.8.2017 të ish Sekretarit të Përgjithshëm është ngritur Komisioni Negocimit të zërave të preventivit të paraqitur nga subjekti zbatues “K”. KVO me procesverbalin nr.5368, datë 8.8.2017 ka barë shqyrtimin e ofertës së paraqitur në vlerën 100,800,000 lekë me TVSH dhe në përfundim të negociimit është rënë dakord me ofertën. Përmes memo nr.5, datë 4721/4, datë 10.8.2017, të Njësisë së Prokurimit njoftohet ish Sekretari i Përgjithshëm se mbikqyrësi i punimeve ka sjellë në MK, zërat e punimeve që mund të zbatohen brenda vlerës 100,800,000 lekë si dhe zërat që do të realizohen duke përdorur kontratë shtesë deri 20% të vlerës së punimeve.

Aneks kontrata është lidhur me nr.25, datë 10.8.2017 për vlerën 100,798,098 lekë me TVSH ndërsa shtesa e kontratës është nr. 60, datë 28.9.2017, në vlerën 19,993,996 lekë me TVSH.

Argumentimi për shtesë kontrate është bërë me shkresën nr.6359/1, datë 27.9.2017 e cila i referohet shkresës nr.17/2, datë 27.9.2017 të subjektit zbatues “K” sh.p.k. ku vlera e punimeve të projektit të ripunuar për të cilën është lidhur aneks kontrata nr.25, datë 10.8.2017 ka ruajtur të pandryshuar, vlerën e fondit limit të kontratës bazë. Me shkresën nr.27/9, datë 27.9.2017 është paraqitur nga sipërmarrësi kërkesa për miratimin e fondit shtesë prej 20,000,000 lekë me TVSH e cila i referohet punimeve të pakryera të montimit të pajisjeve elektrike vlefte e të cilave nuk është përfshirë në aneks kontratën nr. 25, datë 10.8.2017. Për këtë ka dalë Urdhër Prokurimi nr.54, datë 27.9.2017 për prokurimin e vlerës prej 16,661,663 lekë pa TVSH që përbën 20% të vlerës së kontratës. KVO pas hapjes së ofertës ka përgatitur raportin përmbledhës drejtuar titullarit të AK ish Sekretarit të Përgjithshëm me shkresën nr.6385, datë 28.9.2017.e cila është miratuar.

2.3.5. “Rikonstruksioni dhe ndryshim destinacioni i ish Laboratorit të Hidroteknikës në qendër arti Skena e Re” faza e II” me të dhënat si më poshtë:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rikonstruksioni dhe ndryshim destinacioni i ish Laboratorit të Hidroteknikës në qendër arti Skena e Re”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

1.Urdhër Prokurimi Nr. 688, Datë 8.2.2016	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Sh. Sh-Dr. Finances	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 28 dt. 8.2.2016 Z.Ç-Kryetar R. Xh-anëtar Arta Dollani K. A H. D
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “T. Hapur”,	B. H-juriste D. P-arkitekte	
5.Fondi Limit (pa tvsh) 449,612,938 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 379,602,405 lekë pa tvsh	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 70,010,533 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Pas ndryshimeve në DT bëhet 11.4.2016	9.Burimi Financimit Buxheti i shtetit	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 7 OE b) Kualifikuar 2 OE c) të skualifikuar 4 OE
11.Ankimime mbi DT-OE “A”, Sh, E. AK-nr.1391, datë 16.3.2016 Ankime mbi procedurën-A dhe C AK- nr.2195, datë 27.4.2016 dhe nr.2187, datë 27.4.2016	12. Përgjigje Ankesës nga AK nr.1391/1, dt 21.3.2016 nr.2288, datë 3.5.2016 nr.2262, datë 3.5.2016	13.Përgjigje Ankesës nga KKP nr.458/2016 dt 21.6.2016
b. Kontrata e Punimeve		
14.Lidhja e kontratës Nr. 3327 Datë 28.6.2016	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 455,522,886 lekë dhe 379,602,405 lekë pa tvsh	16.Likuiduar deri dt..... Lekë..... Pa likuiduar deri dt.....Lekë.....

Mbi Hartimin e Dokumenteve të Tenderit (DT).

Njësia e Hartimit të dokumentave të tenderit (DT) me procesverbalin nr.1, datë 9.2.2016, prot me nr.711, ka hartuar dhe miratuar DT sipas së cilës është vendosur:

-për **kapacitetin ligjor** të operatorëve ekonomikë është kërkuar “*në Ekstraktin Historik të shoqërisë, Operatori Ekonomik duhet të rezultojë me një eksperiencë aktive prej jo më pak se 3 vjet në fushën e ndërtimit*” (pika 2.1) ndërkohë që në pikën 2.3 “Kapaciteti teknik” pika 1.2 kërkohet që “*Operatori ekonomik duhet të ketë realizuar objekte civile të ngjashme me objektin e prokurimit të realizuar brenda 10 vjecarit të fundit....*”.

Sic shihet kriteret bien ndesh me njëra tjetrën përsa i përket shtrirjes në kohë të kërkesave. Nga ana tjetër vendosja e kriterit sipas të cilit OE të rezultojë me një eksperiencë aktive **jo më pak se 3 vjet në fushën e ndërtimit**, kufizon pjesmarrjen në tender të operatorëve, nuk mundëson trajtim të njëjtë për të gjithë operatorët konkurrues dhe pengon konkurrencën. Bazuar në LPP, kërkesat për kualifikim, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.Operatorët ekonomikë mjafton të vërtetojnë për kapacitetin ligjorë, se kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi (vërtetuar kjo me regjistrimin në QKB/QKR) ose, në rastet e bashkimit të shoqërive, vërtetojnë se i gëzojnë këto aftësi në kohën e lidhjes së kontratës Për pasojë, vendosja e këtij kriteri nuk është në përputhje me nenin 46 të LPP, pika 1/ç dhe pika 3.

-për **kapacitetin ekonomik dhe financiar**, AK ka kërkuar “*vërtetim të xhiros mesatare gjatë 3 viteve të fundit, e cila duhet të ketë një vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të prokuruar*”. Një kërkesë e tillë nuk është në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 26, pika 7/b, sipas të cilit AK kërkon “*kopje të deklaratave të xhiros vjetore.Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 50 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet*”.Në kontekst të këtij përcaktimi ligjor, ku vlera e fondit limit është mbi kufirin e ulët monetar, xhiro vjetore nuk duhet të tejkalojë 50% ose 224,806,469 lekë e vlerës limit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

kontratës dhe jo të jetë një vlerë jo më e ulët se vlera fondit limit të prokuruar (449,612,938 lekë). Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesmarrjen në tender të operatorëve, nuk mundëson trajtim të njëjtë për të gjithë operatorët konkurrues dhe pengon konkurrencën. Për pasojë, kriteri i vendosur nga AK nuk është në përputhje me nenin 46 të LPP me ndryshime dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 26, pika 7/b.

-për **punë të ngjashme** AK ka kërkuar “*punë të ngjashme në punë civile (do të konsiderohen vetëm punët në objekte sociale dhe kulturore që kanë patur të përfshirë zbatimin e një auditori dhe/ose objekte që kanë patur të kombinuar zbatimin e të gjitha punimeve ndërtimore bazë dhe instalime të sistemeve të fonisë.....objektet për një objekt të vetëm në një vlerë prej 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit*”.

Vendosja e një kriteri të tillë nuk është në përputhje me:

-UKM nr.2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu I, pika I A/1 pasi me “**punime ndërtimi**” vlerësohen “*punimet e parashikuara në projektet ndërtimore (përfshirë edhe rikonstruksionet, zgjerimet e përshtatjet) si: ndërtesa banimi, arsimore, shëndetësore, social-kulturore, industriale etj., duke përfshirë instalimet e zakonshme.....*”.

-Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar, neni 26,

-VKM nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime neni 26/5 sipas të cilës “*AK duhet të që në kërkesat e veçanta të kualifikimit të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve*” si dhe me nenin 26, pika 6/a sipas të cilit “*Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit*”.

Referuar këtyre përcaktimeve ligjore “përvoja e mëparshme” vërtetohet me paraqitjen e kontratave të realizuara në sektorin publik apo privat për punë të ngjashme dhe nuk ka nevojë për përshkrime që dalin jashtë përmbajtjes ligjore. Nga ana tjetër, ligji e ka përcaktuar qartë se çfarë janë dhe kush hyn në “punimet e ndërtimit”. Për përmbushjen e kriterit për “punë të ngjashme”, nuk mund të pretendohet për eksperiencë të njëjta, pasi kjo bie në kundërshtim me vetë ligjin dhe rregullat e prokurimit publik dhe konkretisht me nenin 1 të tij, gjë e cila çon në diskriminimin e operatorëve ekonomikë dhe mos trajtim të barabartë të tyre në një procedurë prokurimi.

Neni 26, pika 6/a në mënyrë eksplicite ka përcaktuar dhe limitin e vlerës që nuk duhet të jetë më i madh se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

-Për “**fuqinë mesatare punëtore**”, AK ka kërkuar që “*operatori duhet të dëshmojë se përveç specialistëve të disiplinave të sipërpërmendura....duhet të rezultojnë të punësuar personeli teknik i kualifikuar nga IQT, Grupi III e lart.....*”. Vendosja e këtij kriteri nuk është në përputhje me:

-Ligjin nr.83/2013, datë 14.2.2013 “Për Shfuqizimin e Ligjit nr. 9595, datë 27.7.2006 “Për Krijimin e Inspektoratit Qendror Teknik”, pasi me këtë ligj është shfuqizuar IQT. Në këtë kontekst kriteri i vënë nga AK për kualifikimin nga IQT nuk qëndron, pasi nuk ekziston si subject licensues.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

-Ligjin Nr.8734, datë 1.2.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike” pasi nëse i referohemi dëshmimeve që jep subjekti “*Inspektorati i Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike (IPIE) i cili është organizëm teknik dhe Kontrollues*” që sipas nenit 9 lëshon dëshmi aftësie për përdorimin e pajisjeve elektrike. Sjellim në vëmendje që ligjvënësi në këtë rast, kur kemi të bëjmë me përdorimin e këtyre pajisjeve ka patur parasysh të bëhet nga staf i kualifikuar. Në rastin konkret, objekti i tenderit nuk është “shërbim” apo “furnizim” por është “punë” dhe nisur nga përcaktimi që bën ligji për IPIE-në, si organ që lëshon dëshmi aftësie për rastet kur kemi të bëjmë me kryerje shërbimi mirëmbajtje dhe përdorimi të pajisjeve elektrike, kriteri është jo transparent.

Megjithëse kriteri është inekzistent, përsëri dhe pse i vënë në këto kushte, nuk i është bërë interpretimi teknik dhe ligjor kur është bërë modifikimi/ndryshimi i kësaj kërkesë në DT nga kërkesa për “*personel teknik i kualifikuar nga IQT, Grupi IV e lart*” në kërkesën për “*personel teknik i kualifikuar nga IQT, Grupi III e lart*”, modifikim i cili ka ardhur si rezultat i ankimeve të OE që më hollësisht trajtohen më poshtë. Një veprim i tillë nuk është në përputhje me kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.20014 me ndryshime, neni 61/2 sipas të cilit “*Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim,..... Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjrisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre....*”.

Konkluzion: Për sa sipër, vendosja e këtyre kriterëve nuk është në përputhje me dispozitat ligjore të referuara për çdo rast sipas trajtimit të bërë më lart, të cilat çojnë në kufizimin e pjesëmarrjes në tender të operatorëve, nuk mundëson trajtim të njëjtë për të gjithë dhe pengon konkurrencën.

Ankesa mbi DT:

Në lidhje me DT ka patur ankesa nga operatorë të ndryshëm të cilët kanë paraqitur pretendime mbi kriteret e vendosura nga AK. Konkretisht OE “A” me shkresën e prot. në MK nr.1391, datë 16.3.2016 është ankuar pranë AK i cili ka kthyer përgjigje me shkresën nr.1391/1, datë 21.3.2016 ku pranon pjesërisht ankesën. AK nuk pranon pretendimin e OE ankimues në lidhje me kriterin “*....personeli teknik i kualifikuar nga IQT, Grupi III e lart*” me arsyetimin se “*IQT është krijuar me Ligjin nr. 9595, datë 27.7.2016*” ndërkohë që ligji referues është shfuqizuar (interpretuar më lart). Gjithashtu në dosje, gjenden ankime të operatorëve “Sh” dërguar me shkresën nr.820, datë 16.2.2016 (prot MK), “E” me shkresën nr.861, datë 18.2.2016 (prot MK), që kanë pretendime për kriterin e sipërm, i cili nuk është pranuar nga AK. Pretendimet e operatorëve ankimues të cilat janë marrë në konsideratë nga AK, janë pasqyruar ndryshimet në DT dhe janë publikuar në SPE.

MK me shkresën nr.2543, datë 13.4.2018 për sa sipër ka bërë observacion me komente dhe shpjegime si më poshtë i cili, pasi u mor në shqyrtim nuk merret në konsideratë me arsyetimin:

1.Pretendimi i subjektit: “*Përsa i perket kriterit që OE duhet të kete jo me pak se tre vjet ne fushen e ndertimit ju sqarojmë si më poshtë: Ndryshimi i destinacionit të godinës se “ish Laboratori i Hidroteknikës” në qëndër arti “Skena e re” është nje objekt kompleks dhe inteligjent, eshte mundesi e perhershme krijuese dhe rikrijuese dhe ka per qellim të zgjeroje repertorin e tipologjive hapsinore per veprimtarite artistike, teatrore, muzikale, ekspozuese,*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

performance kercimi bashkohor, leximi letrar, kinematografi etj. Per shkak të ketij kompleksiteti dhe ndërthurje nderdisiplinare, për shkak të mungesës së theksuar ne ekspertizen kombetare per disiplina specifike qe kerkon, kriteret e percaktuara nga AK kane per qellim garantimin e suksesit te vepres..... Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik. Per kete, pika 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, ne paragrafin 2.3. Kapaciteti teknik i operatoreve ekonomike, pika 1.2 vendoset si nje kusht i detyrueshem dhe jo perjashtues (cituar ne dokument), si nje sqarim, zgjatim i kriterit te puneve te ngjashme (pershkrim i asaj qe do te duhet te konsiderohet si pune e ngjashme ne nje kontrate me nje specifike te vecante) dhe kriteri i vendosur brenda 10 viteve te fundit”, nuk eshte aspak ne kuadrin e limitimit, madje e zgjeron me 10 vite eksperiencen ne kontrata specifike sa me afer pershkimit te kontrates objekt prokurimi....”.

Qendrimi i audituesve KLSH-së: Për sa sipër argumenti i subjektit është i njëjtë me observacionet e bëra në lidhje me Akt Konstatimi nr.5, datë 27.2.2018 mbajtur nga audituesit shtetëror dhe nuk ka argumente të reja, për pasojë qëndrimi i KLSH-së është i njëjtë shprehur në Projektraportin e Auditimit, observacioni **nuk merret në konsideratë**.

2.Pretendimi i subjektit: “2.2. Përsa i perket kapacitetit ekonomik dhe financiar, AK ka kerkuar vertetim te xhiros mesatare gjate tre viteve te fundit, e cila duhet të ketë një vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të prokuruar.Ashtu si edhe ju evidentoni ne tabelen e te dhenave te kontrates objekt i ketij auditimi, procedura e prokurimit per kete objekt ka filluar ne date 08.02.2016. Kriteret sa i perket kapacitetit ekonomik dhe financiar, jane percaktuar ne frymen dhe detyrimet qe rrjedhin nga LPP, bazuar ne VKM Nr. 914, date 29.12.14 Rregullat e Prokurimit Publik, i ndryshuar, ne ate kohe ne fuqi, ku neni 26, pika 7 kërkon: b) kopje të deklaratave të xhiros vjetore, ku në asnjë rast vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Ligji nuk ka fuqi paravepruese, si e tille ndryshimet ku reflektohen edhe kushtet e reja kane ndodhur me Vendimin Nr. 797, datë 29.12.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Qendrimi i audituesve KLSH-së: Për sa sipër argumenti i subjektit është i njëjtë me observacionet e bëra në lidhje me Akt Konstatimi nr.5, datë 27.2.2018 mbajtur nga audituesit shtetëror dhe nuk ka argumente të reja, për pasojë qëndrimi i KLSH-së është i njëjtë shprehur në Projektraportin e Auditimit, observacioni **nuk merret në konsideratë**.

3.Pretendimi i subjektit: “2.3. Ne lidhje me konstatimet e bera përsa i perket puneve te ngjashme sqarojmë:“Punë të ngjashme ne pune civile (do të konsiderohen Referuar percaktimit “pune te ngjashme”, njesia e hartimit te dokumentave te tenderit, ka per detyre te orientoje OE pjesemarrës ne zberthimin e preventivit te punimeve qe do te duhet te zbatojne. Terminologjia “pune te ngjashme” ne menyre te zgjeruar nenkupton pune te se njejtës natyre me objektin qe prokurohet. Preventivi i punimeve te zbatimit orienton ne menyre te pakontestueshme me punimet qe do te duhet te perballen OE. Pra NJHD me percaktimin e kryer (do të konsiderohen vetëm punët në objekte sociale dhe kulturore ...ska bere gje tjeter vecse te interpretoje te gjitha punimet ndëtimore dhe sistemet qe do te instalohen ne veper.Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatoreve ekonomikë,..... Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

mëparshme të ngjashme me punimet objekt prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit”.

Qendrimi i audituesve KLSH-së: Për sa sipër argumenti i subjektit është i njëjtë me observacionet e bëra në lidhje me Akt Konstatimi nr.5, datë 27.2.2018 mbajtur nga audituesit shtetëror dhe nuk ka argumente të reja, për pasojë qëndrimi i KLSH-së është i njëjtë shprehur në Projektraportin e Auditimit, observacioni **nuk merret në konsideratë**.

4.Pretendimi i subjektit: “2.4. *Ne lidhje me konstatimet përsa i përket fuqise mesatare punetore,Bazuar ne VKM nr. 943, datë 28.12.2016, Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”,Lidhja 3, pika II.....Lidhja 3/1,; asnje nga kategoritë në fushat e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim nuk percakton nderhyrjet me karakter permiresimin apo ndertimin e sistemeve akustike. Ne te njejten kohe, ne kurikulat e formimit ne disiplinat inxhinierike nuk ekziston figura e inxhinierit apo ekspertit akustik. Per kete arsye, ne menyre qe te mos rrezikohej zhvillimi i procedures, kerkesa e kesaj figure teknike eshte kerkuar me vete, ne permbushjen e ekspertizes se nevojshme (duke perkthyer te gjitha punimet qe kryhen ne kontrate) dhe nuk eshte kerkuar licence (pasi nuk ekziston nje e tille) por eshte kerkuar qe te vertetohet përvoja e duhur per punime ne akustike me referenca per pune te realizuara sipas objektit te prokurimit per pjesen e akustikes.Pretendimi se kjo ekspertize mbulohet nga inxhinieria elektroteknike dhe se kerkesa per “ekspert akustik” kufizon pjesemarrjen ne tender dhe pengon konkurencen nuk qendron. Mos percaktimi dhe limitimi se çfare inxhinierie e mbulon kete ekspertize, ka patur per qellim te hape garen edhe me gjere dhe jo e kunderta”.*

Qendrimi i audituesve KLSH-së: Për sa sipër argumenti i subjektit **merret në konsiderate** duke pasqyruar ndryshimet në këtë Raport Auditimi.

Mbi Zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe lidhjen e kontratës.

Në procedurën e prokurimit morën pjesë 7 OE me oferta si më poshtë:

-BOE “L” sh.p.k.	me vlerë	368,798,212 lekë
-G sh.p.k.	“	390,507,594 lekë
-BOE “F” sh.p.k.	“	399,999,985 lekë
-A sh.p.k.	“	413,610,668 lekë
-BOE “A”	“	397,062.080 lekë
-E sh.p.k.	“	379,348,412 lekë
-C sh.p.k.	“	333,308,142 lekë

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi ofertave të bërë nga KVO:

-Janë kualifikuar 2 OE (E sh.p.k. dhe BOE A),

-Janë skualifikuar 5 OE.

Argumenti i KVO për skualifikimin e ofertave është mospërmbushja prej tyre e kriterëve të vendosura në DT.

Nga auditimi i dokumentacionit në SPE të OE E sh.p.k. të klasifikuar dhe të shpallur fitues i cili ka vlerën më të ulët të ofertës të kualifikuar për konkurrim por jo vlerën më të ulët të ofertave të paraqitura dhe të skualifikuara, konstatohet se:

Për plotësimin e kriterit “**punë të ngjashme**” OE ka paraqitur:

-Kontratën nr.2012/293-539, datë 21.6.2012 mes OE “E” dhe BE (që tenderon për llogari të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

qeverisë shqiptare) me objekt “*Punime për ndërtimin...e laboratorëve të AKU*” e cila është lidhur në vitin 2012 dhe nuk është realizuar gjatë tre viteve të fundit (2013,2014,2015) sipas kërkesave të DT. Kontrata nuk përcakton kohën e fillimit të punimeve dhe afatin e përfundimit. Gjithashtu kontrata nuk shoqërohet me formularin e vlerësimit, akt kolaudimi, situacion përfundimtar dhe faturë tatimore sipas kërkesave të pikës 2.3 seksioni a, të DT, pasi kontrata është lidhur me subjekte publike (AKU). Mungesa e këtij dokumentacioni përbën kusht skualifikues.

-Kontratën me objekt “*Godinë banimi dhe shërbimesh 2,7,dhe 8 kat...*” në vlerën 811,445,287 lekë është kontratë e realizuar me subjekt privat, konkretisht me shoqërinë “Concord Investment” sh.p.k. lidhur me datë 18.12.2008, nr.6516 rep. si dhe nr.1517/1 kol. me afat 18 muaj nga nënshkrimi i kontratës. Siç shihet, nga këto të dhëna kontrata është e vitit 2008 dhe realizimi i saj nuk përfshihet brenda periudhës 3 vjecare (2013,2014,2015) parashikuar në pikën 2.3 seksioni a, të DT.

Për të vërtetuar realizimin e kontratave për “punë të ngjashme” kur ato janë kryer me subjekte private, është “kërkuar leja e ndërtimit, akt kolaudimi dhe situacioni përfundimtar”. Për vërtetimin e këtij kriteri, OE ka paraqitur Lejen e Ndërtimit nr.64/1, datë 27.3.2009 e cila ka afat vlefshmërie 3 vjet (deri në 22.3.2012). Sipas akt kolaudimit rezulton se fillimi i punimeve është bërë në shkurt 2010, mbarimi i punimeve Maj 2014, afati i ndërtimit 43 muaj. Nga këto të dhëna konstatohet se, afati i ndërtimit prej 43 muaj ka tejkaluar afatin e punimeve sipas kontratës që është 18 muaj. Bazuar në nenin 2 të kontratës së sipërme në mënyrë eksplicite është përcaktuar se “*Punimet do të përfundojnë brenda afatit të parashikuar në lejen e ndërtimit*” që sipas lejes është 3 vjet ose 36 muaj, pra në 2012. Në këtë kontekst leje e ndërtimit ka mbaruar afatin e vlefshmërisë dhe nuk rezulton që të jetë paraqitur leje ndërtimi e rinovuar. Në kushte të tilla, dokumenti nuk mund të merret në konsideratë nga KVO. Gjithashtu nga OE është paraqitur dhe formular vlerësimi sipas shtojcës së parashikuar në DST i cili nuk vlen për kontrata të realizuara me subjekte private dhe nuk është i rregullt nga pikpamja e përmbajtjes. Përveç sa sipër, kontrata e ngjashme paraqitur për godinë civile nuk përmbush kushtin për zbatimin e të gjitha punimeve ndërtimore bazë dhe instalimeve të fonisë, sisteme të ndricimit skenik etj. të kërkuar në DT.Për pasojë, për mangësitë e konstatuara në përmbushje të kriterit për “punë të ngjashme”, KVO duhet të kishte skualifikuar këtë operator.

-operatori ka paraqitur dëshmi për 2 elektrikistë, 1 mirëmbajtës të cilat janë dëshmi për punonjësit që punojnë me impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike dhe nuk është lëshuar nga IQT sipas kërkesave të pikës 3 “dëshmi për fuqinë mesatare punëtore”, pika 3.3.Gjithashtu dëshimia nuk është lëshuar as nga IPIE-ja, nëse do ti referohemi si subjekt që pajis me dëshmi sipas ligjit nr.8734, datë 1.2.2001 dhe që përbën kusht skualifikimi sipas kërkesave të DT.

-diploma nr.3865, datë 29.6.2001 e znj. E. Xh, si vërtetim për përmbushjen e kriterit “*ekspert mbi akustikën...*” është diplomë për skenografi-kostumografi dhe nuk përmbush plotësimin e kriterit të pikës 3.3 të DT, duke përbërë kusht për skualifikimin e operatorit.

Konkluzion: Për sa sipër, KVO meqënëse OE “E” sh.p.k. nuk përmbush kriteret e DT, “Kriteret e veçanta për kualifikim” duhet ta kishte skualifikuar atë bazuar në nenin 46 të LPP-së, dhe anuluar tenderin bazuar në nenin 24/ç.

Ankesa mbi procedurën e prokurimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Ndikimi/efekti:	<p>ndryshuar, neni 26, pika 6/a.</p> <p>-UKM nr.2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu I, pika I A/1,</p> <p>-VKM nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime neni 26/5</p> <p>-Ligjin nr.83/2013, datë 14.2.2013 “Për Shfuqizimin e Ligjit nr. 9595, datë 27.7.2006 “Për Krijimin e Inspektoratit Qendror Teknik”,</p> <p>-Përcaktimi i vlerës minimale të kontratës për “punë të ngjashme” në rastin kur vetë ligji nuk e ka bërë, çon në trajtim të pa barabartë të operatorëve ekonomikë dhe shmang konkurrencën.</p> <p>-Interpretim jo i saktë i VKM nr. 914, datë 29.12.20014 e ndryshuar, neni 26, pika 6/a .</p>
Shkaku:	- Vendosja e kriterëve në mospërputhje të LPP dhe akteve në zbatim.
Rëndësia e shkeljes:	E lartë
Rekomandimi:	Të kërkohet nga Agjencia e Prokurimit Publik si organ që ka tagrin ligjor në përputhje me nenin 13, pika 2/a,g, të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006“Për Prokurimin Publik” me ndryshime, të paraqesë pranë Këshillit të Ministrave propozime për rregullat e prokurimit, në mënyrë që të bëhen përmirësime ligjore në VKM nr. 914, datë 29.12.20014 e ndryshuar, neni 26, pika 6/a, duke përcaktuar në mënyrë eksplicite përveç vlerës maksimale dhe vlerën minimale të kontratës për “punë të ngjashme”, të shprehur në përqindje duke vendosur në këtë mënyrë kufij të qartë të vlerës së kontratës në përmbushje të kriterit për përvojën e mëparshme, të realizuar nga operatorët gjatë 3 viteve të fundit.

2.3.6. “Blerje pajisje të teknologjisë dhe informacionit dhe pajisje të tjera për strukturat e Vettingu-t” me të dhënat si më poshtë .

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje pajisje të teknologjisë dhe informacionit dhe pajisje të tjera për strukturat e Vettingu-t”		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 27, Datë 08.09.2017	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit B. H A. A S. Sh	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Z. Ç R. Xh A. D. L. Ll. L. D
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Negocim pa shpallje paraprake (klasifikuar)” ,		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 57,128,028 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) P	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 129,028 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 12.09.2017	9.Burimi Financimit Buxheti i shtetit	10.Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender : P
b. Kontrata e Punimeve : Nr.47, datë 13.09.2017.		

Gjetje nga auditimi:

Situata 1:	Nga auditimi i dokumentacionit të ndodhur në dosjen e tenderit ka rezultuar se: Mbi hartimin e dokumenteve të tenderit:
-------------------	---



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Situata 2:

- Mungon urdhri për ngritjen e grupit të punës për përlllogaritjen e fondit limit dhe gjithashtu është konsultuar se nuk ka asnjë dokumentacion mbi përlllogaritjen e fondit limit;

- Është mbajtur procesverbali nr.2, datë 08.09.2017 “Për përcaktimin dhe miratimin e OE që do të ftohen të marrin pjesë në procedurën e tenderit”. Në këtë procesverbal u përcaktua se: “ftesa për ofertë do t’ju dërgohet operatorëve ekonomikë në bazë të informacionit botërisht të njohur, si dhe të marrë nga APP, nga lista e operatorëve ekonomik të suksesshëm” (informacion i cili mungon në dosjen e prokurimit).

- Me urdhrin nr.31, datë 08.09.2017 është bërë njoftimi i operatorëve ekonomikë për procedurën e prokurimit. Afati i lënë nga Autoriteti Kontraktor për dorëzimin e ofertës është data 12.09.2017. Ky afat është i paarsyeshëm pasi data 08.09.2017 (i takonte ditë e enjte) dhe në ftesë përcaktohet se operatori duhet të paraqitet brenda datës 11.09.2017 për tu njohur me dokumentacionin e kërkuar (që i takojnë ditë e premte, *e shtunë dhe e dielë*). Realisht OE ju ngelen vetëm dy ditë kohë për të përgatitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar.

Mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit:

Procesverbali nr.3, datë 12.09.2017 për hapjen dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit mungojnë dy firma përkatësisht z.A. A si pjesë e Njësisë së Prokurimit dhe z.Z.Ç. në cilësinë e Kryetarit të KVO-s. Në këtë procesverbal shprehen se të tre operatorët e kanë konfirmuar marrjen e ftesës gjë e cila nuk vërtetohet, pasi në ftesat e dorëzuara kanë konfirmuar marrjen e ftesës vetëm dy prej tyre, P dhe I. Me shkresën nr.41, datë 12.09.2017 “Njoftim për klasifikim përfundimtar”, është shpallur fitues operatori P. Pas shqyrtimit të dokumentave të operatorit fitues rezultoi se ato nuk përputheshin me dokumentat standarde të tenderit.

Në kriteret e veçanta të kualifikimit:

1-Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Operatori ka paraqitur një faturë të energjisë elektrike e cila përfshin si muaj të fundit muajin maj. Operatori duhet të paraqiste një vërtetim të faturës të energjisë duke përfshirë si muaj të fundit muajin gusht. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik.

2- Në pjesën e kapacitetit teknik pika 7: “Operatori ekonomik duhet të disponojë kualifikimet e duhura të stafit teknik përkatës për kryerjen e objektit të prokurimit. Për këtë operatori duhet të paraqesë dokumentacion se ka si të punësuar dhe të regjistruar në kompaninë e tij : 4 inxhinierë telekomunikacioni/elektrik/elektronike, 1 inxhinier mjedisi të pajisur me liçensë” Nga auditimi rezultoi se Operatori ekonomik ka paraqitur një diplomë inxhinier agromjedisi i cili nuk përputhet me kërkesat e DST. Ky është një tjetër element që përbën kriter skualifikimi.

3-Me shkresën nr.39, datë 12.09.2017 Ministria e Kulturës i ka kërkuar Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar pajisjen me çertifikata sigurie të kontraktorit P dhe të personelit që do të angazhohen në realizimin e kësaj kontrate. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar me shkresën nr.9371, datë 22.09.2017 ka konfirmuar sigurinë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

<p>Situata 3:</p> <p>Kriteri:</p> <p>Ndikimi/efekti:</p> <p>Shkaku:</p>	<p>për personelin që do të angazhohet në realizimin e kësaj kontrate. Në këtë listë mungojnë 4 nga personat , dokumentat e të cilëve janë paraqitur nga operatori fitues në përmbushje të dokumentave standarde të tenderit, përkatësisht 1-S. A. i diplomuar në Inxhinieri Agromjedis (diplomë e paraqitur për të përmbushur kapacitetin teknik pika 7). 2-A. K. me diplomë Inxhinier Elektrik (diplomë e paraqitur për të përmbushur kapacitetin teknik pika 7), 3- E. T, i pajisur me licensë elektriciist e paraqitur për të përmbushur kapacitetin teknik dhe 4-A. J. i pajisur me licensë elektriciist. Të gjithë këta punonjës dokumentët e të cilëve janë paraqitur për të përmbushur kriteret e kualifikimit nuk janë angazhuar për realizimin e kësaj kontrate. Ata janë zëvendësuar nga punonjës të tjerë për të cilët nuk është paraqitur asnjë dokument në kundërshtim me kërkesat në dokumentet standarde të tenderit. Gjithashtu një element tjetër që vihet re është se operatori që ka fituar nuk ka pjesë të objektit të tij mobilimin por vetëm pajisjet kompjuterike.</p> <p>Mbi zbatimin e kontratës: Është lidhur kontrata me nr.47, datë 13.09.2017, “Blerje pajisje të teknologjisë dhe informacionit dhe pajisje të tjera për strukturat e Vettingut” dhe kontrata për mbikyrjen e punimeve me këtë objekt, me Kontraktuesin Atelier 4, me vlerë 552,000lekë me tvsh kontratë e cila nuk është e vlefshme pasi është lidhur në kundërshtim me Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 “Për Mbikqyrjen Dhe Kolaudimin E Punimeve Të Ndërtimit”, pasi kontrata e mbikqyrjes së punimeve lidhen për procedurat e ndërtimit dhe jo te blerjeve te mallrave.</p> <ol style="list-style-type: none">1. VKM-n nr 914, datë 29.12.2014, neni 59,2. Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”. VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime .3. Udhëzimi nr.3, datë 15.02.2001 “Për Mbikqyrjen Dhe Kolaudimin E Punimeve Të Ndërtimit” <ol style="list-style-type: none">1. Pamjaftueshmëria në ditë e përgatitjes së dokumenteve të tenderit ka ndikuar në uljen e pjesëmarrësve në këtë procedurë, pasi është paraqitur vetëm një OE, gjë e cila ndikon në uljen e konkurrencës dhe në koston e projektit.2. Duke u gjendur në këto kushte ku ky operator nuk përmbush kriteret e vendosura, duhej të ishte skualifikuar, në bazë të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” me ndryshime, neni 46 dhe anuluar tenderin bazuar në nenin 24/ç të këtij ligji.3. Kontrata e lidhur për mbikqyrjen e punimeve me vlerë 552,000 lekë, është e pavlefshme pasi këto kontrata lidhen për procedurat e ndërtimit. <ol style="list-style-type: none">1. Pamjaftueshmëria në ditë e përgatitjes së dokumenteve të tenderit.2. Kualifikimi I Operatorit ekonomik në kundërshtim me DST.3. Lidhja e kontratës për mbikqyrjen e punimeve me objekt “Blerje pajisje të teknologjisë dhe informacionit dhe pajisje të tjera për strukturat e Vettingut”
---	---



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Rëndësia e shkëljes:

1. E ulët/ **E mesme**/ E lartë
2. E ulët/ E mesme/ **E lartë**
3. E ulët/ E mesme/ **E lartë**

MK ka bërë vërejtjet/sqarimet si më poshtë:

Nga ana e auditit është Konstatuar qe mungon Urdheri per ngritjen e Grupit te punes per perlllogaritjen e fondit limit ne kundershtrim te VKM nr. 914, date 29.12.2014.

Në lidhje me këtë konstatim theksojmë se këto procedura nuk mbeshteten apo realizohen bazuar ne Legjislacionin per Prokurimin Publik apo aktet e dala ne zbatim te tij, por realizohen bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret Shteteror” dhe akteve nenligjore te dala ne zbatim te tij”.

Lidhur me përlllogaritjen e fondit limit sqarojmë se me shkresen nr. 5441, date 11.8.2017 i është kërkuar AKSHI miratimi i projektit për këtë procedurë të klasifikuar. Projekti është nenshkruar nga personat pergjegjes TIK te cilet kane hartuar specifikimet teknike. Bashkelidhur projektit jane 3 oferta te cilat justifikojne vleren e tij nga I shpk; Sh shpk dhe P shpk. Me këtë projekt dhe me këto oferta AKSHI ka miratuar zhvillimin e procedureës me shkresen nr. 2352/1, datë 11.78.2017 (bashkelidhur faqja e kontrollit te dokumentit te projektit).

Në lidhje me konstatimin se shoqeria P në vërtetimin e OSHEE përfshin si muaj të fundit muajin maj, ju bëjme me dije se në përmbushje të kriterëve per kualifikim OE i është kërkuar të paraqes vërtetim që i ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike pa specifikuar një periudhë konkrete.

Nga Operatori ekonomik është paraqitur vertetim i OSHE që mban nr. 6334, datë 6.2.2017 ku parashikohet se operatori deri në këtë datë nuk ka asnje detyrim e vlerësuar kjo si konform Kerkesave per Kualifikim.

2. Ne lidhje me konstatimin se Operatori Ekonomik duhet të disponojë kualifikimet e duhura të stafit teknik për kryerjen e objektit të prokurimit, ku ka te punësuar dhe te regjistruar ne kompanine e tij:

4 inxhiniere telekomunikacioni.elektrik/elektronike.

1 Inxhiniere Mjedisi me license.

Ministria e Kulturës në përgjigje sqaron se OE i kualifikuar për këtë procedurë- shoqëria PC STORE - rezulton të ketë plotësuar këtë pikë pasi ka paraqitur stafin teknik si më poshtë:

1. AB Ing.Elektronik
2. DHP Ing.Elektronik
3. AK Ing.Elektronik
4. GS Ing.Elektronik
5. EM Ing.Elektronik
6. Specialist Elektrik
7. KT Elektracist.
8. Inxhiner Mjedisi
9. S Ah Fakulteti I Agromjedis (Dega Mjedis nuk egziston por është nje bashkim i Mjedisit të Bujqesise dhe ne Universitetin Bujqesor ka vetem nje Fakultet i Bujqesise dhe Mjedisit ku është akredituar dhe Departamenti i AGRO-Mjedisit dhe ekologjise (DAME)



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

3. Ne lidhje me personelin qe eshte angazhuar per realizimin e kontrates pretendimi nuk qendron sepse Kompania P ka plotesuar si fillim kriteret e pergjithshme te kualifikimit dhe ne momentin e firmosjes se kontrates ka paraqitur emrat e stafit dhe punonjesve qe do te punojne per zbatimin e kesaj kontrate;

Kjo e vertetueshme me letren Nr.3 Prot tek dosja e tenderit ku jane paraqitur emrat e stafit qe do te marin pjese ne zbatimin e procedures ,te pajisur me certificate sigurie pasqyruar kjo ne shkresen e sjelle nga kompania P Nr.1531 Prot , si me poshte :

1	EM	D.Teknik	5	TH	Teknik
2	AB	D.Punimesh	6	KT	Teknik
3	Dh.P	Ing.Zbatues	7	RSH	Teknik
4	G.S	Ing.Zbatues	8	KP	Teknik

4. Ne lidhje me Objektin e Kompanise P qe nuk ka zerin Mobilim nuk qendron per arsyjen se ka ne Objektin e tij pajisje zyrash ku jane te perfshire te gjithe elementet e nje zyre, Tavolina, Karrige, Rafta etj.

5. Lidhur me kontraten me objekt: “Mbikqyrje e kontrates per Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni + Pajisjet e sistemeve”, zerat e preventivit dhe specifikimet teknike te projektit argumentojne sakte qe pervec kapitullit te pare, atij te blerjes se pajisjeve elektronike dhe telekomunikacionit, eshte edhe kapitulli i dyte ku jane specifikuar edhe punimet per pajisjet e sistemeve, punimet per furnizim vendosje te sistemit telefonik dhe kompjuterik, te sistemit te sinjalizimit te zjarrit, sistemit te monitorimit CCTV, sistemit te furnizimit te rezervuar me energji elektrike, sistemit te lajmerimit zanor, sistemit te hyrjes se kontrolluar dhe alarmit per hyrje te padeshiruara. Ne keto kushte, ne menyre te pakontestueshme, bazuar ne Udhëzimin Nr.1, datë 16.6.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, kapitulli I, pika 1, “Mbikëqyrja e punimeve bëhet për çdo projekt dhe ka për qëllim kontrollin e mbarëvajtjes të të gjithë procesit të zbatimit të punimeve, në përputhje me projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh dhe anën ekonomike të tij”, eshte detyrim ligjor qe punimet me financim publik te mbikqyren. Po ashtu, vlen te theksohet qe nuk jemi perpara nje demi ekonomik te mundeshem pasi sherbimi i kerkuar nga AK eshte realizuar nga OE, per sa me siper vlera e kontrates nuk mund te kerkohet. Demi ekonomik kerkohet vetem ne rastet kur kemi nje pune apo nje sherbim te pa realizuar dhe qe OE eshte paguar.

-Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së: Sqarimet/shpjegimet e dhëna nga MK, nuk prekin argumentet e paraqitur hollësisht në Akt konstatim dhe projektraport, për rrjedhojë, komentet/shpjegimet e MK, **nuk qëndrojnë.**

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi:

- 1-Ish Titullari i Autoritetit Kontraktor.
- 2-Komisioni i Vlerësimit të Ofertave

2.3.7 “Muzealizimi i Godinës së ish Selisë së Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit (Objekti i Gjethit)” me të dhëna si më poshtë:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Muzealizimi i Godinës së ish Selisë së Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit (Objekti i Gjethit)”					
1.Urdhër	Prokurimi	Nr. 27,	Datë	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave
08.09.2017				B H	Z.Ç



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Negocim pa shpallje paraprake (klasifikuar)”	A. A. S. Sh.	R. Xh. A. D. L. Ll L. D
5. Fondi Limit (pa tvsh) 57,128,028 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) PC Store	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 129,028 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 12.09.2017	9. Burimi Financimit Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender : PC Store
b. Kontrata e Punimeve : Nr.47, datë 13.09.2017.		

Situata 1:	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të ndodhur në dosjen e tenderit ka rezultuar se:</p> <p>Mbi hartimin e dokumenteve të tenderit: Me shkresën nr.5521, datë 10.11.2016 është paraqitur projekti teknik i muzerealizimit të “Muzeut të përgjimeve të sigurimit të shtetit” hartuar nga znj.E. T. përfaqësuese e “Studio T” e ngarkuar me kontratën nr.3727/8, datë 30.09.2014 . Fondi limit i përcaktuar për këtë objekt është 41,046,542 lekë pa tvsh. Është mbajtur procesverbali nr.1 me nr.6345, datë 29.12.2016 nga njësia e prokurimit për hartimin e dokumentave të procedurës së prokurimit.</p> <p>1-Në kriteret e veçanta të kualifikimit vërehet se në pikën 2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar “Xhirua mesatare duhet të ketë një vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit” është vënë në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 neni 26, pika 7 “<i>kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet.</i>”</p> <p>2-Gjithashtu pika 2.11.a. “Punë të ngjashme për një objekt të vetëm, në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit” është vënë në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 neni 26, pika 6 “<i>punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.</i>”</p> <p>3- Në specifikimet teknike , pjesa e paraqitjes së certifikatave, është specifikuar gabim Çertifikata Iso 99:2012 pasi nuk ekziston një certifikatë e tillë por ekziston certifikata BS PAS 99:2012.</p>
Situata 2:	<p>Mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit: -Nga auditimi mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe lidhjen e kontratës rezultoi se:</p> <p>Është mbajtur procesverbali nr 2 me nr. 6345, datë 23.01.2017 i hapjes së procedurës sipas të cilit u paraqitën dy Operatorë Ekonomik Ofertues si më poshtë :1.BOE “A” & “T”shpk me ofertë ekonomike 40,625,201 lekë pa tvsh, 2. B “B”me ofertë ekonomike 34,048,691 lekë pa tvsh. Është mbajtur procesverbali nr. 3 me nr. 6345/3, datë 31.01.2017 i shqyrtimit të dokumentacionit sipas të cilit është skualifikuar operatori B “B”me ofertë ekonomike 34,048,691 lekë pa tvsh pasi kishte mungesë në disa nga dokumentet standarde të tenderit.</p> <p>Nga auditimi konstatojmë se skualifikimi i operatorit B “B”me ofertë ekonomike 34,048,691 lekë pa tvsh është i drejtë pasi kishte mangësi në</p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

	<p>dokumentacion. Është kualifikuar BOE “A” & “T”shpk me ofertë ekonomike 40,625,201 lekë pa tvsh.</p> <p>Nga auditimi konstatohet se dhe Operatori Fitues ka mungesë të dokumentacionit dhe nuk duhej të ishte kualifikuar pasi :</p> <p>1- Operatori fitues ka paraqitur 2 punonjës disagner por njëri prej tyre nuk e vërteton se ka kryer specializim designer, ka paraqitur diplomë ekonomik.</p> <p>2-Në rastin e specifikimit që kërkohen Skela 1000 m² Operatori fitues e ka paraqitur skelën 2000m², ndërkohë që operatori që është skualifikuar e ka paraqitur skelën 1500m² .</p> <p>3- As operatori fitues as ai që është skualifikuar nuk kanë paraqitur Certifikatën ISO 99:2012, certifikatë e cila është kërkuar gabim nga AK. Ndërkohë që një nga arsyet e skualifikimit të operatorit B ka qenë mosparaqitja e kësaj certifikate.</p> <p>4-Operatori fitues nuk ka paraqitur modele broshurash të prodhuara më parë me karakteristika si zëri18 tek specifikimet teknike.</p> <p>5- Operatori fitues nuk ka paraqitur modele printimesh me ploter me bojëra ekologjike, shoqëruar me faturën tatimore. Sipas DST mosparaqitja e dorëzimit të dokumenteve përbënte kusht skualifikimi.</p> <p>Kriteri:</p> <ol style="list-style-type: none">1. VKM nr.914, datë 29.12.2014 neni 26, pika 7. VKM nr.914, datë 29.12.2014 neni 26, pika 6.2. Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe neni 24,ç. Dokumentet e Tenderit <p>Ndikimi/efekti:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Specifikimet teknike janë vendosur në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.20014 e ndryshuar, neni 57, duke ndikuar në uljen e pjesëmarrësve në këtë procedurë, dhe skualifikimin e tyre.2. Duke u gjendur në këto kushte ku ky operator nuk përmbush kriteret e vendosura, duhej të ishte skualifikuar, në bazë të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” me ndryshime, neni 46 dhe anuluar tenderin bazuar në nenin 24/ç të këtij ligji. <p>Shkaku:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Vendosja e Specifikimeve teknike në kundërshtim me bazën ligjore.2. Kualifikimi i Operatorit ekonomik në kundërshtim me DST. <p>Rëndësia e shkeljes:</p> <ol style="list-style-type: none">1. E ulët/ E mesme/ E lartë2. E ulët/ E mesme/ E lartë
--	---

MK ka bërë vërejtjet/sqarimet si më poshtë:

Konstatimi në projekt-raport: “Në kriteret e veçanta të kualifikimit vërehet se në pikën 2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar “xhiroja mesatare duhet të ketë një vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit” është vënë në kundërshtim me VKM nr 914, datë 29.12.2014 neni 26, pika 7 “kopje të deklarave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën e fundit limit të kontratës që prokurohet. Gjithashtu pika 2.11.a. “Punë të ngjashme për një objekt të vetëm, në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

prokurohet dhe që është realizur gjatë tri viteve të fundit” është vënë në kundërshtim me VKM- në nr 914 datë 29.012.2014, neni 26, pika 6 “pune të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit”. Ministria e Kulturës në përgjigje sqaron se përsa i përket dokumentimit të kapacitetit ekonomik dhe financiar të subjektit zbatues, AK ka kërkuar vërtetim të xhiros mesatare gjatë tre viteve të fundit, e cila duhet të ketë një vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të prokuruar. Procedura e prokurimit për këtë objekt ka filluar në datë 02.12.2016. Kriteret përsa i përket kapacitetit ekonomik dhe financiar të subjektit, janë përcaktuar në frymën dhe detyrimet që rrjedhin nga LPP si dhe bazuar në parashikimet e nenit 26 të VKM Nr. 914 date 29.12.14 “Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në atë kohë në fuqi. Konkretisht neni 26 “Kontratat për punë publike” në pikën 7 parashikon se AK siguron provueshmërinë e përmbushjes së kriterit për kapacitetet financiare dhe ekonomike të subjektit, duke kërkuar: “(...) b) kopje të deklaratave të xhiros vjetore, ku në asnjë rast vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet”. Ky parashikim ligjor zbatohet në procedurën objekt auditimi pasi në rastin konkret ligji nuk ka fuqi paravepruese, si e tille ndryshimet ku reflektohen edhe kushtet e reja kanë ndodhur me Vendimin Nr. 797, datë 29.12.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar e si të tilla të pazbatueshme në procedurën objekt auditimi. Në lidhje me specifikimet teknike, pjesa e paraqitjes së certifikatave është specifikuar gabim Certifikata Iso 99:2012 pasi nuk ekziston një certifikatë e tillë por ekziston certifikata BS PAS 99:2012. Lidhur me pikën e mësipërme pranojmë që ka qenë një lapsus në emërtimin e certifikatës dhe është vendosur ISO ku duhet të ishte PAS: Certifikatën ISO 99:2012 mbi “Dizenjim dhe prodhim i të gjitha produkteve të shtypshkrimeve, botimeve dhe shtypshkrimeve me elementë sigurie, materialeve promocionale, materiale reklamuese, prodhimin dhe montimin e paneleve reklamuese, si dhe tregtim i materialeve prej kompoziti”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Ne cdo rast, sqarimi sa i përket certifikimit është i qarte dhe lehtësisht i identifikueshem.

Kjo vërtetohet edhe nga operatori ekonomik BOE Albdesign PSP & Tea D” që ka paraqitur në dokumentacioni e saj duke e marrë si të mirëqenë BS PAS 99:2012. Certifikata e sjelle nga operatori (BS PAS 99:2012) është një certifikatë ku përfshin të gjitha certefikatat ISO gjë që përmbush dhe specifikimet e kërkuara nga AK.

-Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së: Sqarimet/shpjegimet e dhëna nga MK, nuk prekin argumentet e paraqitur hollësisht në Akt konstatim dhe projektraport, për rrjedhojë, komentet/shpjegimet e MK, nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi:

1-Njësia e Prokurimit

2-Komisioni i Vlerësimit të Ofertave

2.3.8. “Sistemi i disifektimit, konservimit i ruajtjes së ikonave në Muzeun e Artit Mesjetar Korçë” me të dhënat si më poshtë:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt , “Sistemi i disifektimit, konservimit i ruajtjes së ikonave në Muzeun e Artit Mesjetar Korçë”			
1.Urdhër Prokurimi nr.202, datë 16.06.2016	3.Hartuesit e Tenderit	Dokumenteve	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave L. L



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Negocim pa shpallje paraprake”,	Daniel Pirushi B. H A T	K A S K I T S M
5.Fondi Limit (pa tvsh) 39,787,907 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 39,574,055.45 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 213,852 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 23.06.2016	9.Burimi Financimit Buxheti i shtetit	10.Operatoret Ekonomike
b. Kontrata e Punimeve : Nr.3306, datë 27.06.2016		

Situata 1:

Nga auditimi i dokumentacionit të ndodhur në dosjen e tenderit ka rezultuar se:

Mbi përzgjedhjen e procedurës dhe hartimin e dokumenteve të tenderit:

Nga auditimi konstatohet se është paraqitur raporti me nr.49, datë 18.04.2016, i Monitorimit mbi zhvillimin e aktivitetit të Misionit të tretë në Korçë në kuadër të projektit “Restaurimi përmes një programi të integruar të konservimit parandalues” në bashkëpunim me institutin Kombëtar të Restaurimit të Francës. Konkluzionet e këtij raporti janë , se për të bërë transferimin e koleksioneve drejt muzeut të ri duhet një plan investimi i cili përfshin tërësinë e mobiljeve të vendosjes së fondeve rezervë (penele lëvizëse, rafte me sirtarë etj), pajisje e domosdoshme për mirëmbajtjen e lokaleve të muzeut të ri (kosh teleskopik për murin me lartësi 10 m dhe makinën larëse të dyshemesë për të kufizuar sasinë e ujit gjatë pastrimit), dhoma e trajtimit termik, e domosdoshme për procedurat e heqjes së insekteve në koleksionet para transferimit por gjithashtu për të siguruar vazhdimësinë e përditshme sanitare. Me memon nr.2032, datë 22.04.2016 nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik Për Trashëgiminë Kulturore. Sipas kësaj memoje kërkohet marrja e masave për mundësinë e blerjes së pajisjes së dizifektimit të objekteve që do të vendosen në Muzeun Kombëtar të Artit Mesjetar Korçë referuar iniciativës së MK për hapjen e këtij Muzeu në datën 29 Shtator 2016. Me shkresën nr.2032/2, datë 28.04.2016 nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës i është kërkuar drejtorit të MKAMK të marrë masat për hartimin e një projekti preventiv me qëllim realizimin e dhomës së dizifektimit përmes vendosjes së një aparature në të cilat do të kalojnë të gjitha fondet muzeore para hyrjes në godinën e re. Është miratuar leja me urdhrin e Ministres së Kulturës me nr.193, datë 16.06.2016, për lëvizjen e 238 objekteve të luajtshme të Trashëgimisë Kulturore, pjesë e Fondit të Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar Korçë, nga godina aktuale të ajo e re. Nga Bashkia e Korçës është dërguar shkresa me nr.3092, datë 14.06.2016 ku kërkohet bashkëpunim për inagurimin e Muzeut të Artit Mesjetar në datën 29 Shtator, me rastin e ditës së Trashëgimisë Kulturore. Me shkresën nr.2032/4, datë 16.06.2016 është vendosur kronologjia e pajisjeve ku ndër të tjera shpjegohet dhe përzgjedhja e procedurës, ku përcaktohet se me qëllim të realizimit të këtij investimi që korrespondojnë me inagurimin e Muzeut në datën 29 shtator rezultojnë se afati për zhvillimin e kësaj procedure me procedurë të hapur nuk mund të zbatohet pasi koha në dispozicion deri në inagurimin e objektit e bën të pamundur ndjekjen e procedurave normale që e tejkalojnë afatin e parashikuar për inagurim më datë 29.09.2016. Të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

	<p>ndodhur në kushtet e mësipërme Institucioni ndodhej në kushte “urgjence” parashikon procedurën Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit sipas ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, neni 33, gërma c “kur për arsye të nevojës ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor, afati kohor i parashikuar në nenin 43 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 për njoftimin e kontratës për procedurat e hapura, të kufizuara ose me negociim, me publikim, nuk mund të respektohet. Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga veprimi ose mosveprimi i autoritetit kontraktor. Kushtet dhe rrethanat e përdorimit të kësaj procedure përcaktohen në rregullat e prokurimit.”.</p> <p>-Nga auditimi mbi Hartimin e Dokumenteve të Tenderit (DT) rezultoi se:</p> <p>Urdhri i Prokurimit me nr.202, datë 16.06.2016, me fond limit 39,787,907 lekë pa tvsh .Mungon formulari i deklaramit të konfliktit të interesave nga znj.Kozeta Angjeliu.</p> <p>Drejtoria e Muzeut Kombëtar Korçë ju drejtua studios Dea për hartimin e preventivit të pajisjeve, ku përfshihen laborator i dezinfektimit, raftet, një kosh teleskopik, ndricuesat e sensorët e tavanit si dhe një pajisje larëse-tharëse.</p> <p>Konstatohet se ky preventiv nuk është bërë në përputhje me objektin e këtij prokurimi pasi në këtë preventiv janë futur zëra të cilat nuk janë përmendur më parë as në raportin e ekspertit francez , objekti i këtij prokurimi është vetëm pajisja e desinfektimit, panelet lëvizëse, koshi teleskopik dhe raftet për mbajtjen e ikonave. Në këtë preventiv janë futur zëra si : pajisje mobilimi, lavapjatë, kënd ndenje, karrige, tavolina laborator, tavolinë qëndrore te këndi i ndenjes, tavolina pune, varëse rrobash , tabela et, me vlerë 1.564.530 lekë pa tvsh. Përveç ndriçuesve të cilët mund të justifikohen pasi do vendosen në këtë laborator janë vendosur dhe pajisje të tjera si frigorifer mini, televizor led, laptop, kompjuter me vlerë 1.403.000 lekë pa tvsh.</p> <p>Është mbajtur procesverbali nr.1 me nr 3138Prot, datë 16.06.2016, Për hartimin dhe miratimin e dokumentave standarde dhe përcaktimin e operatorëve ekonomik që do të ftohen të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi. Në dokumentat standarde të prokurimit vihet re ky prokurim është trajtua si një prokurim punimesh ndërtimi dhe jo si një prokurim me objekt dizinfektimin , në dokumentet standarde nuk është kërkuar asnjë restorator i cili është i domosdoshëm në këtë procedurë. U është dërguar ftesa për ofertë katër operatorëve, në datën 16.06.2016.</p> <p>Kriteri:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, neni 33, gërma c.2. VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 36. <p>Ndikimi/efekti:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Përzgjedhja e kësaj procedure nuk ka lejuar në zhvillimin e një procedure të hapur prokurimi, duke kufizuar numrin e operatorëve pjesëmarrës dhe gjithashtu ka çuar në shmangien e konkurrencës.2. Ky prokurim nuk është bërë në përputhje me objektin e tij por janë futur zëra të tjerë të cilët nuk ishin parashikuar më parë.
--	--



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Shkak:

1. Kjo procedurë nuk është zhvilluar në përputhje me bazën ligjore përkatësisht me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, neni 33, dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014, neni 36, nuk ndodhet në kushtet e emergjencës, pasi arsyeja e përdorur nga AK për realizimin i këtij investimi që korresponon me inagurimin e Muzeut në datën 29 shtator nuk është rast emergjent, pasi inagurimi mund të bëhej dhe në një datë të mëvonshme duke zhvilluar kështu një procedurë të hapur. Në përfundim konstatohet se inagurimi i këtij objekti as nuk është zhvilluar në datën e parashikuar 29 shtator, por më vonë, në datën 03 tetor 2016.

Rëndësia e shkeljes:

1. E ulët/ E mesme/ **E lartë**
2. E ulët/ **E mesme**/ E lartë

-Nga auditimi mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe lidhjen e kontratës rezultoi se:

Është mbajtur procesverbali nr.2 me datë 3138/1, datë 23.06.2016, për hapjen e procedurës . Kanë paraqitur ofertë ekonomike tre operatorë ekonomik 1.E sh.p.k me vlerë oferte 39,655,577.56 lekë pa tvsh, 2. H sh.p.k me vlerë oferte 39,696,533 lekë pa tvsh, 3.L me vlerë oferte 39,574,055.45 lekë pa tvsh. Është skualifikuar operatori E shpk për mungesë dokumentacioni.Janë kualifikuar dy operatorët e tjerë të cilët i kishin paraqitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe është shpallur fitues operatori L me vlerë më të vogël. Nga auditimi konstatohet se dokumentacioni i operatorit fitues është në përputhje me dokumentet standarde të prokurimit. Është lidhur kontrata me nr. 3306, datë 27.06.2016 me objekt “Sistemi i disinfektimit, konservimit dhe i ruajtjes së ikonave në Muzeun e Artit Mesjetar, Korçë”me Shoqërinë “L” me afat 2.5 muaj dhe vlerë 39,574,055.45 lekë pa tvsh ose 47,488,866.54 lekë me tvsh. Është kryer prokurimi me vlerë të vogël dhe është lidhur kontrata për mbikëqyrjen e punimeve me nr. 3239/3, datë 28.06.2016, me Shoqërinë Infratech shpk, me vlerë700,000 lekë pa tvsh. Është mbajtur procesverbali mbi fillimin e punimeve në datën 28.06.2016. Punimet kanë përfunduar në datën 13.09.2016 . Me shkresën nr.202/2, datë 16.09.2016 është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim të punimeve.

MK ka bërë vërejtjet/sqarimet si më poshtë:

-Ne lidhje me procedurën është detajuar në memon drejtuar Titullarit të AK procedura e perzgjedhur me negociim pa shpallje. Kjo vertetohet edhe me emailin e Kr ku në fillim konfirmohet si date inagurimi data 29 shtator që perkon dhe me ditën kombetare të trashëgimise kulturore. (bashkelidhur mail). Procedura ka nisur me kete praktike. Gjate kohes që zhvillohej investimi nga Kryeministria është nderruar agenda për pasoje e angazhimeve të tjera të kryeministrit. Për kete arsye nuk është zhvilluar në date 29. Bashkelidhur do të gjeni dhe një nga mailet e kryeministrise, por kjo gje nuk varej nga Mk dhe nuk mund të ktheheshim mbrapsht për të ribere procedurën.

-Në lidhje me konstatimin se ky preventiv nuk është bërë në përputhje me objektin e këtij prokurimi pasi në këtë preventiv janë futur zëra të cilët nuk janë përmendur më parë as në raportin e ekspertit francez, objekti i këtij prokurimi është vetëm pajisja e dezinfektimit, panelet lëvizëse, koshi teleskopik dhe raftet për mbajtjen e ikonave. Në këtë preventiv janë futur zëra si: pajisje mobilimi, lavapjatë, kënd ndenje, karrige, tavolina laboratorit, tavolinë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

qendrore te këndi i ndenjës, tavolina pune, varëse rrobash, tabela et, me vlerë 1.564.530 lekë pa tvsh. Përveç ndriçuesve të cilët mund të justifikohen pasi do vendosen në këtë laborator janë vendosur dhe pajisje të tjera si frigorifer mini, televizor led, laptop, kompjuter me vlerë 1.403.000 lekë pa tvsh. Është mbajtur procesverbali nr.1 me nr. 3138 prot. datë 16.06.2016, Për hartimin dhe miratimin e dokumenteve standarte dhe përcaktimin e operatorëve ekonomike që do të ftohen të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi. Në dokumentet standarte të prokurimit vihet re ky prokurim është trajtuar si një prokurim punimesh ndërtimi dhe jo si prokurim me objekt dezinfektimin, në dokumentet standarte nuk është kërkuar asnjë restaurator i cili është i domosdoshëm në këtë procedurë.

-Gjithcka eshte vendosur per te permbushur nevojat e institucionit qe te ishte konform cdo standarti per inagurimin dhe funksionimin e tij.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së : Sqarimet/shpjegimet e dhëna nga MK, nuk prekin argumentet e paraqitur hollësisht në Akt konstatim dhe projektraport, për rrjedhojë, komentet/shpjegimet e MK, **nuk qëndrojnë.**

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi:

2.Njësia e Prokurimit :

2.3.9. “Krijimi i qendrave të informimit publik për regjistrimet online të pasurive kult-kombet” me të dhënat si më poshtë .

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Krijimi i qendrave të informimit publik për regjistrimet online të pasurive kult-kombet”.		
1.Urdhër Prokurimi Nr.386, datë 20.10.2015	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “T. Hapur”,	B. H S Sh A A	Z Ç E M E Gj M M A T
5.Fondi Limit (pa tvsh) 36,046,173 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 33.908.635 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 137,538 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 23.11.2015	9.Burimi Financimit Buxheti i shtetit	10.Operatorët Ekonomike
11.Ankimime mbi DT-OE I Shpk dhe Stroka Shpk Ankime mbi procedurën: Operatori C	12. Përgjigje Ankesës nga AK nr.5352/1, datë 25.11.2015 nr.5933/1, datë 1.12.2015	13.Përgjigje
b. Kontrata e Punimeve		

Gjetje nga auditimi:

Situata:	-Nga auditimi Mbi Zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe lidhjen e kontratës rezultoi se: Bazuar në procesverbalin nr.2, datë 23.11.2015 rezultoi se ishin paraqitur katër operatorë ekonomik në Sistemin e Prokurimeve Elektronik: 1-C me ofertë ekonomike 31.944.400 lekë pa tvsh.
----------	---



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

<p>Kriteri:</p> <p>Ndikimi/efekti:</p> <p>Shkaku:</p> <p>Rëndësia e shkeljes:</p>	<p>2-D me ofertë ekonomike 33.908.635 lekë pa tvsh 3-I, i cili nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion 4-I, i cili nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion.</p> <p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit është skualifikuar operatori Communication progress për mungesë dokumentacioni dhe është kualifikuar operatori D . Nga shqyrtimi i dokumentave të operatorit fitues dhe të operatorit të skualifikuar u konstatua se operatorit fitues ka paraqitur dy certifikata ISO 9001:2008, dhe certifikatën ISO27001:2013, këto certifikata janë lëshuar nga Shoqëria e Certifikimit “ Certind Sa” me seli në Bukuresht, Rumani, në gjuhën shqipe, gjë e cila nuk mund të ndodhi pasi certifikatat lëshohen në gjuhën angleze ose në gjuhën në të cilin ndodhet shoqëria e certifikimit, gjithashtu në këtë certifikatë shkruhet se verifikimi i saj mund të kryhet në faqen e internetit ëëë.rig-cert.com. Pas verifikimit në këtë faqe konstatohet se kjo certifikatë është dhënë nga shoqëria e certifikimit “Rig Cert” e cila ndodhet në Tiranë dhe ka bashkëpunim me shoqërinë Rigcert në Greqi dhe në Kosovë, dhe nuk ka asnjë bashkëpunim me shoqërinë Certind në Rumani. Kjo çon në dyshimin se këto certifikata janë të pasakta. Duke u gjendur në këto kushte Komisioni i Vlerësimit të ofertave duhej të kishin kërkuar shpjegime dhe të kishin skualifikuar këtë operator ekonomik për paraqitje të dokumenteve të pasakta dhe jo në përputhje me DST. Operatori C është ankuar lidhur me skualifikimin e tij (mungon formulari i ankesës). I është kthyer përgjigje Operatorit Ekonomik Communication Progres me shkresën nr. 5933/1, datë 1.12.2015 ku sqarohet se pretendimet e operatorit nuk qëndrojnë. Nga auditimi konstatohet se operatorit i skualifikuar kishte mangësi në dokumentacion . Është lidhur kontrata me nr. 6156, datë 11.12.2015 me BOE, D, FBS dhe S me vlerë 33.908.635 lekë pa tvsh. Është ngritur grupi i punës me urdhrin nr. 445, datë 11.12.2015 për mbikëqyrjen dhe marrjen në dorëzim të projektit.</p> <p>-VKM nr. 914, datë 29.12.20014 e ndryshuar, neni 66.</p> <p>Duke u gjendur në këto kushte ku ky operator nuk përmbush kriteret e vendosura, duhej të ishte skualifikuar, në bazë të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” me ndryshime, neni 46 dhe anuluar tenderin bazuar në nenin 24/ç të këtij ligji.</p> <p>Mos përputhja e dokumenteve të operatorit fitues me DST</p> <p>E ulët/ E mesme/ E lartë</p>
---	---

-Nga auditimi Mbi Hartimin e Dokumenteve të Tenderit (DT) rezultoi se:

Me urdhrin nr.”2, datë 10.02.2015 është ngritur grupi i punës për hartimin e projektit “Krijimi i Qendrave të Informimit Publik për Regjistrimin Online të Pasurive Kulturore Kombëtare”.Me shkresën nr. 1625, datë 03.09.2015, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Informacionit pas kërkesës së bërë nga Ministria e Kulturës për miratimin e këtij projekti, e cila shprehet pozitivisht për miratimin e termave dhe specifikimeve teknike të kësaj procedure. Është ngritur grupi i punës me urdhrin nr. 2, datë 10.02.2015 “Për ngritjen e Grupit të Punës për Hartimin e Projektit” “Krijimi i qendrave të informimit publik për regjistrimet online të pasurive kult-kombet”. Është ngritur urdhri i prokurimit me nr. 386, datë 20.10.2015, me fond limit 36,046,173 lekë pa tvsh me njësi prokurimi. Me urdhrin 386/1, datë 20.10.2015, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. Nuk është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga asnjë nga anëtarët e KVO-s në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 56. Është mbajtur procesverbali i miratimit të dokumenteve të tenderit nga njësia e Prokurimit me nr. 5214, datë 20.10.2015. Janë paraqitur dy ankesa për dokumentet standarde të tenderit nga operatorët ekonomik I Shpk dhe S Shpk. Ankesa e operatorit S shpk konsiston në ndryshimin në dokumentet standarde të Shtojcës 8, ku në kriteret e veçanta të Kualifikimit është kërkuar “Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë dokumentet e lartpërmendur. Kërkohet që të hiqet kjo pikë nga Kriteret e Veçanta dhe të vendoset në kriteret e përgjithshme në përputhje me VKM-n nr.914, datë 29.12.2014, neni 74, pika 3. Pas pezullimit të procedurës dhe shqyrtimit të ankesës, Ministria e Kulturës i ka kthyer përgjigje operatorit me shkresën nr. 5352/1, datë 25.11.2015, se ka vendosur ta pranojë ankesën dhe të bëjë ndryshimet përkatëse në DST. Ankesa e Operatorit Infosoft konsiston në ndryshimin e disa prej kritereve të veçanta të kapacitetit teknik të kriteret e veçanta pasi sipas tyre këto kritere janë vendosur në kundërshtim m ligjin dhe cenojnë këtë procedurë. Ankesa e këtij operatori është marrë në konsideratë dhe janë ndryshuar këto kritere. Nga auditimi konstatohet se këto kritere janë ndryshuar në formularin e ankesës, por nuk janë reflektuar në relacionin e mbajtur nga shqyrtimi i ankesës me shkresën me nr. 5214/2, datë 03.11.2015.

MK ka bërë vërejtjet/sqarimet si më poshtë:

Lidhur me konstatimin së nga shqyrtimi i dokumentave të operatorit fitues DATECH SH.P.K u konstatua se ka paraqitur 2 certifikata ISO 9001:2008 (9663 C) dhe certifikatën ISO 27001:2013 (615 SI), këto certifikata janë lëshuar nga Shoqëria e Çertifikimit “Certind Sa” me seli ne Bukuresht, Rumani në gjuhën shqipe, gjë e cila nuk mund të ndodhi pasi certifikatat lëshohen ne gjuhen angleze ose ne gjuhën në të cilin ndodhet shoqëria e certifikimit, gjithashtu në këtë certikatë shkruhet se verifikimi i saj mund të kryhet ne faqen e internetit ëëë.rig-cert.com. Pas verifikimeve në këtë faqe konstatohet se kjo certefikate është dhënë nga shoqëria “Rig Cert” e cila ndodhet në Tiranë dhe ka bashkëpunim me shoqërinë “Rig Cert” në Greqi dhe në Kosovë, dhe nuk ka asnjë bashkëpunim më shoqërinë Certind në Rumani. Kjo çon në dyshimin se këto certifikata janë të pasakta.

Përsa i përket konstatimit më lartë nuk qëndron pasi nga verifikimet e bëra tek faqja e ëëbit <http://ëëë.rig-cert.com/kliente> vertetohet se këto dy certifikata janë lëshuar per kompaninë D dhe janë të vlefshme si me poshtë:

<i>Emri i shoqerise: DATECH SH.P.K Vendndodhja: Tirane NIPT: J81702002U Certifikata te mbajtura: ISO 9001:2008 Numri i certifikimit: 9663C Statusi (e vlefshme, pezulluar, anuluar): Vlefshme</i>	<i>Emri i shoqerise: DATECH SH.P.K Vendndodhja: Tirane NIPT: J81702002U Certifikata te mbajtura: ISO/IEC 27001:2013 Numri i certifikimit: 615SI Statusi (e vlefshme, pezulluar, anuluar): Vlefshme</i>
---	--



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së : MK ka sjellë argumente dhe materiale shitesë, për rrjedhojë ky observacion merret në konsideratë.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi:

Komisioni i Vlerësimit të ofertave

3. MBI HARTIMIN, DETAJIMIN DHE ZBATIMIN E PLANIT TË BUXHETIT

Sipas Programit të Auditimit nr. 1264/2, datë 14.12.2017, është audituar planifikimi dhe zbatimi i buxhetit të Ministrisë së Kulturës për vitin 2015, 2016 dhe 2017. Për auditimin e kësaj pike grupi i auditimit është mbështetur në:

- Ligjet vjetore të “Zbatimit të buxhetit të Shtetit”;
- Udhëzimin nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, udhëzimet plotësuese vjetore, si dhe çdo akt nënligjor i nxjerrë në zbatim të tij;
- Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 “Mbi procedurat e zbatimit të buxhetit” me ndryshime, udhëzimet plotësuese vjetore, si dhe çdo akt nënligjor i nxjerrë në zbatim të tij;
- Ligjin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Manualin mbi MFK-në, etj.

3.1/a. Zbatimi i kritereve në planifikimin e buxhetit.

Pesha specifike e zërave të shpenzimeve ndaj planit total

Zërat	Aparati			Art/Kulturë			Trashëgimia			Total Ministria
	Në % ndaj totalit			Në % ndaj totalit			Në % ndaj totalit			
	2015	2016	2017	2015	2016	2017	2015	2016	2017	
600	36.35	53.98	59.68	51.24	45.29	40.27	33.16	43.75	48.01	42.60
601	5.94	8.96	10.05	8.60	7.52	6.85	5.64	7.44	8.40	7.16
602	33.45	29.33	28.98	8.66	5.67	6.30	15.27	17.86	23.61	13.89
602/5	0.00	0.00	0.00	1.16	1.01	0.87	1.21	2.10	2.86	1.05
604	2.69	0.00	0.00	16.40	13.26	13.06	17.18	5.71	5.96	15.23
605	0.00	0.00	0.00	1.75	1.00	0.72	0.04	0.05	0.07	0.90
606	1.25	0.15	0.00	0.20	0.08	0.00	0.11	0.04	0.00	0.28
231	20.00	7.58	1.29	11.97	26.18	31.93	27.35	23.05	11.08	18.85
Total	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100

Burimi i informacionit: MK

Punoi: KLSH



Siç shihet nga të dhënat e mësipërme, zëri i pagave (600) ka peshën më të lartë specifike kundrejt shpenzimeve të planifikuara me rreth 42.6 % në nivel grupi, investimet (231) me



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

18.9 %, transferta e brendshme (604) me 15.2 % dhe shpenzimet operative (602) me 13.9 % ndaj totalit.

Nga auditimi i planifikimit të buxhetit për vitet 2015-2016-2017, u konstatua:

- Në planifikimin e buxhetit MK, ka respektuar tavanet vjetore të vendosura nga MFE, të cilët në raport me projektbuxhetet afatmesme kanë pësuar ndryshime. Gjithashtu, ndryshime të projektbuxheteve vjetore kanë rezultuar edhe nga një PBA në tjetrën si më poshtë:

PBA-2015-2017/2015, në 000/lekë

Programet	2015 (1)	2016 (2)	2017 (3)	Plan vjetor/2015 (4)	Diferenca (4-1)
Menaxhimi	138,900	140,845	140,845	161,966	23,066
Art-Kultura	833,439	843,016	843,426	818,048	-15,391
Trashëgimia	434,596	439,188	440,238	497,146	62,550
Totali	1,406,935	1,423,049	1,424,509	1,477,160	70,225

PBA-2016-2018/2016, në 000/lekë

Programet	2015 (1)	2016 (2)	2017 (3)	Plan vjetor/2016 (4)	Diferenca (4-2)
Menaxhimi	138,900	131,966	131,933	131,966	0
Art-Kultura	833,439	1,178,584	1,178,584	966,584	-212,000
Trashëgimia	434,596	593,759	583,699	527,759	-66,000
Totali	1,406,935	1,904,309	1,894,216	1,654,309	-250,000

PBA-2016-2019/2017, në 000/lekë

Programet	2015 (1)	2016 (2)	2017 (3)	Plan vjetor/2017 (4)	Diferenca (4-3)
Menaxhimi	138,900	131,966	145,376	155,276	9,900
Art-Kultura	833,439	1,178,584	1,051,786	1,051,786	0
Trashëgimia	434,596	593,759	457,038	462,038	5,000
Totali	1,406,935	1,904,309	1,645,200	1,669,100	23,900

- Për planifikimin e investimeve janë plotësuar propozimet e projekteve (FPPI) për investime sipas “Shtojcës 2A” 2015-2017, në të cilën është evidentuar vlera e plotë e projekteve, buxheti sipas viteve, argumentimi i investimit etj.
- Nga MK janë respektuar të gjitha afatet e përcaktuara në udhëzimet e mësipërme dhe shkresat e Ministrisë së Financave, mbi startimin e procesit të programimit, zhvillimin e fazave dhe përfundimin e tij.
- Për përgatitjen e PBA nga Titullari i MK-së janë nxjerrë urdhrat përkatës për krijimin e Ekipit të Menaxhimit të Programit (EMP). Nga MK janë plotësuar të gjitha pasqyrat e kërkuara, si dhe janë plotësuar fishat mbi Planifikimin e Shpenzimeve të Programit (PSHP) dhe mbi Rishikimin e Politikave të Programit (RPP). Plotësimi i tyre është bërë për të gjitha rubrikat e kërkuara, në përputhje me kërkesat e udhëzimeve përkatëse, janë të firmosura nga NA dhe EMP.
- Megjithatë, rezulton se tavanet buxhetore në nivel programi dhe kapitulli për vitet 2015, 2016 dhe 2017, nga njëra PBA në tjetrën kanë pësuar ndryshime.

Sa më sipër, arrijmë në konkluzionin që: Në fazën e planifikimi i buxhetit MK, ka zbatuar kriteret e paracaktuara dhe të parashikuara në Udhëzimin nr. 8, datë 29.03.2012 “Për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, Udhëzimin nr. 23, datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, si dhe udhëzimet vjetore plotësuese.

3.1/b. Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit, detajimi i planit fillestar, transferimi i fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor konform dispozitave ligjore.

Buxheti i vitit 2015:

- Me shkresën nr. 18082, datë 24.12.2014 Ministria e Financave ka dërguar buxhetin e miratuar për vitin 2015. MK si njësi shpenzuese ka bërë detajimin e shpenzimeve korente, dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 6033, datës 26.12.2014.
- Për vitin 2015, plani i buxhetit të MK-së dhe detajimi i tij është miratuar me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 18082/95, datë 08.01.2015 “Dërgim i detajimit të buxhetit të vitit 2015”, për shpenzimet korente dhe me shkresën nr. 18082/195, datë 14.01.2015 “Miratimi i detajimit të investimeve për vitin 2015” për shpenzimet kapitale, për Ministrinë e Kulturës (aparati) dhe institucionet në varësi të saj.

Buxheti i vitit 2016:

- MK si njësi shpenzuese ka bërë detajimin e shpenzimeve korente, dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 6387, datës 24.12.2015.
- Për vitin 2016, plani i buxhetit të MK-së dhe detajimi i tij është miratuar me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 17761/97, datë 07.01.2016 “Dërgim i detajimit të buxhetit të vitit 2015”, për shpenzimet korente dhe me shkresën nr. 301/1, datë 25.01.2016 “Miratimi i detajimit të investimeve për vitin 2016” për shpenzimet kapitale, për Ministrinë e Kulturës (aparati) dhe institucionet në varësi të saj.

Buxheti i vitit 2017:

- MK si njësi shpenzuese ka bërë detajimin e shpenzimeve korente, dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 6350, datës 30.12.2014.
- Për vitin 2015, plani i buxhetit të MK-së dhe detajimi i tij është miratuar me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 17911/189, datë 23.01.2017 “Dërgim i detajimit të buxhetit të vitit 2015”, për shpenzimet korente dhe me shkresën nr. 17911/155, datë 19.01.2015 “Miratimi i detajimit të investimeve për vitin 2015” për shpenzimet kapitale, për Ministrinë e Kulturës (aparati) dhe institucionet në varësi të saj.

Plani me ndryshime në nivel Grupi/Ministria, në 000/lekë

Emërtimi i shpenz.	Viti 2015			Viti 2016			Viti 2017		
	Pl/F	Ndryshime	Pl/P	Pl/F	Ndryshime	Pl/P	Pl/F	Ndryshime	Pl/P
(600)	759,014	-35,441	723,573	752,614	-23,463	729,151	738,060	+29,137	767,197
(601)	124,486	-2,785	121,701	125,886	-4,899	120,987	126,440	+567	127,007
(602)	194,580	+59,365	253,945	210,207	+19,076	229,283	242,783	+10,966	253,749
(604)	161,103	+97,641	258,744	162,103	+50,900	213,003	164,856	+59,803	224,659
(605)	15,777	-489	15,288	10,1936	-2,445	7,748	7,961	-5,360	2,602
(606)	2,200	+2,577	4,777	1,196	+2,168	3,364		+2,014	2,014
T/Korente	1,257,160	+120,868	1,378,028	1,262,199	+41,337	1,303,536	1,280,100	97,127	1,377,227
T/Investime	220,000	+100,287	320,287	392,110	+39,043	431,153	389,000	+190,266	579,266
Total njësie	1,477,160	+211,905	1,698,315	1,654,309	+80,380	1,734,689	1,669,100	+287,393	1,956,493

Burimi i informacionit: MK
Punoi: KLSH



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Plan me ndryshime në nivel Aparati/Ministria, në 000/lekë

Emërtimi i shpenz.	Viti 2015			Viti 2016			Viti 2017		
	Pl/F	Ndryshime	Pl/P	Pl/F	Ndryshime	Pl/P	Pl/F	Ndryshime	Pl/P
600	76,239	-10,000	66,239	71,239	-1,200	70,039	92,676	-16,000	76,676
601	11,827	-1,000	10,827	11,827	-1,200	10,627	15,600	-3,500	12,100
602	50,196	13,849	64,045	50,727	-11,823	38,904	73,010	-5,490	67,520
604	110,830	51,430	162,260	109,830	34,893	144,723	114,656	40,794	155,450
605	14,352	0	14,352	8,518	-2,480	6,038	6,500	-4,834	1,666
606	1,900	370	2,270	200	220	420	0	1,146	1,146
T/Korente	265,344	+54,649	319,993	252,341	18,410	270,751	302,442	12,116	314,558
T/Investime	120,609	+21,748	142,357	230,153	95,802	325,955	389,000	188,014	577,014
T/Aparati	385,953	+76,397	462,350	482,494	114,212	596,706	92,676	-16,000	76,676

Burimi i informacionit: MK

Punoi: KLSH

Mbi rishpërndarjen e fondeve buxhetore.

- Për periudhën objekt auditimi, plani buxhetit ka pësuar ndryshime me Aktet normative të dala në ndryshim të ligjeve vjetore të buxhetit, si dhe me rishpërndarjet gjatë viteve buxhetore si më poshtë:

Plani sipas AN dhe Plani përfundimtar në 000/lekë

Viti	Plan Fillestar (PF)	Aktet Normative (AN)	Ndryshimi (AN-PF)	Plani Përfundimtar (PP)	Ndryshimi (PP-AN)	Ndryshimi (PP-PF)
2015	1,477,160	1,534,563	57,403	1,698,315	173,752	231,155
2016	1,654,309	1,687,293	32,984	1,734,689	47,396	80,380
2017	1,669,100	1,897,303	228,203	1,956,493	77,189	305,392

Burimi i informacionit: MK

Punoi: KLSH

1. MK, për rishpërndarjen e fondeve për investime ka zbatuar kriteret e përcaktuara në udhëzim pika 76.b ku përcaktohet:

Rishpërndarjet e fondeve të projekteve të investimeve brenda të njëjtit program të njësisë së qeverisjes qendrore miratohen nga Ministri i Financave pa cenuar burimet e financimit (buxheti, financimi i huaj, të ardhurat detyësore).

Nga auditimi mbi rishpërndarjen e fondeve për shpenzime kapitale gjatë vitit 2017, rezultoi:

Projekti M120730 “Skena e Re”

- Me shkresën nr. 11545/2, datë 07.08.2017 të Ministrisë së Financave, drejtuar Ministrisë së Kulturës, janë pakësuar nga fondet buxhetore për investime për projektin Qendra Kombëtare Kulturore “Skena e Re” fondi në vlerën 150,000,000 lekë.
- Me shkresën nr. 9023/4, datë 21.06.2017 të Ministrisë së Financave, drejtuar Ministrisë së Kulturës, janë pakësuar nga fondet buxhetore për investime për projektin Qendra Kombëtare Kulturore “Skena e Re” fondi në vlerën 103,000,000 lekë.
- Me shkresën nr. 1669/1, datë 22.02.2017 të Ministrisë së Financave janë pakësuar fondet për këtë projekt në shumën 6,932,159 lekë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

- Me shkresën nr. 16148/37, datë 21.11.2017, në zbatim të Aktit Normativ nr. 3, datë 06.11.2017, i është akorduar Aparatit të Ministrisë dhe Kulturës, fondi në shumën 105,053,917 lekë për projektin Qendra Kombëtare Kulturore “Skëna e Re”.

Projekti M120720 “Regjistrimi i pasurive kulturore kombëtare”

- Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 4965/1, datë 18.04.2017 i janë shtuar fonde (FZHR) në shumën 8,066,275 lekë.
- Me shkresën nr. 12975/1, datë 10.10.2017 të Ministrisë së Financave, drejtuar Ministrisë së Kulturës, janë pakësuar fonde buxhetor për këtë projekt në shumën 4,430,000 lekë.
- Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 16148/37, datë 21.11.2017, në zbatim të aktit normative nr. 3, datë 06.11.2017, është shtuar fonde në shumën 4,430,000 lekë.

Projekti M120722 “Rikonstruksion i godinës së Teatrit Migjeni”

- Me shkresën nr.1669/1, datë 22.02.2017 të Ministrisë së Financave, drejtuar Ministrisë së Kulturës, është shtuar fonde në vlerën 5,797,159 lekë.
- Me shkresën nr. 7417/4 datë 25.07.2017, të Ministrisë së Financave është pakësuar fonde për këtë projekt në shumën 2,252,399 lekë.

Projekti M120764 “Biblioteka e letrave Mysine Kokalari”

- Me shkresën nr. 1669/1, datë 22.02.2017 të Ministrisë së Financave, drejtuar Ministrisë së Kulturës, është shtuar fonde në shumën 10,000,000 lekë.
- Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 16148/37, datë 21.11.2017, në zbatim të aktit normative nr. 3, datë 06.11.2017, është pakësuar fonde në shumën 10,000,000 lekë për këtë projekt.

Projekti M120774 “Blerje pajisje elektronike-Vetting”

- Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 11545/2, datë 17.08.2017, është shtuar fonde në shumën 51,300,000 lekë;
- Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 12389/1, datë 13.09.2017, është pakësuar fonde në shumën 5,800,000 lekë;
- Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 16148/37 në zbatim të Aktit Normativ nr. 3, datë 21.11.2017, është shtuar fonde në shumën 9,580,000 lekë

Projekti M120773 “Përshtatje e godinës së Lidhjes së Shkrimtarëve për akomodimin e Vetting”

- Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 11545/2, datë 17.08.2017 i është shtuar fonde në shumën 20,600,000 lekë;
- Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 9023, datë 21.06.2017 i është shtuar fonde në shumën 103,000,000 lekë.

Projekti M120775 “Blerje pajisje Vetting”

- Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 11545/2, datë 17.08.2017, është shtuar fonde në shumën 54,000,000 lekë;
- Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 12389/1, datë 13.09.2017, është pakësuar fonde në shumën 30,400,000 lekë;
- Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 16148/37 në zbatim të Aktit Normativ nr. 3, datë 21.11.2017, është shtuar fonde në shumën 3,910,000 lekë.

Projekti 120763 “Rikonstruksion TKOBAP”

- Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 11545/2, datë 17.08.2017 i është shtuar fonde në shumën 24,100,000 lekë;
- Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 12389/1, datë 13.09.2017, i është shtuar fonde në shumën 36,200,000 lekë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës


- Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 16148/37 në zbatim të Aktit Normativ nr. 3, datë 21.11.2017, është shtuar fondi në shumën 68,556,083 lekë.

Gjetje nga auditimi:

Situata:

Sa më sipër, është konstatuar se gjatë viteve buxhetore MK, ka kryer një numër të lartë të rishpërndarje të fondeve gjatë vitit buxhetor, të cilat kanë prekur të gjithë zërat e buxhetit, si: paga (600), sigurime (601), shpenzime operative (602), transferta të brendshme (604), ku në analizë kemi marrë zërin e shpenzimeve kapitale (llog.231).

-Niveli i ndryshimeve në planin e investimeve kundrejt planit fillestar ka rezultuar në nivele të larta, në vitin 2015 në masën 45 % të planit fillestar, në vitin 2016 në masën 10 % dhe në vitin 2017 në masën 49 % të planit fillestar. Në mënyrë grafike paraqitet si më poshtë:



Kriteri:

Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 2, datë 06.02.2012 “Mbi procedurat standard të zbatimit të Buxhetit të Shtetit”, pika 79 ku cilësohet: “Numri i rishpërndarjeve të fondeve buxhetore për çdo njësi të qeverisjes qendrore mund të përbëjë **një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit**”.

Ndikimi/efekti:

Siç shihet nga të dhënat e tabelës së mësipërme për vitin 2015 dhe 2017, niveli i ndryshimeve të planit të buxhetit është në masën 45 dhe 49 %.

Ky nivel ka ndikim negativ në realizimin e projekteve të investimeve të planifikuara, pasi rishpërndarja e fondeve në projekte të tjera gjatë vitit, ka ndikim negativ në realizimin e tyre në sasi dhe cilësi, si dhe flet për një performancë të ulët të planifikimit buxhetor, apo të menaxhimit të tij gjatë vitit,

Shkaku:

Ky nivel i lartë i ndryshimit të planit të investimeve ka ardhur si rezultat i një planifikimi jo të saktë të fondeve për investime në nivel projekti, si dhe i mosrealizimit të tyre gjatë vitit sipas parashikimeve, gjë që ka sjellë nevojën e rishpërndarjes së tyre gjatë viteve buxhetore.

Rëndësia shkeljes:

e

E mesme



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

2- Kërkesat për rishpërndarjen e fondeve kanë ardhur nga institucionet përkatëse të varësisë, apo vetë MK për “Planifikim menaxhimin”, si dhe kanë marrë konfirmimin, miratimin e MFE, sipas përcaktimeve të bërë në pikën 73 të udhëzimit ku citohet:

Në njësinë e qeverisjes qendrore, rishpërndarja e fondeve iniciohet nga njësi shpenzuese e vartësisë dhe/ose nga organi qendror i njësisë, ku përfshihen drejtuesit e programeve buxhetore dhe nëpunësit autorizues të gjithë niveleve sipas hierarkisë së brendshme të njësisë qendrore.

Nga auditimi me zgjedhje i disa praktikave të rishpërndarje të fondeve u konstatuan këto mangësi:

- Me shkresën nr. 4255, datë 27.08.2015 të Drejtorisë së Krijimitarisë dhe Edukimit përmes Kulturës është bërë kërkesë për rialokim fondesh. Në këtë kërkesë, drejtuar Ministrisë së Kulturës, thuhet: “Referuar kërkesës së Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor lutemi për rishpërndarje fondesh”, ndërkohë që kërkesa e TKOBAP me nr. 1547 mban datën 31.08.2015, pra 4 ditë më pas kësaj kërkesë, si dhe nuk është paraqitur asnjë analizë apo argument për rishpërndarje fondesh.
- Në kërkesën e TKOBAP, por edhe në kërkesën e Drejtorisë së Krijimitarisë dhe Edukimit përmes Kulturës, nuk është bërë asnjë lloj analize apo argumentimi mbi ri shpërndarjen e këtyre fondeve.
- Me shkresën nr. 4483, datë 09.09.2015 të Drejtorisë së Krijimitarisë dhe Edukimit përmes Kulturës është bërë kërkesë për rialokim fondesh. Në këtë kërkesë, drejtuar Ministrisë së Kulturës, thuhet: “Referuar kërkesës së Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit me nr. 4458, datë 09.09.2015, lutemi për rishpërndarje fondesh”. Në kërkesën e TKOBAP, por edhe në kërkesën e Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit, nuk është bërë asnjë lloj analize apo argumentimi mbi rishpërndarjen e këtyre fondeve.
- Në kërkesën për rishpërndarje fondesh nr. 1821, datë 28.10.2016, drejtuar Ministrisë së Kulturës nga TKOBAP, në nivel artikulli nuk është dhënë asnjë argument mbi domosdoshmërinë e shtimit të fondeve të nga artikulli 600-601 në artikullin 604, në shumën 1,380,000 lekë.
- Në kërkesën e Teatrit Kombëtar nr. 892, datë 28.10.2016, është kërkuar rishpërndarje fondesh (shitesë), për një shfaqje të TK në Prishtinë, ku thuhet se nuk mbulon dot shpenzimet, ndërkohë që i referohet një aktiviteti i cili është i planifikuar në Kalendarin Artistik të përbashkët ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, ç’ ka do të thotë që ky fond duhej të ishte i planifikuar.
- Me shkresën nr. 13971/1, datë 12.10.2017 MFE, ka miratuar rishpërndarje të fondeve sipas tabelës bashkëngjitur, në nivel artikull, sipas kërkesës së MK nr. 6594, datë 09.10.2017. Në përgjigje të kërkesës së MK, drejtuar institucioneve të varësisë si njësi shpenzuese është evidentuar se, planifikimi i buxhetit nuk është në nivelet e duhura dhe i mbështetur realisht në nevojat e tyre.
- Në përgjigjen e TKOBAP, evidentohet se ka mungesë fondesh në artikullin 602, ku fondi në dispozicion nuk është i mjaftueshëm për të likuiduar shpenzimet e detyrueshme të 6-mujorit të dytë dhe detyrime të mbartura nga 6-mujori i parë. Gjithashtu, ka mungesë fondesh në artikullin 604, për realizimin e Kalendarit artistik shtator-dhjetor, kalendar i cili miratohet që me planifikimin e buxhetit;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

- Në përgjigjen e Arkivit Qendror të Shtetit, ku evidentohet se në limitin mujor të akorduar nuk arrijnë të mbulojnë shpenzimet e detyrueshme për energji, ujë, roje private;
- Në përgjigjen e TKE, evidentohet se ka mungesë fondesh për pagesë energjie, shpenzime gjyqësore dhe për realizimin e produksioneve;
- Në përgjigje të TK, evidentohet se ka nevoja të paplotësuara për shpenzime të detyrueshme si energji, karburant për ngrohje, ujë, shpenzime gjyqësore (artikulli 602);
- Në përgjigje të Muzeut Skënderbeut në Krujë, evidentohet se ka nevoja të paplotësuara për shpenzime të detyrueshme si energji, karburant për ngrohje, taksa vendore, paga, etj.

Gjetje nga auditimi:

Situata:	<p>Nga auditimi me zgjedhje i disa praktikave ka rezultuar se kërkesat për rishpërndarje të fondeve buxhetore korente) jo në të gjitha rastet janë shoqëruar me analiza.</p> <p>Gjithashtu kjo mangësi është evidentuar edhe përsa i përket rishpërndarjes së fondeve në nivel projekti ku është konstatuar se: rialokimet e fondeve buxhetore gjatë vitit për një projekt, kanë pësuar ndryshime (shtesa e pakësim), të pa argumentuara, konkretisht: projektit “M120775” në muajin gusht i është shtuar fondi në shumën 54,000,000 lekë dhe pas 1 muaji i është pakësuar fondi në shumën 30,400,000 lekë; projektit M120720 me një diferencë kohore prej 1 muaji (tetor-nëntor) është shtuar dhe pakësuar fondi në shumën 4,300,000 lek; projektit “M120763” me një diferencë kohore prej 1 muaji i është shtuar fondi në shumën 21,100,000 lekë dhe pakësuar fondi në shumën 36,200,000 lekë, etj</p>
Kriteri:	<p>Udhëzimi nr. 2, datë 06.02.2012, pika 74 të udhëzimit ku përcaktohet:</p> <p><i>“Çdo kërkesë për fonde shtesë ose rishpërndarje fondesh shoqërohet me analizë ku identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme, kontributi në arritjen e qëllimit dhe objektivave dhe risqet e lidhura, pakësimet e mundshme dhe pasojat”.</i></p>
Ndikimi/efekti:	<p>Përbën risk për realizimin e veprimtarisë, aktiviteteve të planifikuara, të njëjësive shpenzuese.</p>
Shkaku:	<p>Mos identifikim i drejtë i nevojave, mos përfshirje e tyre në planin vjetor të buxhetit, mos miratim nga MFE i fondeve të kërkuara nga MK sipas kërkesave të paraqitura nga institucionet e varësisë dhe vetë MK.</p>
Rëndësia e shkeljes: Rekomandime:	<p>E mesme</p> <p>Ministria e Kulturës, në cilësinë e njësisë së qeverisjes së përgjithshme, të rrisë kërkesën për llogaridhënie, deri në mosmiratim të kërkesave për rishpërndarje fondesh të njëjësive shpenzuese të varësisë, nëse këto të fundit nuk paraqesin analizë të detajuar, ku të argumentojnë nevojën për shtim fondesh, si dhe arsyet e mos planifikimit në masën e duhur, duke nxjerrë dhe përgjegjësitë, me qëllim minimizimin e numrit të rishpërndarjes të fondeve gjatë vitit buxhetor.</p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

3. Nga MK, është respektuar afati i fundit i kërkesave për transferime buxhetore, data 15 nëntor e çdo viti, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 80 të udhëzimit, ku cilësohet:

E drejta e njësisë së qeverisjes së përgjithshme për rishpërndarjen e fondeve të miratuara për vitin buxhetor, ushtrohet deri në datën 15 nëntor të çdo viti, e cila konsiderohet data e fundit e paraqitjes së kërkesës tek Nëpunësi i Parë Autorizues.

4. Nga MK, janë hartuar, dorëzuar në MF dhe publikuar në faqen zyrtare të MK, informacionet e detajuara mbi performancën buxhetore si dhe Raportet e monitorimit vjetore, të cilët janë të konfirmuar NA, Drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të Programit, sipas kërkesave të pikës 256 dhe 257 të udhëzimit ku cilësohet:

NA e njësisë të qeverisjes qendrore duhet të paraqesin te NPA brenda datës 28 të çdo muaji pasardhës të tremujorit informacion të detajuar mbi performancën e produkteve të buxhetit vjetor. Raporti i monitorimit duhet të paraqitet brenda datës 30 Janar.

5. Gjithashtu, rishpërndarjet e fondeve buxhetore për projektet e investimeve janë miratuara nga Ministri i Financave, sipas përcaktimit të bërë në pikën 76.b ku cilësohet:

b) Rishpërndarjet e fondeve të projekteve të investimeve brenda të njëjtit program të njësisë së qeverisjes qendrore miratohen nga Ministri i Financave pa cenuar burimet e financimit (buxheti, financimi i huaj, të ardhurat dytësore)

Sa më sipër, arrijmë në konkluzion që:

- Detajimi i planit të buxhetit nga Ministria e Kulturës, është bërë në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 “Mbi procedurat e zbatimit të buxhetit” me ndryshime, si dhe udhëzimet plotësuese vjetore;
- Ministria e Kulturës, si institucion qendror ka rakorduar me Ministrinë e Financave planin përfundimtar të buxhetit për tre vitet buxhetore 2015-2016-2017, në nivel grupi, programi, kapitulli dhe artikulli. Rakordimet janë kryer brenda afateve të përcaktuara si dhe është nënshkruar nga përfaqësuesi i Ministrisë së Financave dhe NZ i Ministrisë së Kulturës, në përputhje me Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012. “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, si dhe ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin;
- Në detajimin e fondeve janë respektuar kufijtë buxhetorë dhe limiti mujor i shpenzimeve të përcaktuar nga Ministria e Financave, si dhe afatet e dërgimit të detajimit të fondeve në MF;
- Gjatë viteve buxhetore **kërkesat për rishpërndarje fondesh jo në të gjitha rastet janë shoqëruar me analizë** ku të identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme, risqet e lidhura, pakësimet e mundshme dhe pasojat;
- Gjithashtu, është kryer një numër i lartë rishpërndarje fondesh gjatë vitit ushtrimor, që prekin të gjithë zërat e buxhetit, por që grupi i auditimit mori në analizë transferimet e fondeve për investime, ku u konstatua se rishpërndarja e tyre gjatë vitit ka ndikuar negativisht në realizimin e planit të buxhetit dhe të vetë projekteve.

3.1/c. Zbatimi i limiteve të fondeve buxhetore të miratuara, realizimi sipas klasifikimit ekonomik si dhe kompetenca e përdorimit të tyre.

Realizimi i planit të buxhetit, në nivel Grupi/Ministria në 000/lekë

Emërtimi i	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
------------	-----------	-----------	-----------



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

shpenz.	Pl/P	Fakt	R/%	Pl/P	Fakt	R/%	Pl/P	Fakt	R/%
(600)	723,573	717,173	99	729,151	726,000	99	767,197	759,343	99
(601)	121,701	119,283	98	120,987	119,651	99	127,007	125,152	99
(602)	253,945	238,909	94	229,283	226,168	99	253,749	250,178	99
(604)	258,744	242,971	94	213,003	208,010	97	224,659	217,109	97
(605)	15,288	15,013	98	7,748	7,068	91	2,602	2,412	93
(606)	4,777	3,895	82	3,364	2,496	74	2,014	2,004	100
T/Korente	1,378,028	1,337,244	97	1,303,536	1,289,393	98	1,377,227	1,356,198	98
T/Investime	320,287	266,343	83	431,153	409,793	95	579,266	545,688	94
Total njësie	1,698,315	1,603,587	94	1,734,689	1,699,186	98	1,956,493	1,901,886	97

Burimi i informacionit: MK

Punoi: KLSH

Realizimi i planit të buxhetit, në nivel Aparati në 000/lekë

Emërtimi i shpenzimeve	Viti 2015			Viti 2016			Viti 2017		
	Pl/P	Fakt	F/P në %	Pl/P	Fakt	F/P në %	Pl/P	Fakt	F/P në %
(600)	66,239	64,999	98	70,039	68,622	98	76,676	73,907	96
(601)	10,827	10,317	95	10,627	10,627	100	12,100	11,583	96
(602)	64,045	54,981	86	38,904	38,744	99	67,520	66,894	99
(604)	162,260	150,774	93	144,723	142,050	98	155,450	149,554	96
(605)	14,352	14,150	98	6,038	5,845	97	1,666	1,666	100
(606)	2,270	1,553	68	420	400	95	1,146	1,136	99
T/Korente	319,993	296,774	93	270,751	266,288	98	314,558	304,740	97
T/Investime	142,357	121,620	85	325,955	304,622	93	577,014	539,128	94
Total Aparati	462,350	418,394	90	596,706	570,910	96	891,572	843,868	95

Burimi i informacionit: MK

Punoi: KLSH

- Midis Ministrisë së Kulturës dhe MF-së është mbajtur Aktrakordimi mujor/progresiv për realizimin e shpenzimeve, si dhe Aktrakordimi vjetor për periudhën Janar-dhjetor 2015, 2016 dhe 2017. Aktrakordimi është firmosur nga Sekretari i Përgjithshëm, në cilësinë e NA, Drejtori i Financës në cilësinë e NZ, shefi i Zyrës së Financës, si dhe përfaqësuesi i MF, Specialisti i thesarit, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 2 datë 06. 02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, “Rakordimi mujor i shpenzimeve” pika 172 ku cilësohet:

“Nëpunësi zbatues rakordon me strukturën përgjegjëse për thesarin deri në datën 5 të çdo muaji, mbi shpenzimet mujore/progresive që ka kryer njësia e qeverisjes së përgjithshme”.

- Nga auditimi me zgjedhje, për 3 vitet objekt auditimi, nga MK, janë zbatuar kërkesat për zbatimin e buxhetit të shtetit edhe në aspektin e zbatimit të ligjit për “Menaxhimin Financiar dhe kontrollin”, përsa i përket kompetencës së përdorimit të tyre.
- Për vitin 2015, rezulton se realizimi i planit të buxhetit në total është në masën 90 %. Në këtë mosrealizim, ndikim ka patur mosrealizimi i investimeve me 15 % dhe i shpenzimeve operative në masën 86 %.
- Për vitin 2016, rezulton se realizimi i planit të buxhetit në total është në masën 96 %, por edhe sipas zërave të shpenzimeve është realizuar në nivele optimale, ku shpenzimet për investime janë realizuar në masën 93%.
- Për vitin 2017, plani i buxhetit është realizuar në masën 95 %, por edhe sipas zërave të shpenzimeve është realizuar në nivele optimal, ku shpenzimet për investime janë realizuar në masën 94%.




KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Gjetje nga auditimi:

Situata:

Nga auditimi është evidentuar fenomeni i përqëndrimit të likuidimit të shpenzimeve në fund të vitit buxhetor, ku në vitin 2015 likuidimet në fundviti zënë 34.5 % të shpenzimeve vjetore, në vitin 2016 zënë 39.3 % të shpenzimeve vjetore dhe në vitin 2017 zënë 40 % të shpenzimeve vjetore. Ky trend, i cili shoqërohet me ndryshim të herëpashershëm të planit të arkës, në mënyrë grafike paraqitet më poshtë:



Kriteri:

Udhëzimi nr. 2, datë 06.02.2012, Kapitulli III “Procedurat për kryerjen e shpenzimeve publike”, “Parashikimi i pagesave dhe arkëtimeve-Plani i arkës”, pika 137 ku cilësohet: *“Plani i arkës është i rishikueshëm gjatë vitit buxhetor. Numri i rishikimeve të planit të arkës për çdo njësi të qeverisjes së përgjithshme është një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit”.*

Ndikimi/efekti:

Përqëndrimi i likuidimit të shpenzimeve në periudha të caktuara të vitit buxhetor, sidomos në muajin dhjetor, shkakton vështirësi në nivelin e likuiditetit të buxhetit të shtetit.

Shkaku:

Zvarritje e procedurave të prokurimit, të realizimit të investimeve publike në kohë, likuidimi i tyre brenda vitit ushtrimor për shkak të mos transferimit të tyre në vitin buxhetor pasardhës.

Rëndësia e shkeljes:

Rekomandime:

E mesme

Ministria e Kulturës, si njësi e qeverisjes së përgjithshme të marrë masa për realizimin e procedurave të investimeve, për realizimin faktik të kontratave të punimeve, shërbimeve apo mallrave, si dhe për likuidimin e tyre në mënyrë periodike, brenda limitit mujor të arkës, si nga ana e saj edhe e njësisve shpenzuese që ka në varësi, me qëllim realizimin dhe likuidimin e tyre në kohë, minimizimin e ndryshimit të limitit të arkës gjatë vitit buxhetor, me qëllim rritjen e performancës buxhetore të saj.

Sa më sipër arrijmë në konkluzionin që: MK, ka vepruar në përputhje me kriteret e paracaktuara, në lidhje me zbatimin e buxhetit për vitet 2015, 2016 dhe 2017, me përjashtim përqëndrimin e likuidimit të shpenzimeve në fund të periudhës buxhetore, shoqëruar kjo me ndryshim të planit mujor të arkës gjatë gjithë vitit.

3.1/d Zbatimi i buxhetit me destinacion fondet e investimeve.

Zbatimi i planit të investimeve në vitin 2015, ka rezultuar në masën 83 %, ku programi “Arti & Kultura” paraqitet me nivel më të ulët realizimi, në masën 76 %.

Në nivelin e mosrealizimeve ka ndikuar projekti “Kaldajat me peleta” fondi i alokuar gjatë vitit buxhetor dhe që është realizuar në masën 0 %, me një diferencë në shumën 11,773,944



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

lekë dhe projekti për “Muzeun mesjetar” në Korçë fondi i alokuar gjatë vitit buxhetor dhe që është realizuar në masën 70 %, me një diferencë në shumën 10,696,803 lekë.

Në programin “Trashëgimia kulturore” me nivel të ulët realizimi paraqitet projekti “IMK Durrës” me 77 %, ose me një diferencë në shumën 20,454,823 lekë. Edhe për këtë projekt ka patur shtesë fondesh gjatë vitit ushtrimor në masën 21,017,469 lekë. Po kështu projekti “Dixhitalizimi i QKIPK”, është realizuar në masën 74 %, ose me një diferencë në shumën 3,051,000 lekë. Ky projekt është financuar gjatë vitit buxhetor me rishpërndarje fondesh (shtesë) në masën 11,685,000 lekë.

Gjatë këtij viti, janë rialokuar fonde nga buxheti i shtetit për 15 projekte, të cilat nuk kanë qenë pjesë e projektbuxhetit dhe buxhetit fillestar të MK-së. (Të dhënat në tabelën nr. 8/1)

Planifikimi dhe realizimi i planit të investimeve për vitin 2015, në lekë

Emërtimi	P/Fillestar	Ndryshime	P/Përfundimtar	Fakti	Diferenca	R/ në %
Planifikim/Menaxhimi	35,000,000	1,990,327	36,990,327	32,647,566	-4,342,761	88
Trashëgimia Kulturore	100,000,000	80,894,603	180,894,603	155,538,285	-25,360,318	86
Arti & Kulture	85,000,000	17,401,772	102,401,772	78,156,913	-24,244,859	76
Total/Ministria	220,000,000	100,286,702	320,286,702	266,342,764	53,943,948	83

Burimi i informacionit: MK

Punoi: KLSH

Planifikimi dhe realizimi i planit të investimeve në nivel projekti, në lekë

Nr	Emertimi	P/Fillestar	Ndryshime	P/Përfundimtar	Fakti	Diferenca	R/ %
I	Planifikim/Menaxhimi	35,000,000	1,990,327	36,990,327	32,647,566	4,342,761	88
II	Trashëgimia Kulturore	100,000,000	80,894,603	180,894,603	155,538,285	25,360,318	86
1	IMK Korçe	4,700,000	-	4,700,000	4,214,127	485,873	89
2	IMK Durrës	70,100,000	21,017,469	91,117,469	70,662,646	20,454,823	77
3	IMK Vlore	4,000,000	-	4,000,000	3,898,466	101,534	97
4	Muzeu Hist. Komb.	0	2,800,000	2,800,000	2,772,000	28,000	99
5	TVSH	10,000,000	-8,576,719	1,423,281	301,996	1,121,285	21
6	Bashkëfinancim	11,200,000	-11,200,000	0	0	-	-
7	Qendër Muze Berat	0	1,000,000	1,000,000	986,446	13,554	98
8	Restaurim Kisha Karavasta	0	15,049,000	15,049,000	15,000,000	49,000	100
9	Varrezat Rremaj	0	7,518,000	7,518,000	7,503,000	15,000	100
10	Dixhitalizimi QKIPK	0	11,685,000	11,685,000	8,634,000	3,051,000	74
11	Blerje Kamionçina	0	16,000,000	16,000,000	15,960,000	40,000	100
12	Rikonstrukcion Nënçatia GK	0	25,606,000	25,606,000	25,606,000	0	100
III	Arti & Kulture	85,000,000	17,401,772	102,401,772	78,156,913	24,244,859	67
1	Monumenti i Lushnjës	2,059,000	0	2,059,000	2,059,000	0	100
1	Teatri Kombetar	0	1,920,000	1,920,000	1,919,854	146	99
2	TKOB-ansambli	0	371,677	371,677	371,677	-	100
3	Galeri Komb. Arteve	5,713,000	(4,809,000)	904,000	903,079	921	99
4	Qendr.real.Veprave te Artit	2,000,000	-	2,000,000	1,997,446	2,554	99
5	Teatri Eksperimental	4,000,000	(1,000,000)	3,000,000	2,999,370	630	99
6	Skena e Re faza I	14,252,000	0	14,252,000	13,918,942	343,058	98
7	Kaldajat me peleta	0	11,773,944	11,773,944	0	11,773,944	0
8	FZHR	56,976,000	-56,976,000	0	0	-	-
9	Komuna Markat (vare.z.came)	0	10,000,000	10,000,000	9,297,418	702,582	93
10	Komuna Markat (pall.kult.)	0	936,151	936,151	936,151	0	100
11	Bashkia Shkoder	0	12,000,000	12,000,000	11,279,807	720,193	94
12	Bashk.Korce (Teatri)	0	7,000,000	7,000,000	7,000,000	0	100
13	Bashk. Korçe (Muzeu Mesjet)	0	36,181,000	36,181,000	25,484,197	10,696,803	70
I+II+III	Total/Ministria	220,000,000	100,286,702	320,286,702	266,342,764	53,943,948	83

Burimi i informacionit: MK

Punoi: KLSH



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Zbatimi i planit të investimeve në vitin 2016, ka rezultuar në masën 95 %. Gjatë këtij viti niveli i realizimit të investimeve ka rezultuar në nivele optimale. Me nivel të ulët realizimi paraqitet programi “Planifikim/Menaxhimi”, në masën 58 %, ose me një mosrealizim në shumën 4,191,407 lekë. Gjatë këtij viti, janë rialokuar fonde nga buxheti i shtetit për 15 projekte, të cilat nuk kanë qenë pjesë e projektbuxhetit dhe buxhetit fillestar të MK-së. Në programin “Trashëgimia kulturore”, rezultojnë 3 projekte të cilat rezultojnë në nivele realizimi nga 74, 77 dhe 86 %, të cilët përfaqësojnë projekte të filluara dhe buxhetuara gjatë vitit buxhetor. (Të dhënat në tabelën nr.9/1)

Planifikimi dhe realizimi i planit të investimeve për vitin 2016, në lekë

Emertimi	P/Fillestar	Ndryshime	P/Përfundimtar	Fakti	Diferenca	R/në %
Planifikim/Menaxhimi	10,000,000	-	10,000,000	5,808,593	4,191,407	58
Trashëgimia Kulturore	121,200,000	32,380,038	153,580,038	140,035,543	13,544,495	91
Art & Kultura	260,910,000	6,663,000	267,573,000	263,948,414	3,624,586	99
Totali	392,110,000	39,043,038	431,153,038	409,792,550	21,360,488	95

Burimi i informacionit: MK

Punoi: KLSH

Tabela 9/1-Planifikimi dhe realizimi i planit të investimeve në nivel projekti, në lekë

Nr	Emërtimi	P/Fillestar	Ndryshime	P/Përfundimtar	Fakti	Diferenca	R/ %
I	Planifikim/Menaxhimi	10,000,000	0	10,000,000	5,808,593	4,191,407	58
1	Mobilim	949,000	0	949,000	949,000	0	100
2	Sistemi Kamerave	2,765,000	0	2,765,000	2,765,000	0	100
3	Blerje Aparate TV	948,000	0	948,000	948,000	0	100
4	Aredim salleTeftaTashko	840,000	0	840,000	756,000	84,000	90
5	Te tjera	4,498,000	0	4,498,000	390,593	4,107,407	9
II	TrashëgimiaKulturore	121,200,000	32,380,038	153,580,038	140,035,543	13,544,495	91
1	Restaurim KishaKaravasta	1,000,000	-142,023	857,977	857,921	56	100
2	Rikonst. God. Kinost. Nençatia	32,030,000	-2,960,668	29,069,332	29,069,332	0	100
3	Dixhitalizimi QKIPK	0	35,579,038	35,579,038	27,512,763	8,066,275	77
4	ShtepiaFlamuritKorce	0	25,275,189	25,275,189	21,744,382	3,530,807	86
5	Pastrim disifektim ikonave Korce	0	48,480,335	48,480,335	47,605,324	875,011	98
6	Gjon Mili	0	4,000,000	4,000,000	2,949,840	1,050,160	74
7	Muzeu Gjethi, Projekti Mekanik DR	33,370,000	-33,355,600	14,400	14,400	0	100
8	Muzealizim I Gjethit	33,600,000	-33,600,000	-	-	-	-
9	TVSh Apollonia	10,000,000	-3,414,526	6,585,474	6,585,474	0	100
10	Bashkefinancim	11,200,000	-11,200,000	-	-	-	-
11	TVSH Artvizion	0	277,692	277,692	277,200	492	100
12	TVSH Adrifort	0	1,006,834	1,006,834	1,004,660	2,174	100
13	BlerjePajisjeBerat	0	200,000	200,000	182,400	17,600	91
14	Gjethi Projekti Elektrik	0	2,113,767	2,113,767	2,113,767	0	100
15	BlerjePajisje Dures	0	120,000	120,000	118,080	1,920	98
III	Arti&Kulture	260,910,000	6,663,000	267,573,000	263,948,414	3,624,586	99
1	Skena Re	108,568,555	-23,850,000	84,718,555	84,718,554	1	100
2	QendraFemijeve	57,354,115	-4,150,000	53,204,115	53,079,229	124,886	100
3	Blerje Pajisje QendraFemijeve	0	11,900,000	11,900,000	11,848,272	51,728	100
4	Albafilm	0	15,000,000	15,000,000	11,560,622	3,439,378	77
5	TKE Blerje Pajisje	0	5,700,000	5,700,000	5,698,520	1,480	100
6	TKE Rikonstruksion	0	2,400,000	2,400,000	2,400,000	0	100
7	FZHR	92,987,330	-92,987,330	-	-	-	-
8	TK rikonstruksion	2,000,000	-337,000	1,663,000	1,655,748	7,252	100
9	Teatri Korce	0	52,987,330	52,987,330	52,987,330	0	100
10	Teatri Shkoder	0	40,000,000	40,000,000	40,000,000	0	100
I+II+III	Total/Ministria	392,110,000	39,043,038	431,153,038	409,792,550	21,360,488	95

Burimi i informacionit: MK

Punoi: KLSH



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Zbatimi i planit të investimeve në vitin 2017, ka rezultuar në masën 94 %. Gjatë këtij viti niveli i realizimit të investimeve ka rezultuar në nivele optimale. Janë rialokuar fonde nga buxheti i shtetit për 8 projekte, të cilat nuk kanë qenë pjesë e projektbuxhetit dhe buxhetit fillestar të MK-së. Mosrealizimi i planit përfundimtar të buxhetit, është kryesisht rezultat i mosrealizimit të investimeve për këto projekte, ku buxhetimi i tyre është bërë gjatë vitit nëpërmjet rishpërndarjes së fondeve, apo me aktet normative. *(Të dhënat në tabelën nr. 10/1)*

Planifikimi dhe realizimi i planit të investimeve për vitin 2017, në lekë

Emertimi	P/Fillestar	Ndryshime	P/Përfundimtar	Fakti	Diferenca	R/në %
Planifikim/Menaxhimi	2,000,000	(500,000)	1,500,000	1,492,400	7,600	99
TrashëgimiaKulturore	51,200,000	13,166,275	64,366,275	59,592,881	6,593,424	96
Art & Kultura	335,800,000	177,599,991	513,399,991	484,602,329	28,797,692	94
Totali	389,000,000	190,266,266	579,266,266	545,687,610	33,578,656	94

Burimi i informacionit: MK

Punoi: KLSH

Planifikimi dhe realizimi i planit të investimeve në nivel projekti, në lekë

Nr	Emertimi	P/Fillestar	Ndryshime	P/Përfundimtar	Fakti	Diferenca	R/ %
I	Planifikim/Menaxhimi	2,000,000	(500,000)	1,500,000	1,492,400	7,600	99
1	Blerje Pajisje Kompjuterike	500,000	-500,000	0	0	0	-
2	BlerjePajisje	1,500,000	0	1,500,000	1,492,400	7,600	99
II	Trashëgimia Kulturore	51,200,000	13,166,275	64,366,275	59,592,881	4,773,394	96
1	TVSH	11,200,000	-3,391,000	7,809,000	7,809,000	0	100
2	Muzealizim i Gjethit	40,000,000	5,100,000	45,100,000	45,100,000	0	100
3	Dixhitalizimi QKIPK	0	8,066,275	8,066,275	3,622,329	4,443,946	45
4	Shtëpia e Flamurit	0	3,391,000	3,391,000	3,061,552	329,448	90
III	Arti&Kulture	335,800,000	177,599,991	513,399,991	484,602,329	28,797,692	94
1	Rikonstrukcion TKOB	0	128,856,083	128,856,083	103,319,929	25,536,154	80
2	Skena e Re	322,835,000	-154,878,242	167,956,758	167,883,535	73,223	100
3	FZHR	12,965,000	-12,965,000	0	0	0	-
4	Teatri Migjeni Shkoder	0	3,544,760	3,544,760	3,544,760	0	100
5	Vetingu	0	206,190,000	206,190,000	203,419,151	2,770,849	99
6	BK	0	2,252,390	2,252,390	1,878,800	373,590	83
7	Albafilm	0	4,100,000	4,100,000	4,064,154	35,846	99
8	Blerje Pajisje	0	500,000	500,000	492,000	8,000	98
I+II+III	Total/Ministria	389,000,000	192,266,266	579,266,266	545,687,610	33,578,656	94

Burimi i informacionit: MK

Punoi: KLSH

Sa më sipër, arrijmë në konkluzionin që: Mosrealizimi i shpenzimeve për investime në nivel projekti gjatë vitit 2015, 2016 dhe 2017, ka patur si shkak kryesor fillimin e projekteve të investimeve gjatë vitit buxhetor, gjë e cila shkakton mos realizimin e tyre në kohën e duhur, si për shkak të procedurave të prokurimit, po ashtu edhe për shkak se realizimi i tyre kërkon kohën e duhur.

Për mangësitë e trajtuara më sipër mbajnë përgjegjësi, Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” me ndryshime, neni 9 dhe neni 12, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të buxhetit” Kapitulli II.2 “Buxheti i shtetit”, Rishpërndarja e fondeve buxhetore, pika 75.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Në përfundim mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 400⁴, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, bazuar në (ISSAI 4100⁵) japim opinion të pakualifikuar me theksim çështje, si më poshtë:

Opinion:

3.1/a. Çështja e audituar, mbi planifikimin dhe detajimin e fondeve, është në përputhje me kriteret e paracaktuara (kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi) në të gjitha aspektet materiale, si dhe informacioni i paraqitur është i vërtetë dhe i drejtë.

3.1/b. Çështja e audituar, mbi rishpërndarjen e fondeve buxhetore, në përgjithësi është në përputhje me kriteret e paracaktuara (kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi) në të gjitha aspektet materiale, si dhe informacioni i paraqitur është i vërtetë dhe i drejtë, **përveç sa më poshtë:**

- Kërkesat për rishpërndarje fondesh, jo në të gjitha rastet janë shoqëruar me analizë, ku të identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme, risqet e lidhura, pakësimet e mundshme dhe pasojat, në përputhje me kriteret e paracaktuara në udhëzimin e MF nr. 2, datë 06.02.2012 me ndryshime;

- Është kryer një numër i lartë rishpërndarje fondesh gjatë vitit ushtrimor, që prekin të gjithë zërat e buxhetit, por që grupi i auditimit mori në analizë transferimet e fondeve për investime, ku u konstatua se rishpërndarja e tyre gjatë vitit ka ndikuar negativisht në realizimin e planit të buxhetit dhe të vetë projekteve. Kjo tregon gjithashtu, për një performancë jo të mirë të planifikimit të buxhetit, referuar kriterëve të përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012.

3.1/c. Çështja e audituar, mbi zbatimin e planit të buxhetit, është në përputhje me kriteret e paracaktuara (kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi) në të gjitha aspektet material, si dhe informacioni i paraqitur është i vërtetë dhe i drejtë **përveç sa më poshtë:**

- Nga auditimi është evidentuar fenomeni i përqendrimit të likuidimit të shpenzimeve në fund të vitit buxhetor, gjë e cila shoqërohet me ndryshim të herëpashershëm të planit të arkës, që është një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit”.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraportit të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 3, datë 26.02.2018, protokolluar në Ministrinë e Kulturës me nr.1365, datë 28.02.2018, mbi të cilin janë paraqitur observacionet nga z. Shpëtim Shehu dhe Marjana Braholli.

Pretendimi i subjektit:

“Numri i lartë i rialokimeve, rishpërndarja e fondeve gjatë gjithë vitit ushtrimor vjen si rezultat i shumë arsyeve të ndryshme, kryesisht pamjaftueshmërisë së fondeve në institucionet e varësisë për shpenzimet korrente, përmendim këtu rritjen e pagës së rojeve nga 22,000 lekë në 36,000 lekë. Në përgjithësi rialokimet, transferimet e fondeve janë bërë për arsye dhe nevoja të ndryshme, ku çdo institucion ka paraqitur kërkesën me motivacionin përkatës pranë drejtorisë sonë. Për sa i përket rialokimeve për shpenzimet kapitale në të shumtën e rasteve këto transferime janë bërë duke marrë shkas nga kërkesat e Këshillit të Ministrave për investime jashtë parashikimeve të buxhetit vjetor siç ishte rasti për vitin 2017 për për ish

⁴ ISSAI 400: Parimet themelore të përputhshmërisë

⁵ ISSAI 4100 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

godinën e Lidhjes së Shkrimtareve me qëllim akomodimin dhe funksionimin e organeve të Vettingu-ut”.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:

- Në lidhje me argumentimin e kërkesave për rialokim fondesh, nuk janë paraqitur fakte dhe argumente shtesë, pas ballafaqimit dhe diskutimit të problematikave në fazën e auditimit në terren.

-Në lidhje me numrin e lartë të rishpërndarjes së fondeve, pjesërisht jemi dakord me faktin se edhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka rol të rëndësishëm në buxhetimin e institucioneve, por planifikimi i buxhetit kalon në disa faza, ku Ministria e Kulturës është përgjegjëse për argumentimin e kërkesave dhe sigurimin e mbështetjes buxhetore në nivel grupi.

Për arsyet e mësipërme observacioni nuk merret në konsideratë.

4. Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit dhe Auditimit të Brendshëm.

Auditimi i kësaj pike të programit iu referua Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të lartë të shtetit”; Ligjit nr. 114/2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe VKM nr. 212, datë 30.03.2012, “Për miratimin e kritereve për ngritjen e Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik.”, Manualit të Auditimit të Brendshëm të botuar nga Njësia e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik; Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2012, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, INTOSAI GOV 9100 “Udhëzime për Standartet e Kontrollit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

Nga auditimi rezultoi:

Për vitin 2015, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka funksionuar sipas strukturës së miratuar nga Kryeministri me Urdhërin Nr.185, datë 18.10.2013 “Për miratimin e strukturës dhe organikës në Ministrinë e Kulturës”. Numri total i punonjësve 5 (pesë), një drejtues dhe katër specialist.

Për vitin 2016, DAB ka funksionuar sipas strukturës së miratuar me Urdhërin e Kryeministrit Nr. 66, datë 07.04.2016” Për miratimin e strukturës dhe të organikës së MK” i ndryshuar me Urdhërin Nr. 179, datë 28.12.2016, përbërja prej 5 punonjësish, 1 drejtor dhe 4 specialist. Organika e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2016 ka rezultuar e paplotësuar në 1 pozicion specialisti.

Për vitin 2017, Me Urdhërin e Kryeministrit Nr. 164, datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së MK” njësia e Auditimit të Brendshëm është organizuar në sektor dhe përbëhet prej 3 punonjësish, 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialist.

-Aktualisht ky sektor funksionon vetëm me dy specialist, ndërsa pozicioni i përgjegjës të sektorit është vakant. Struktura e pa plotësuar dhe mungesa e përgjegjës të sektorit shmang filtrin e kontrollit të cilësisë për vlerësimin dhe rishikimin e raporteve të auditimit.

Ndryshimi i strukturës nga Drejtori në Sektor, nuk ka asnjë argument apo analizë kosto/benefit nga drejtuesit e MK.

Duhet të ndërmerren masa të menjëhershme për plotësimin e strukturës me qëllim përmbushjen e kërkesave ligjore. Sipas Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2012, “Për Menaxhimin



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Financiar dhe Kontrollin”. Kreu II, Neni 8, Përgjegjshmëria Menaxheriale, pika 8, gërma “dh”, *përcakton se është përgjegjësi e titullarit të njësisë publike rregullimi dhe funksionimi i auditimit të brendshëm dhe garantimi i pavarësisë funksionale të tij.*

-Nga shqyrtimi me përzgjedhje rastësore i dosjeve të auditimit, konstatuam se grupet e auditimit janë përbërë nga një specialist i AB dhe një specialist pjesë e strukturës së MK. Kjo formulë u justifikua me përmbajtjen e Pikës 3.1.5 të Manualit të Auditimit për ‘Përlllogaritjen e burimeve të auditimit’, por *theksojmë se përfshirja e specialistëve të fushës në grupet e auditimit është praktikë e aplikueshme në raste specifike dhe jo standard i angazhimeve në auditim.*

-Për vitet 2015, 2016 dhe 2017, njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ka ndërmarrë asnjë angazhim auditimi në aparatën e Ministrisë së Kulturës, edhe pse në Planin Strategjik 2015-2019 dhe në planet vjetore respektive MK është vlerësuar me “Risk të Lartë”, dhe sipas përcaktimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Faza3, pika 3.1.3, Strategjia e Auditimit (frekuenca e kryerje së auditimeve), sistemet e vlerësuara me risk të lartë duhet të auditohen një herë në vit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për t’i dhënë titullarit sigurinë e arsyeshme mbi aktivitetin ekonomik-financiar, qeverisjen e institucionit dhe përmbushjen e objektivave për aparatën e MK.

Burimet njerëzore të AB janë të pamjaftueshme për të mbuluar nevojat për auditim të MK.

Për periudhën e audituar angazhimet janë kryer mbështetur në programet vjetore konform ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe manualit të procedurave audituese, në mbështetje të strategjisë dhe misionit të MK, duke përcaktuar zonat me risk të lartë dhe prioritetet e auditimit.

Për vitin 2015, me shkresën Nr. 203 prot., datë 15.01.2016, Ministria e Kulturës ka dërguar pranë Njësisë së Harmonizimit për Auditim të Brendshëm në Ministrinë e Financave raportin vjetor të veprimtarisë së njësisë së AB për vitin 2015; në këtë vit ishin parashikuar të kryheshin 27 auditime dhe në mbyllje të vitit arritën të realizoheshin 29 auditime; 14 të plota dhe 15 të pjesshme.

Për vitin 2016, me shkresën Nr. 812 prot., datë 14.02.2017, Ministria e Kulturës ka dërguar pranë Njësisë së Harmonizimit për Auditim të Brendshëm në Ministrinë e Financave raportin vjetor të veprimtarisë së njësisë së AB për vitin 2016; për këtë vit ishin parashikuar 34 auditime të cilat janë realizuar në masën 100%.

Për vitin 2017, kryerja e angazhimeve të auditimit të brendshëm është bërë në zbatim të programit vjetor miratuar nga titullari i MK me Nr. 5063/1, datë 14.10.2016 “Plani vjetor dhe strategjik 2017-2020”, ku ishin planifikuar 14 misione të realizuara 100%.

Në asnjë rast njësia e auditimit nuk ka ndërmarrë iniciativën për kryerjen e auditimeve të performancës, por profilizimi i vetëm i auditimeve është “të plotë” ose “të pjesshëm”. Auditimi i performancës në dryshim nga auditimi financiar dhe i përputhshmërisë, ka një qasje drejt shërbimeve duke mbajtur parasysh Ekonominë, Eficiencën dhe Efektivitetin. Përpos këtij fakti, është me rëndësi që për fusha me risk të lartë ku vlerat financiare të investuara janë me peshë të konsiderueshme për buxhetin e institucionit, kryerja e një auditimi performance nuk duhet të shmang auditimin financiar apo të përputhshmërisë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Me zgjedhje rastësore u përzgjedhën për vlerësim 15 dosje auditimi të evaduara.

Nga auditimi i dosjeve konstatuam se:

Dokumentacioni i auditimit është plotësuar konform dispozitave ligjore; para fillimit të auditimit janë plotësuar deklaratat për konflikt interesi të audituesit me subjektin e kontrollit. Në përfundim të kontrollit janë mbajtur procesverbale apo aktverifikime dhe më pas është hartuar Projekt Raporti i auditimit, i cili është lënë në dispozicion të subjektit të kontrollit sipas afateve të përcaktuara në ligjin për auditimin në sektorin publik.

Janë shqyrtuar me korrektësi sqarimet apo observacionet e subjektit të kontrolluar. Mbi bazën e këtyre ndryshimeve është hartuar Raporti Final dhe memorandumimi për titullarin e institucionit. Në përfundim të shqyrtimit janë hartuar konkluzionet përfundimtare dhe është dërguar Raporti Final subjektit të audituar së bashku me rekomandimet përkatëse.

Raporti final është hartuar konform ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, VKM nr. 345, datë 01.6.2004 “Për miratimin e manualit të procedurave të auditimit të brendshëm”.

Sa më sipër arrihet në konkluzion se:

Mungesa e burimeve njerëzore në njësinë e Auditimit të Brendshëm ndikon negativisht në shqyrtimin e efektivitetit të proceseve dhe dhënien e rekomandimeve në funksion të suportit në vendimarrje dhe mirëqeverisje të institucionit. Funksionimi i kësaj njësie në kapacitet të plotë dhe në parametrat e përcaktuara në ligj, ka një ndikim pozitiv në rritjen e përgjegjshmërisë menaxheriale dhe proceseve operacionale në Ministrinë e Kulturës dhe institucioneve në varësi të saj. Organizimi si njësi sektor dhe numri i limituar i audituesëve nuk arrin të mbulojë volumin e auditimeve të miratuara në planet vjetore dhe funksionimin në efikasitet të plotë të njësisë.

5. Të tjera të dala gjatë auditimit.

Gjatë vitit 2016 – 2017 Ministria e Kulturës dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri” kanë shqyrtuar/miratuar projektzbatimin “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Multifunkionale të Shërbimeve në Qytetin Antik të Butrintit”, mbështetur në kërkesën e subjektit “H” shpk me objekt marrjen me qira të një objekt ndërtimi (e cila nuk është monument kulture), pranë Qytetit Antik të Butrintit me qëllim vënien e saj në shfrytëzim për aktivitet tregtar bar - kafe- restorant. Vendndodhja e këtij objekti është në Parkun Kombëtar të Butrintit (PKB) me sipërfaqe 9,424,4 ha, në nënzonën “A” me sipërfaqe 3,838, 75 ha, në të cilën zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes.

Sipas “Relacion dhe specifikime teknike” të vitit 2017 (punuar nga ing. A D me detyrë Drejtor dhe D Sh me profesion inxhinier ndërtimi e N G me profesion arkitekt) ... *kjo godinë një kat e degraduar totalisht ... është ndërtuar në vitin 1975... ka shërbyer për vendstrehimi për rojet... ... së fundmi për disa vite me radhë ... është përdorur për magazinë ... depo dhe nuk është mirëmbajtur prej vitesh...Në vitin 2008 është hartuar projekti “Ambiente shlodhëse në Butrint Sarandë” i miratuar me vendim të KKR nr. 8, datë 8.4.2008.*

5.1. Parregullsi e konstatuar:

Në përgjithësi arsyetimi për miratimin e projektzbatimit “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Multifunkionale të Shërbimeve në Qytetin Antik të Butrintit”, bie ndesh me:

Ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”:

- nenin 30 në të cilin ndër të tjera është përcaktuar se ... *Zonat arkeologjike, në varësi të intensitetit dhe rëndësisë së gjetjeve arkeologjike, kategorizohen në zona “A” dhe zona “B”. Zonifikimi miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të ministrit*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Në zonat arkeologjike “A” është e ndaluar çdo lloj ndërhyrjeje me karakter ndërtimor.

- nenin 38 në të cilin është përcaktuar se ... Çdo vendim i marre nga këshillat e rregullimit të territoreve për ndërhyrje ose ndërtim në zonat e shpallura monument kulture ose në zonën e mbrojtur pranë një monumenti kulture, pavarësisht nga pronësia, është i pavlefshëm.

- VKM nr. 693, datë 10.11.2005 “Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit “Park Kombëtar” i ndryshuar me VKM nr. 134, datë 20.12.2013, në të cilin ndër të tjera është përcaktuar se ... Nënzona qendrore e shënuar në hartë me shkronjën “A” me sipërfaqe prej 3,980 ha, që përcaktohen si nënzona me vlera të mëdha për natyrën dhe biodiversitetin. Në këtë zonë zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes ... etj.

- Kombinimin e përcaktimeve të bëra midis nenit 4, pika 1, shkronja “b”, neni 5, 6 ... të ligjit 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar, VKM nr. 693, datë 10.11.2005 “Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit “Park Kombëtar” ndryshuar me VKM nr. 134, datë 20.12.2013 sipas të cilit ... në PKB nënzona qendrore (në të cilin ndodhet dhe objekti) zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes ... janë të ndaluara ndërtime të çdo lloji ... etj.

Referuar Ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, ndërtimi “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Multifunkionale të Shërbimeve në Qytetin Antik të Butrintit”, nuk përbën trashëgimi kulturore etj, në kuptim të Ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, për rrjedhojë, Ministria e Kulturës (më parë IMT dhe KKR), duhet ta refuzonin kërkesën e subjektit “H” sh.p.k.

MK në arsyetimet e saj, e ka konsideruar dhe e ka trajtuar objektin “depo/magazinë” si monument kulture dhe mbi këtë bazë ka miratuar kërkesën e subjektit “H” sh.p.k. duke lidhur një kontratë enfiteoze nr 360, datë 2.6.2017 me objekt “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Multifunkionale të Shërbimeve në Parkun Kombëtar të Butrintit”. Për MK kontratën e ka firmosur zj. Elira Kokona me detyrë Sekretare e Përgjithshme.

Në nenin 1 “Baza ligjore” është përcaktuar se ... kjo kontratë bazohet në ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Kulturës nr. 5110 datë 13.10.2015 “Për dhënien me qira dhe mënyrën e administrimit të monumenteve të kulturës me qëllim rijetëzim”, i ndryshuar.

Në nenin 2 “Objekti i Kontratës” është përcaktuar se ... Objekti i kësaj kontrate është ... me qëllim dhënien me enfiteozë të një ambienti me sipërfaqe rreth 100 m² për përdorimin e tij si Qendër Multifunkionale Shërbimesh në Parkun Arkeologjik të Butrintit.

Në nenin 4 “Afati” është përcaktuar se ... Afati i kësaj kontrate është 5 vjet me të drejtë rinovimi ...

Në nenin 6 “Çmimi” është përcaktuar se ...Çmimi i kësaj kontrate, që Enfiteozëmarrësi detyrohet t’i paguajë Enfiteodhënësit përbëhet nga vlera e qirasë sipas parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar, si dhe vlera e mirëmbajtjes së pronës sipas planit të mirëmbajtjes hartuar nga IMK (Aneks 4);



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Vlera e qirasë e përlogaritur sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, është 10,000 lekë në muaj.

Duke shqyrtuar dokumentacionin, bazën ligjore mbi të cilën është lidhur kontrata midis MK dhe subjektit “H” sh.p.k. rezulton se:

5.2. Pasaktësi e konstatuar:

Pranimi dhe zbatimi i kërkesës të subjektit “H” sh.p.k. është në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 dhe Ligjin nr. 125/2013, datë 25.4.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” i ndryshuar.

Në përgjithësi ka një përzierje të kriterëve për dhënie me qira dhe enfiteozë të VKM Nr. 54, datë 5.2.2014 dhe të vet këtij Vendimi me Ligjin nr. 125/2013, datë 25.4.2013 I ndryshuar, por duke mos respektuar asnjërin prej tyre, si dhe mos rakordim të të dhënave nga fillimi i procedurës deri në përfundimin e saj.

5.2/1. Mënyra se si ka nisur dhënia me qira/enfiteozë e *depos/magazinës*, është në formën e një “Propozim i pakërkuar”, që parashikohet nga Ligji nr. 125/2013, datë 25.4.2013 dhe përfundon me VKM Nr. 54, datë 5.2.2014.

5.2.2. Në nenin 2 “Objekti i Kontratës” është përcaktuar se ... *Objekti i kësaj kontrate është ... me sipërfaqe ... rreth 100 m²*, kurse mbështetur në projektin e vitit 2017 hartuar nga Instituti I Monumenteve të Kulturës sipërfaqe e parashikuar për objektin është **217,38 m²** (sipërfaqe objekti 60,33 m² dhe 153,45 m² sipërfaqe ndihmëse).

Duke u trajtuar si objekt me sipërfaqe nën 200 m², procedura e dhënies me enfiteozë, nuk I është nënshtruar procesit të konkurrencës, kompetencës dhe afateve kohorë, sipas parashikimeve të VKM Nr. 54, datë 5.2.2014 i ndryshuar.

5.2.2. Sipas “Plan biznesi” të subjektit “H” Sh.p.k., “*Krijimi i qendrës multifunkionale...*” do të zgjasë rreth 2 muaj dhe vlera e investimit parashikohet 300,000 euro.

Në pikën 5 të “Plan biznesit” subjekti ka parashikuar realizim të të ardhurave 587,970,965 lekë (mesatarisht rreth 350,000 euro/vit), me normë fitimi 6 pë qind dhe afat shlyerje 12 vjet.

Sipas preventivit të punimeve të hartuar nga IMK vlera e investimit është rreth 3,800 mijë lekë.

Sipas preventivit të hartuar nga subjekti “H” sh.p.k vlera e mobilieve dhe pajisjeve të parashikuara për investim është 11.927 mijë lekë. .

Sipas “Ofertë për tarifën mujore të qirasë” nr. 109, datë 24.5.2017, dërguar MK ... “H” sh.p.k. do të kryej një investim prej 300,000 euro me tarifë mujore 13,000 lekë me TVSH, në një sipërfaqe shërbimi prej 140 m².

Sa më lart janë kontradiktore, ndërkohë që subjekti në “Plan biznes”, nuk jep të dhëna se mbi çfarë baze (numër turistësh, kohë pune, afat vjetorë do të punojë, pasi është punë sezonale dhe kryesisht do të shfrytëzohen vetëm muajt e verës, ku dhe si do të investohen 300,000 euro etj.) janë bërë llogaritjet për fitimin, afatin e vet shlyerjes së investimit etj. (varianti optimist, realist dhe i keq).

5.3. Parregullsi e konstatuar:

IMK nuk ka kërkuar që paraprakisht projekti “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Multifunkionale të Shërbimeve në Qytetin Antik të Butrintit”, fillimi i procedurës të kryhet, pasi Institucioni të jetë i pajisur me leje zhvillimi/ndërtimi në kundërshtim me parashikimet e nenit 15, 16 të VKM nr. 502, datë 13.7.2009 i ndryshuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Kryerja e punimeve nuk është shoqëruar me leje zhvillimi/ndërtimi në kundërshtim me nenin 8 etj, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, i cili përcakton se ... "Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në **përputhje me lejen e ndërtimit ...**

5.4. Antikushtetutshmëria e Udhëzimit të Ministrit të Kulturës nr. 5110 datë 13.10.2015

Kuadri rregullator që lidhet me miratimin e projektit “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Multifunkionale të Shërbimeve në Qytetin Antik të Butrintit” si dhe lidhjen më pas të kontratës përkatëse të enfiteozës, përbëhet nga:


1. Nenet 784 deri 800 të Ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë“, i ndryshuar;
2. Ligji nr. 9048, datë 7.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore”;
3. Ligji nr. 9967, datë 24.7.2008 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”;
4. Ligji nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar;
5. VKM nr. 426, datë 13.7.2007 “Për miratimin e Kartës Shqiptare të Restaurimit”;
6. VKM nr. 693, datë 10.11.2005 “Për shpalljen e kompleksit litiganor të Butrintit “Park Kombëtar”, i ndryshuar;
7. VKM nr. 396, datë 31.03.2005 “Për miratimin e kufijve dhe të rregullores së administrimit të parqeve arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Orikumit, Antigonesë, Finiqit dhe Butrintit”;
8. VKM nr. 857, datë 19.02.2003 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të zyrës së administrimit dhe koordinimit të Parkut Kombëtar të Butrintit”;
9. VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”;
10. VKM nr. 531, datë 31.10.2002 “Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit dhe të territorit përreth tij zonë natyrore veçanërisht e mbrojtur dhe përfshirjen e tij në listën e ligatinave me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve ujore”;
11. VKM nr. 82, datë 2.3.2000. “Për shpalljen Park Kombëtar në mbrojtje të shtetit të zonës arkeologjike të Butrintit”;
12. Udhëzimi i Ministrit të Kulturës nr. 5110 datë 13.10.2015 “Për dhënien me qira dhe mënyrën e administrimit të monumenteve të kulturës me qëllim rijetëzimi”;
13. Urdhër i Ministrit të Kulturës nr. 8, datë 17.01.2014 “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të KKR”.

Më konkretisht kuadri i mësipërm rregullator pasqyrohet në skemën e mëposhtme:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës



E gjithë procedura e shqyrtimit nga MK të projektit të propozuar nga subjekti "HAKO" sh.p.k. si dhe më pas lidhja e kontratës së enfitozës me këtë subjekt bazohet kryesisht në përcaktimet e bëra në Udhëzimin e MK nr. 5110, datë 13.10.2015 "Për dhënien me qira dhe mënyrën e administrimit të monumenteve të kulturës me qëllim rijetëzimi" (ndryshuar me Udhëzimin nr. 5127, datë 20.10.2016).

Udhëzimi nr. 5110, datë 13.10.2015 "Për dhënien me qira dhe mënyrën e administrimit të monumenteve të kulturës me qëllim rijetëzimi", i ndryshuar, pretendohet se është nxjerrë në mbështetje të:

- 1) Nenet 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,
- 2) Neneve 784-801 të Ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,
- 3) Ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", i ndryshuar, si dhe



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

4. Pikën 10 të VKM nr. 54, datë 5.2.2014, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

Referuar nenit 118 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të përcaktohet që:

- “1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë.
2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.
3. Organi i autorizuar me ligj për të nxjerrë akte nënligjore, siç specifikohet në paragrafin 2 të këtij neni, nuk mund t’ia delegojë kompetencën e tij një organi tjetër.”

Ligji në bazë të të cilit mund të pretendohet se është hartuar dhe miratuar Udhëzimi nr. 5110, datë 13.10.2015, është Ligji nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar. Në nene të caktuara të këtij ligji parashikohen një sërë rastesh ku Ministri dhe Këshilli i Ministrave autorizohen për nxjerrjen e një sërë urdhërave apo udhëzimeve dhe më konkretisht:

1. Në nenin 6 të ligjit, autorizohet Këshilli i Ministrave që të përcaktojë me VKM përbërjen dhe masën e shpërblimit të Komitetit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore dhe gjithashtu autorizohet Ministri që të miratojë përmes një Urdhri rregulloren dhe mënyrën e funksionimit të këtij Komiteti.
2. Në nenin 17 të ligjit, autorizohet Ministri që përmes një urdhri të krijojë Këshillin Kombëtar të Restaurimeve (KKR) si dhe të miratojë me urdhër rregulloren e organizimit dhe funksionimit të këtij Këshilli.
3. Në nenin 19 të ligjit, autorizohet Këshilli i Ministrave që përmes një udhëzimi të përcaktojë procedurat e lëvizjeve të objekteve të lëvizshme të trashëgimisë kulturore.
4. Në nenin 42 të ligjit, autorizohet Ministri që përmes një urdhri të miratojë statutin e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik dhe gjithashtu autorizohet Kryeministri që përmes një urdhëri të miratojë strukturën dhe organikën e kësaj Agjencie.
5. Në nenin 53 autorizohet Këshilli i Ministrave që të miratojë zonat arkeologjike si dhe kufijtë dhe rregulloret e administrimit të parqeve arkeologjike në disa qytete të vendit, ndër to edhe në Sarandë.

Në analizë të përcaktimeve të bëra në Ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore” evidentohet fakti që në asnjë nen të këtij ligji nuk përcaktohet kompetenca e Ministrisë së Kulturës që përmes një Udhëzimi të përcaktojë dhënien me qira dhe mënyrën e administrimit të monumenteve të kulturës me qëllim rijetëzimi.

Për rrjedhojë, arrihet në konkluzionin që përderisa Udhëzimi nr. 5110, datë 13.10.2015 “Për dhënien me qira dhe mënyrën e administrimit të monumenteve të kulturës me qëllim rijetëzimi”, i ndryshuar, nuk është nxjerr në respektim të përcaktimeve të bëra në nenin 118 të Kushtetutës ky Udhëzim është antikushtetues dhe nuk ka asnjë fuqi juridike.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Antikushtetutshmëria dhe mungesa e fuqisë juridike e Udhëzimit nr. 5110, datë 13.10.2015 “Për dhënien me qira dhe mënyrën e administrimit të monumenteve të kulturës me qëllim rijetëzimi”, i ndryshuar, klasifikon automatikisht si të paligjshme të gjithë procedurën e ndjekur në lidhje me shqyrtimin dhe miratimi e projekt propozimit të subjektit “HAKO” sh.p.k duke përfshirë këtu edhe vetë kontratën e enfiteozës të lidhur në përfundim të kësaj procedure ndërmjet subjektit privat dhe Ministrisë së Kulturës.

Përpos kësaj, vetë VKM nr. 54, datë 5.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” (të cilën Ministri i Kulturës e përmend si bazë normative për nxjerrjen e Udhëzimit nr. 5110, datë 13.10.2015) në pikën 10 të Kreut I, parashikon që:

“Monumentet e kulturës jepen me qira ose enfiteozë nga Ministria e Kulturës në përputhje me ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar.”

Pra për dhënien me qira ose enfiteozë të monumenteve të kulturës vetë VKM nr. 54, datë 5.02.2014 e përjashton veten nga zbatimi i saj duke ju referuar në mënyrë eksplicite Ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar.

Ligji nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar, nuk trajton në mënyrë të detajuar procedurën që duhet të ndiqet për dhënien me qira apo enfiteozë të monumenteve të kulturës. I vetmi nen që rregullon procedurën e rijetëzimit dhe shfrytëzimit të monumenteve të kulturës si dhe lidhjen e kontratave përkatëse të shfrytëzimit, është neni 39 i ligjit, i cili përcakton:

- “1. Monumentet e kulturës mund të rijetëzohen për qëllime administrative dhe social-kulturore, me kusht që funksioni i ri të mos dëmtojë vlerën e monumentit. Kushtet dhe kriteret paraprake të rijetëzimit dhe të shfrytëzimit të monumenteve të kulturës miratohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës.*
- 1/1. Rijetëzimi ose shfrytëzimi i Monumenteve të Kulturës, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë VI.2 të shtojcës së ligjit për licencat. Këto leje jepen sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave në vijim, të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njërës nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në nënkategori. Në rastin e dytë nuk zbatohet parimi i miratimit në heshtje.*
- 2. Në çdo rast, shfrytëzimi i monumenteve të kulturës bëhet vetëm pasi të jetë marrë miratimi i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve për lidhjen e kontratës së shfrytëzimit ndërmjet palëve.*
- 3. Kontrata e shfrytëzimit lidhet ndërmjet ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe përdoruesit të monumenteve. Në rast se përdoruesi shkel kushtet dhe kriteret e kontratës, atëherë drejtoria rajonale e kulturës kombëtare i propozon ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore të zgjidhë kontratën në mënyrë të njëanshme.”*

Përcaktimet e mësipërme, të bëra në nenin 39 të Ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar, në vetvete janë të pamjaftueshme për të ezauruar një sërë çështjesh që lidhen me procedurën e dhënies me qira apo enfiteozë të monumenteve të kulturës. Duke qenë se Ligji nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

trashëgiminë kulturore” është i vetmi akt normativ që rregullon procedurën e rijetësimit të monumenteve të kulturës, ky akt normativ ose duhet të plotësohet me nene të tjera ose duhet të autorizonte shprehimisht Ministrinë e Kulturës (ose Këshillin e Ministrave) në nxjerrjen e një akti nënligjor.

Nxjerrja e Udhëzimit nr. 5110, datë 13.10.2015, i ndryshuar, nga ana e Ministri i Kulturës, pa patur asnjë autorizim nga Ligji nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, për të rregulluar dhe plotësuar procedurën e dhënies me qira/enfiteozë si dhe mënyrën e administrimit të monumenteve të kulturës, është një veprim antikushtetues.

Përpos antikushtetutshmërisë dhe pavlefshmërisë së tij juridike, Udhëzimi nr. 5110, datë 13.10.2015, i ndryshuar, bën një sërë përcaktimesh të cilat:

- nuk ruajnë të njëjtin standard me parashikimet e bëra në VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore (VKM në bazë të cilës i referohet si bazë ligjore vetë Udhëzimi nr. 5110, datë 13.10.2015)
- i japin Ministrisë kompetencë të plotë në krijimin apo jo një sërë organeve funksionet e të cilave janë kryesisht konsultative dhe propozuese, dhe
- përqendron të gjithë vendimmarrjet në duart e Ministrisë

Në pikën 5/a, Kreut – I, të VKM nr. 54, datë 05.02.2014, përcaktohet që:

“Përjashtohen nga konkurrimi: a) dhënia me qira e sipërfaqeve deri në 200 m², të cilat jepen me afat deri në 1 vit.”

Ndërsa në paragrafin 1, të pikës B, të Kreut – II dhe paragrafin 2/a, të pikës C, të Kreut – I, të Udhëzimit nr. 5110, datë 13.10.2015, përcaktohet që:

“Përjashtohen nga procedura e konkurrimit dhënia me qira /enfiteozë me qëllim rijetëzimin/shfrytëzimin për objektet me sipërfaqe deri në 200 m². ... Për sipërfaqet deri 200 m², kohëzgjatja do të jetë nga 1 deri në 5 vjet”

Pra ndryshe nga VKM nr. 54, datë 05.02.2014, Udhëzimi nr. 5110, datë 13.10.2015 lejon lidhjen e kontratave të qirasë apo enfiteozës (pa procedurë konkurrimi) deri në 5 vjet.

Përcaktimet e mësipërme, të bëra në Udhëzimin nr. 5110, datë 13.10.2015, i ndryshuar, i mundësuan Ministrisë që të lidhë, pa ju nënshtruar paraprakisht procedurave të konkurrimit, Kontratën e Enfiteozës nr. 3681, datë 02.06.2017 për një periudhë 5 vjeçare, ndërkohë që normalisht, nëse do të ruhej standardi i vendosur nga VKM nr. 54, datë 05.02.2014, kjo kontratë, pa procedura konkurrimi, mund të lidhej maksimumi për një afat deri në 1 vit.

Në analizë të përcaktimeve të bëra në Kontratën e Enfiteozës nr. 3681, datë 02.06.2017 arrihet në konkluzionet si më poshtë:

3.2.1 Mungesa e fuqisë juridike të Kontratës së Enfiteozës

Referuar nenit 1 të Kontratës së Enfiteozës nr. 3681, datë 02.06.2017, në të përcaktohet si bazë ligjore e lidhjes së kontratës:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

- 1) Ligji nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë“, i ndryshuar;
- 2) VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” të ndryshuar;
- 3) Udhëzimi i Ministrit të Kulturës nr. 5110, datë 13.10.2015 “Për dhënien me qira dhe mënyrën e administrimit të monumenteve të kulturës me qëllim rijetëzimi”, i ndryshuar.

Në analizë të tre akteve të mësipërme, të referuara si bazë ligjore në lidhjen e kontratës së enfiteozës, arrihet në konkluzionin që kontrata e enfiteozës nr. 3681, datë 02.06.2017 nuk është lidhur në përputhje me përcaktimet e bëra në nenet 786 dhe 83 të Kodit Civil dhe njëkohësisht si VKM nr. 54, datë 05.02.2014, i ndryshuar ashtu dhe Udhëzimi i MK nr. 5110, datë 13.10.2015, i ndryshuar nuk mund të shërbejnë si bazë ligjore për lidhjen e kësaj kontrate.

- 1) Përsa i përket poszbatimit nga MK të përcaktimeve të bëra në Kodin Civil, sqarojmë që referuar përcaktimeve të bëra në nenin 786 të Kodit Civil, në të përcaktohet që:

“Kontrata e enfiteozës duhet të bëhet në formën që kërkohet për kalimin e pronësisë për pasuritë e paluajtshme.”

Ndërsa, referuar përcaktimeve të bëra në nenin 83 të Kodit Civil, në të përcaktohet që:

“Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistruhet, përndryshe nuk është i vlefshëm. Është i pavlefshëm veprimi juridik që nuk është bërë në formën e kërkuar shprehimisht nga ligji.”

Nga shqyrtimi i Kontratës së Enfiteozës nr. 3681, datë 02.06.2017, të lidhur ndërmjet subjektit “HAKO” sh.p.k dhe Ministrisë së Kulturës, evidentohet fakti që kjo kontratë nuk është bërë me akt noterial dhe nuk është regjistruar në ZVRPP. Për rrjedhojë, në referencë të përcaktimeve të bëra në nenet 786 dhe 83 të Kodit Civil, kjo kontratë është e pavlefshme dhe nuk ka asnjë fuqi juridike.

- 2) Përsa i përket VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, sqarojmë që kjo VKM e përjashton veten nga zbatimi i saj përsa i përket rasteve të dhënies me qira apo enfiteozë të monumenteve të kulturës duke i referuar këto raste drejtpërsëdrejti tek Ligji nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar. Më konkretisht në pikën 10 të Kreut I, të VKM nr. 54, datë 05.02.2014, të ndryshuar, parashikohet që:

“Monumentet e kulturës jepen me qira ose enfiteozë nga Ministria e Kulturës në përputhje me ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar.”



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Sa më sipër, Kontrata e Enfiteozës nr. 3681, datë 02.06.2017, nuk ka asnjë fuqi juridike nëse bazohet në VKM nr. 54, datë 05.02.2014, të ndryshuar, pasi kjo VKM nuk aplikohet në rastin e dhënies me qira ose enfiteozë të monumenteve të kulturës.

- 3) Përsa i përket Udhëzimit të Ministrit të Kulturës nr. 5110, datë 13.10.2015 “Për dhënie me qira dhe mënyrën e administrimit të monumenteve të kulturës me qëllim rijetëzimi”, i ndryshuar, ashtu sic edhe është trajtuar më sipër, në kushtet kur ky Udhëzim i MK nuk është nxjerrë në bazë dhe për zbatim të ndonjë ligji (cka e bën këtë udhëzim automatikisht një akt antikushtetues) nuk ka se si ky Udhëzim të shërbejë si bazë juridike në lidhjen e Kontratës së Enfiteozës nr. 3681, datë 02.06.2017.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që Kontrata e Enfiteozës nr. 3681, datë 02.06.2017 është lidhur në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenet 786 dhe 83 të Kodit Civil dhe njëkohësisht është bazuar në dy akte juridike (VKM nr. 54, datë 05.02.2014, i ndryshuar dhe Udhëzimi i MK nr. 5110, datë 13.10.2015, i ndryshuar) ku njëri nuk ka si objekt rregullimin e marrëdhënieve juridike objekt të kësaj kontrate ndërsa tjetri është një akt haptazi antikushtetues. Si rrjedhojë, mungesa e një baze juridike në lidhjen e Kontratës së Enfiteozës nr. 3681, datë 02.06.2017, e bën këtë akt të pavlefshëm dhe pa asnjë fuqi juridike.

Edhe sikur VKM nr. 54, datë 05.02.2014, i ndryshuar dhe Udhëzimi i MK nr. 5110, datë 13.10.2015, i ndryshuar të shërbenin si bazë për lidhjen e Kontratës së Enfiteozës nr. 3681, datë 02.06.2017, sërish, fakti i vetëm që kjo kontratë nuk është lidhur në formën e kërkuar nga nenet 786 dhe 83 të Kodit Civil, e bën këtë akt automatikisht të pavlefshëm.

3.2.2 Problematikat juridike të parashikimeve kontraktore

Përpos pavlefshmërisë juridike të kontratës së enfiteozës, nga shqyrtimi i saj dhe anekseve bashkëlidhur, konstatohen edhe një sërë çështjesh dhe problemesh të tjera të cilat ngrenë shqetësime serioze lidhur me bazueshmërinë juridike të këtyre parashikimeve kontraktore, si dhe zbatimin e kësaj kontrate në të ardhmen.

Në vetvete, Kontrata e Enfiteozës nr. 3681, datë 2.06.2017 përbëhet nga kontrata bazë dhe 5 anekse të saj konkretisht:

- Aneksi-I “Për tipologjitë e shërbimeve në qytetin antik të Butrintit”;
- Aneksi-II që përmban Vendimin e KKR për “Rehabilitimin dhe ndërtimin e pikave të shërbimit në qytetin antik të Butrintit, Sarandë”;
- Aneksi-III që përmban kontratën e bashkëpunimit për punime në zonat e TK;
- Aneksi-IV që përmban planin e mirëmbajtjes”;
- Aneksi-V që përmban planin e biznesit.

Të gjitha këto anekse konsiderohen si pjesë integrale e kontratës.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

a) *Mungesa e specifikimit të saktë të sipërfaqes së objektit*

Nga shqyrtimi i kontratës bazë, si dhe Aneksit-III të saj, evidentohet fakti që në to nuk specifikohet sipërfaqja e saktë e objektit të dhënë me enfiteozë.

Më konkretisht, në nenin 2 “Objekti i kontratës”, të Kontratës së Enfiteozës, përcaktohet:

“Objekti i kësaj kontrate është rregullimi i marrëdhënieve mes palëve me qëllim dhënien me enfiteozë të një ambienti me sipërfaqe rreth 100 m².”

Ndërsa në nënin 23 të Aneksit-III “Prona”, të Kontratës së Bashkëpunimit, parashikohet:

“Ambienti me sipërfaqe rreth 100 m² për përdorimin e tij si Qendër Multifunktionale Shërbimesh në Parkun Arkeologjik të Butrintit sipas përshkrimit të vendimit të KKR nr. 149, datë 12.05.2017.”

Sa më sipër evidentohet fakti që si në Kontratën e Enfiteozës ashtu dhe në Kontratën e Bashkëpunimit nuk përcaktohet saktë sipërfaqja e objektit të kontratës.

Rëndësia e përcaktimit të saktë të sipërfaqes së objektit të dhënë me enfiteozë jo vetëm që është një ndër elementët e domosdoshëm të kontratës për të përcaktuar fizikisht se deri ku do të shtrihen të drejtat dhe detyrimet e enfiteozëmarrësit por është dhe baza e përllogaritjes së detyrimeve të tij mujore.

Pasaktësia në përcaktimin e sipërfaqes së saktë të pronës në m² çon automatikisht në pamundësinë e llogaritjes së saktë të vlerës së detyrimit mujor. Për këtë arsye, vihet në diskutim se si është përllogaritur nga hartuesit e kontratës detyrimi mujor prej 10,000 Lekë.

Nga ana tjetër, në përllogaritjen e vlerës prej 10,000 Lekë kontrata i referohet VKM-së nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, e cila në pikën 10 të Kreut I të saj vetëpërfshihet nga rregullimi i procedurave që lidhen me objektet monument kulture.

b) *Mospërcaktimi i qartë i vlerës së investimit*

Kontrata e Enfiteozës dhe anekset e saj, nuk përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të argumentuar vlerën totale të investimit. Të vetmet parashikime kontraktore ku flitet për investimin janë ato të: Aneksit-III Kontrata e Bashkëpunimit dhe Aneksit-IV Plan Biznesi.

Më konkretisht, në nenin 7 “Çmimi i kontratës”, të Aneksit-III Kontrata e Bashkëpunimit, përcaktohet që:

“Çmimi i kësaj kontrate përkon me vlerën e situacioneve të miratuara nga përfituesi në zbatim të legjislacionit në fuqi.”

Ndërsa, në pikën 6 “Kostoja e Projektit” (fq. 4) të Aneksit-IV Plan Biznesi, përcaktohet që:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

“Kosto totale e investimit: 300.00 (treqind mijë) Euro.”

Përpos këtyre parashikimeve, në Preventivin e Punimeve që shoqëron Aneksin-IV Plan Biznesi, pasqyrohet si vlerë totale e investimit, vlera prej 3,667,918.57 Lekë.

Përcaktimet e mësipërme kontraktore, ngrenë një sërë dyshimesh në lidhje me mënyrën se si është argumentuar nga hartuesit e kontratës vlera prej 300,000 Euro si kosto totale e investimeve, kur Preventivi i Punimeve përcakton si vlerë totale vlerën prej 3,667,918.57 Lekë.

Gjithashtu, është e paqartë se përse në kontratë përdoren vlera monetare të shprehura në dy valuta të ndryshme (në Euro dhe në Lekë) ndërkohë që thjesht fakti i vendosjes së vlerës së investimit në Euro mbart në vetvete riskun e penalizimeve si pasojë e ndryshimeve në kohë të kursit të këmbimit.

Përcaktimi në kontratë i një vlere të paargumentuar investimi prej 300,000 Euro, krijon një sërë problemesh në rastin hipotetik të ndërprerjes së kontratës në mënyrë të njëanshme (nga secila prej palëve) pasi në këtë rast enfiteozëmarrësi mund të pretendojë ndaj MK njohjen e vlerës së investimit prej 300,000 eurosh, si dhe fitimin e munguar, ndonëse në Prevendimin e Punimeve vlera totale e investimit përllogaritet në 3,667,918.57 Lekë.

c) *Ekzistenca e mospërputhjeve ndërmjet afateve të Plan Biznesit dhe Kontratës së Enfiteozës*

Në nenin 4 “Afati” të Kontratës së Enfiteozës, përcaktohet që:

“Afati i kësaj kontrate është 5 vjet me të drejtë rinovimi nëse janë plotësuar me korrektësi të gjitha detyrimet kontraktuale dhe ligjore të kësaj kontrate.”

Ndërsa në pikën 5 (fq. 4) të Plan Biznesit, përcaktohet që:

“Ky aktivitet fitimprurës, ka garanci për vetëshlyerjen e investimit 12 vjet.”

Në analizë të përcaktimeve të mësipërme kontraktore, vihet në pikëpyetje se si do të mund të shlyhet një investim prej 300,000 Euro në 12 vite, ndërkohë që afati i Kontratës së Enfiteozës është 5 vjet.

Theksojmë që si përcaktimet e bëra në Kontratën e Enfiteozës ashtu dhe ato të bëra në Aneksin-V Plan Biznesi kanë të njëjtën vlerë juridike. Mospërputhja e afateve kohore të sipërcituara ngre një sërë pikëpyetjesh në rastin hipotetik të zgjidhjes së marrëdhënieve kontraktore, nëse mund të përllogaritet si dëmshpërblim vlera totale e investimit prej 300,000 Euro dhe fitimi i munguar i një Plan Biznesi 12 vjeçar në zgjidhjen e një Kontrate Enfiteoze 5 vjeçare.

Nëse do të ishte e parëndësishme mospërputhja e afateve ndërmjet Plan Bizneseve si Anekse të kontratës dhe Kontratës së Enfiteozës, atëherë do të dilej në konkluzionin që Ministria e Kulturës, për kontrata 5 vjeçare, mund të pranojë edhe Plan Biznese me afat 99 vjet.

d) *Ekzistenca e mospërputhjeve ndërmjet afatit të kohëzgjatjes së punimeve*

Normalisht, afati i Plan Biznesit, duhet të ishte reflektuar në Kontratën e Enfiteozës dhe në Kontratën e Bashkëpunimit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Në Planin e Biznesit evidentohen dy afate shumë të rëndësishme:

- 1) afati kur pretendohet të kenë përfunduar punimet dhe fillojnë ofrimi i shërbimit (në rastin konkret 2 muaj) dhe
- 2) afati maksimal i Plan Biznesit brenda të cilit pretendohet se biznesi vetëshlyhen investimin (në rastin konkret 12 vite).

Afati i parë prej 2 muajsh duhet të ndikonte automatikisht tek Kontrata e Bashkëpunimit (Sipërmarrjes), ndërsa afati i dytë duhet të ndikonte tek afati maksimal i Kontratës së Enfiteozës.

Faktikisht, në Kontratën e Bashkëpunimit, jo vetëm që nuk evidentohet afati 2 mujor i parashikuar në Plan Biznes, por përkundrazi, parashikimet e bëra në nenin 8 të Kontratës së Bashkëpunimit, mund ta çojnë teorikisht përfundimin e punimeve përtej afatit 5 vjeçar. Më konkretisht, në pikën 1 të nenit 8, parashikohet se:

“Sipërmarrësi do të përfundojë punimet në një afat prej nga data e fillimit të punimeve në zonat e trashëgimisë kulturore (“Afati i Përfundimit”).”

Për sa më sipër, në mungesë të përcaktimit të afateve konkrete kohore të përfundimit të punimeve në Kontratën e Bashkëpunimit, jo vetëm që nuk mund të përllogariten penalitetet por edhe humbet sensi i miratimit të një projekti të tillë i cili presupozon ofrimin sa më të shpejtë të një sërë shërbimeve ndaj publikut.

e) *Mospërputhja e subjektit që do të kryejë punimet e restaurimit*

Kontradikta dhe përplasje në parashikimet kontraktore evidentohen edhe përsa i përket faktit se cili subjekt do të kryejë punimet e restaurimit. Më konkretisht në Aneksin-V Plan Biznesi parashikohet që:

“zbatimi i projektit të rijetëzimit nga stafi teknik i HAKO sh.p.k., i specializuar për ngritjen e pikave të shërbimit në të gjithë Shqipërinë....Stafi teknik: inxhinieri dhe personeli teknik, janë specialistë që njohin mirë teknikat e ndërtimit dhe teknologjisë, të nevojshme për rijetëzimin e kësaj pike shërbimi. Një pjesë e personelit inxhiniero teknik është specializuar jashtë shtetit.”

Ndërkohë në Kontratën e Bashkëpunimit parashikohet që:

“Agi KONS sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit ... do të kryejë punimet në zonën e trashëgimisë kulturore, si dhe ato të sistemeve”.

f) *Mungesa e parashikimeve specifike teknike*

Në nenin 2 “Objekti i kontratës” të Kontratës së Bashkëpunimit parashikohet që:

“Sipërmarrësi merr përsipër, në përputhje me afatet dhe kushtet e kësaj Kontrate, përcaktimeve teknike dhe kushteve për cilësinë të përcaktuara në anekset bashkëngjitur kësaj Kontrate, preventivit, specifikimeve teknike si dhe dokumentacionit që shoqëron vendimin e KKR, të kryejë, me mjetet e pajisjet e veta dhe shpenzimet e Investitorit, punime me qëllim përmirësimin e objektit të përshkruar në nenin....të kësaj kontrate.”

Nga shqyrtimi dhe analizimi i gjithë akteve të vëna në dispozicion përmes observacioneve, në asnjë prej tyre nuk parashikohen në mënyrë specifike:

- materialet dhe produktet që do të përdoren,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

- kushtet specifike për kryerjen dhe dorëzimin e punimeve
- vlera e mirëmbajtjes së pronës.

Mungesa e parashikimeve të mësipërme sjell automatikisht pamundësinë në përcaktimin e 0 zbatimit dhe kontrollit të zbatimit në mënyrën e duhur të kontratës, si dhe garantimin e mbrojtjes së ndërtimit ekzistues dhe mjedisit, aq më tepër kur bëhet fjalë për një ndërtim të ndodhur në një zonë të mbrojtur.

Parregullsitë e konstatuara ngarkojnë me përgjegjësi KKR të përbërë nga zj. Mirela Kumbaro Ministër, në cilësinë e kryetarit, Arta Dollani Drejtore IMK në cilësinë e sekretares, Rudina Zoto, Agron Islami, Adelina Greca, Lorenc Bejko, Iris Pojani, Valbona Koçi, Dritan Baboçi në cilësinë e anëtarëve të KKR dhe Risena Xhaja në cilësinë e Drejtorit të Shërbimeve Mbështetëse.

MK ka bërë vërejtje si më poshtë vijon:

- Kërkojmë vëmendjen tuaj për të konsideruar në mënyrë të veçantë argumentat e paraqitura nga MK në akt konstatimin nr. 6 si dhe rrjedhimisht ndryshimin e gjetjeve tuaja në faqen 103 të projektraportit pasi rekomandimi i audituesve për këtë pjesë do të përbënte dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në kushtet kur anulimi i kontratës së enfiteozes çon automatikisht në zgjidhjen e kontratës së investimit të dhuruar nga subjekti privat në përfitim të ZAKPB.

*I nderuar Kryetar, më lejoni të tërheq paksa vëmendjen tuaj në fotot bashkëngjitur, siç mund ta shihni, objekti i ri me objektin e vjetër kanë një ndryshim rrënjësor duke përmirësuar ndjeshëm pronën shtetërore me financim privat në favor të saj, **pa prekur nëntokën dhe pabërë ndërtuar objekt të ri, por vetëm duke pastruar dhe sistmuar mjedisin** ekzistues për një shërbim më cilësor ndaj vizitorëve. Në këto kushte, zgjidhja e kontratës do të thotë kthimin e pronës në gjendjen e mëparshme, që detyron shtetin të rimbursojë investimin e kryer nga subjekti privat.*

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së : Në argumentet e tij grupi i auditimit i është referuar kontekstit ligjor nëse lejohet ose jo rikonstruksioni. Nën këtë arsyetim, komentet/shpjegimet e tyre, nuk qëndrojnë.

Lidhur me argumentin e MK se ... *objekti i ri ... ka ndryshim rrënjësor ... pa prekur nëntokën dhe pa bërë/ndërtuar objekt të ri, por vetëm duke pastruar dhe sistmuar mjedisin ekzistues*

...

Grupi i auditimit sqaron/kujton se sipërfaqe e parashikuar/ndërtuar pas rikonstruksionit, është është **217,38 m²**, nga e cila sipërfaqe objekti 60,33 m² dhe 153,45 m² sipërfaqe ndihmëse, e gjitha e betonuar (sipërfaqe objektit para rikonstruksionit ka qenë 60 m²).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

III. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i projekteve në art-kulturë dhe trashëgimi kulturore për vitet 2015, 2016 dhe 2017 konstatohet se në disa raste, tarifa për financimin e zërave të tillë si “orkestrantë kategoria e parë”, “spala”, “koncert maestër i orkestrës”, “regjisor”, “prodhimi i videoklipeve në monumentet e trashëgimisë kulturore shqiptare”, “drejtor artistik”, “koordinator artistik”, “skenograf” etj. i referohet çmimeve të tregut dhe eksperiencave të mëparshme, pasi nuk ka tarifa të miratuara për kontributin e angazhimit të përkohshëm në projektet artistike. Ministria e Kulturës, si organ qendror nuk ka një Bord Artistik sikurse kanë organet e saj të varësisë bazuar në nenin 10, të Ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën” me ndryshime, në të cilat ajo ka përfaqësuesit e saj, pasi në bazë të detyrimit që përcakton neni 11 i këtij Ligji, Bordet miratojnë kriteret dhe masën e shpërblimit të krijimtarisë artistike.

Në lidhje me zbatimin e këtij neni dhe referuar nenit 34, pika 1 të ligjit “Për artin dhe kulturën” me ndryshime ⁶, ligjvënësi ka ngarkuar Këshillin e Ministrave për përcaktimin e masës së shpërblimit të gjinive artistike, sipas fushave të artit dhe për kontributin e angazhimit të përkohshëm në projektet artistike. Ky instrument ligjor ende nuk është miratuar dhe pse në nenin 35 të tij, afati ligjor i parashikuar ka qenë 6 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit. Në kushtet e mungesës së rregullimit ligjor për tarifën, për vlerësimin e projekteve, krijohen mundësi për abuzime/shpenzime të paargumentuara gjatë realizimit të tyre (*trajtuar më hollësisht në faqet nr. 24-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi: Të kërkohet nga Këshilli i Ministrave përmirësim ligjor (shtesa dhe ndryshime), në Ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën” me ndryshime, në nenin 10 dhe neni 35. Ministria e Kulturës si organ përgjegjës për artin dhe kulturën, të ketë pranë saj Bordin Artistik Bordet të civilitetit ligji i njeh të drejtën e miratimit të kriterëve dhe masës së shpërblimit të krijimtarisë artistike.

Gjithashtu, bazuar në nenin 35 të ligjit Ministria e Kulturës të kërkojë nga Këshilli i Ministrave, sipas detyrimit që rrjedh nga neni 34 i ligjit, nxjerrjen e vendimit për masën e shpërblimit të gjinive artistike, sipas fushave të artit dhe për kontributin e angazhimit të përkohshëm në projektet artistike.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik, konkretisht mbi hartimin e Dokumenteve të Tenderit, konstatohet se vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit për të vërtetuar përvojën e mëparshme përmes paraqitjes së kontratave për “*punë të ngjashme të së njëjtës natyrë për një objekt të vetëm...*”, në shumicën e rasteve nuk i referohet vlerës në përqindje të vënë nga ligjvënësi e cila “*nuk duhet të jetë më e madhe se 50% e vlerës së objektit që prokurohet*” sipas VKM nr. 914, datë 29.12.20014 e ndryshuar, neni 26, pika 6/a. Autoriteti Kontraktor (MK) vendos një vlerë dysHEME, që në disa raste varion “*në një vlerë prej 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet*” ose “*në një vlerë jo më të ulët se 50% e vlerës së objektit që prokurohet*”. Megjithëse ligjvënësi nuk ka vendosur vlera minimale dhe as nuk ka ndaluar vendosjen e tyre, Autoriteti Kontraktor në asnjë rast nuk duhet të anashkalojë detyrimin ligjor vlerës maksimale të shprehur në

⁶ Konkluzioni bazohet në Ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010 me ndryshime, i cili është në fuqi.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

përqindje për “kontratat për punë të ngjashme”, pasi shmang konkurrencën dhe trajton në mënyrë jo të barabartë operatorët (*trajtuar më hollësisht në faqet nr. 69-71, 74-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi: Të kërkohet nga Agjencia e Prokurimit Publik si organ që ka tagrin ligjor në përputhje me nenin 13, pika 2/a, g, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” me ndryshime, të paraqesë pranë Këshillit të Ministrave propozime për rregullat e prokurimit, në mënyrë që të bëhen përmirësime ligjore në VKM nr. 914, datë 29.12.20014 e ndryshuar, neni 26, pika 6/a, duke përcaktuar në mënyrë eksplicite përveç vlerës maksimale dhe vlerën minimale të kontratës për “punë të ngjashme”, të shprehur në përqindje duke vendosur në këtë mënyrë kufij të qartë të vlerës së kontratës në përmbushje të kriterit për përvojën e mëparshme, të realizuar nga operatorët gjatë 3 viteve të fundit.

Neni 26, pika 6/a VKM nr. 914, datë 29.12.20014 e ndryshuar, të riformulohet:

Ishte

Për të provuar përvojën mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Të bëhet

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% dhe jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Menjëherë

3. Në kuadrin legjislativ që normon kuptimin, mbrojtjen, administrimin dhe ndërhyrjen në pasuritë trashëgimi kulturore dhe zonat e mbrojtura janë bërë ndryshime të shpeshta, edhe nga Ministrat përgjegjës për kulturën ndër vite. Ajo çka evidentohet nga aktet juridike në fuqi, sidomos ato të nxjerra nga vetë Ministri i Kulturës me apo pa autorizim ligjor, është fakti që ky Ministër gëzon kompetenca tepër të zgjeruara, mjaftueshëm për të ndikuar edhe në vendimmarrjen e atyre organeve të cilat në ligje dhe/ose akte nënligjore përcaktohen si kolegjiale dhe me rol vendimmarrës në gjithë procesin e administrimit dhe ndërhyrjes në këto zona/objekte të mbrojtura në mënyrë specifike.

Ne rekomandojmë se duhet të bëhen parashikime ligjore, ose të paktën me Vendime të Këshillit të Ministrave (të dala në bazë të autorizimeve ligjore, të cilat të kenë përcaktuar çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto VKM) më specifike dhe të detajuara. Rekomandimet nuk duhet të konsistojnë vetëm në qartësimin e kuadrin rregullator, qartësimin për ushtruesit e detyrave publike lidhur me hierarkinë e akteve dhe domosdoshmërinë e nxjerrjes së akteve nënligjore vetëm nëse ligji në kuptimin formal autorizon nxjerrjen e tyre, qartësimin dhe përkufizimin e termave juridik në kuptim të akteve të ndryshme, por veçanërisht bërjen e parashikimeve të cilat krijojnë balancë mes kompetencave/pushtetit vendimmarrës të Ministrisë të Kulturës dhe atyre të organeve kolegjiale, me qëllim shmangien e ndikimit dominues të Ministrisë të Kulturës në këto procedura sensitive dhe me impakt për ekzistencën e objekteve/zonave me mbrojtje të veçantë, për opinionin publik, si dhe për buxhetin e shtetit.

Një gjë e tillë duhet bërë veçanërisht për parashikimet lidhur me krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar të Restaurimeve, organ vendimmarrës shumë i rëndësishëm në procesin e miratimit të projekteve për restaurim dhe dhënien e licencave për projektim dhe restaurim në



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

fushën e monumenteve të kulturës. Kjo për shkak se, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 9048/2003 “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar, përforcuar dhe nga Urdhri i Ministrit të Kulturës nr. 8, datë 17.01.2014, “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve”, KKR është një organ në duart e Ministrit të Kulturës dhe gjithë procesi për miratimin e projekteve për restaurim dhe dhënien e licencave për projektim dhe restaurim është “një qark i mbyllur”, ku çdo parashikim direkt ose indirekt të çon te Ministri i Kulturës.

Më konkretisht, bazuar në ligjin nr. 9048/2003, KKR krijohet me Urdhër të Ministrit të Kulturës dhe organizimi dhe funksionimi i tij përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Ministri i Kulturës. KKR miraton kriteret për licencimin e subjekteve në fushën e projektimit apo të restaurimit të objekteve të trashëgimisë kulturore, dhe pas plotësimit të kriterëve të miratuara për këtë qëllim, i propozon Ministrit të Kulturës licencimin e tyre. Ky i fundit ka kompetencë ta miratojë atë. Çdo projekt për restaurim i paraqitet për miratim KKR-së, e cila përcakton kriteret dhe kategorinë e projekteve, që miratohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës. Në çdo rast, shfrytëzimi i monumenteve të kulturës bëhet vetëm pasi të jetë marrë miratimi i KKR-së për lidhjen e kontratës së shfrytëzimit ndërmjet palëve. Bazuar në Urdhër nr. 8/2014 të nxjerrë nga Ministri i Kulturës, KKR përfaqësohet në cilësinë e Kryetarit nga vetë Ministri i Kulturës dhe në përbërje ka përfaqësues të institucioneve të specializuara, si dhe specialistë të fushës jashtë sistemit të Ministrisë së Kulturës, numri i të cilëve, element ky ndër vendimtarët në vendimmarrjen e organeve kolegjiale, përcaktohet po nga Ministri i Kulturës, është numër tek dhe mund të jetë i ndryshueshëm. Ligji nr. 9048/2003 ka një qasje tjetër lidhur me pesë organet e tjera të reja që krijon, për të cilat parashikon përcaktimin e përbërjes dhe funksionimit të tyre, kriterëve të vlerësimit dhe shpërblimit me Vendim të Këshillit të Ministrave. Për njërin prej këtyre organeve, Komitetin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore, që në ligj parashikohet kryesimi i tij nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe nuk i lihet Ministrit të vetëshpallet Kryetar.

Pra, në këtë situatë juridike, KKR e drejtuar nga Ministri i Kulturës, me numër anëtarësh të përcaktuar nga Ministri i Kulturës, përcakton kriteret dhe kategorinë e projekteve për restaurim dhe miraton lidhjen e kontratës së shfrytëzimit ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe shfrytëzuesve të monumentit; miraton kriteret për licencim të subjekteve e të personave juridik në fushën e restaurimeve, licencat për projektim dhe restaurim të të cilëve miratohen Ministri i Kulturës; bën inspektime për zbatimin e projekteve të miratuara nga vetë ajo dhe ka të drejtën të vlerësojë ekzistencën e shkeljeve që mund të sjellin pasoja në objekt dhe t'i propozojë Ministrit të Kulturës heqjen e licencës së shoqërisë restauruese dhe/ose drejtuesit teknik restaurator. Si rrjedhojë, bazuar në sa më sipër, pa asnjë ekuivok mund të thuhet se të gjitha parashikimet që rregullojnë këtë proces të çojnë në vendimmarrjen e Ministrit të Kulturës.

Problematika me këtë karakter evidentohen edhe lidhur me normimin e përbërjes, kompetencave dhe funksionimit të Institutit të Monumenteve të Kulturës, i cili miraton kriteret dhe kategorinë e objekteve për restaurim.

Në këtë kuadër, ne rekomandojmë që me ligj të miratuar nga Kuvendi duhet të përcaktohen të paktën numri i anëtarëve, përbërja, mënyra e zgjedhjes dhe shkarkimit, afati i mandatit, arsyet e përfundimit para kohe, kompetencat, si dhe rregullimi i raportit të tyre dhe Ministrit përgjegjës për kulturën. Minimalisht, marrëdhënia mes Ministrit dhe këtyre organeve kolegjiale duhet të përcaktohet me VKM, nxjerrja e së cilës të jetë autorizuar nga ligji, i cili të ketë të përcaktuar çështjet që VKM-ja duhet të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

rregullojë, si dhe parimet në bazë të të cilave do të nxirret kjo VKM. S'mund të jetë Ministri rregullator i raportit të tij me këto organe kolegjiale dhe i procedurës së funksionimit të tyre, për sa kohë implikohen raportet e tij me këto organe dhe akti i nxjerrë prej tij, qoftë Urdhër apo Udhëzim, shërben për dhënien e kompetencave për vetë Ministrin i cili e nxjerr. Akte me të tilla parashikime nxirren në kushtet e konfliktit të interesit mes detyrave të Ministrit dhe interesit që ai ka në shtimin e kompetencave të tij.

Kushtetuta, në nenin 102, parashikon se Ministri nxjerr Urdhra dhe Udhëzime vetëm në zbatim të kompetencave të tij, si rrjedhojë, nuk mund të shërbejnë këto akte nënligjore të nxjerra nga vetë Ministri si burim për marrjen e kompetencave që ai nuk i ka. Ministri i Kulturës, me Urdhrin nr. 8/2014 i jep vetes kompetenca në lidhje me përcaktimin e numrit të anëtarëve të KKR, “vetëshpallet” Kryetar i KKR-së, si dhe përcakton funksionimin dhe vendimmarrjen e KKR-së.

Ndërsa në Udhëzimin nr. 5110/2015, Ministri i Kulturës parashikon kriteret e vlerësimit, si dhe organet për vlerësimin e dhënies me qira dhe administrimit të monumenteve të kulturës me qëllim rijetëzimi, krijimin ose jo të të cilave, si dhe përbërjen e tyre e ka në diskrecion vetë Ministri i Kulturës (si për shembull Komisionin për Menaxhimin e Pasurive Kulturore) dhe në fund, pavarësisht ngritjes ose jo të tyre, vendimmarrës sërish mbetet nxjerrësi i këtyre akteve nënligjore, Ministri i Kulturës.

Ne rekomandojmë gjithashtu se Ministria duhet të tregohet shumë e kujdesshme lidhur me monitorimin e zbatimit të kësaj kontrate, sidomos për sa i përket zgjidhjes së njëanshme të saj, e cila do të sillte pasojat financiare të larta për buxhetin e shtetit, për shkak të njohjes së vlerës së (lartë) të investimit. Për më tepër që, të njëjtin person juridik i cili do të kryejë punimet restauruese për rijetëzimin e objektit të ndodhur në Parkun Kombëtar të Butrintit, A sh.p.k., Ministria e Kulturës e ka shpallur fitues si pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomik edhe për rehabilitimin e Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor (*trajtuar më hollësisht në faqen 113-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimeve të kryera me bankë, për justifikimin e shpenzimeve për udhëtim e dieta jashtë vendit, konkretisht për shpenzimet e akomodimit (hotel), nga këqyrja e dokumentacionit u konstatua se, bashkëngjitur urdhër shpenzimeve, nuk ndodhet asnjë dokument që vërteton vlerën e akomodimit të konfirmuar nga hotelet e rezervuara on-line, dërguar agjencive turistike që kanë ofruar shërbimin për Ministrinë e Kulturës. Likuidimi i tyre është bërë vetëm referuar faturës së paraqitur nga agjencitë turistike, ku nuk është e ndarë kosto e hotelit dhe kosto e shërbimit për agjencitë. Kjo mënyrë procedimi për likuidimin e shpenzimeve të akomodimit nëpërmjet agjencive është si rezultat i pamundësisë që institucionet buxhetore të përdorin mënyrën e parapagimit, e cila është formë likuidimi e palejueshme, referuar udhëzimit të MF nr. 2, datë 06.02.2012, paragrafi “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike” pika 147, si dhe nga ana e tyre nuk disponohet kartë krediti. Aktualisht rezervimi i hoteleve kryhet nga agjencitë me pa parapagim, nëpërmjet, kartë kreditit. Ofrimi i këtij shërbimi nga agjencitë ka kosto shtesë (kosto shërbimi) për buxhetin e shtetit, e cila në rastin e MK, nuk është e identifikueshme (*trajtuar më hollësisht në faqet nr.14-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë në shqyrtim këtë fakt, i cili sjell kosto shtesë për buxhetin e shtetit dhe të pajisë me kartë krediti në emër të Nëpunësit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Zbatues, institucionet buxhetore, me qëllim që të përdoret për kryerjen e këtyre pagesave. Gjithashtu, të bëhet rregullim në udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, paragrafi “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike” pika 147, ku në rastet përjashtimore të parashikohet pajisja dhe përdorimi i “kartë krediti” dhe forma e “parapagimit” për shpenzimet e akomodimit në hotel, në rastet e udhëtimit të punonjësve të administratës publike jashtë vendit.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2016, u konstatua se në aktiv të bilancit kontabël, posti C “Llogari të tjera aktive”, është paraqitur llogaria “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në vlerën 55,991,568 lekë, që përfaqëson shpenzime për blerje ose shërbime, realizimi faktik i të cilave ndodh në vitin e ardhshëm, pagesa të kryera në avancë. Po kjo vlerë në shumën 55,991,568 lekë është paraqitur në pasiv të bilancit kontabël llogaritë 401-408 të cilat përfaqësojnë detyrimet e institucionit ndaj furnitorëve për fatura të pa likuiduara dhe që si kundërparti në aktiv të bilancit duhet të kenë llogarinë “Operacione më shtetin debitor” (*trajtuar më hollësisht në faqet nr. 6-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi: Ministria e Kulturës, Nëpunësi Zbatues të marrë masa për kryerjen e sistemimit kontabël, pasqyrimin e drejtë të kundërpartisë së llogarisë pasive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në aktiv të bilancit kontabël.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2016, u konstatua se, vlera prej 1,090,851 lekë si pakësim i AQT nga nxjerrjet jashtë përdorimi është përfshirë dy herë në pasqyrën nr. 8 “Lëvizja e fondeve”, njëherë llog. 1015 në shumën 1,090,851 dhe njëherë si pjesë e llog. 1016 në shumën 40,529,437 lekë e cila është e përbërë nga “pakësime të tjera” në 39,438,586 lekë dhe “pakësim nga nxjerrje jashtë përdorimi” në shumën 1,090,851 lekë (*trajtuar më hollësisht në faqet nr. 6-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi: Ministria e Kulturës, Nëpunësi Zbatues të marrë masa për kryerjen e sistemimit kontabël, pasqyrimin e drejtë Aktiveve të Qëndrueshme të trupëzuara (AQT) në pasqyrën nr. 8 “Pasqyra e lëvizjes së fondeve”.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i disa praktikave mbi transferimin e fondeve buxhetore gjatë viteve objekt auditimi ka rezultuar se kërkesat për rishpërndarje të fondeve buxhetore (shpenzime korente) jo në të gjitha rastet janë shoqëruar me analiza. Gjithashtu, kjo mangësi është evidentuar edhe përse i përket rishpërndarjes së fondeve në nivel projekti ku është konstatuar se: rialokimet e fondeve buxhetore gjatë vitit për një projekt, kanë pësuar ndryshime (shtesa e pakësime), të pa argumentuara (*trajtuar më hollësisht në faqet nr. 96-109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi: Ministria e Kulturës, si njësi e qeverisjes së përgjithshme, të rrisë kërkesën për llogaridhënie, deri në mosmiratim të kërkesave për rishpërndarje fondesh të njëjësive shpenzuese të varësisë, nëse këto të fundit nuk paraqesin analizë të detajuar, ku të argumentojnë nevojën për shtim fondesh, si dhe arsyet e mos planifikimit në masën e duhur, duke nxjerrë dhe përgjegjësitë, me qëllim minimizimin e numrit të rishpërndarjes të fondeve gjatë vitit buxhetor.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e buxhetit të Ministrisë së Kulturës, është evidentuar fenomeni i përqendrimit të likuidimit të shpenzimeve në fund të vitit buxhetor (nëntor-dhjetor), ku në vitin 2015 likuidimet në fund-vitit zënë 34.5 % të shpenzimeve vjetore, në vitin 2016 zënë 39.3 % të shpenzimeve vjetore dhe në vitin 2017 zënë 40 % të shpenzimeve vjetore. Ky trend, i cili shoqërohet me ndryshim të herëpashershëm të planit të arkës, tregon për një performancë të ulët të zbatimit të buxhetit (*trajtuar më hollësisht në faqet nr. 106-109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi: Ministria e Kulturës, si njësi e qeverisjes së përgjithshme të marrë masa për realizimin e procedurave të investimeve, për realizimin faktik të kontratave të punimeve, shërbimeve apo mallrave, si dhe për likuidimin e tyre në mënyrë periodike, brenda limitit mujor të arkës, si nga ana e saj edhe e njërive shpenzuese që ka në varësi, me qëllim realizimin dhe likuidimin e tyre në kohë, minimizimin e ndryshimit të limitit të arkës gjatë vitit buxhetor, me qëllim rritjen e performancës buxhetore të saj.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2016 – 2017 Ministria e Kulturës dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri” kanë shqyrtuar/miratur projektzbatimin “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Multifunkionale të Shërbimeve në Qytetin Antik të Butrintit”, mbështetur në “Propozim të pakërkuar” të bërë nga subjekti “H” sh.p.k. për marrjen me qira të një objekti ndërtimi, magazinë (e cila nuk është monument kulture), pranë Qytetit Antik të Butrintit me qëllim vënien e saj në shfrytëzim për aktivitet tregtar bar - kafe- restorant. Vendndodhja e këtij objekti është në Parkun Kombëtar të Butrintit (PKB), në nënzonën “A”, në të cilën zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes.

Në përgjithësi arsyetimi për miratimin e projektzbatimit “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Multifunkionale të Shërbimeve në Qytetin Antik të Butrintit”, bie ndesh me:

Ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”:

- nenin 30 në të cilin ndër të tjera është përcaktuar se ... *Zonat arkeologjike, në varësi të intensitetit dhe rëndësisë së gjetjeve arkeologjike, kategorizohen në zona “A” dhe zona “B”. Zonifikimi miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Në zonat arkeologjike “A” është e ndaluar çdo lloj ndërhyrjeje me karakter ndërtimor.*

- nenin 38 në të cilin është përcaktuar se ... *Çdo vendim i marre nga këshillat e rregullimit të territoreve për ndërhyrje ose ndërtim në zonat e shpallura monument kulture ose në zonën e mbrojtur pranë një monumenti kulture, pavarësisht nga pronësia, është i pavlefshëm.*

- VKM nr. 693, datë 10.11.2005 “Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit “Park Kombëtar” i ndryshuar me VKM nr. 134, datë 20.12.2013, në të cilin ndër të tjera është përcaktuar se ... *Nënzona qendrore e shënuar në hartë me shkronjën “A” me sipërfaqe prej 3,980 ha, që përcaktohen si nënzona me vlera të mëdha për natyrën dhe biodiversitetin. Në këtë zonë zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes ... etj.*

- Kombinimin e përcaktimeve të bëra midis nenit 4, pika 1, shkronja “b”, neni 5, 6 ... të ligjit 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura” i ndryshuar, VKM nr. 693, datë 10.11.2005 “Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit “Park Kombëtar” ndryshuar me VKM nr. 134, datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

20.12.2013 sipas të cilit ... në PKB nënzona qendrore (në të cilin ndodhet dhe objekti) zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes ... janë të ndaluara ndërtime të çdo lloji ... etj.

Referuar Ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, ndërtimi “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Multifunksionale të Shërbimeve në Qytetin Antik të Butrintit”, nuk përbën trashëgimi kulturore etj, në kuptim të Ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, për rrjedhojë, Ministria e Kulturës (më parë IMT dhe KKR), duhet ta refuzonin kërkesën e subjektit “H” sh.p.k.

Rekomandimi: Ministria e Kulturës të kërkojë/anulojë kontratën e enfileozës nr. 360, datë 2.6.2017 me objekt “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Multifunksionale të Shërbimeve në Parkun Kombëtar të Butrintit” lidhur me subjektin “H” sh.p.k. me argumentet e paraqitur hollësisht në Projekt Raportin e Auditimit. Me realizimin e anulimit të kontratës marrin përgjigje, gjejnë zgjidhje dhe pasaktësi të tjera të evidentuara/trajtuar më hollësisht në Projekt Raportin e Auditimit.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI⁷

Dëmi ekonomik i shkaktuar është **2,633,039 lekë** gjithsej, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në sistemin elektronik të APP të tenderit me objekt “Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor” me fond limit 998,862,862 lekë i zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se në preventivin e punimeve është përfshirë si zë punimi (më vete) “Punime për ngritje kantjeri”. Në preventivin e bashkimit të operatorëve ekonomikë (BOE) “E” sh.p.k. & “A” sh.p.k. fitues, punimet për ngritje kantieri janë paraqitur me vlerë 1,841,942 lekë, ose 1,934,039 lekë gjithsej (1,841,942 lekë x 1.05 fondi rezervë). Në preventiv/situacion (ndarja e punimeve) ky punim është parashikuar/realizuar nga OE “E” sh.p.k.

Përfshirja si zëra punimi me vete në preventiv/situacion i sa më sipër është në kundërshtim me germën B/3 të “Shpenzimet e përgjithshme dhe fitimi” të UKM nr. 2, datë 8.5.2003 në të cilën është përcaktuar se në shpenzimet e përgjithshme përfshihen Shpenzimet për masat e sigurimit teknik, rrethimet e përkohshme gjatë ndërtimit në lartësi, skelat, makineritë, tabelat sinjalizuese etj. Nën këtë arsyetim vlera prej 1,934,039 lekë gjithsej përbën dëm ekonomik, e cila është përfituar padrejtësisht nga OE “E” sh.p.k. (trajtuar më hollësisht nr. 36-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi: Të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **1,934,039 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, përfituar nga OE “E” sh.p.k.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në sistemin elektronik të APP të tenderit me objekt “Rikonstruksioni i Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijët/Teatri i Kukullave dhe Qendrës Kombëtare të Veprimtarive të Folklorit”, me fond limit 47,835,830 lekë i zhvilluar në vitin 2015 me OE fitues “B” sh.p.k., u konstatua se në preventivin e punimeve të objektit janë përfshirë dhe zërat e punimeve “Rrethim i përkohshëm” me vlerë 120,000 lekë dhe “Rrethim rruge me rrjetë teli” me vlerë 20,000 lekë, ose 147,000 lekë

⁷ Në këtë vlerë, nuk është përfshirë rezultati për “projektet kulturore dhe artistike”



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

gjithsej (përfshirë dhe fondin rezervë përkatës në masën 5 për qind), në kundërshtim me pikën 3 të germës B “Shpenzimet e përgjithshme” të UKM nr. 2, datë 5.2.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostot së punimeve të ndërtimit” në të cilën është përcaktuar se ... Në shpenzimet e përgjithshme përfshihen ... Shpenzimet për masat e sigurimit teknik, rrethimet e përkohshme gjatë ndërtimit në lartësi, skelat, makineritë, tabelat sinjalizuese etj., për mbrojtjen në punë si trajtimi me veshmbathje, ushqime, antidot, ndihmë e shpejtë etj, e cila nën këtë arsyezim përbën dëm ekonomik (trajtuar në faqe nr. 64-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi: Të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **147,000 lekë gjithsej**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, përfituar nga OE “B” sh.p.k.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me emërtim “Blerje pajisje të teknologjisë dhe informacionit dhe pajisje të tjera për strukturat e Vettingut”, për mbikëqyrjen e punimeve është lidhur kontratë me vlerë kontrate 552,000 lekë me subjektin “A” sh.p.k.

Sipas AK, ky veprim është i mbështetur në UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për Mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.

Sa më sipër është në kundërshtim me UKM nr. 3, datë 15.02.2001 i ndryshuar, pasi ky udhëzim parashikon mbikëqyrje, për kontratat e zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe jo për blerje mallra etj, të kësaj natyre (trajtuar më hollësisht nr. 79-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi: Të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **552,000 lekë gjithsej**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, përfituar padrejtësisht nga OE “A”shpk.

Menjëherë

D. MBI PËRDORIMIN PA EFEKTIVITET, EFICENSË DHE EKONOMICITET TË FONDEVE PUBLIKE

Ministria e Kulturës, në vitin 2016 ka zhvilluar tenderin me objekt “Rikonstruksioni i TOB...”.

Në këtë procedurë tenderimi, kanë marrë pjesë tre OE me të dhëna si më poshtë:

Nr	Operatorët ekonomikë	Njësia e matjes	Ofertat ekonomike		Kualifikuar/skualifikuar
			Pa TVSh	Me TVSh	
1	BOE ”A & C & ”	000 L	846,326,626		skualifikuar
2	BOE ”E” & ”A” sh.	”	926,754,355		fitues
3	OE ”A” sh.p.k.	”	965,902,760		kualifikuar

Për mangësi/parregullsi në dokumentacionin ligjor kualifikues, autoriteti kontraktor ka skualifikuar me të drejtë BOE “A & C & ...” sh.p.k.

Autoriteti kontraktor, ka kualifikuar e në vijim ka shpallur fitues BOE “E” sh.p.k. & ”A” sh.p.k. me vlerë të ofertës ekonomike 926,754,355 lekë pa TVSH.

Nga verifikimi i dokumentacionit ligjor dhe kualifikues të BOE “E” sh.p.k. & ”A” sh.p.k. u konstatuan mangësi/parregullsi për të cilat autoriteti kontraktor, duhet të kishte skualifikuar këtë BOE.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Në kushtet që autoriteti kontraktor, nuk e ka skualifikuar BOE "E" sh.p.k. & "A" sh.p.k, atëherë duke ruajtur të njëjtin standard, do të ishte më e arsyeshme që autoriteti kontraktor të kualifikonte dhe shpallte fitues BOE "A& C & ..." sh.p.k. me ofertë 846,326,626 lekë, ose 80,427,729 lekë më pak se sa oferta ekonomike e BOE "E" sh.p.k. & "A" sh.p.k. e cila nën arsyetimin e mësipërm përbën përdorim pa efektivitet, eficensë dhe ekonomikitet të fondeve publike (*trajtuar më hollësisht nr. 35-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

IV. Konkluzione dhe opinioni i auditimit.

OPINIONI AUDITUESIT:

Baza për opinionin mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë (*ISSAI 4000*⁸) e veprimtarisë së Ministrisë së Kulturës, Tiranë.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti Ministria e Kulturës, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (*kriteret*), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur nuk janë materiale, të cilat konsistojnë si më poshtë:

1. Mbi auditimin e pasqyrave financiare.

Paraqitja e pasqyrave financiare është në përputhje me kriteret e paracaktuara (kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi) në të gjitha aspektet materiale, si dhe informacioni i paraqitur është i vërtetë dhe i drejtë, me përjashtim të dy rasteve të kontabilizimit të gabuar; të pakësimit të AQT- në shumën 1,090,851 lekë dhe pasqyrimit të llogarisë "Furnitorë e llogari të lidhura me to", në shumën 55,991,568 lekë.

2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit.

Planifikimi, detajimi dhe zbatimi i buxhetit, është në përputhje me kriteret e paracaktuara (kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi) në të gjitha aspektet materiale, si dhe informacioni i paraqitur është i vërtetë dhe i drejtë, *përveç rasteve të mëposhtme:*

- Kërkesat për rishpërndarje fondesh, jo në të gjitha rastet janë shoqëruar me analizë, ku të identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme, risqet e lidhura, pakësimet e mundshme dhe pasojat, në përputhje me kriteret e paracaktuara në udhëzimin e MF nr. 2, datë 06.02.2012 me ndryshime;

- Është kryer një numër i lartë rishpërndarje fondesh gjatë vitit ushtrimor, që prekin të gjithë zërat e buxhetit, por që grupi i auditimit mori në analizë transferimet e fondeve për investime, ku u konstatua se rishpërndarja e tyre gjatë vitit ka ndikuar negativisht në realizimin e planit të buxhetit dhe të vetë projekteve. Kjo tregon gjithashtu, për një performancë jo të mirë të planifikimit të buxhetit, referuar kriterëve të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 2, datë 06.02.2012.

- Nga auditimi është evidentuar fenomeni i përqendrimit të likuidimit të shpenzimeve në fund të vitit buxhetor, gjë e cila shoqërohet me ndryshim të herëpashershëm të planit të

⁸ *ISSAI 4000* – Objektiv i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

arkës, që është një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit”.

Opinion:

*Nga auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 4000, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së, i kryer në subjektin Ministria e Kulturës, Tiranë, nuk u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësishme materiale për të cilën japim **opinion të pakualifikuar**⁹.*

3. Për auditimin me objekt “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Multifunkionale të Shërbimeve në Qytetin Antik të Butrintit”:

Ministria e Kulturës ka shqyrtuar/miratuar projektzbatimin “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Multifunkionale të Shërbimeve në Qytetin Antik të Butrintit”, mbështetur kryesisht në Udhëzimin nr. 5110, datë 13.10.2015 “Për dhënien me qira dhe mënyrën e administrimit të monumenteve të kulturës me qëllim rijetëzimi” i ndryshuar, në përgjigje të një “Propozim të pakërkuar” të bërë nga subjekti “H” sh.p.k. për marrjen me qira të një objekti ndërtimi, magazinë (e cila nuk është monument kulture), pranë Qytetit Antik të Butrintit me qëllim vënien e saj në shfrytëzim për aktivitet tregtar bar - kafe- restorant. Vendndodhja e këtij objekti është në Parkun Kombëtar të Butrintit (PKB), në nënzonën “A”, në të cilën zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes.

Nga verifikimi ligjshmërisë mbi të cilin ka operuar Ministria e Kulturës në miratimin e këtij projekti, rezulton se nxjerrja nga Ministria e Kulturës të Udhëzimit nr. 5110, datë 13.10.2015 “Për dhënien me qira dhe mënyrën e administrimit të monumenteve të kulturës me qëllim rijetëzimi” i ndryshuar, është bërë pa pasur autorizim nga Ligji nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, për të rregulluar dhe plotësuar procedurën e dhënies me qira/enfiteozë si dhe mënyrën e administrimit të monumenteve të kulturës, si i tillë, nuk ka asnjë fuqi juridike.

Opinion:

*Nga auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 4000, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së, i kryer në subjektin Ministria e Kulturës, Tiranë u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale të shkaktuara nga interpretimi i gabuar i dispozitave ligjore, për të cilën japim **opinion të kualifikuar**¹⁰.*

⁹ Një ***opinion i pakualifikuar*** (pa rezervë) jepet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se: a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi; b) pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse; c) situata e paraqitur nga pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e audituesit mbi njësinë publike të audituar dhe d) janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare.

¹⁰ ***Opinion i kualifikuar***. Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

Audituesit shtetëror të KLSH-së

Fatmir ZILJA

Miranda HAXHIA

Brunilda ZENELI

Alkida LLAKAJ

Erjola MEÇAJ

Drejtori Departamentit

Bashkim ARIZAJ

Tabela e Shkurtimeve

përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës

Nr.	Shkurtimi	Emërtimi i Plotë
1.	KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
2	KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
3	M K	Ministria e Kulturës
4	AK	Autoriteti kontraktor
5	KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
6	KKR	Këshilli Kombëtar i Restaurimeve
7	VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
8	INSTAT	Instituti i Statistikës
9	DST	Dokumente Standarde të Tenderit
10	APP	Agjencia e Prokurimit Publik
11	LPP	Legjislacioni i Prokurimit Publik
12	OE	Operator ekonomik
13	BOE	Bashkim i operatorëve ekonomikë
14	PKB	Parku Kombëtar Butrint